

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

UNMIK

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T I
I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 30. 7. 2007

T R A N S K R I P T
SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA
ODRŽANE 30. 07. 2007. GODINE

KORRIK – JULI 2007

RENDI I DITËS

1. Debat për procesin politik lidhur me vazhdimin e zgjidhjes së statusit të Kosovës

DNEVNI RED

1. Rasprava o političkom procesu u vezi odlaganja rešavajna statusa Kosova

AGENDA

1. Debate regarding the political process of the postponement of the solution of the Status of Kosova

KRYETARI KOLË BERISHA – Propozoj që të fillojmë punën. Në sallë janë aktualisht 81 deputetë.

I nderuari President Sejdiu,

I nderuari Kryeministër dhe anëtar i Ekipit Negociator, zoti Çeku,

Të nderuar anëtarë të Ekipit të Unitetit, kryetarë partish dhe deputetë të Parlamentit të Kosovës, zoti Thaqi dhe Surroi,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë, zonja dhe zotërinj.

E hapi seancën plenare të Kuvendit të Kosovës me të vetmen pikë të rendit të ditës:

Debat për procesin politik lidhur me vazhdimin e zgjidhjes së statusit të Kosovës

Më lejoni t'ju njoftoj se në mbledhjen e 12 korrikut, të përbashkët me Kryesinë e Kuvendit dhe me shefat e grupeve parlamentare, pos tjerash është shqyrtuar edhe kërkesa e Grupit Parlamentar të PDK-së dhe ajo e Përfaqësuesit të LPK-së dhe është vendosur që të dy këto kërkesa të hyjnë si një pikë e rendit të ditës në seancën plenare të 12 korrikut

2007, por me kusht që paraprakisht të mbahet një mbledhje e përbashkët me Kryesinë e Kuvendit dhe me Ekipin e Unitetit.

Po atë ditë, nga Aeroporti i Prishtinës, Skender Hyseni, duke udhëtuar së bashku me Presidentin e Kosovës dhe me anëtarin e Ekipit Negociator, zotin Thaqi, më marrin në telefon dhe më pyesin për rrjedhat e asaj mbledhjeje të Kryesisë dhe, natyrisht, i njoftoj se Kryesia ka marrë vendim që për seancën e 12 korrikut të mbahet një mbledhje e përbashkët e Grupit të Unitetit bashkë me Kryesinë e Kuvendit. Për shkak të vizitave të njëpasnjëshme të Presidentit të Kosovës bashkë me anëtarët e Grupit të Unitetit, së pari me zotin Thaqi, e pastaj edhe me Kryeministrin Çeku, takimi nuk ka mund të mbahet ashtu siç ka qenë i planifikuar.

Kuvendi i Kosovës, përkatësisht shefi i Grupit Parlamentar i PDK-së dhe përfaqësuesi i LPK-së, në seancën e 12 korrikut kanë qenë këmbëngulës që kjo pikë e rendit të ditës të shqyrtohet menjëherë dhe të merret një qëndrim lidhur me situatën e krijuar në Kosovë pas shtyrjeve të fundit të afatit për zgjidhjen e statusit të Kosovës.

Kërkesat e lartshënuara janë përkrahur edhe nga një grup deputetësh.

Kam sqaruar se ky është vendim i Kryesisë dhe unë nuk jam kompetent për ta konvokuar mbledhjen e Grupit të Unitetit e as ta caktoj datën për këtë.

Në seancë ndërkohë është paraqitur nevoja që për një defekt elektronik të merret një pauzë prej 15 minutash, me ç'rast i kam ftuar shefat e grupeve parlamentare dhe anëtarët e Kryesisë dhe kemi biseduar për këtë çështje. Ka ardhur një propozim unanim që seanca të vazhdojë me pika të tjera të rendit të ditës, por me kusht që posa të kthehen Presidenti Sejdiu bashkë me anëtarët e tjerë të Ekipit të Unitetit nga vizitat jashtë, të bisedohet ose të konvokohet seanca plenare për këtë çështje. Me të arritur të Presidentit Sejdiu nga jashtë, ditën e enjte shumë vonë, të premten në mëngjes jam takuar me te dhe ia kam përcjellë kërkesën e Kuvendit, të cilën ai e ka pranuar pa hezitim, por edhe për shkak të vizitës së Kushnerit atë ditë në Prishtinë, ishte ditë e premte, nuk ka mund të mbahet seanca. Është caktuar mbledhja e Ekipit Negociator për datën 16 në orën 10,00, dhe ajo është mbajtur.

Ftoj Presidentin e Kosovës, zotin Sejdiu ta marrë fjalën.

PRESIDENTI FATMIR SEJDIU – I nderuari Kryetar i Kuvendit, zoti Berisha,

Të nderuar anëtarë të Ekipit të Unitetit,

I nderuari zoti Kryeministër dhe ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në emër të Ekipit të Unitetit t'ju njoftoj shkurtimisht me zhvillimet kryesore që kanë të bëjnë me përcaktimin e statusit politik të Kosovës si dhe me kahet kryesore që do t'i përcjellim bashkërisht për ta përfunduar sa më shpejt këtë proces të rëndësishëm dhe jetik për Kosovën.

Nga marsi i këtij viti, kur Kuvendi i Kosovës mbështeti propozimin gjithëpërfshirës të presidentit Ahtisari, duke dhënë njëkohësisht zotimin e vet për zbatimin e tij në Kosovën e pavarur, janë bërë zhvillime të shumta politike në skenën ndërkombëtare të cilat veçanërisht kanë qenë të fokusuara lidhur me këtë propozim në Këshillin e Sigurimit të

Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Po kështu, trajtimi i tij është bërë duke siguruar mbështetje edhe në nivelet e Bashkimit Evropian dhe në institucionet e tjera evropiane.

Duhet theksuar se ky propozim të cilin e kemi cilësuar si dokument i balancuar dhe i kompromiseve të mëdha që ka bërë Kosova, është rezultat i një procesi të gjatë dhe të mundimshëm ndërkombëtar të udhëhequr përmes negociatave nga ana e Presidentit Ahtisari dhe ekipit të tij dhe që është mbështetur gjatë gjithë kohës nga vendet anëtare të Grupit të Kontaktit. I proceduar si i tillë në Këshillin e Sigurimit, krahas mbështetjes që ka marrë nga Bashkimi Evropian dhe mekanizmat e tjerë evropian, ky dokument që nga momenti i procedimit në Këshillin e Sigurimit ka marrë edhe mbështetjen e Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, zotit Ban Ki Mun dhe të shumicës së vendeve anëtare të Këshillit të Sigurimit. Për fat të keq, përkundër përpjekjeve të vazhdueshme dhe jashtëzakonisht intensive të shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të vendeve anëtare të Këshillit të Sigurimit nga Bashkimi Evropian që nëpërmjet rezolutave të bashkësponzoruara nga ato të përmbyllin këtë proces me miratimin e një rezolute të re që do ta mbështeste këtë propozim dhe njëkohësisht do ta hiqte nga fuqia Rezolutën 1244, për shkak të bllokimit të vazhdueshëm me kërcënime me veto nga ana e Federatës Ruse, pas pesë projektrezolutave nuk u hodh në votim një tekst përfundimtar.

Ekipi i Unitetit, duke përcjellë me vëmendje gjithë këto zhvillime dhe duke shprehur shqetësimin e vet të institucioneve dhe të popullit të Kosovës për këto pengesa të pajustificueshme, gjatë gjithë këtyre muajve ka zhvilluar një aktivitet të gjerë e të gjithanshëm diplomatik me qëllim të argumentimit dhe të sigurimit të mbështetjes tek të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Sigurimit për pavarësinë e Kosovës. Sado që në fillim vizita e paralajmëruar e anëtarëve të Këshillit të Sigurimit në Kosovë është vështruar me qasje të ndryshme, në të shumtën edhe si një mundësi për të shtyrë procesin, kjo vizitë, përkundrazi, ka nxjerrë në sipërfaqe realitetin e ndërtuar pozitiv në Kosovë, vizionin e saj politik për të ardhmen e gjithë qytetarëve të saj, të shumicës dhe të pakicave, gatishmërinë e institucioneve dhe të popullit të Kosovës për të funksionuar si shtet sovran dhe i pavarur, por edhe paqëndrueshmërinë e status quos si pengesë themelore për zhvillimin dhe prosperitetin e përgjithshëm demokratik dhe ekonomik të Kosovës dhe të perspektivës të qytetarëve të saj.

Me këtë rast duhet theksuar se qëndrimi pozitiv për Kosovën dhe për mbështetjen e propozimit të Presidentit Ahtisari kanë mbizotëruar tek shumica dërmuese e vendeve anëtare të Këshillit të Sigurimit, pra edhe tek ato vende që fillimisht kanë pasur hezitime. Përgjashtim është Federata Ruse që ende vazhdon me qasjen e saj të ditur.

Ekipi i Unitetit gjatë kësaj periudhe dhe, në veçanti pas propozimit të Presidentit francez Sarkozy në Samitin G8, i cili mbështeti idenë e vazhdimit të procesit me angazhimet e reja të palëve edhe për 120 ditë, duke theksuar automatizmin e hyrjes në fuqi të propozimit të Ahtisarit dhe që, si i tillë, në variante të ndryshme është propozuar në projektrezolutat e Këshillit të Sigurimit, ka intensifikuar aktivitetin e tij sidomos në kontaktimin e vendeve anëtare të Këshillit të Sigurimit nga Bashkimi Evropian si dhe me zyrtarët më të lartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Duke pasur parasysh qëndrimin e qartë të shteteve të Bashkuara të Amerikës, i thënë edhe nga niveli më i lartë shtetëror nga Presidenti George W. Bush gjatë qëndrimit të tij në Romë, Tiranë dhe Sofje, si dhe qëndrimet e vendeve kyçe të Bashkimit Evropian në mbështetje të propozimit të Ahtisari për pavarësinë e mbikëqyrur për Kosovës, Ekipi i Unitetit ka marrë po kështu garancione në vazhdim për këtë mbështetje nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Komisioneri për Politikë të Jashtme i Bashkimit Evropian, zoti Solana dhe nga vendet kyçe të Bashkimit Evropian veç e veç.

Në të njëjtën kohë, duke parashikuar paperspektivën e kapërcimit të një rezolute që do të mbështeste propozimin e Ahtisarit në Këshillin e Sigurimit, këta faktorë kanë propozuar qasjen alternative në një proces të ri të angazhimeve për të siguruar mbështetjen e propozimit të Ahtisarit dhe njohjen e koordinuar të pavarësisë së Kosovës pas një angazhimi shtesë prej 120 ditësh.

Ekipi i Unitetit, duke i analizuar në thellësi të gjitha këto zhvillime dhe duke pasur respektin e thellë për qasjen serioze që kanë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet kyçe të Bashkimit Evropian, e sidomos pas kontakteve të kohëve të fundit edhe me Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, zotin Ban Ki Mun, Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, zotin Jap De Hop Skefer, zotin Solana, zotin Baroso nga Bashkimi Evropian, ministrat e jashtëm të Italisë, të Gjermanisë, të Francës dhe të Portugalisë, e cila tani ka presidencën e Bashkimit Evropian, sigurimet e vazhdueshme për mbështetjen nga Britania e Madhe si dhe bisedat e zhvilluara të Ekipit me Sekretarin e Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zonjën Kondoliza Rajs, nënsekretarin Nikolas Berns, ndihmësekretarin Daniel Frid, drejtorin politik për Evropën Juglindore Rozmari di Karlo, emisarin special-ambasadorin Frank Wisner dhe këshilltarin për Siguri Nacionale Stiven Hedli, ka shprehur gatishmërinë e tij që të kontribuojnë në këtë proces të ri të angazhimeve, pra në këtë qasje alternative për të përmbyllur procesin e pavarësimit të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Duke përcjellë me vëmendje vështirësitë që i ka hasur ky proces gjatë kësaj periudhe, Ekipi i Unitetit ka dhënë vizionin e tij të qartë se rruga më e mirë do të ishte nxjerrja e një rezolute që do të kishte mbështetje në Këshillin e Sigurimit. Por, nëse ky proces do të shkojë drejt bllokimit dhe zhagjitjes së tij, kemi theksuar prerazi se Kosova nuk mund të mbetet peng i vazhdueshëm i bllokadave që pengojnë përfundimin e mbarë të këtij procesi. Prandaj, duhet kërkuar rrugë alternative që nënkupton edhe këtë përpjekje të vendeve që e kanë mbështetur dhe mbështesin fuqimisht projektin e Ahtisarit dhe vizionin tonë politik për të ardhmen tonë e Kosovës, e po kështu edhe marrjen e vendimeve kyçe nga ana e institucioneve të Kosovës, përkatësisht nga ana e Kuvendit të Kosovës.

Duke pasur parasysh Rezolutën e Kuvendit të Kosovës lidhur me procesin e definimit të statusit politik të Kosovës, përkatësisht pavarësimin e saj, të majit 2005, duhet theksuar në veçanti:

1. Në këtë proces të angazhimeve shtesë në nivelin e Grupit të Kontaktit, përkatësisht në formatin që duhet saktësohet këto ditë, Kosova ua ka bërë me dije të gjithë faktorëve relevantë ndërkombëtarë, dhe këtë e ritheksojmë edhe tani, se pavarësia e Kosovës është e panegociueshme

2. Integriteti territorial dhe funksional i Kosovës është i pacenueshëm. Kosova është unike dhe e pandarë.

3. Propozimi i gjithëpërfshirës i Presidentit Ahtisari konsiderohet dokument i përfunduar dhe i mbyllur për ne dhe si i tillë nuk mund të hapet e as nuk mund të negociohet. Këtë dokument jemi zotuar se do ta zbatojmë në plotësi.

4. Delegacioni i Kosovës, përkatësisht Ekipi i Unitetit mendon se gjatë kësaj periudhe, në konsultim me përfaqësuesit e Bashkësisë Ndërkombëtare do të japë kontributin e vet maksimal në trajtimin e aspekteve të veçanta të temave që kanë të bëjnë me relacionet e ardhshme të Kosovës dhe të Serbisë si shtete të pavarura. Këto tema mund të jenë, bie fjala, përfundimi i procesit që ka të bëjë me kthimin e të pagjeturve dhe ndriçimin e fatit të tyre, çështjet e të drejtave të pensionistëve dhe të realizimit të tyre nga ana shtetasve të njërit vend dhe vendit tjetër, çështjet që kanë të bëjnë me suksesione, çështjet që kanë të bëjnë me lirinë e lëvizjes dhe liberalizimin e kufijve, krijimi i mundësive për kthim të qëndrueshëm të qytetarëve të Kosovës që gjenden në Serbi dhe në vendet e tjera dhe të ngjashme.

5. Ekipi i Unitetit konsideron se kjo do të jetë vonesa e fundit në këtë proces dhe se nuk mund të pranojë shtyrje të tjera të afateve, të cilat, si të tilla, sjellin me vete rreziqe të veçanta, jo vetëm në komprometimin e procesit, por edhe në ngritjen e shqetësimeve dhe të tensioneve me pasoja të paparashikueshme.

6. Ekipi i Unitetit zotohet se gjithë këtë proces në vijim deri në përfundimin e tij, duke llogaritur edhe marrjen e vendimeve të rëndësishme në Kuvendin e Kosovës, pra shpalljen e pavarësisë së Kosovës, do ta bëjë në partneritet dhe bashkëpunim të ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me Bashkimin Evropian.

7. Ekipi i Unitetit, gjatë kësaj kohe, me institucionet e tjera të Kosovës do të angazhohet për përgatitjen e Kosovës me gjithë strukturën kushtetuese dhe legjislative dhe institucionale për të lehtësuar kështu edhe rrugën tonë si shtet i pavarur dhe sovran drejt integritit në Bashkimin Evropian, në mekanizmat dhe organizatat ndërkombëtare dhe në NATO. Prandaj, besojmë se ky afat kohor prej 120 ditësh do të përfundojë pa asnjë shtyrje. Ju faleminderit për mbështetjen e gjithmonshme, të nderuar deputetë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, President! Fjalën e ka Kryeministri Çeku.

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU –
I nderuari zoti President i Kosovës,

I nderuari zoti Kryetar i Kuvendit,
Të nderuar kolegë të Grupit të Unitetit
Të nderuar deputetë, ministra,
Zonja dhe zotërinj,

Të gjithë kemi besuar se në seancat e këtij Kuvendit gjatë muajit korrik do të merremi me implementimin e pakos së Ahtisarit, do të merremi me miratimin e ligjeve që dalin nga pakoja e Ahtisarit dhe askush nga ne nuk ka pritur që tani, në fund të korrikut, në këtë Kuvend të debatojmë për procesin e definimit të statusit apo për shtyrjen që tanimë po ndodh. Pak kush nga ne ka besuar që Rusia do të jetë aq kundërshtuese ndaj njohjes së realitetit të ri të krijuar në Kosovë, ndaj njohjes së vullnetit të më shumë se 2 milionë qytetarëve të Kosovës për pavarësi dhe ndaj njohjes së vullnetit të shumicës dërmuese të Bashkësisë Ndërkombëtare për njohjen e këtij realiteti, për njohjen e pavarësisë apo mbështetjen e pakos së Ahtisarit.

Është e vërtetë se gjatë vitit të kaluar shpeshherë kemi përmendur periudha kohore kur presim të ndodhë pavarësia. Këtë e kemi bërë duke qenë të sigurt në përkushtimin e madh të miqve, të partnerëve tanë, duke parë sigurimin dhe përkushtimin e tyre për pavarësi dhe ne e kemi thënë këtë edhe pse na është thënë. Kështu, të gjithë që kemi qenë të përfshirë në këtë proces kemi pritur, kemi punuar që ky proces të përfundojë shumë më herët sesa që do të përfundojë tani. Pra, procesi i realizimit të pavarësisë së Kosovës përmes Këshillit të Sigurimit, që do të ishte zgjidhja më e mirë të cilën e kemi dëshiruar, e kemi preferuar, fatkeqësisht ka dështuar. Por, kjo nuk duhet të na dekurajojë. Përkundrazi, duhet të na bëjë edhe më të vendosur, edhe më këmbëngulës të gjejmë zgjidhje të shpejtë dhe të drejtë në partneritet të plotë me miqtë tanë ndërkombëtarë, në radhë të parë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Unionin Evropian. Nuk duhet të na dekurajojë, sepse jemi dëshmitarë që Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Unioni Evropian apo Bashkësia Ndërkombëtare nuk i ka ndalur përpjekjet për gjetjen e një zgjidhjeje të shpejtë, është duke punuar me një dinamikë të shtuar dhe është duke e vazhduar procesin. Është duke gjetur mënyra të reja për ta finalizuar procesin e pavarësimit të vendit tonë.

Me gjithë dështimin në miratimin e Rezolutës në Këshillin e Sigurimit ne duhet ta ruajmë besimin te Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Unioni Evropian dhe duhet të jemi të vetëdijshëm se pavarësia e Kosovës mund të ndodhë vetëm me bekimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Unionit Evropian apo së paku të një numri të konsiderueshëm të vendeve të Unionit Evropian. Nuk ka dyshim se Uashingtoni ka qenë dhe mbetet motori dhe lokomotiva që e ka shtyrë përpara këtë proces, procesin e njohjes ndërkombëtare të pavarësisë. Një mbështetje të tillë e kemi marrë edhe gjatë takimit të fundit të Grupit të Unitetit me Sekretaren e Shtetit Rajs. Në këtë takim Sekretarja Rajs edhe njëherë theksoi mbështetjen e rezervë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për pavarësinë e vendit tonë dhe për mbështetjen për një kohë shumë të gjatë edhe pas pavarësisë. Në këtë takim, gjithashtu, u krijuan edhe më shumë qartësi dhe e kemi edhe më të qartë rrugën e ecjes përpara, por jo tërësisht të qartë dhe jo një qartësi të tërësishme të cilën e kemi kërkuar.

Në këtë takim ne i kemi bërë shumë të qarta qëndrimet tona. Treguam se Kosova është e gatshme për pavarësi, treguam se Kosova është e gatshme t'i përballojë të gjitha sfidat e pavarësisë, t'i marrë të gjitha përgjegjësitë e pavarësisë, që populli i Kosovës është në pritje të vazhdueshme dhe kjo pritje ka kufi. Po ashtu ua kemi bërë të qarta të gjitha ato që i tha edhe Presidenti që nuk ka nevojë për negociata dhe nuk ka mbetur asgjë për të negociuar. Por, ne do t'i mbështesim dhe, duke ruajtur partneritetin e Bashkësisë Ndërkombëtare, do ta mbështesim kërkesën, ashtu si e quajnë, të angazhimit intensiv, të kësaj periudhe të angazhimit intensiv prej 120 ditësh, por duke qenë shumë të qarta se pavarësia, pakoja e Ahtisarit dhe tërësia e territoriale e Kosovës nuk janë tema për diskutim.

Ne kemi kërkuar njohjen e pavarësisë brenda këtij viti. Kemi shprehur gatishmërinë dhe kemi kërkuar që, nëse kjo nuk ndodh, të na jepet liria që ne vetë të marrim vendime dhe vendimet të mbështeten nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. E shoh të arsyeshme të jap disa sqarime këtu. Në takimet tona të Grupit të Unitetit, kur kemi hartuar platforma, qasje se çfarë janë kërkesat tona që i kemi në Uashington dhe idetë tona për ecjen përpara, është e vërtetë që të gjithë ne kemi pasur ide të ndryshme. Është e vërtetë që unë kam pasur një ide që në këtë kohë të procesit të kemi një qasje të re, një qasje më dinamike, një qasje më të guximshme që të imponojmë veten si partner në këtë proces, jo thjeshtë si etatist, dhe të shkojmë me kërkesa konkrete. Ne vazhdimisht kemi kërkuar afatizim, kemi kërkuar datë dhe kemi thënë se në qoftë se ju nuk mund të na jepni datën, ne jemi të gatshëm që ta propozojmë datën. Ideja ka qenë që të caktojmë një datë të caktuar e cila në tërë këtë koncept i përfshin të gjitha kërkesat e Bashkësisë Ndërkombëtare, kërkesën për 120 ditë angazhim, kërkesën për mbështetjen e pakos së Ahtisarit, kërkesën për prezencën dhe mbikëqyrjen ndërkombëtare. I përfshin gjithashtu edhe zotimet tona që i kemi dhënë si Parlament, si Grup Uniteti në mbështetjen dhe implementimin e pakos së Ahtisarit. Por, përfshin gjithashtu edhe afatizimin e procesit dhe konkretizon hapat që duhet t'i marrim. Partneritetin e kemi kërkuar edhe në Uashington, partneriteti na është premtuar. Kemi kërkuar një dinamikë më të re, na është premtuar dinamika, kemi kërkuar një qartësi, na është premtuar. Kështu, partneriteti nënkupton besim, respekt reciprok, nënkupton harmonizim të qëndrimeve dhe të veprimeve. Nuk ka qenë ideja e deklarimit unilateral, ideja ka qenë që të kërkojmë koordinim të veprimeve, koordinim të qëndrimeve, një qasje të përbashkët se jemi partner. Ky proces ka të bëjë në radhë të parë me ne, me të ardhmen e Kosovës, të ardhmen e popullit të saj. Ka qenë, pra, ideja që të harmonizojmë veprimet, të harmonizojmë qëndrimet. Kështu, ka qenë, më në fund, një përfundim që duhet të shkojmë me këto kërkesa, të cilat i përmenda që i kemi bërë, dhe ne kemi shkuar unik me kërkesa tona. Ideja e këtij plani ka qenë që detyrat që i parasheh pakoja e Ahtisarit të ndodhin 120 ditë pas rezolute, ne t'i kryejmë në këtë 120- ditëshin që po hyjmë dhe besoj që do të hyjmë shpejt, d.m.th. pasi ta caktojmë një ditë, brenda këtij 120 ditshi të jemi të gatshëm për zgjidhje edhe më të shpejta nëse ndodhin, pse jo, për takime, për bisedime, t'i vizitojmë qendrat evropiane, kryeqendrat e tyre, ta shpjegojmë procesin, t'i japim garancitë e nevojshme që jemi partner në këtë proces, të përfundojmë miratimin e Rezolutës, të simboleve, të ligjeve, të pakos së Ahtisarit, transferin e kompetencave, të bisedojmë me Unionin Evropian për modalitetet e ardhjes së misionit të tyre, të bisedojmë me Kombet e Bashkuara për modalitetet e largimit të UNMIK-ut nga Kosova, të bisedojmë me liderët e komuniteteve pakicë, t'ua sqarojmë

procesin, t'u japim garanci të nevojshme etj. etj. Kështu, ka qenë një përpjekje që të pushojmë t'u themi vetëm po kërkesave të faktorit ndërkombëtar, por t'ia shtojmë edhe atë "por". Po, por. Kjo "por" do të thotë që e respektojmë këtë periudhë prej 120 ditësh, por 120 ditë duam qartësi, duam vendim, jemi të gatshëm ta marrim këtë vendim. Ne kemi premtime, kemi zotime se pas këtyre 120 ditëve do të zgjidhet statusi i Kosovës, kështu që janë sugjerimet e partnerëve tanë, të miqve tanë që nuk ka nevojë për data. Procesi ecën me dinamikën e vet, me një dinamikë të shtuar që do ta imponojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Unë, më në fund, dua ta bëjë të qartë se nuk kemi pasur pretendime dhe asnjë kryeministër nuk mund të ketë agjendën e vet. Jam anëtar i Grupit të Unitetit dhe gjatë formulimit të qëndrimeve, të veprimeve, kam idetë e mia, por pasi të merret vendimi, unë kam qasjen ndaj vendimit të Grupit të Unitetit sikur të ishte vendimi im dhe ashtu do të sillem duke qenë i vetëdijshëm se tri gjërat më të rëndësishme në këtë periudhë janë: uniteti, stabiliteti dhe partneriteti me miqtë dhe aleatët tanë ndërkombëtarë.

Unë dëshiroj ta kemi dhe preferoj ta kemi një qasje më dinamike, por t'i ruajmë këta tre komponentë shumë të rëndësishëm për ecjen e procesit përpara. Jam për një qasje me dinamike, sepse kështu ndihmojmë edhe procesin, por edhe miqtë edhe aleatët tanë duke kontribuar, duke dhënë kontributin tonë dhe duke treguar gatishmëri për marrjen e përgjithësisë. Sigurisht që nuk duhet të jemi aventurier dhe të veprojmë me mendjelehtësi. Por, po ashtu nuk duhet të jemi edhe të paguximshëm dhe ta bëjmë atë që populli e pret prej nesh. Sukseset në këtë proces të definimit të statusit, por edhe dështimet janë të përbashkëta për të gjithë ne. Kjo do të thotë se as historia, as brezat që vinë nuk do të na verifikojnë si individ, por si kolektiv. Andaj, unë bëj ftesë për unitet, bëj ftesë për një dinamikë të re dhe për një qëndrim unik. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, Kryeministër! Ftoj zotin Thaqi ta marrë fjalën.

HASHIM THAQI – I nderuari President Sejdiu, zoti Çeku, Berisha, Surroi dhe deputetë të Parlamentit të Kosovës,

Faleminderit për mbështetjen dhënë procesit të angazhimeve për zyrtarizmin e pavarësisë së Kosovës nga Ekipi i Unitetit dhe gjithë potenciali i angazhuar në këtë proces prej spektrit politik dhe institucional të Kosovës.

Jam i nderuar që t'i drejtohem këtij Kuvendi të respektuar dhe përsëri të qëndroj përgjegjshëm para jush dhe qytetarëve krenarë për vendin tonë dhe për atë që kemi bërë bashkërisht.

Pavarësia e Kosovës, sfida e madhe me të cilën ballafaqohemi sot, nuk ka të bëjë me afatet kohore, ultimative, apo me datat e parapëlqyera nga ne. Negociata për pavarësinë e Kosovës nuk do të ketë. Komuniteti ndërkombëtar ka përkrahur dhe respektuar vullnetin e qytetarëve të Kosovës për pavarësi. Angazhime shtesë, të përgjegjshme dhe intensive, do të ketë. Kjo ka të bëjë me përgjegjësitë tona që ne si lider i kemi ndaj qytetarëve dhe

vendit tonë me synim që të lëvizim përpara më shpejt. Në javët e fundit edhe personalisht kam lëvizur rregullisht anembanë Kosovës, kam takuar qytetarë të kategorive të ndryshme dhe të partive të ndryshme, por të gjithë, pa dallim, nga ne kërkojnë që të lëvizim më shpejtë përpara. Por, tani ne duhet ta kuptojmë se për të lëvizur përpara nga ne kërkohet që të ulemi edhe njëherë, njëherë të fundit, me vullnetin e mirë të bëjmë përpjekje që t'i bindim të tjerët për atë që për ne është shumë e qartë, që Kosova të bëhet e pavarur dhe të njihet nga shtetet e lira të botës, që integriteti territorial i Kosovës është i shenjtë dhe i paprekshëm, që pavarësia e Kosovës është pjesa e fundit e enigmës që është garanci e stabilitetit dhe e paqes në Ballkan. Ka edhe opinione që shprehen se pavarësinë duhet të shpallim apo rishpallim sot, pastaj ta rideklojmë vullnetin e qytetarëve. Ashtu siç shprehen, koha ka kaluar, është koha të heqim dorë. Të gjithë ne duhet kuptuar se, ashtu siç bota nuk na la të vetmuar para tetë vitesh, as ne nuk do të heqim dorë nga bota perëndimore. Përgjegjshmëria e lidershit tonë kërkon që t'i kuptojmë pasojat negative të një vendimi të tillë. Partnerët e botës së lirë nga ne duan siguri dhe besim në bashkëpunim, e jo befasi e mosbesim me pasoja për pavarësinë e Kosovës, integritetin territorial dhe integritimin e Kosovës në strukturat euroatlantike. Sot duhet të kuptojmë dhe t'u themi qytetarëve në mënyrë shumë të sqartë se çelësi nuk është tek deklaratat apo rishpallja, por tek domosdoshmëria e njohjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

Ne kemi dhënë betimin tonë para qytetarëve tanë se do të jemi udhëheqës të përgjegjshëm në qasjen tonë, sepse mënyra se si do ta bëjmë pavarësinë e vendit do të ketë implikime afatgjata për të ardhmen e vendit dhe të qytetarëve. Një gjë e tillë do t'i përcaktojë raportet tona me partnerët tanë politikë dhe ekonomikë, do të përcaktojë nivelin e kualifikimit për grante dhe kredi bankare në institucionet ndërkombëtare dhe, mbi të gjitha, rrugën drejt integritimit në Bashkimin Evropian dhe në NATO. Shkurt, mënyra e veprimit tonë do të përcaktojë modelin e Kosovës që do ta ndërtojmë në të ardhmen.

Të nderuar deputetë,

Tani më lejoni që shtroj disa pyetje: a dëshirojmë të ndërtojmë një Kosovë të izoluar nga bota e lirë dhe demokratike? Një Kosovë, ku tregu i lirë do të jetë i mbyllur për ne, ku 42% e qytetarëve të Kosovës do të vazhdojnë të mbesin të papunë, ku papunësia vazhdon të rritet 9% në vit, ku arsimi dhe shëndetësia do të mbesin në kolaps, buzë kolapsit, ku veteranët e luftës dhe familjet e dëshmorëve përbuzen dhe mashtrohen, ku pensionistët në mungesë të përkujdesjes meritore institucionale po shndërrohen në lypsarë, ku njerëzit në mungesë perspektive vazhdojnë të largohen jashtë vendit, ndërsa diasporës i vështirësohet kthimi për investim dhe jetë në atdhe. Në një Kosovë, në të cilën fëmijët tanë, që janë shpresa jonë për të ardhmen, a do të detyrohen të vazhdojnë të shesin cigare në rrugë që të sigurojnë bukën e gojës?! Një realitet i tillë nuk paraqet Kosovën e shpresave tona dhe e di shumë mirë se kjo nuk do të ishte një Kosovë çfarë e kemi ëndërruar dhe për cilën kemi sakrifikuar të gjithë. Është obligim ynë që vendi ynë në përputhshmëri me vullnetin tonë të shkojë drejt pavarësisë dhe të vazhdojmë të punojmë me botën demokratike për të bërë realitet këtë qëllim tonin dhe duhet të ecim përpara duke punuar shumë, me qëllim që të sigurohemi se jeta e qytetarëve të vendit tonë do të jetë shumë më e mirë pas pavarësisë. Duhet ecim përpara të ndërtojmë një Kosovë e cila

siguron ambient dhe zhvillim ekonomik, ku Qeveria do të jetë e hapur për biznese dhe jo anasjelltas. Duhet të ecim përpara të ndërtojmë një Kosovë e cila siguron vende të reja të punës dhe paga dinjitoze për të gjithë qytetarët tanë, duhet të ecim përpara të ndërtojmë një Kosovë e cila siguron kujdes shëndetësor kualitativ dhe, së fundi, ne duhet të ecim përpara të ndërtojmë një Kosovë e cila siguron një sistem të arsimimit cilësor dhe modern në të cilën fëmijëve do të mundësohet të mësojnë në klasa dhe jo të shesin gjëra të ndryshme nëpër rrugët e Prishtinës dhe anekënd Kosovës.

Kosova për të cilën po flas është e arritshme, por kërkohet nga ne që të jemi të përgjegjshëm. Pra, tani më shumë se kurrë më parë kërkohet udhëheqje e përgjegjshme dhe unike dhe jo të humbim kohë me agjenda personale dhe të bëjmë politikë së koti. Duhet të mbetet zotim në fuqi obligimi ynë për të punuar me botën e lirë dhe demokratike me qëllim që të bëjmë ëndrrën në të drejtën tonë realitet dhe ne nuk do të largohemi nga partneriteti me botën e lirë.

Po thuaj katër muaj më parë, të nderuar kolegë, unë dhe kolegët e mi kemi qëndruar para jush në të njëjtin vend dhe u kam kërkuar që të bëjmë gjithçka që është e mundur që të sigurohemi se në vitet e ardhshme jo vetëm të shënojmë rritje ekonomike dhe prosperitet, por të sigurojmë respekt, dinjitet, nder për vendin dhe popullin tonë. Të mbesim të bashkuar në premtimin tonë për të ecur përpara dhe të shkojmë tutje të vendosur të tregohemi të përgjegjshëm, të atillë çfarë kërkojnë dhe meritojnë qytetarët tanë. Mbi të gjitha ndërtimi i shtetit të Kosovës, pastaj agjendat e tjera.

Në këtë proces, të nderuar kolegë deputetë, Ekipi i Unitetit ka bërë punën më të mirë të mundshme për zyrtarizmin e shtetit të Kosovës, realizimin apo zyrtarizmin e realitetit të Kosovës së pavarur, të ndërtuar në qershor të vitit 1999. Sot pavarësinë e Kosovës e përkrahin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian dhe vendet e tjera. Shumë shpejt pavarësia e Kosovës do të njihet ndërkombëtarisht nga po këto shtete dhe të gjitha shtetet e tjera të botës demokratike. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, zoti Thaqi! Ftoj zotin Surroi të marrë fjalën.

VETON SURROI – I nderuari Kryetar i Kosovës Sejdiu,
I nderuari Kryeministër Çeku,
I nderuari Kryetar i Kuvendit, zoti Berisha,
I nderuari zoti Thaqi,
Ministra të nderuar,
Zonja dhe zotërinj kolegë,

Ftesën për këtë debat e kam kuptuar si një ftesë jo vetëm për dhënie të një përgjegjësie dhe një llogarie normale, por edhe për një bashkëbisedim dhe për një marrëveshje të re të cilën duhet ta mbërrijmë në ecjen tonë të mëtutjeshme.

Jemi në një situatë delikate dhe çdo ditë që shkon, do të jetë më e vështirë në këtë ecje. Kemi kaluar nga një koncept i cili e kishte rrjedhën e vet logjike. Kosova do të merrte

pjesë në një proces negociator, ndërmjetësit do të prodhonin një paketë e cila do të jetë sugjerim i Bashkësisë Ndërkombëtare për mënyrën se si do të funksionojë Kosova. Nga kjo paketë do të rridhte një rekomandim në Këshillin e Sigurimit në formë të rezolutës dhe nga kjo rezolutë do të rridhte shpallja e pavarësisë dhe njohja nga shtetet veç e veç, ose me rekomandim të plotë për shtetet për njohjen an-bllok.

Tash bëhet kalimi nga ky koncept në një koncept ende të padefinuar, ende në përpunim e sipër, në të cilin ka ende shumë pikëpyetje dhe një pjesë e pikëpyetjeve, natyrisht, do të shtrohet këtu në Kuvend, një pjesë të pikëpyetjeve i kemi shtruar si Grup i Unitetit në takimet tona me Sekretaren Rajs dhe me njerëz të diplomacisë nga Evropa.

Nga një kalim në tjetrin, nga një koncept në tjetrin, megjithatë është shënuar një fitore e madhe për Kosovën dhe kjo është se koncepti i pavarësisë, pavarësia në mënyrë eksplicite është tashmë një koncept i përkrahur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga shumica e shteteve të Bashkimit Evropian. Në fakt, vetëm sivjet në mënyrë të hapët edhe Presidenti Bush, edhe Presidenti Sarkozy, edhe liderët të tjerë kanë dalë haptas me konceptin e pavarësisë si fundin logjik normal të këtij procesi.

Por, kalimi prej një koncepti në konceptin tjetër nuk duhet të na lejojë që mos të analizojmë se në këtë ecje çfarë kemi bërë dhe çka mund të përmirësojmë. Kalimi prej një koncepti në konceptin tjetër, në fakt, na ka dobësuar edhe ne si Ekip Negociator, jo me dëshirën tonë, jo me vullnetin tonë. Është dëmtuar kredibiliteti ynë negociator, sepse kredibiliteti ynë ka qenë i investuar bukur shumë në një proces në të cilin kemi marrë pjesë me sinjeritetin më të madh.

Pasoja e dytë është se, duke marrë pjesë në një koncept negociator, ne i kemi shpenzuar të gjitha mundësitë për koncesione. Kosova nuk ka çka të marrë pjesë më në negociatë, sepse nuk ka çka të japë më si koncesion. Mund të marrë pjesë në forma të tjera të bashkëbisedimit, në forma të tjera të komunikimit. Por, negociatë tipike klasike, në të cilat dy palët japin diçka për të mbërritur një mes, nuk mund të ketë.

Rrjedhimisht, pozita jonë e dobësuar negociatore na vë para rreziqeve dhe sfidave të reja në të ardhmen, e të gjitha këto kanë të bëjnë o me funksionalitetin, o me tërësinë tokësore. Nuk është procesi negociator i cili sjell zhvillime aq dramatike. Tërësia tokësore, funksionimi tokësor i tërësisë së Kosovës ka qenë i rrezikuar që nga viti 1999 deri më sot, nuk është ndonjë risi që po ndodh, por në këtë fazë fiton një dimension, peshë të veçantë.

Me këtë bagazh rreziqesh, me të cilat po nisemi, duhet të shikojmë se çka mund të bëhet më mirë dhe më shumë. Jo dorëzim, por më mirë dhe më shumë.

Çështja e parë është krijimi i një natyre të re të partneritetit. Këtë kemi provuar ta bëjmë edhe në Uashington, edhe në takimet tona të tjera. Ne duam jo ta prishim partneritetin, por duam të jemi partner aktiv, jo transmetues të politikave.

Çështja e dytë është që duhet të formalizojmë kanalet tona të komunikimit. Kosova ka hyrë në një proces negociator me dobësinë e mungesës së shërbimit të vet diplomatik. Meqenëse është gjendja çfarë është, atëherë së paku mund të formalizojmë diçka që mund të duket si një përpjekje e përbashkët diplomatike, ndonëse i dimë të gjitha kufizimet nga Korniza Kushtetuese.

Çështja e tretë, e cila është, më duket vendimtare, është që duhet të manifestohet më shumë autonomia vendimmarrëse e politikës sonë, e këtij Kuvendi, e kësaj Qeverie, e të gjitha institucioneve tona. Nuk mund të vijmë në situatë çfarë kemi qenë që për një çështje, e cila do të na unifikonte të gjithëve, siç janë simbolet, të kalojmë kaq kohë të gjatë debati apo pritjeje të ndonjë vendimi të zyrave ndërkombëtare në Prishtinë. Partneriteti nënkupton të drejtën tonë që të marrim vendime dhe të drejtën tonë që të japim sugjerime, e jo që t'i presim të gjitha të gatshme dhe vetëm të kalojmë nëpër një përkthim të thjeshtë gjuhësor.

Tri janë rreziqet që i shoh në këtë periudhë të ardhshme. Rreziku i parë është që në procesin negociator do të bëhet përpjekja që të rrezikohet funksionaliteti i shtetit të ardhshëm të Kosovës. Edhe këtu qëndrimi ynë duhet të ndërtohet me një mbrojtje shumë më të avancuar sesa e kemi pasur deri më sot.

Rreziku i dytë është forcimi i vijave ndarëse në Veriun e Kosovës, jo si një përpjekje e popullatës së atjeshme, por si një infuzion politik që vjen nga disa qarqe ruse për krijimin e konflikteve të ngrira në Evropë. Çështja e Kosovës dhe, rrjedhimisht, çështja e Veriut të Kosovës shndërrohet apo mund të shndërrohet në një pjesë të dyluftimit, ta quaj ashtu, të ftohtë mes Perëndimit dhe Rusisë.

Dhe, çështja e tretë, është vështirësia që do ta kemi në legalizimin dhe legjitimimin e pavarësisë së Kosovës në një proces bukur të vështirë që po na pret më tutje.

Unë mendoj ashtu, siç kam menduar edhe para se të shkojmë në Uashington, se do të duhej të uleshim dhe të bisedonim para shkuarjes dhe të merrnim vendime të përbashkëta. Ende mendoj se Ekipi i Unitetit ka nevojë për mbështetje, ka nevojë për llogaridhënie, por ka nevojë edhe për mbështetje të Kuvendit të Kosovës. Unë mendoj se tri duhet të jenë drejtimet e ardhshme të politikës së përgjithshme e cila duhet përcaktohet në këtë Kuvend të Kosovës.

Pika e parë është se Kuvendi i Kosovës, sipas mendimit tim, duhet të marrë iniciativë që të shndërroj paketën e Ahtisarit në agjendë të veten legjislative. Paketa e Ahtisarit nuk mund të jetë objekt negociatash, por mund dhe duhet të jetë vetëm objekt transformimi në ligj dhe në kushtetutë. Kosova duhet t'i ketë të gjitha ligjet dhe të gjitha aktet që rrjedhin nga paketa e zotit Ahtisari në një periudhë të ardhshme 120 ditëshe, siç u shpreh edhe Presidenti Sejdiu.

Pika e dytë është që ne duhet ta ruajmë partneritetin me Bashkësinë Ndërkombëtare edhe në procesin e ardhshëm 120 ditësh, por ky proces i ardhëm 120 ditësh duhet ta ketë vulën tonë, duhet ta ketë edhe dëshirën edhe projektimin e asaj çka duam të bëjmë në këto

negociata. Një pjesë të kësaj platforme tashmë e paraqiti Presidenti Sejdiu si një platformë të përbashkët të Ekipit të Unitetit.

Dhe, çështja e tretë është që Kuvendi i Kosovës ka obligim ndaj qytetarëve të vet. Këtë obligim për funksionalizimin e pavarësisë duhet ta kryejë brenda këtij viti deri në Kërshëndella të këtij viti. Ky është një obligim, i cili nuk e prish partneritetin, është një obligim, i cili ndërtohet me partneritet. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Fjalën e ka Kryetari i Parlamentit, zoti Berisha.

KRYETARI KOLË BERISHA -

I nderuari President Sejdiu,

I nderuari kryeministër dhe anëtar i EU, z. Çeku,

Të nderuar anëtarë të EU, kryetarë partish dhe deputetë të këtij Parlamenti, z. Thaçi dhe z. Surroi,

I nderuari zëvendëskryeministër Haziri dhe kabinet qeveritar, përfaqësues të misioneve diplomatike në Kosovë, përfaqësues të mjeteve të informimit, pjesëtarë të OJQ-ve që përcillni punimet e Kuvendit të Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Që në fillim, dua të them se, kërkesa ose mocioni i shefit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, z. Jakup Krasniqi, e shoqëruar edhe me atë të kryetarit të LPK-së, z. Emrush Xhemajli, për ta zhvilluar një debat në seancë plenare me qëllim që Kuvendi i Kosovës ta formësojë një qëndrim të vetin lidhur me situatën e krijuar rreth shtyrjeve të afateve për zgjidhjen e statusit të Kosovës, është pranuar edhe nga Kryesia e Kuvendit, por edhe nga shefat e grupeve parlamentare.

Kjo, për faktin se, rezervat, frika, shqetësimet dhe humbja e një doze, qoftë edhe shumë e vogël, e besimit për zgjidhje të shpejtë e të drejtë të statusit të Kosovës, që natyrshëm vjen si pasojë e zhvillimeve të fundit në Nju-Jork, në një mënyrë janë të kuptueshme, sepse, të gjithë ne, pastaj, edhe e tërë Kosova dhe mbarë bota shqiptare, me të drejtë kemi pritur se, pas gjithë atyre sakrificave të bëra, por duke pasur parasysh edhe faktin se, gjatë tërë këtyre viteve, ne ishim partnerët vërtet më seriozë të bashkësisë ndërkombëtare, prandaj, edhe për këtë element, që unë e konsideroj jo pak të rëndësishëm, nga bashkësia ndërkombëtare kemi pritur dhe e kemi merituar njohjen formale të pavarësisë së Kosovës.

Megjithatë, kjo nuk ndodhi. Nuk ndodhi as në ditët e para të pasluftës, as pas tri vjetësh nga Rambujeja, nuk ndodhi as tani.

Për më tepër, zvarritjet dhe shtyrjet e shpeshta të afateve për zgjidhjen e statusit të Kosovës; pastaj tërheqja e çështjes së Kosovës nga KS i OKB-së, ku, Rusia, me një fanatizëm tradicional, i refuzoi, një nga një, të gjitha rezolutat e hartuara nga perëndimorët; dërgimi i pakos se Ahtisarit në Grupin e Kontaktit; propozimi për të

ashtuquajturat “negociata shitesë” në kohëzgjatje prej katër deri në gjashtë muaj; qëndrimi rus edhe më tej i paluhatshëm kundër pavarësisë së Kosovës që solli deri te hezitimi ose luhatja e disa vendeve dhe, shtruarja, ose rilansimi i tezës për ndarjen e Kosovës, pra, të gjitha këto, nëse pranohen kështu siç duken në shikim të parë, vërtet lënë hapësirë për shqetësim dhe dyshim se, mos vallë, edhe kësaj here, po na përsëritet historia.

Unë nuk them se çdo vonesë, sado e vogël qoftë, në zgjidhjen e statusit të Kosovës nuk e ka çmimin e saj, madje mjaft të lartë, marrë në të gjitha aspektet, kumulativisht. Unë, po ashtu, nuk them se çdo ditë e kaluar me këtë status quo që e kemi, nuk i kushton Kosovës shumë shtrenjtë në shumë fusha të jetës, qoftë në atë ekonomike, politike, sociale, arsimore, etj., e, mbi të gjitha, në humbjen e hapit karshi simotrave të saj në rajon për të trokitur në dyert e familjes së madhe evropiane e evroatlantike.

Por, për asnjë moment, nuk mund të pranohet droja se, sot, në fillim të shekullit 21, një populli, i cili, kohë më parë, në sajë të angazhimit të tij, por edhe me ndihmën e miqve të shumtë, diti ta mbijetojë apokalipsin, do t’i përsëritet historia.

Kosovës, nëse di të ruajë partneritetin me miqtë, sot nuk i kërcënohet rreziku i kthimit prapa. Kanë kaluar kohët kur Kosova ishte e vetme, pa askënd afër, pa ndihmën e askujt.

Prandaj, për momentin, për mua, me rëndësi është që të japim përgjigje në pyetjen: jemi këtu ku jemi, por, çfarë të bëjmë tani si Kuvend i Kosovës?

Në shikim të parë, përgjigjja më e lehtë në këtë pyetje është:

Ta bëjmë hapin e fundit, pa e bërë atë që duhet bërë së pari. Pra, ta shpallim pavarësinë e Kosovës. Por, çka pastaj?

Përgjigja nuk është e lehtë. Ke bërë hapin e parë, pa e ditur se a mund ta bësh të dytin. Për më tepër, ke ndërmarrë një hap aq të madh pa e përfillur fare partneritetin me miqtë dhe pa harmonizuar me ta veprimet. Të gjithë partnerët dhe miqtë tanë të vërtetë na thonë se nuk duhet ndërmarrë hapa të njëanshëm.

Për ndërmarrje të mëdha, nuk mjafton vetëm dëshira, vetëm vullneti, vetëm ndjenja e zjarrtë e patriotizmit, e atdhedashurisë; nuk mjafton vetëm guximi, vetëm gatishmëria për sakrificë, që kurrë nuk na kanë munguar.

Por, tani, çështja është se si ta realizojmë qëllimin, pa ndonjë sakrificë. Mjaft kemi sakrifikuar gjatë historisë. Kemi humbur kokë e tokë, për të arritur këtu ku jemi. Tashmë, nuk i takojmë vetëm vetvetes. Nuk jemi një territor i panjohur, një territor i izoluar. Kosova tashmë është pjesë e një tërësie, brenda të cilës, po qe se dimë të sillemi, nuk ka kthim prapa.

Dhe, së fundi: a e duam një pavarësi që vlen vetëm këtu në këtë sallë; një pavarësi gjysmake; një pavarësi të një territori të rrudhur; të një territori të përgjysmuar, madje edhe të izoluar; apo e duam një pavarësi pa e cenuar tërësinë territoriale të Kosovës, pra

një pavarësi të njohur dhe të pranuar edhe jashtë kësaj salle, të njohur edhe nga pjesa më e madhe e shteteve të botës, të njohur e të pranuar nga e tërë bota demokratike?

Të nderuar deputetë,

Ne nuk kemi më nevojë që me akte të njëanshme t'i tregojmë vetes dhe botës se çka duam.

Që me Referendumin e vitit 1990, pastaj me atë rezistencën tonë të qetë, por aktive; me rebelimin, mosnjohjen dhe mospranimin e organeve të pushtetit serb, dhe me ndërtimin e institucioneve tona; me nxjerrjen e Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut dhe me Kushtetutën e 7 Shtatorit; me thyerjen e propagandës mbi dyqindvjeçare serbe kundër shqiptarëve; pastaj me luftën e armatosur që bënë djemtë dhe vajzat tona; me krijimin e një numri të madh miqsh nga mbarë bota, e sidomos me SHBA-në, e cila, nga 24 marsi e deri më 9 qershor 1999, u priu nëntëmbëdhjetë shteteve - anëtare të NATO-s, në intervenimin mbi caqet ushtarake dhe policore në Serbi; me administrimin e Kosovës nga Misioni i Kombeve të Bashkuara, pra me të gjitha këto ne kemi bërë shkëputje totale nga sundimi serb. Për këto tetë vjet, ne ia kemi bërë të qartë çdo qytetari të Kosovës, por edhe opinionit të gjerë, madje edhe vetë qendrave të vendosjes, qëllimin tonë. Ua kemi bërë me dije se Kosova kurrë nuk pranon të jetojë nën regjimin serb. Madje, tani e tetë vjet, Kosova jeton e pavarur nga Serbia.

Ne, si Kuvend, mund të marrim ndonjë qëndrim konform situatës aktuale, por ky Kuvend nuk do të bëjë ultimatume, nuk do të caktojë data, nuk do të premtojë vendime apo veprime të pamatura. Kuvendi i Kosovës do të marrë vendimin e duhur në kohën e duhur dhe në partneritet me miqtë ndërkombëtarë.

Tashmë, besoj që jemi bindur se nuk jemi vetëm; se fuqia më e madhe e botës, por edhe aleatët e saj në Evropë, po punojnë me ne dhe për ne. Qëndrimi i tyre dhe yni është i qartë: Kosova po shkon kah pavarësia...

Porosia e fundit e miqve tanë ishte: filloni të mendoni, filloni të punoni dhe filloni ta ndjeni veten si të pavarur.

Kosova, në fakt, është e pavarur.

Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Hap debatin duke filluar me shefat e grupeve parlamentare. Ftoj shefin e Grupit Parlamentar të LDK-së, zotin Gashi.

ALUSH GASHI – Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit.

I nderuari zoti President, zoti Kryeministër, zoti Thaçi, zoti Surroi, zotëri ministra dhe shumë të çmuar zotërinj deputetë të Kuvendit të Kosovës.

Duke mirëpritur dhe mbështetur fjalën e Presidentit të Kosovës Fatmir Sejdiu, më lejoni të përkujtoj se me një mbështetje të fuqishme të qytetarëve të Kosovës dhe të përfaqësuesve të saj në institucionet e Kosovës, të fokusuara në mbështetje të Delegacionit të Unitetit, Kosova ka arritur që ta arrijë mbështetjen për pavarësinë e saj nga pjesa dërmuese e botës së lirë. Ne sot nuk kemi shumë arsye që të jemi të shqetësuar se a do ta arrijmë pavarësinë, a jo. Hera e parë në historinë e vendit tonë dhe në historinë e këtij populli në takime zyrtare në tryezë është në mbështetje të plotë pavarësia e Kosovës nga pjesa dërmuese e anëtarëve të Këshillit të Sigurimit, të unitetit të plotë të Bashkimit Evropian si dhe të një numri të madh të shteteve që përbëjnë Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së.

Andaj, Lidhja Demokratike e Kosovës, e cila ka mbështetur Rezolutën për Ekipin e Unitetit, rikonfirmon mbështetjen e plotë dhe përcaktimin që Presidenti i Kosovës, së bashku me Delegacionin e Unitetit të mos lëvizë nga qëndrimet e votuara në Rezolutën e Kuvendit të Kosovës, qëndrimet të cilat sot kondensohen në fjalën e Presidentit të Kosovës.

Kjo aq më tepër kërkon nga institucionet demokratike të Kosovës që të punojnë intensivisht në vend dhe jashtë në ngritje të kapaciteteve, në sjellje transparente si shtet sovran dhe i pavarur. Me ditën e mbështetjes së propozimit të Ahtisarit ne kemi hyrë në një obligim ndërkombëtar që ta demonstrojmë seriozitetin tonë që Kosova të jetë një vend i lirë, të jetë një vend demokratik, një vend i cili do të ofrojë ardhmëri për të gjithë qytetarët e saj. Ne kemi demonstruar se kemi mësuar të jetojmë në paqe të brendshme, kemi demonstruar se e mirëpresim bashkëpunimin konstruktiv të fqinjëve tanë. Është hera e parë në historinë e vendit tonë që ne e kemi arritur mbështetjen e shumicës së fqinjëve tanë që Kosova të jetë shtet i pavarur.

Shqiptarët dhe dashamirësit e lirisë dhe të pavarësisë kërkojnë nga ne që ta vazhdojmë punën tonë. Lidhja Demokratike e Kosovës kërkon qartësi dhe qartësinë e kemi, qartësia jonë është pavarësia e vendit tonë. Por qartësia në këto hapa të ditëve të ardhshme është e nevojshme për përfaqësuesit e institucioneve tona. Por përfaqësuesit e institucioneve tona e kanë të drejtën të jenë shumë më efikas në punë të përditshme, si në Kosovë, ashtu edhe në raport me vendet e tjera. Siç ju kujtohet, ne me shumë mund në vitet e 90-ta, por edhe pas ndërhyrjes së NATO-s, kemi punuar në shtyrje të vijës së kuqe të kompetencave në vendin tonë. Ne duhet të veprojmë si shtet dhe në atë pjesë të kufizimit të kompetencave ne duhet të bashkëpunojmë me Bashkësinë Ndërkombëtare në mënyrë që ky proces të ecën sa më para. Qartësia e ushqen durimin, durimi është shoqëruesi më i mirë i mençurisë.

Ata të cilët nuk e mbështesin pavarësinë e vendit tonë nuk janë të shumtë, por janë të rëndësishëm. Ata llogarisin në humbjen e nervave të përfaqësuesve tanë, në humbjen e durimit të qytetarëve tanë që pastaj ne të merremi me problemet tona të brendshme, jo me çështje statusore. Por, përsëri edhe kjo kërkon nga ne që përfaqësuesit tanë në

institucione t'i jenë shumë më aktiv. Duke dhënë mbështetjen për këtë punë, zoti President, kishim për të mirëpritur një aktivitet më intensiv me hapjen e përfaqësive diplomatike të vendit tonë jashtë, me një qasje shumë më efikase drejt Fondit Monetar Ndërkombëtarë, Bankës Botërore dhe Bankës Evropiane për zhvillim.

Politika të cilën e ka kultivuar Lidhja Demokratike e Kosovës dhe më vonë edhe partitë e tjera që kanë lindur dhe puna aktive e Luftës Çlirimtare të Kosovës, bashkëpunimi me Bashkësinë Ndërkombëtare, në veçanti me trupat e NATO-së dhe me aleat të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka prodhuar rezultate që Kosova sot ta ketë mbështetjen e pjesës dërmuese të Bashkësisë Ndërkombëtare.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti President, si ekzekutori i politikës së Lidhjes Demokratike të Kosovës do ta vazhdojë mbështetjen në kuadër të rezolutës të cilën e ka miratuar Kuvendi i Kosovës lidhur me mandatin e përcaktuar për realizimin e pavarësisë. Ju keni një gjerësi shumë të madhe veprimi dhe ju falënderojmë për përkushtimin e transparencën për informim në këtë seancë dhe në veçanti për diversitetin e pikëpamjeve të cilat disa nga anëtarët e Ekipit të Unitetit i ndajnë me ne. Ne mendojmë që ky bashkëbisedim duhet të vazhdojë, ky bashkëbisedim është shumë aktiv në kuadër të grupit tonë parlamentar me anëtarët e delegacionit të Ekipit të Unitetit si edhe me përfaqësuesit apo me shefat e grupeve parlamentare të partive të tjera, qofshin ato në pozitë ose në opozitë. Ju faleminderit shumë, zoti Kryetar!.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit zoti Gashi! Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Krasniqi.

JAKUP KRASNIQI- Zoti Kryetar,
Të nderuar anëtarë të Grupit Negociator,
Të nderuar deputetë,

Këtë seancë e kemi thirr për të debatuar për pengesat e paarsyeshme që po i bëhen njohjes ndërkombëtare të shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës, të krijuar me Luftën Çlirimtare të UÇK-së dhe me mbështetjen e kësaj lufte nga NATO-ja dhe e gjithë bota demokratike.

Nuk jemi ne të vetmit që me luftë çlirimtare e bëmë shtetin. Të gjitha shtetet e OKB-ës nga luftërat kanë dalë. Nga luftërat kanë dalë edhe vendet anëtare të Këshillit të Sigurimit, edhe shteti ynë nga lufta ka dalë. Prandaj, s'ka nevojë të merret as si rast për presedencë të tjera, as si sui generis. Si sui generis është trajtimi që po i bëhet sot Serbisë pas tri luftërave shkatërrimtare të përmasave të gjera që ka bërë në hapësirat e ish Jugosllavisë.

Njohjen ndërkombëtare ne e pritëm në fund të vitit 2006. Në fakt ndodhi shtyrja pa arsye. Ajo nuk ndodhi as në vitin 2007. Njohja e pavarësisë së Kosovës shtet i pavarur dhe sovran është dashur të ndodhte në vitin 2000-2001, atëherë kur duhej të ndëshkohej gjenocidi serb i ushtruar për mbi 100 vjet mbi shqiptarët dhe hapësirat e tij. Në vend të kësaj, popullit shqiptar veç të tjerash po i dënohen edhe gjeneratat që lindin e do të lindin

në vitet në vazhdim, pse baballarët e tyre luftuan për liri dhe pse e kërkuan ndërtimin e vendit të sflitur dhe të shkatërruar nga lufta. Këtë të drejtë për shtet nuk e fituam me lutje e pritje, ndonëse nuk munguan as ato, por me luftë çlirimtare e flijime të shumta. Edhe deri më tani është vonuar e drejta jonë për jetë, për liri e demokraci, për shtet ligjor dhe zhvillim. Kjo vonesë e ka penguar dhe po e pengon ecjen tonë në të gjitha segmentet e jetës shoqërore, ekonomike, politike e publike. Po të ndodhte njohja në vitin 2001, në Kosovë do të kishte më shumë stabilitet politik, do të kishte më shumë zhvillim ekonomik, do të kishte më shumë punë, më shumë siguri kombëtare, do të kishte më shumë drejtësi e siguri për të gjithë. Sigurisht do të ndodhte edhe integrimi i pakicës serbe.

Qytetarët pa dallim do të kishin një jetë më dinjitoze, një jetë më kualitative, do të kishim qeverisje tjetër, do të kishim kapacitete tjera administrimi, do të kishim lidhshmëri me përgjegjësi të tjera politike, morale, vendi do të qeverisej nga njerëz me kualitete të tjera profesionale, morale, intelektuale, politike, kombëtare që sot i duhen këtij vendi më shumë se kurrë, i duhen më shumë se buka e uji. Kosova dhe qytetarët e saj sot nuk e meritojnë këtë ndëshkim dhe izolim.

Kosova që sa vite pa të drejtë është getoizuar në mesin e Evropës së bashkuar. Që dy e më tepër dekada qytetarët shqiptarë janë të shtrënguar të ikin tinëzisht si hije nga vendi i tyre i izoluar e i pa prespektivë për të mbijetuar në vendin e tyre. Prandaj, kërkesa jonë për debat të ngutshëm ka pasur për qëllim ta ndërpresë statusin quon mjerane të mosveprimit, të pengojë paligjshmërinë e instaluar në të gjitha nivelet e qeverisjes, si të vendorëve ashtu të ndërkombëtarëve, që janë në mision për të grabitur pasurinë tonë kombëtare e publike, të ndërpresë logjikën -ligji jam unë, prokurori jam unë, gjykatësi jam unë, unë vrajë e kthjellë në këtë vend.

Kërkesa kishte për qëllim që së bashku me të zgjedhurit e popullit të kërkonim nga bota demokratike, nga ata që së bashku u dhamë fund ndjekjeve, dëbimeve, shfarosjes, gjenocidit që politika serbe u kishte bërë në kontinuitet shqiptarëve, ta njihte pavarësinë e sovranitetin e shtetit të Kosovës, që t'i hapte rrugë veprimit të shtetit ligjor që ende nuk po duken në horizont për fajin e pengesave që po i bëhen Kosovës. Ne jemi të bindur se edhe vendet që na kanë mbështetur e vazhdojnë të na mbështesin e kanë ndihmuar këtë shtyrje pasi janë vonuar në ndëshkimin e gjenocidit serb në Kosovë. Ani pse ata, për qëllime politike, nuk e kanë cilësuar si gjenocid.

Ne jemi të bindur se në këtë situatë që ka Kosova sot, qytetarët e saj nuk kanë prespektivë ekonomike dhe, për pasojë, nuk do të kenë kualitet jetësor të dinjitetshëm, nuk do të ketë lëvizje të lirë të qytetarëve. Ky kualitet i jetës që ofron Kosova sot nuk është dhe nuk do të jetë tërheqës as për shumicën, as për pakicën në Kosovë.

Situata e krijuar politike në Kosovë e për Kosovën na obligon që të qartësojmë vetveten për veprime tona të mëtejshme, që të kërkojmë qartësim dhe afatizim të procesit nga mbështetësit tanë, veçanërisht nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ne si klasë politike ose duhet të ushtrojmë përgjegjësinë që e kemi kërkuar nga qytetarët, ose duhet t'ua lëshojmë rrugën atyre që dinë, donë e guxojnë ta marrin

vendimin historik për Kosovën dhe për qytetarët e saj. Këtë vendim mund ta marrin vetëm ata që guxojnë të udhëhiqen nga filozofia politike e Adem Jasharit, nga filozofia dhe vendimmarrja e komandantit legjendar të UÇK-së, pa të cilin vendim nuk di ku do të ishim sot, por këtu nuk do të ishim. Çdo politikë tjetër do ta ndihmonte serbizimin e Kosovës. Shpëtimi dhe nderi ynë ishte Lufta Çlirimtare, të cilën me kohë nuk e vlerësuam si e meritonte. Kosovës i duhet lidërsip që guxon të marrë vendime të rëndësishme për vendin.

Të nderuar deputetë,

Për ne dokumenti Ahtisarit është një kompromis i dhimbshëm që kemi pranuar me sugjerimin e partnerëve tanë në kushtet e ruajtjes së tërësisë territoriale të Kosovës, të njohjes së pavarësisë dhe të sovranitetit të shtetit të Kosovës, të rindërtimit dhe të ndërtimit të vendit. Në rrethana të tjera, oferta jonë nuk është e obligueshme për ne. Ne nuk jemi për ndryshim kufijsh, ani pse jemi kombi më i coptuar i Evropës. Loja me kufij në Ballkan është e rrezikshme. Ata që mohojnë njohjen ndërkombëtare të shtetit të Kosovës janë duke përgatitur rreziqe të reja dhe jo vetëm për Ballkanin. Politika që vazhdon të udhëhiqet nga Serbia e paramilitarit Koshtunica, duke u mbështetur nga Rusia pansllaviste, as deri më tani nuk ka prodhuar paqe, siguri, prosperitet, madje as në vendet e tyre.

Politika serbe në të kaluarën e afërt në hapësirën shqiptare ka prodhuar tri luftëra. Në situatën e krijuar nuk jemi të interesuar t'i zëvendësojmë procedurat demokratike të institucioneve me procedura demokratike jashtë institucionale. Veçse nëse na imponohet siç na është imponuar në luftërat e fundit, ne do të jemi të detyruar t'i përgjigjemi interesit të vendit tonë. Nëse politika serbe e Beogradit ka njëherë të drejtë të kërcënojë me luftë, ne kemi 1001 herë të drejtë të bëjmë kërcënimin me luftë çlirimtare. Nëse Serbia një herë ka të drejtë të kërcënojë me luftë shfarosëse e zjarrvënëse me gjenocid e shkatërrime, siç ndodhi në fund të shekullit XX, e kjo ka ndodhur disa herë, ne kemi të drejtë 1001 herë të organizojmë luftë çlirimtare mbarë kombëtare. Ndoshta është koha e fundit që politika shqiptare e gjithë hapësirës kombëtare, të copëtuar pa të drejtë, pas kësaj shtyrjeje me ndikimin e armiqve tanë shekullor, të mendojnë ndryshe për të ardhmen e kombit shqiptar në përgjithësi.

Në situatën e krijuar, ky Kuvend më së paku duhet të konfirmojë Rezolutën e miratuar në fillim të procesit politik dhe të miratojë një deklaratë që t'i konfirmojë edhe njëherë disa qëndrime që janë minimumi i minimumit të kërkesave tona.

1. Të konfirmojë përcaktimin e njohur të arritur në luftën çlirimtare për pavarësinë e sovranitetit të shtetit të Kosovës. Nëse edhe pas 6 muajve ose pas mbylljes së kohës shtesë të afatizuar nuk njihet me automatizëm pavarësia e Kosovës, Kuvendi i Kosovës duhet ta obligojë Kuvendin e ardhshëm që të shpallë pavarësinë dhe sovranitetin e shtetit të Kosovës dhe të kërkojë njohjen ndërkombëtare të tij.

2. Të konfirmojë zbatueshmërinë e dokumentit të presidentit Ahtisari ...(ndërprerje e diskutimit nga ana e teknikës)...të pavarësisë dhe të sovranitetit të shtetit të Kosovës.

3. Të marrë përgjegjësinë për realizimin e decentralizimin në tërë hapësirat e shtetit të pavarur sovran të Kosovës, pa dallime etnike e për të gjithë qytetarët.
4. Institucionet e shtetit të Kosovës duhet të respektojnë tri parimet kryesore të Grupit të Kontaktit të deklaruar në fillim të këtij procesi.
5. Të zotohen se do të respektojnë vlerat evropiane që ndihmojnë në integrimin e vendit në Bashkimin Evropian dhe në Aleancën Veriatlantike.
6. Kërkojmë nga vendet e botës demokratike, Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës si dhe nga OKB-ja dhe Këshilli i Sigurimit që ta respektojnë e mbrojnë dokumentin e Presidentit Ahtisari që është prodhim i politikës dhe i ekspertëve të tyre të ngarkuar enkas për këtë qëllim, është prodhim i vlerave euroatlantike.
7. Çdo ndryshim në dokumentin e Ahtisarit bisedimet mes Beogradit dhe Prishtinës i kthen në fillim të procesit.
Ju faleminderit!.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në emër të AAK-së Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA – I nderuari zoti President, zoti Kryetar, zoti Kryeministër, zoti Thaqi, zoti Surroi, ministra, të nderuar deputetë,

Ne sot jemi në një udhëkryq në rrugën drejt pavarësisë. Ne tani dimë diçka më qartë se kurrë më parë se: ky është kuvendi që do të shpallë pavarësinë e vendit tonë. Askush nuk do ta marrë këtë vendim për ne, në të vërtetë askush as që do të mundëj ndonjëherë.

Kur të shpallim shtetësinë tonë, duhet të përgatitemi që t'i themi botës – bashkë me brezat e ardhshëm të popullit tonë – pse po e bëjmë këtë hap, dhe çfarë synojmë të krijojmë.

Ky vendim, kjo deklaratë, nuk është çështje që ka të bëjë me një njeri apo një parti të vetme, me një komb apo me një grup të vetëm etnik. Secili prej nesh ka një votë për të votuar. Për një çështje të tillë jetike, secili prej nesh, duhet të votojë në përputhje me ndërgjegjen e vet, duke marrë parasysh përgjegjësinë që kemi për të folur në emër të popullit që na ka zgjedhur.

Në përputhje me këtë, i propozoj Kuvendit të Kosovës që të formojmë një trup të veçantë, gjithëpërfshirës, një Asamble Parlamentare për Shpalljen e Pavarësisë.

Kjo Asamble Parlamentare do të përcaktojë parimet e saj, do ti argumentojë ato dhe do të hartojë një projekt-deklaratë që duhet t'i parashtrahet Kuvendit për miratim. Gjithashu, Asambleja Parlamentare duhet të takohet në baza të rregullta për të monitoruar procesin dhe në momentin e duhur të marr vendimin. Shpallja e pavarësisë nuk është një çështje partiake apo një mundësi për të shënuar pikë në politikë – ajo është detyra jonë e shenjtë

para popullit. Duke iu përmbajtur kësaj, Asambleja Parlamentare, do të jetë e hapur ndaj të gjithë anëtarëve të Kuvendit, të vullnetit të mirë, mbi bazë të barabartë dhe individuale, duke marrë parasysh që secili prej nesh ka të njëjtin mandat dhe obligim për t'i kontribuar pavarësisë së vendit.

Ne nuk do të jemi populli i parë që ka shkruar deklaratën e pavarësisë. Partneri dhe aleati ynë më i madh, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, na japin një model të pashoq të lindjes së tyre si pishtar i demokracisë së botës. Më shumë se 230 vjet më parë, Kongresi i Shteteve të Bashkuara debatoi për pavarësinë e vet, formoi një komitet për të hartuar një projekt të deklaratës, debatoi për deklaratën dhe e miratoi atë ashtu që më së miri i përshtatej parimeve dhe interesave të kombit. Rezultati përfundimtar nuk ishte aksident apo improvizim, as nuk ishte imponim. Ne ia kemi borxh popullit tonë një deklaratë të pavarësisë dhe jo më pak se kaq.

Deklarata historike amerikane për pavarësinë rikujton një histori të shtypjes dhe tiranisë që shumë prej nesh e kemi përjetuar dhe kundër së cilës kemi luftuar.

Amerikanët atëherë e dinin atë që edhe ne e mësuam nga përvoja e dhimbshme e historisë sonë, që për të drejtat e patjetërsueshme, jetën, lirinë dhe kërkimin e lumturisë, duhet luftuar dhe ato duhen fituar. Pasi kemi fituar lirinë, ne duhet tani të përgatitemi për hapin tjetër, për të siguruar të ardhmen tonë. Nuk mund t'ia lëmë këtë detyrë askujt tjetër. Dhe nuk mund ta shmangim më, marrjen e kësaj përgjegjësie.

Sot nuk është dita për t'i hyrë çështjes se kur duhet shpallur pavarësia. Ky Kuvend i ka dhënë mandat Grupit Negociator të Kosovës, dhe ne presim që anëtarët e tij të vazhdojnë të ushtrojnë mandatin që u kemi deleguar. Detyrimi ynë tani, përmes themelimit të Asamblesë Parlamentare, është që të shtrojmë rrugën për të përmbushur pjesën e mbetur të përgjegjësisë tona.

Asambleja Parlamentare, ashtu si Kuvendi në tërësi, duhet t'i përmbahet qëndrimit të marrë më parë. Kjo do të thotë që ne duhet të vazhdojmë zotimin e palëkundur ndaj planit të Ahtisarit si një model për organizimin e Kosovës së pavarur. Plani i Ahtisarit mbetet modeli më i mirë për Kosovën për harmonizimin e interesave tona shtetërore me nevojën për një partneritet të ngushtë dhe efektiv me komunitetin ndërkombëtar në vitet që vijnë.

Deklarata jonë e Pavarësisë duhet të shprehë përkushtimin tonë për një Kosovë që është shtëpi për gjithë popullin dhe komunitetet që jetojnë në të. Duhet ta bëjmë të qartë se pavarësia e vendit është rezultat i historisë dhe kushteve aktuale të kombit shqiptar, por jo ekskluzivisht e një kombi të vetëm.

Ne nuk mund të zgjidhim në një dokument të vetëm apo me një akt të vetëm parlamentar të gjitha kontradiktat dhe konfliktet e historisë. Por duhet ta kemi të qartë se historia e Kosovës përfshin të gjithë popujt dhe kombet që kanë jetuar këtu në shekuj. Dhe ne duhet të jemi të sigurtë dhe të vendosur që pavarësia jonë do të mbrojtë të drejtat dhe interesat e të gjithë atyre që jetojnë këtu tani.

Vë re me keqardhje që kolegët tanë serbë nuk janë sot në Kuvend. Por ata do të jenë të mirëpritur në Asambleenë Parlamentare për Shpalljen e Pavarësisë, sepse ky është vendi i tyre gjithashtu. Unë i ftoj që t'i përgjigjen në mënyrë pozitive kësaj nisme dhe të zënë vendin e tyre në përcaktimin e së ardhmes së Kosovës.

Deklarata jonë e pavarësisë duhet t'i përçojë botës të drejtën tonë për shtetësi. E drejta jonë ligjore për pavarësi duhet të argumentohet me saktësi, dhe duhet të shpjegojë edhe të drejtën natyrore të popullit tonë për të vendosur për formën e vet të qeverisjes, edhe të drejtën ligjore të Kosovës për pavarësi që rrjedh nga faktet e historisë.

Deklarata jonë e pavarësisë duhet të tregojë rrugën drejt së ardhmes. Ditën që shpallim pavarësinë, Kombet e Bashkuara do të jenë ende këtu, siç kanë qenë për më shumë se 8 vjet duke mbikqyrur administrimin e vendit. Megjithatë, shpallja e pavarësisë nënkupton fundin e Misionit të Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë, ne duhet ta bëjmë në një mënyrë që të mënjanojmë konfliktin e panevojshëm dhe në vend të tij, të hapim rrugën për një zgjidhje të organizuar dhe të dakorduar.

Synimi ynë nuk është për të shpallur pavarësi të njëanshme, por për ta shpallur ashtu si duhet, për të fituar mbështetjen e botës demokratike.

Duhet gjithashtu të ftojmë NATO-n, partnerin tonë për çlirim, që të vazhdojë të mbështesë dhe mbrojë Kosovën. Ne duhet të shprehim angazhimin tonë për sigurinë, për veten, për fqinjët tanë, dhe për të gjithë anëtarët e Aleancës Veri-Atlantike, në respektimin e vlerave tona të përbashkëta të lirisë, paqes dhe demokracisë.

Dhe Deklarata jonë e Pavarësisë duhet gjithashtu të demonstrojë gadishmërinë tonë për të pritur ata anëtarë të bashkësisë ndërkombëtare që dëshirojnë të vazhdojnë mbështetjen për sundimin e ligjit në Kosovë dhe mbikqyrjen e zbatimit të angazhimeve tona ndërkombëtare.

Duhet gjithashtu t'u dërgojmë një mesazh fqinjëve të Kosovës, një mesazh risigurimi, të integritetit rajonal dhe të vazhdimësisë të marrëdhënieve të mira që kemi me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi.

Mesazhi ynë për Serbinë sigurisht do të jetë ndryshe, duke pasur parasysh intolerancën e udhëheqësve të saj ndaj lirisë së Kosovës dhe agresionit të saj kundër vendit tonë në të kaluarën. Por edhe duhet të shohim përtej kësaj, të shohim drejt ditës kur ne do të mund të zhvillojmë marrëdhënie të mira fqinjësore edhe me Serbinë, të bazuara në barazinë si shtete dhe në vlerat e përbashkëta të integritetit trans-Atlantik. Dhe duhet të pranojmë interesat legjitime të Serbisë për mirëqenien e serbëve të Kosovës.

Është përgjegjësia jonë për ta shpallur pavarësinë, pastaj duhet të përgatitemi për ta bërë këtë bashkë në një mënyrë që i shkon për shtati dinjitetit të të gjitha përpjekjeve tona për liri. Asambleja Parlamentare për Shpalljen e Pavarësisë nuk do të përbëhet nga partitë politike. Do të përbëhet nga anëtarë të këtij Kuvendi që pranojnë në përrputhje me diktatin

e ndërgjegjes së tyre për të marrë mandatin që u është dhënë nga populli, dhe të shpallin vullnetin e tyre për të jetuar në liri dhe paqe.

Ka ardhur koha që të dëshmojmë se jemi përfaqësues të këtij populli dhe se jemi të gatshëm të mbrojmë interesat e tij.

Të nderuar deputetë,

Bashkohuni me mua në pranimin e kësaj thirrjeje. Bashkohuni me mua në formimin e një trupi të veçantë gjithëpërfshirës, të një Asambleje Parlamentare për Shpalljen e Pavarësisë. Duhet ta bëjmë këtë për popullin e Kosovës. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Nga ORA Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA –

I nderuari President i Kosovës,

I nderuari Kryeministër,

I nderuari Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar anëtarë të Ekipit të Unitetit,

Deputetë, ministra,

Ne e përkrahim diskutimin të cilin e pati kryetari i Partisë sonë lidhur me këtë proces dhe, gjithashtu, përkrahim që ky Kuvend do të duhej të mblidhej jo vetëm kësaj here që është e nevojshme, po do të duhej të mblidhej edhe përpara shkuarjes në Uashington, sepse edhe Ekipi i Unitetit, edhe të gjithë do të duhej që të fuqizoheshin më tepër prej këtij Kuvendi dhe ta kishin mbështetjen e deputetëve, mbështetjen e Kuvendit.

Ky proces është nisur moti, është nisur prej të 99-ës, por më saktësisht, më afërsisht prej Bashkësisë Ndërkombëtare, e cila e pa që status quoja nuk mund të vazhdohet dhe angazhoi Kai Aiden që të definojë nevojën për ndryshimin e këtij procesi. Kjo vazhdoi pastaj me Ahtisarin, me dokumentin e të cilit shumica e anëtarëve të Bashkësisë Evropiane, të Amerikës, u pajtuan. Por, ky proces nuk përfundoi ashtu qysh e pritëm të gjithë, që të përfundojë më 2006, që të dorëzohet në Këshillin e Sigurimit dhe Këshilli i Sigurimit me një Rezolutë të ndryshojë 1244 dhe të shkojë në një proces të paraparë. Por, ky proces devijoi. Devijoi, ndryshoi dhe tash jemi para një realiteti të ri. Para një realiteti në të cilin Ekipi i Unitetit e ka pozitën më të dobësuar seç e kishte vitin e kaluar. Kosova dhe Kuvendi e ka një pozitë pakëz më ndryshe sesa që është paraparë më parë dhe me një kredibilitet më të ulët sesa që do të duhej të ishte.

Prej marsit të këtij viti, në fakt, roli i Ekipit të Unitetit, i cili ishte lojtar, ishte pjesëmarrës në vendime, ndryshoi dhe pas kësaj kohe Kosova, apo pala kosovare, mbeti më tepër si një shikues dhe jo partner i barabartë në këtë proces. Ky partneritet i ri do të duhej të tregonte një kualitet tjetër, të vazhdohet përsëri partneriteti, por me disa premisa tjera që edhe Ekipi i Unitetit të jetë partner më aktiv dhe që përmes Ekipit të Unitetit të dëgjohet zëri i deputetëve dhe me zërin e deputetëve të dëgjohet edhe zëri i Kosovës.

Është një kohë tjetër, e cila ka sjell shumë më tepër variabla dhe për ato variabla dhe për këtë kohë do të duhej që edhe ne të përgjigjemi me një unitet, me një strategji, me vendime të përbashkëta brenda, por gjithashtu edhe në partneritet me Bashkësinë Ndërkombëtare.

Është koha kur Kuvendi duhet ta rikthejë rolin e vet dhe që ky proces të tentojë të përfundojë përpara Vitit të Ri, përpara Kërshëndellave, përpara skadimit të afatit të këtij Kuvendi.

Gjatë kësaj kohe do të duhet që Ekipi i Unitetit dhe uniteti i gjithmbarshëm prej fjalës unitet të kalojë në një unitet të vërtetë, në një unitet të vërtetë të brendshëm dhe një unitet me Bashkësinë Ndërkombëtare, në mënyrë që ky proces i nisur së bashku, të përfundojë së bashku. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Nga Grupi 6+ Mahir Yagcılar.

MAHIR YAGCILAR – Faleminderit zoti Kryetar. Sayın Kosova Başkanı, Meclis Başkanı, Başbakan, Birlik Ekibi Üyeleri ve Sayın Milletvekilleri,

Sözlerime Kosova'nın tarihi ve kritik bir dönemden geçtiğini bir daha vurgulayarak başlamak istiyorum. Bu yüzden bize düşen görevi hepimiz yeni koşullarda en iyi bir şekilde yerine getirmeliyiz, dolayısıyla Kosova'nın nihai statü çözümü konusundaki uluslararası topluluğun yeni yaklaşımı karşısında ciddiyetimizi kanıtlamalıyız.

Kosova statüsü konusunda, hepimiz uluslararası topluluğun hodri meydan yaklaşımında olduğunun bilincindeyiz. Kendilerine has nedenlerden dolayı, bir bakıma dünyadaki büyük ve karar verici güçlerin boy ölçüşme sürecinde olduklarının da bilincindeyiz. Bundandır, bu kritik dönemde sabırlı ve tedbirli olmalakla birlikte, Kosova'ya daha çok taraftar ülke kazandırarak, ABD ile AB'nin ortaklığıyla bağımsız Kosova statüsünü sadece fiilen değil meşru olarak çözüme bağlamamız gerekmektedir. Bunu gerçekleştirebilmemiz için usuluslararası güçlerin desteğine, daha doğrusu Temas Grubu üye ülkelerin desteğine ihtiyacımızı göz ardı etmemeliyiz. Dolayısıyla Başkan Buşun ifadesi, AB'nin garantisi ve biz Kosova Meclisi üyelerinin ezici bir çoğunlukta kabul ettiği Ahtisari Planı gibi, elverişli esaslar mevcuttur. Bundandır 120 günlük müzakere sürecinin devamını lehimize dönüştürerek, Kosova bağımsızlığının tanınması konusunda ikircimlikle yaşanan tüm devletlere, dünyaya, bağımsızlık için olgun olduğumuzu göstermeliyiz. Bir yandan Kosova bağımsızlığının yörede istikrarlığı sağlayacağını ve tüm Kosova vatandaşlarına daha iyi bir yaşam temin edeceğini tasdiklerken diğer taraftan Kosova'nın fonksiyonel olup hukuk üstünlüğünün bütün topluluklara demokratik garantileri sağlayacak bir demokratik devlet olacağını da dile getirmeliyiz.

Kosova'nın, rüşvet ve buna benzer tüm diğer yolsuzluk ve olumsuz belirtilerlerden arındırılmış, en üst düzey demokrasi ve özgürlüklerin hüküm süreceği bir ortam olacağını ispat etmeliyiz.

Bu yüzden beraberlik ve gerçek politik birliktelik içinde olmakla birlikte, bir buçuk yıllık müzakere süreci içinde yapılan eksiklikler ortadan kaldırılarak yeni duruma daha liyakatlı

yanaşmalı, gelecek dönem ve yeni müzakere sürecine çok daha iyi bir şekilde hazırlanmalıyız.

Sayın milletvekiller,

Bildiğiniz gibi, merhum Başkan Rugova'nın önerisi üzere Birlik Ekibi'nin kuruluşu, ancak bu ekipte hiçbir temsilcimizin olmamasına ve yedekli davranmamıza rağmen, 6+ Parlamenter Grubu Birlik Ekibini desteklemiştir. Oyumuzu verirken önde gelen Arnavut partilerin birlikteliğinin Kosova'ya istikrarlık getireceğini ve müzakerelerde Kosovanın pozisyonunu güçlendireceği inancını taşıdık. Ancak, Birlik Ekibi konusunda, gerek oylama öncesi gerek sonrasında verilen vaadlere dayanarak, bu sürece etkin olarak katılacağımızı da umut ediyorduk. Diğer taraftan ne yazık ki koalisyon ortaklarımızda, bizleri de stratejik-politik grubuna veya uzmanlar grubuna dahil etmemekle birlikte, Birlik Grubu idare organında seferber edilmemizle ilgili çağrılarımıza da kulak vermediler. Bu yapılmadı, bazıları Topluluklarla Danışma Kurulunun bu amaçla kurulduğunu söyleyebilir. Topluluklarla Danışma Kurulu'nun, en iyi amaçla ve bizim de razımız üzere kurulduğu doğrudur, ancak bu kurul, toplulukların sadece istemlerinin ortaya atıldığı bir forum anlamını taşıdı ve ne yazık ki bu forumda ortaya atılan istemlerimiz son aşamada yeterince önemsenmedi. Öyleki bu Kurulda varılan anlaşmalar, Birlik Ekibinde ve hatta Kosova Meclisi'nde saygıyla karşılanmadı. Diller Yasası olayını herhalde hatırlıyorsunuzdur, yarın Kimlik Belgelerine ait Yasa konusunda bu durumun tekrarlanmayacağını umut ediyorum. Bu yetmedi bizim grubumuz, Viyanadaki müzakereler konusunda danışmalara dahil edilmeyerek, son dakikaya kadar, topluluklardan hangi temsilcinin müzakerelere katılacağı ve bu temsilcinin, topluluklar ve Kosova açısından ne konuda temsil edileceği de bilinmedi. Maalesef herhangi bir alanda ister şahsi olarak ister de temsil ettiğimiz topluluğun vekilleri olarak, yardımcı olup olamayacağımız konusunda da bizlerden düşünce istenilmedi. Daha iyi bir koordinasyon ve sağduyu karşısında yardımlarımızın daha fazla olabileceği düşüncesindeyim. Diğer taraftan, kamuoyu ve vatandaşların müzakere süreci hakkında yeterince bilgilendirilmeyerek, bazı önemli konular söz konusu olunca Meclis bile kenarda bırakıldı. Düşünceme göre gözlenen bu hattalar ortadan kaldırılarak Birlik Ekibi'nin yaptığı kusurları tekrarlamayarak bu süreci, daha dikkatli ve ciddiyetle incelemelidir. Eğer ki sürece aynı şekilde devam edilirse ve hattalar ortadan kaldırılmazsa bu kusurlar, muhakkak ki iç politik istikrarlığı ve beraberliği de olumsuz etkileyecektir.

Sayın milletvekiller,

Daha başlangıçta da belirttiğim gibi bana göre Kosova'da, mevcut olan fiilen durumun meşru kılınmasını gerektiren yeni bir sürece girmektedir. Müzakereler ve BM Güvenlik Konseyi sayesinde bu eylemin hayata geçirilmesi konusundaki ilk girişim maalesef ürün vermedi. Geçen dönemin başarılı olmamasına rağmen biz, Kosova vatandaşlarının çoğunluğunun istemlerini gerçekleştirmek için yeni çaba tüketmeliyiz. Bu doğrultuda akıllı ve sabırlı olmalıyız ve Kosova bağımsızlığının tanınmasıyla ilgili nihai süreç ve karara olumsuz etkide bulunabilecek hataları tekrarlamamalıyız. Türk Demokratik Partisi ve „Vakat“ Boşnak Koalisyonundan oluşan 6+ Parlamenter Grubu olarak bizler de nihai amacın gerçekleşmesine kendi katkımızı sunarak şu önlemleri öneriyoruz :

- 120 günlük dönemin ciddiye alınması ve üstü kapalı davranılmaması;
- Gelcek 120 günlük döneme ait stratejinin hazırlanması;
- Statü ile ilgili olası kararlar hakkında 120 günden sonraki döneme ait Stratejinin hazırlanması;
- Temas Grubunun, Kosovanın bölünmemesi, Kosovanın diğer bir devletle birleşmemesi ve 1999 yılından önceki statüye dönmemesi ile ilgili önceki temel tutumların, Ahtisari paketinin açılmasından önce, herhangi bir olası müzakere şekli için başlangıç nokta olarak göz önünde bulundurulması;
- Stratejinin hazırlıklarına, strateji-politik grubundan başka, parlamento gruplarının da katılımının sağlanması;
- 120 günlük dönem sonlarına kadar kabulü için Anayasa'nın hazır olması ve bu arada Ahtisari planı ile öngörülen Yasaların kabul edilmesi;
- UNMİK şefinden, yeni Yasaları hazırlarken Ahtisari Planından yararlanmamız için Yasal esası sağlamak amacıyla, yeni Kosova Anayasasının kabulüne kadar Anayasa Çerçevesi'nin, Ahtisari Planı'nın İlaveleri ile tamamlanması;
- Yeni stratejiye uyumlu olarak, parlamento ve yerel seçimlerin öngörülmesi;
- Kosovanın nihai statüsünün belirlenmesi amacıyla ABD, AB ve diğer uygun uluslararası faktörler ile ortaklığın devam etmesi ve gelecek 120 gün içinde tek taraflı faaliyetlerde bulunulmaması;
- Sürece tüm toplumların etkin olarak katılımının sağlanması;
- Yeni Hükümetin kurulmasına kadar bugünkü Hükümetin güçlendirilmesi;
- Diller Yasası, Kültürel Miras Yasası ve diğer önemli yasalar gibi şimdiye kadar kabul edilen yasaların gerçek uygulanmasının sağlanması;
- Kosovanın bütün vatandaşları için tam güvenliğin ve serbest devinimin sağlanması;
- Rüşvet, devlet kaynaklarının ve mali araçların elverişsiz kullanımı konusunda gerçekten sıfır toleranslığın uygulanması, dolayısıyla bu kurallara saygı göstermeyenlere karşı sert önlemlerin alınması;
- Birlik Ekibi, Hükümet ve Meclis arasında daha iyi koordinasyonun sağlanması;
- Süreç hakkında kamuoyu ve vatandaşların, daha yakından bilgilendirilmesi;
- Dışilişkiler Bakanlığı ve Savunma Bakanlığının 120 günden hemen sonra etkinleştirilmesi için tüm teknik ve politik hazırlıkların sona ermesi.

Sayın milletvekiller,

Biz, ortaya attığımız bu bazı önerilerimizin göz önünde bulundurulacağına ümitle bakıyor, hepimiz için önemli olan gelecek süreç içinde uygun muamele görmeyi ve etkinliklere dahil edilmeyi arzu ediyoruz.

Konuşmamın sonunda Birlik Ekibinin gerçek birlikteliğini ve otoritesini korumasını diliyor, bu önemli ve kritik dönemde başarılı olarak bizi yönetmesini isterken, hepinizi içtenlikle selamlıyor ve dikkatiniz için teşekkürlerimi sunuyorum. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Grupi për Integrim Vezira Emrush. Urdhëroni, Baliq!

NUMAN BALIĆ – Faleminderit zoti Berisha. Dozvolite da u samom početku selamim i dopustite mi da kažem nekoliko reči u ime Grupe za integraciju i u moje osobno ime vezano za probleme koje sve nas okupljaju, koje se tiču sudbine Kosova i njegove budućnosti.

Mislim da je vrijeme da mi koji smo članovi kosovskog parlamenta, političari, estrabilišment koji vodi ovu zemlju, kosovski narod u cjelini, da je vrijeme da ozbiljno preispitamo dosadašnju politiku koja je vođena na Kosovu i šta da radimo dalje. Mislim da trebamo ozbiljno razmotriti odnos prema sebi samima, odnos prema narodu Kosova, odnos prema Evropskoj Zajednici i Americi, prema regiji i ostatku svijeta.

Naravno, uvijek zaboravljamo da taj ostatak svijeta ima blizu 5 milijardi ili godovo 90% stanovništva na zemlji i da je u tom takozvanom ostatku svijeta nekoliko važnih članova Savjeta Bezbednosti, od kojih je i zavisilo u mnogome izglasavanje, nažalost, neuspješno izglasavanje Rezolucije u Savetu Bezbednosti o Kosovu. Dakle, rječ je o propustima koje moramo ispravljati.

Dopustite mi da zajednički razmatramo neke stvari koje se tiču ovih pitanja koje sam naveo. Ponoviću pitanja koje sam rekao na prošlom sazivu parlamenta: Da li smo mi sigurni da je Evropska zajednica spremna da podrži pravedno rešenje kosovskog pitanja. Pravedno rešenje kosovskog pitanja jeste država Kosova koju ovaj narod saslučuje, koju svi narodi i većinski Albanci, Bošnjaci, Gorani i svi ostali podržavaju i zalažu se za nju i da li su Evropska Zajednica i Amerika spremne da bezuslovno podrže takvo Kosovo. I pitanje takođe, dali je u okviru ovih procesa koji su vezani za Kosovo, dali će Amerika takođe biti spremna da ispuní obećanja koja su data vezano za rokove, vezano za status, vezano za punu nezavisnost, vezano za proglašenje nezavisnosti u ovom parlamentu i sva ona pitanja koja smo ovih dana pratili budno i sa pažnjom.

Ja ću zajedno sa vama pokušati da postavim neke činjenice na sto i da pokušamo da nađemo odgovore. Najprije i Evropljani i Amerikanci ne mogu dati sigurne garancije da će Kosovo biti država, da će biti bezuslovno nezavisno. Oni čak ne mogu dati garancije ni da će ono biti uslovno ili nadgledano nezavisno.

Drugo, Ahtisarijev paket je u krizi. Nakon što je odobren, nakon što je usvojen, sada imamo pomjeranja, već se nagovešava njegovo povlačenje, a možda i propast. Treće, sasvim su sigurni novi pregovori. poslednje vjesti govori o tome da je prvi čovek evropske diplomatije imenovao čovjeka koji će voditi pregovore o Kosovu. Dakle, u pitanje je jedna velika kontradikcija. Na jednoj strani Evroamerikanci insistiraju na Ahtisariju, koji znači kraj procesa o statusu Kosova, ali na drugoj strani se jasno govori o novim pregovorima. Oprostite, ali ta kontradikcija nije moguća. I Ahtisarijev paket, i novi pregovori, to jednostvo nije moguće. Jedno ili drugo, oboje ne može.

Četvrto, stvar koja je vrlo važna. Sve se više govori o mogućem kompromisu koji će verovatno za nas kosovare biti bolan ili gorak. Sve se više nagoveštava mogućnost stvaranja srpskog entiteta na Kosovu ili davanja jednog dela suvereniteta nad Prištinom – Beogradu. To su stvari koje su neprihvatljive na Kosovu. Šta su alternative? Alternative su podjela Kosova, bilo davna dogovorena podjela ili naravno o čemu se takođe sve glasnije i glasnije govori, o čemu se već spominje da pojedini evropski aktori i razgovaraju o tom pitanju, ili naravno nasilna putem rata, stvari koje su veoma opasne i o kojima trebamo ozbiljno da razmišljamo. Dakle, u pitanju je jedna stvar zbog koje moramo svi biti jako zabrinuti. Jedna od alternativa je, naravno, i stavljanje Kosova u neki položaj Kipra na Balkanu ili, nedaj bože, nagoreg pitanja- Palistine na Balkanu. Dakle, nešto što nikako ni bi odgovaralo ovom narodu.

Šesta stvar koja je vrlo važno a koje se tiče rokova jeste da nijedan od rokova više ne važi, ništa više nije sigurno. Pregovori koji se nagoveštavaju uopšte nije sigurno kad će početi, niko ne garantuje kako će se pregovori završiti, niko ne daje garancije da će status biti riješen ove godine. Dozvolite mi da osobno predvidim da status Kosova neće biti riješen ove godine, jednostavno nema vremenskih mogućnosti. Ja čak osobno ne mogu predvideti da će on biti rešen i sledeće godine. Dakle, mi smo u situaciji da ozbiljno razmislimo o tome šta nas čeka i da nađemo rešenja za ta pitanja. I, naravno, dozvolite mi da kažem da na kraju imamo historijsku dilemu šta da postupimo i kako da uradimo. Prdlažem da promenimo ukupan odnos prema ovom pitanju. Moramo podvući crtu i moramo preći sa pasivne politike, politike koja je podrazumjevala da mi jednostavno prenosimo ono što nam se kaže i radimo ono što nam se kaže, da pređemo na aktivnu politiku. Mislim da je kraj razdoblja pasivne politike koja traje jedan dug period vremena ovde na Kosovu.

Predložio bi da mi ne možemo dati blanko sudbinu Kosova bilo kome u svjetu, niti Sjedinjenim državama, niti Evropi, niti bilo kome bez da nam garantuje jasno: „dobićete državu tada i tada i toga i toga mjeseca“. Bez toga nema davanja blanko sudbine. To ne radi nijedan politički narod na svjetu. Mi kosovari to ne smjemo uraditi.

Druga stvar koja se tiče jeste da moramo naći načina da artikuliramo snagu ovoga naroda koju ima, koja je uspravna, koja je disperzirana i koja je izgubljena. Moramo povratiti vjeru među ljudima, dakle snaga naroda koju je uzvišeni bog dao ovome narodu kao jednom od naroda na Balkanu koji se najviše množi, kosovski albanci se najviše povećavaju u celoj ovoj regiji. Svi mi kosovari smo narod koji rastemo. Moramo iskoristiti tu snagu, i mi moramo naći odgovorna pitanja kako da dođemo do snage koja je potrebna da stvorimo državu, kako da dođemo do sange koja je potrebna da održimo tu državu i kako da dodjemo do snage koja je potrebna da odbranimo tu državu i ako je potrebno ratom da je odbranimo. I ako je potrebno da tu državu održimo ne za 10. godina i 20. godina, nego 100 i 200 godina. I u onoj situaciji kada Amerika bude najjaća ili kada Tirana bude jaća ili kada Južna Afrika ili bilo ko. Dakle bilo kada i u svim uslovima. To je istorijski odgovor na pitanje koje mi moramo dati i svome narodu, i sebi samom. Moramo malo prelistati udžbenike iz istorije i vidjeti kako se prave države. Oprostite, ali one se ne donose na sahanu i ne serviraju se nikome. Neće nama niko donjeti na sahanu našu državu, mi se moramo boriti za nju, naravno zajedno sa našim

prijateljima, sa našim saveznicima, sa prvim prijateljem ove zemlje, sa Amerikom, sa Evropom, sa svima onima koju su nas godinama pomagali. Naravno, zajedno sa njima, ali ne da oni rade, a mi da spavamo. To se mora promijeniti i to je novi akcenat koji moramo uraditi. Ja nisam video u nijednom od današnjih govora da se to jasno i isričito spomenulo. Svi se oslanjaju na nekoga drugoga. Naravno, oslonićemo se na njihovu pomoć, ali mi moramo da radimo i moramo da saslužimo to što dobijemo. I, naravno, dozvolite da dam predloge pošto je uobičajeno i popularno da se daju predlozi. Daću ja i neke predloge, nadam se i uz podršku mojih kolega iz grupe, a i moje neke predloge.

Mislim da Skupština Kosova ima obavezu da gospodi pregovaračima iz Grupe pregovora postavi pitanje: da li su u stanju da urade ono na čemu su potrošili najveći deo svoga mandata? Najveći deo političkog zalaganje Grupe za pregovore bio je status i država. Gospodo, jeste li u stanju da nam stvorite državu i kada ćete da je stvorite. Vi ste dužni da to odgovorite. Ako niste dužni, molimo vas, položite račune Skupštini, povucite se. Ja predlažem da se povučite, a naravno Skupština će odlučiti. Ja kao čovjek predlažem, a vi rešavajte.

Dalje, mislim da je Vlada koja sada postoji, velikim djelom izgubila legitimitet kako zbog broja poslanika koji je značajno umanjen zbog stvaranja nove parlamentarne grupe, tako i zbog, jednostavno, političkih činjenica koje postoje. Ne možemo sebe zavaravati da imamo Vladu koja nema više od 55 članova - glasova u parlamentu, a treba joj 61. Predlažem da se formira sveobuhvatna vlada koja će obuhvatiti sve političke faktore i nove političke faktore i predlažem da to bude model koji će biti i kod budućih izbora. Svakako, Vlada mora biti sveobuhvatna. I stvar koja se tiče, takođe, i ostalih zajednica: Bošnjaka, Roma Egipćana. Aškalija, Gorana, Turaka i svih ostalih. Moramo naći mogućnosti da sve zajednice budu uključene, dakle, svi politički faktori, sve partije, stare i nove, ...(prekid diskusije), sve političke snage i sve etničke zajednice dođu do svog izražaja onako kako su neki od poslanika ovde govorili. Dakle, moramo imati osjećaja za zahteve i Bošnjaka i Gorana i svih ostalih, moramo imati sluha za zahteve za decentralizaciju, za jezik, za pismo, za kulturu. Moramo imati osjećaja i za pitanje Mamuše, i za pitanje Gore, i za pitanje Vitomirice, i Rečane i tako dalje. To je jedini način i predlažem da nijedo od krupnih pitanja ne riješimo bez zajedničkog konsenzusa.

Sada ću se na kraju baviti jednim pitanjem koje bi značilo jedno od pitanja po kojima bi smo ...išli . I na kraju, naravno, ono što smatram najvažnijim. Pitanje opstanka ove političke elite i uopšte političkog establišmenta na Kosovu su novi izbori. Ja vas molim, danas govorim sa namerom da budem najkonstruktivniji. Ukoliko ne održimo izbore ove jeseni, imaćemo veliku političku krizu, za koju će najprije biti odgovorni oni koji su u Vladi, a onda i svi mi ostali. I ja, naravno, jer uvijek sam prihvaćao moju odgovornost.

Sadašnje političko rukovodstvo, na žalost, nije u stanju da se nosi, nije u stanju da se nosi sa ovim problemima koji postoje. Mislim da igra ili priča oko toga da ako se bude rešavao status Kosova ne možemo držati izbore, a ako se ne bude rešavao status Kosova, održaćemo izbore. To je obmana, to je varka. Nemojmo da, mi smo svi odrasli, punoletni, znamo o čemu se radi. Nije moguće da mi ponovo odložimo izbore zbog statusa jer smo jednom već odložili. vi ste dobro sjećate sastanka, dozvolite mi to da posvedočim. 26.

aprila prošle godine u zgradi OSCE-a koji je vodio gospodin Petersen i tada mislim da je bio predsednik Sejdiu. Tada sam osobno rekao da razlog za odlaganje izbora prošle godine zbog statusa je nevaljan, jer tada status te godine nije bio riješen i ni ove godine neće biti status riješen. Pa koja je logika da odlažimo izbore zbog statusa koji neće biti riješen. Moramo biti otvoreni i poštteni prema sebi i prema javnosti Kosova.

Mislim da je ključ opstanka političke elite na Kosovu održavanje izbora i mogućnost, naravno, da još jednom isprobamo narod. Prebacićemo odgovornost za narod, biće otvorene liste, biraće najbolje kandidate. Oni ljudi koje oni odaberu, podjeliće zajedničku odgovornost. Prema tome, ne možemo samo Grupu za pregovore i nego i za ostale. I da se osvrnem na još jedno pitanje koje je vrlo važno, ovo je zadnje.

Gospoda Syla je govorilo vrlo vano pitanje koje se tiče proglašenje nezavisnosti. Ja ne znam da li ćemo imati mogućnost da ponovo govorim za ovim parlamentom. Imam obavezu kao građanin Kosova, kao čovjek koji se bori za ovu zemlju i dalje se bori za državu Kosovo, da kažem jednu stvar.

Molimo vas, razmislite oko toga, hoće li se Evropa i Amerika jednoglasno dogovoriti oko toga da podrže ono rešenje kada ovaj parlament Kosova kaže - mi hoćemo državu Kosova. Razmislite oko toga. Ja mogu da predvidim da veliki broj evropskih zemalja neće biti spreman da podrži kosovski parlament da izglasa rezoluciju o nezavisnosti. Naravno, da mi ćemo raditi u tom smislu, ali moramo biti oprezni i odgovorimo sebi na pitanje, jesmo li mi sigurni onog momenta kad mi proglasimo državu Kosova ovdje u parlamentu da Srbi neće okupirati djelove Kosova u kojima oni imaju većinu, jesmo li mi sigurni da oni neće bombardirati Mitrovicu i Prištinu, a možda i Peć i Prizren? I zar to nije obaveza za nas da mi kao članovi parlamenta budemo na prvim borbenim linijama, a ne da se ponašemo kao 99-te kako je bilo. Dakle, moramo biti spremni za to. Ja kažem sad i obećavam, ako ne bi podržao nijedno rešenje za koje se svi dogovorimo, ali ako ovaj parlament to uradi i ako bude trebalo da se puca, biću sigurno onaj koji će biti na tim linijama gdje se treba braniti ovo Kosovo, ali ne rječima, nego djelom.

I na kraju, naravno, ovo je bio moj doprinos ovoj diskusiji i ovom zajedničkom pitanju. Mislim da trebamo biti veoma zabrinuti i da trebamo zajednički rešavati pitanje. I mislim da nijedno globalno pitanje od sudbinske važnosti Kosova nebi se trebalo rešiti bez opšteg konsenzusa i zajedničkog dogovora i bez toga da se dogovaramo oko toga sve dok se potpuno ne dogovorimo u interesu ovog naroda. Hvala vam lepo!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ramadan Kelmendi -LDD, Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI – Faleminderit, zoti Kryetar, anëtarë të Ekipit të Unitetit, të nderuar deputetë,

Së pari, pas gjithë këtyre debateve, do të thoja, diskutimeve që i patëm deri tash, do të duhej një pyetje t'ia shtronim vetvetes: a ka qenë i nevojshëm ky debat sot të zhvillohet në një format të tillë çfarë është duke u zhvilluar? Ka qenë i nevojshëm dje, sot është

dashur të konceptohet pak më ndryshe dhe ta kemi një qasje krejt tjetër. Pra, është edhe një lëshim në vazhden e lëshimeve që na kanë përcjellë si Kuvendi i Kosovës.

Është e vërtetë se para 4 muajsh kemi pasur debat. Mirëpo, është shumë e vërtetë se pas 4 muajve, debatit të fundit, prapë e kemi të njëjtën retorikë, e kemi prapë të njëjtën qasje. Derisa procesi ka evoluar, dinamika është shumë e theksuar dhe sot prapë po diskutojmë gjëra të njëjta. Megjithatë, sot secili prej nesh ka shumë çka të diskutojë për arsye se ka të bëjë me një çështje që është jetike për qytetarët e Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Në këtë sallë të këtij Kuvendi na është thënë shumë herë se çështja e pavarësisë së Kosovës është çështje dite, bile, bile është çështje e metrave të caktuar. Por, shumë më keq, ka pasur edhe raste kur edhe gazetarëve u është thënë - mos u largoni për vikend nga Prishtina se mund të ndodhë diçka që Kosovës do t'i hakmerret në aspektin propagandës mediale. Pikërisht kjo ka të bëjë dhe këto janë disa elemente që tregojnë qartë performansën e politikës sonë aktuale me një fotografi shumë të qartë.

Në këtë parlament është votuar Grupi i Unitetit, në atë kohë me një përbërje krejt tjetër, për të udhëhequr një proces të përcaktimit të statusit të Kosovës, me të gjitha kapacitetet e mundshme njerëzore dhe materiale që bashkërisht ta arrijmë cakun aty edhe e kemi. Por, ja që sot kemi një proces, i cili jo vetëm është degjeneruar, por edhe ka devijuar nga platforma bazë për çka është përcaktuar ky Kuvend i Kosovës. Krejt kjo mund të shtohet me një proces të skajshëm të josinqeritetit dhe lirisht të themi pa një vizion të qartë për cakun se ku dëshirojmë të arrijmë. Kjo mund të argumentohet dhe në anën tjetër nuk është hera e parë apo e fundit që Grupi ynë Negociator është zënë gafil në befasi sa herë që kemi të bëjmë me proces të shtyrjes së statusit dhe gjithnjë kemi dëgjuar dhe prapë po dëgjojmë një retorikë të njëjtë, pa pasur një qasje koherente për t'i ndryshuar këto rrethana dhe pa i adaptuar nevojat që shtron procesi politik në vend. Kjo dëshmon më së mirë se Grupi i Unitetit, mirëpo edhe institucionet nuk kanë qenë në nivelin e përgjegjësisë politike, nuk kanë qenë në nivelin e sinqeritetit dhe të përgjegjësisë qytetare dhe deklaratimet që janë bërë, lirisht mund të kuptohet jo vetëm nga klasa politike, ata të cilët munden në kohëracë të analizojnë, mirëpo ka qenë pjesë e një propagande apo marketingu personal sesa pjesë e një strategjie komunikuese me opinionin. Këtu lirisht mund të shtojmë se e gjithë kjo strategji e komunikimit “me opinionin” ka përmbajtur doza të larta të iritimit dhe kemi një situatë çfarë e kemi.

Unë po ashtu do ta përmend edhe një fakt të pamohueshëm edhe ai ka të bëjë me keqkuptimin dhe keqinterpretimin e partneritetit me Bashkësinë Ndërkombëtare. Ne jemi mirënjohës, jemi dhe do të jemi mirënjohës për punën që ka bërë Bashkësia Ndërkombëtare në krye me SHBA-të në procesin e çlirimit të Kosovës dhe tash në procesin e pavarësisë së Kosovës. Mirëpo, nuk mund të pranojmë dhe nuk është nevoja që sot nevojën për partneritet të mirëfilltë, të qëndrueshëm, që dikush e propagandon, ta kthejë dhe ta përdorë për qëllim konsumi të brendshëm politik.

Të nderuar deputetë,

Tashmë jemi të vetëdijshëm se po hapet një kapitull i ri 120 ditësh për Kosovën dhe sot klasa jonë politike, e sidomos Grupi i Unitetit aktualisht është një pat pozicion. Kjo po shihet krejt prej deklarimeve që kemi pasur deri më tash. E kjo mund të vazhdojë edhe do të vazhdojë kjo gjendje derisa kemi dhe mungon një vizion shumë i qartë, mungon profesionalizmi që është parë dhe mbi të gjitha përgjegjësia dhe sinqeriteti.

Unë jam i vetëdijshëm për atë çka u tha deri më tash dhe jam i vetëdijshëm se do të thuhet edhe me këtë rast. Mirëpo, një gjë do ta përmbylli me këtë. Ekipit të Unitetit dhe klasës politike kosovare i nevojitet një këndellje dhe tash nuk është koha as të prognozojmë për muaj, as të prognozojmë për data, por është koha për një qasje të përgjegjshme dhe të paktën një sinqeritet të demonstrohet në raport me qytetarët e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli.

EMRUSH XHEMAJLI –

I respektuari President i Kosovës,

I respektuari Kryetar,

Të nderuar anëtarë të Grupit Negociator, qeveritarë, ju kolegë deputetë dhe përfaqësues të zyrave diplomatike në Prishtinë dhe gjithë ju pjesëmarrës që jeni këtu,

Lëvizja Popullore e Kosovës i përshëndet debatet, pra edhe këtë debat, kur ato dalin me përfundimet e nevojshme dhe shpresoj se kështu do të ndodhë me debatin të sotëm. Me vëmendje e kemi përcjellë qindra takime që janë mbajtur brenda dhe jashtë Kosovës lidhur me statusin përfundimtar të vendit.

Qe tetë vite çështja e Kosovës është duke u sjellë në një rreth vicioz, i cili tani është më i dukshëm se kurrë. Shprehim keqardhjen tonë thellë për dështimet e deritashme që përmes Këshillit të Sigurimit kaloi çështja e pavarësisë së Kosovës. Për neve ky është një lajm shumë i keq. Ka mbetur edhe një rrugë pa u provuar, që Kuvendi i Kosovës, Qeveria, Presidenca dhe populli i Kosovës, në koordinim në mes veti dhe me aleatët e Kosovës të koordinojnë shpalljen e pavarësisë përmes Kuvendit, përmes formave demokratike - referendumit ose propozimeve që u dhanë këtu.

Kjo formë e pavarësimit nuk është e njëanshme, por formë e rregullt në mënyrë siç kanë vepruar edhe të tjerët. Gjithë ata që po kërkojnë që edhe Serbia të pajtohet me pavarësinë e Kosovës, jo vetëm nuk janë realistë, por thjesht janë duke u tallur me institucionet e Kosovës dhe me qytetarët e këtij vendi. Ne kemi qenë dhe jemi që Këshilli i Sigurimit dhe mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë të zgjidhin çështjen e Kosovës, por të gjithë jemi dëshmitarë se ata kanë vështirësi dhe nuk po mund ta bëjnë këtë. Ne jo se jemi më të fuqishëm se ata, por për faktin se neve na takon ta kryejmë një pjesë të punës. Për atë ne duhet të lëvizim. Andaj, shpallja e pavarësisë në njëfarë forme na u ka imponuar nga nevoja për përparim, për zhvillim dhe për të ardhmen tonë. Ne nuk mund të pajtohemi me praktikën, sipas së cilës, Serbia vepron njëanshëm kundër Kosovës, ndërsa kundërshtarët e veprimit të njëanshëm heshtin. Rasti më i freskët është Rezoluta e njëanshme e Serbisë

me cilën sulmohet Kosova, ndërsa kur vepron Kosova në mbrojtje të interesit të saj vital për të dalë nga bllokimi, kjo quhet veprim i njëanshëm. Andaj, janë për keqardhje edhe thirrjet që, në fakt janë thirrje të njëanshme nga drejtimet e ndryshme që palët të mos bëjnë veprime të njëanshme, sepse këtu me palë kuptohet vetëm njëra palë, kuptohet vetëm Kosova, ajo që vërtet ka nevojë të bëjë veprime të nevojshme për zhvillim. Kjo punë është, thjesht, me dy kritere, që nuk shkon. Për këto arsye, Kuvendi i Kosovës, me propozimin e shëfave të grupeve parlamentarë, për mendim tonë, sot duhet të votojnë Propozim agjendën e veprimit të Kosovës dhe këtë ta shtrojnë para aleatëve dhe në këtë agjendë, për mendimin tonë, duhet të mos përfshihet vetëm një vendim i vetëm, po të dilet me një paketë vendimesh edhe për arsye se ky Kuvend është vonuar shumë për të marrë vendime një nga një. Unë pajtohem me propozimin e zotit Jakup Krasniqi, përkatësisht me shumicën e kërkesave që i shtroi aty, një paketë vendimesh që duhet të merren. Gjithashtu, një propozim shumë të mirë e pati edhe zonjusha Gjylnaze Syla, e AAK-së.

Këtu të gjithë jemi në një mendje, që të caktohet një datë e deklarimit të pavarësisë së Kosovës dhe ndërkohë të përgatitet vendi për atë akt, të bëhet Kushtetuta, të bëhen të gjitha aktet. Mendoj se edhe një diçka tjetër këtu duhet të ndodhë. Duhet të shikohet edhe pozicionimi i Serbisë, përkatësisht raportet ekonomike të pashpallura, por që funksionojnë në mënyrë të padrejtë mes Kosovës dhe Serbisë.

Kjo agjendë për të cilën po flasim, mund të mos jetë e njëjtë me agjendat që kanë shtetet veç e veç, si dhe organizmat e caktuar ndërkombëtarë që merren me Kosovën. Por, meqë është kështu, puna e institucioneve të Kosovës do të ishte që t'i koordinojnë agjendat, agjendën e vet, hapat e veprimet për të përfunduar me sukses një mision të përbashkët.

Në emër të LPK-së jam kundër çfarëdo bisedimi me Serbinë para shpalljes dhe njohjes Kosovës shtet pavarur dhe sovran. Bisedime duhet të ketë gjithmonë mes shteteve, por ato sot me Serbinë më nuk kanë kuptim, nuk kanë sukses. Para pavarësisë së Kosovës çdo gjë është e kotë. Atëherë, pse duhet të merremi me punë dhe me veprime të kota. Nuk ka kuptim të vazhdohet kështu në formë të pasinqertë në veprime ku, nga të gjithë ata që janë të përfshirë në çështjen e Kosovës, humb vetëm Kosova me aleatët e vet, ndërsa fiton vetëm Serbia dhe Rusia. Nuk ka kuptim që të vazhdohet me bisedime derisa barrën e rëndë të humbjeve të gjithanshme në ekonomi dhe në shoqëri e bartë Kosova, ndërsa Serbia, nga pozita komode dhe cinike për teket e saja agresive, vështron me qesëndi duke u përpëlitur një popull i tërë.

Sipas institucioneve financiare ndërkombëtare, Kosova para disa viteve ishte jo shumë larg në të hyra për kokë banori me vendet fqinje. Tani ajo ka ngecur, në kohën kur vendet tjera përreth janë duke ecur me hapa të shpejtë. Stagnimet janë pasojë direkte e statusit të pavendosur të vendit tonë. Ata që kërkojnë apo që pajtohen me bisedime shtesë, duhet të llogarisin edhe humbjet shtesë të Kosovës. Këto humbje janë të pallogaritshme. Serbia jo vetëm nuk ka mbuluar dëmet miliardëshe që i ka shkaktuar në kohën e luftës së Kosovës, por po vazhdon bashkë me Rusinë t'i shkaktojë miliarda humbje të tjera. Çdo insistim për bisedime shtesë pa biseduar kush i mbulon këto humbje, janë pastër kundër zhvillimit të Kosovës. Andaj, ne po kërkojmë që përmes një takse shtesë për mallrat e Serbisë, që

lirisht mund të quhet taksa e shtyrjes së statusit, për të cilën vetë është fajtores, t'u vihet mallrave të Serbisë në mënyrë që Serbia mos ta përdorë Kosovën si treg të shkretë neokolonial.

Ata krerë që deklarohen për bisedime nuk e ndiejnë peshën e vuajtjeve të një populli të tërë sot, por do ta ndiejnë. Kriza do të ndihet shpejtë edhe te krerët e institucioneve të Kosovës. Gabohen të gjithë ata që po mendojnë se mund të kenë një fakt tjetër nga pjesa tjetër e qytetarëve të vuajtur të Kosovës, nga mësuesit, nga punëtorët e shëndetësisë, punëtorët e krahut, punëtorët e biznesit, të shërbimeve, fat tjetër prej policëve apo prej ushtarëve të TMK-së.

Unë nuk kisha dëshiruar ta kritikoj Grupin Negociator dhe nuk do të zgjerohem. Por është një moment, në të cilën mendoj se vendi është dëmtuar së tepërmi dhe nuk ka kurrfarë kuptimi që tejkalohet. Është fjala për rimandatimin e këtij grupi. Pas dorëzimit të pakos së Ahtisarit në Këshillin e Sigurimit, nuk u ripozicionua Kuvendi rreth këtij grupi dhe nuk u rimandata, kështu që objektivisht kemi dalë kontradiktor para botës, sepse me të drejtë njerëzit kanë pyetur: - pasi ky ekip negociator tha që s'ka më bisedime, pse atëherë nuk e dorëzon mandatin? Ai nuk qenka për bisedime, d.m.th. nuk ka pasur kurrfarë logjike. Është dashur që Kuvendi i Kosovës të kujdeset t'i rimandatojë jo vetëm për faktin se po dëshirojnë të jenë në grup, por edhe për nevojat të Kosovës. Kështu, kjo i ka prurë në situatë vendet e ndryshme, është dhënë mesazh i gabuar, më shkurt, është dhënë mesazh se duke ekzistuar ky grup i negociatave pa objekt negociatash, shqiptarët ndoshta po donë ende bisedime dhe, si rrjedhim i kësaj, jo vetëm i kësaj, nënkuptohet, ka ardhur deri te kjo situatë, në të cilën një pjesë të fajit duhet të jemi ndërgjegjshëm se duhet ta mbajë edhe Grupi Negociator dhe të gjithë ata që janë zyrtarë të lartë të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Naim Maloku, e pastaj shkojmë në drekë.

NAIM MALOKU – I nderuari zoti Kryetar i Kosovës, dola në foltore kur u hap debati për deputetët e këtij Kuvendi për faktin se dëshiroj t'ju shohë në sy. Më lejoni që t'ju jap mbështetje të plotë fjalës së juaj, zoti Kryetar, shtatë parimet e cituara në fjalën tuaj i konsideroj si parime të arritura me konsensus brenda Grupit të Unitetit, shtatë parime të cituara këtu para këtij Kuvendi në fjalimin tuaj, zoti Kryetar, unë i konsideroj si bazë për të vazhduar procesin në të cilin po hyjmë tani dhe po vazhdohet jo me dëshirën dhe vullnetin tonë, jo me dëshirën dhe vullnetin as tuajin, të nderuar anëtarë të Grupit të Unitetit.

Më lejoni që të përshëndes Kryetarin e Kuvendit, zotin Thaqi, kryeministrin Çeku, Surroin dhe të gjithë juve deputetë të pranishëm.

Ne i kemi besuar Bashkësisë Ndërkombëtare, ne i kemi besuar paqes, kemi qenë popull paqësor edhe atëherë kur të tjerët janë djeg në luftë. Kur janë bërë masakra dhe humbje qindra mijëshe, ne kemi besuar në faktorin ndërkombëtar, kemi besuar që do të ndalet ajo dhunë, kemi besuar që do të ndalet lufta, kemi besuar që problemi i Kosovës do të

zgjidhet me mjete paqësore. Nuk e kemi filluar luftën për qejf, e kemi nisur atëherë kur s'kemi pasur çka të bëjmë tjetër, kur na u kanë shterë të gjitha mundësitë, e kemi nisur nga pamundësia për të gjetur rrugëdalje tjetër. Na u ka imponuar lufta. I kemi besuar Bashkësisë Ndërkombëtare të gjithë bashkë edhe në Rambuje, i kemi besuar që do të ndërhyjë dhe do të ndalet gjakderdhja në Kosovë. I kemi besuar Bashkësisë Ndërkombëtare dhe miqve tanë edhe në misionin e UNMIK-ut dhe të KFOR-it në Kosovë.

Të nderuar të pranishëm,

Bashkësia Ndërkombëtare kurrë nuk ka pasur, nuk ka dhe nuk do të ketë misione më të lehta ushtarake dhe paqësore sesa në Kosovë. Kjo është meritë e besimit që e ka pasur populli i Kosovës jo meritë e institucioneve të Kosovës, por meritë e popullit të Kosovës, të besimit të popullit të Kosovës në misionet paqësore që janë zhvilluar dhe po mbahen në Kosovë. Kemi besuar se ata nuk kanë ardhur veç për neve, kanë ardhur për Kosovën, kanë ardhur edhe për të tjerët rreth nesh, kanë ardhur për procese pozitive në rajon.

Ne kemi hyrë në procesin negociator duke besuar në Bashkësinë Ndërkombëtare, që është proces i Bashkësisë Ndërkombëtare. Të nderuar të pranishëm, plani i Ahtisarit ka qenë plan i udhëhequr nga Bashkësia Ndërkombëtare. Ne i kemi besuar Bashkësisë Ndërkombëtare, ne e kemi miratuar atë plan këtu, ne kemi dhënë gatishmërinë tonë dhe vullnetin për ta implementuar atë. Unë ftoj që ky Kuvend edhe tani të shprehë një besim edhe 120 ditësh në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Bashkësinë Ndërkombëtare dhe të jetë edhe një besim i shprehur, por të mos kuptohet si ligësi. As atëherë në vitet e 90-ta, as gjatë luftës, as pas luftës, as tash ky besim i ynë, i qytetarëve të Kosovës në Bashkësinë Ndërkombëtare nuk është shprehje e ligësisë, por është shprehje e vullnetit të qytetarëve të Kosovës për paqe dhe stabilitet në rajon.

Të nderuar të pranishëm,

Nuk kam qenë kur rrahgjokës për luftë. Lufta po përmendet, u përmend edhe pardje nga vet fjala e zotit Putin që pavarësia e Kosovës mund të sjellë luftë. Nuk kam qenë dhe nuk jam nga ata që rrahin gjoks dhe gatishmëri për luftë. Lufta është e vështirë, lufta është e keqe, lufta sjell vështirësi jo vetëm për ne, por për të gjithë. Por, dhe është gjithmonë ajo "por", Kosova mund ta marrë dhe është e gatshme ta marrë përgjegjësinë për sigurinë e qytetarëve të vetë dhe sigurinë e tjerëve rreth nesh vetëm si shtet. Kosova nuk është e gatshme ta marrë përgjegjësinë për siguri të tjerëve në qoftë se nuk na pranohet barabarësia, nuk na pranohet shteti i Kosovës në mënyrë që bashkë të ndërtojmë institucione të forta të sigurisë, ta marrim përgjegjësinë për sigurinë e të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe ta marrim pjesën tonë të përgjegjësisë si shtet për siguri edhe të tjerëve. Çdo vendim tjetër ky Kuvend nuk mund të pranojë. Ne nuk kemi mandat tjetër përveç pavarësisë së Kosovës, përveç ndërtimit të shtetit të Kosovës. Konsideroj se çdo thënie e datave e të tjera vetëm mund ta rëndojë këtë besim, mund të shfaq mosbesim në proces. Pasi që kemi besuar kaq shumë, ftoj këtë Kuvend që t'u besojmë aleatëve tanë, t'u besojmë parimeve të Bashkësisë Ekonomike Evropiane, parimeve demokratike, parimeve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të lirisë e të demokracisë.

Dhe, krejt në fund, unë propozoj që për këto 120 ditët e ardhshme Qeveria të jetë më dinamike në hartimin dhe në sjelljen e ligjeve në Kuvend që dalin nga pakoja e Ahtisarit. Ka ngecje, i nderuari zoti Kryeministër. Ato ligje duhet të vijnë, të miratohen në Kuvend, të hartohet dhe të miratohet Kushtetuta e Kosovës dhe të ndërtohen kapacitete të tjera, që të mos i përmend unë, i thanë parafolësit e mi, që e bëjnë Kosovën shtet. Të mos ndalemi dhe të presim, por ky Kuvend, Qeveria dhe të gjithë ne të punojmë në ndërtimin e kapaciteteve të cilat do të jenë të nevojshme për shtetin e ardhshëm të Kosovës.

Të nderuar të pranishëm, zoti Kryetar,

Konsensusi arrihet me debat kur ka edhe mendime të ndryshme. Ne e kemi një institucion, ky është Kuvendi i Kosovës. Mendoj se çfarëdo ideje për t'u zëvendësuar ky institucion me tjetër është i dëmshëm, nuk e kemi legjitimitetin, nuk është legjitim. Ky Kuvend është legjitim, ky Kuvend e ka mandatin për të vendosur për fatin e Kosovës.

Dhe, të nderuar të pranishëm, po lidhem në një fjali të zotit Surroi: "çdo ditë më e vështirë në ecje". Për këto 120 ditë jam i sigurt që çdo ditë do të jetë e vështirë në ecje, do të jetë periudhë me potencial shumë të madh destabilizues për stabilitetin politik të vendit. Brenda këtyre 120 ditëve po tentohet të ndërmerren edhe disa veprime të tjera, të cilat, secila në vete, bartin potencial destabilizimi, siç janë zgjedhjet, pastaj Kushtetuta, simbolet dhe të gjitha këto, a do të jemi në gjendje, nëse jemi, po, dhe ky është konsensus dhe unë e përkrahu atë konsensus. Atëherë, vendimi i këtij Kuvendi duhet të jetë - zgjedhjet me lista të hapura. Qytetarët e Kosovës më në fund duhet të kenë të drejtë të votojnë individin, e jo partinë. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Pushim dreke deri në orën 14:30.

Vazhdimi i punës së seancës pas pauzës

KRYETARI KOLË BERISHA – Vazhdojmë punën. Radhën e paraqitjes së deputetëve e keni në monitor. Fjalën e ka deputeti Bajram Kosumi.

BAJRAM KOSUMI – I nderuari Kryetar i Kuvendit,
I nderuari Kryetar i Kosovës, Kryeministër dhe anëtarë të Ekipit të Unitetit, Të nderuar ministra, deputetë,

Unë i dëgjova me vëmendje fjalët e anëtarëve të Ekipit të Unitetit dhe pjesërisht nuk janë ato fjalë që kemi pritur dhe është dash të jenë sot këtu. Një pjesë e fjalëve kryesisht u përngjajnë shfajësimeve për punët që janë bërë apo si janë bërë, një pjesë e fjalimeve ju përngjajnë fushatave elektorale. Ndërkaq, në të vërtetë sot askush nuk ka qenë i interesuar këtu as të akuzojë dhe as të bëjë fushatë elektorale, por në situatën e krijuar të mundohemi ta gjejmë një zgjidhje më të mirë dhe më të leverdishme për procesin në të cilën po ecim, e i cili me të vërtetë po hasur në vështirësi muajve të fundit.

Procesi i pavarësimit të Kosovës ka hasur në vështirësi me vetë faktin që një koncept për këtë proces, koncepti i bërjes së Kosovës shtet përmes Këshillit të Sigurimit ka dështuar,

ka dështuar, dihet prej të gjithëve, me fajin e Federatës Ruse. Tash po lansohet një proces i ri negociator. Është një ndryshim mjaft i madh edhe për ne, edhe për procesin dhe ky ndryshim nuk besoj se duhet të kalohet pa diskutime serioze dhe pa marrjen e disa qëndrimeve, pa disa ripozicionime në çështjet kyçe në procesin që na pret në të ardhmen.

Pozicionimi i parë apo diskutimi i parë që duhet ta bëjmë ka të bëjmë me hartimin e një platforme, ose të një strategjie të re se si do të ecim në procesin që na pret tash e tutje. Hartimi i kësaj strategjie ose i kësaj platforme se cilat do të jenë veprimet tona dhe cila do të jetë rruga që do të ndjekim e faktorizon Ekipin e Unitetit dhe Kosovën në këtë proces, e rikthen edhe njëherë fuqinë e Ekipit të Unitetit në këtë proces. Kjo çështje e hap edhe temën e partneritetit, e cila u përmend edhe më herët gjatë debateve këtu. Partneritet mund të ketë nëse ne kemi nismat tona, nëse ne kemi vizionin tonë, nëse ne kemi strategjinë tonë dhe konceptin tonë. Përndryshe, nëse ne nuk i kemi këto, nuk mund të krijojmë partneritet me dikë sepse nuk kemi bazë për të krijuar partneritet. Asnjëherë një lypës nuk mund të bëhet partner me një bankier, por gjithmonë ose shumë herë mund të ndodhë që një ndërmarrës që ka vizion të qartë, që ka projekte të qarta, mund të bëhet partner me një bankier dhe të marrë kredi prej bankave. Ne duhet të mëtojmë që të kemi vizionin tonë, të kemi konceptin tonë dhe të kemi strategjinë tonë në ditët që na presin. Prandaj, në këtë drejtim, fjalimi i zotit President të Kosovës ka disa pika që mund të shërbejnë si bazë fillestare për hartimin e strategjisë për muajt që na presin. Por, e ftoj Ekipin e Unitetit edhe Presidentin që mbi ato pika dhe mbi diskutimet që sot janë bërë dhe po bëhen këtu në Kuvend, të hartojnë strategjinë apo platformën e veprimit dhe atë strategji unike apo platformë unike ta rikthejnë edhe njëherë në Kuvendin e Kosovës që ta diskutojmë, ta pasurojmë me sugjerimet tona dhe Ekipi i Unitetit të veprojë pastaj mbi bazën e asaj platforme apo të asaj strategjie.

Çështja e dytë që kërkon një ripozicionim është ripozicionimi ndaj kohës kur do të vendoset për statusin final të Kosovës. Nuk besoj se mund ta kemi drejt kur themi se nuk është e rëndësishme koha kur do të vendoset statusi final i Kosovës. Koha është njëri prej faktorëve kyç që do të ndikojë edhe në cilësinë e statusit final të Kosovës, është njëri prej faktorëve kyç që do të ndikojë edhe në mënyrën se si do të vendoset për statusin final të Kosovës.

Ju e dini shumë mirë se kur Grupi i Kontaktit ka lansuar bisedat për statusin final të Kosovës ka dashur të hyjë në proces pa e limituar kohën. Në fund të vitit 2005 dhe në fillim të vitit 2006 është thënë se do të fillojë procesi, por nuk dihet kur do të përfundojë. Ekipi i Unitetit ka arritur ta bindë Grupin e Kontaktit atëherë që duhet të ketë një kufi kohor kur do të përfundojë procesi dhe kjo është arritur dhe ky kufi kohor është caktuar nga Grupi i Kontaktit. E ftoj Ekipin e Unitetit që bashkë me Kuvendin, me Qeverinë dhe me institucionet e tjera të bindë edhe sot Grupin e Kontaktit dhe sidomos Shtetet e Bashkuara të Amerikës për afatizimin, përcaktimin e një limiti kohor kur do të përfundojë procesi i bërjes së Kosovës shtet. Ndoshta u tha disa herë se nuk është praktikë e mirë që caktohet data, por pas përfundimit të 120 ditëve të negociatave të reja, Ekipi i Unitetit në bashkëpunim të ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Britaninë e Madhe dhe me Unionin Evropian duhet të caktojë kohën optimale se kur do të përfundojë procesi i bërjes shtet të Kosovës.

Pozicionimi i tretë, duhet të bëhet ndaj vet negociatave. Ne po flasim, Këshilli i Sigurimit po flet, Grupi i Kontaktit po flet për negociata të reja. Çfarë janë ato negociata, cila është tema e negociatave, a do të negociohet prej fillimit gjithçka apo do të rinegociohet pakoja e Ahtisarit, a do të rinegociohet pakoja në tërësi, apo disa pjesë të pakos së Ahtisarit etj. etj., janë një varg pyetjesh që kërkojnë përgjigje shumë të saktë prej Ekipit të Unitetit, prej Kuvendit të Kosovës dhe prej Qeverisë së Kosovës. Prandaj, duhet pasur përgjigje në këto pyetje në mënyrë që të dihet apriori pozicioni i Kosovës në këtë çështje.

Pozicionimi i pestë, duhet të bëhet ndaj vetë dokumentit të Ahtisarit dhe implementimit të dokumentit këtu. Kuvendi i Kosovës e ka votuar dhe e ka pranuar dokumentin e Ahtisarit në çka edhe sot mund të thirremi, edhe në të ardhmen mund të thirremi se për ne është valid ai dokument pa ndryshime. Por kohëve të fundit gjithnjë e më shumë diplomatë evropianë flasin se dokumenti i Ahtisarit është bazë e mirë për negociatat e reja, që e lënë të hapur mundësinë e ndryshimeve, ani pse njëherë thonë formale, por në fakt ato ndodhin substanciale në dokumentin e Ahtisarit. Ne duhet t'ua bëjmë të qartë se dokumenti i Ahtisarit, i tillë çfarë është, është i pranueshëm prej nesh, por nëse ndryshohet, dokumenti i Ahtisarit bëhet i papranueshëm për palën kosovare dhe ndaj këtij dokumenti duhet të marrim edhe një qëndrim në implementimin e tij. Dokumenti i Ahtisarit është i implementueshëm në tërësinë e vet. Nuk mund të implementohet një pjesë e dokumentit dhe pjesa tjetër të mbetet, sepse do të jetë e dëmshme për procesin dhe për vetë Kosovën. Dokumenti është i implementueshëm në tërësinë e vet duke nënkuptuar edhe bërjen e Kosovës shtet.

Pozicionimi i ri do të bëhet ndaj vetë Ekipit të Unitetit. Kuvendi i Kosovës ka votuar një rezolutë që ka fuqizuar dhe i ka dhënë mandat të caktuar Ekipit të Unitetit që të prijë në procesin e vendimit për statusin final të Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës e ka përkrahur Ekipin e Unitetit dhe duhet të vazhdojë ta përkrah në këtë cilësi deri në fund. Por, Ekipi i Unitetit nuk besoj se duhet t'i japë vetes të drejtë të merret edhe me gjëra të tjera që nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt me statusin final të Kosovës ashtu qysh ka ndodhur deri më tash. Çështjet siç janë simbolet e Kosovës, zgjedhjet, ligjet zgjedhore, janë çështje të Kuvendit të Kosovës dhe të Qeverisë së Kosovës, por jo çështje të Ekipit të Unitetit. E ftoj Ekipin e Unitetit, por edhe Kuvendin e Kosovës që të qëndrojnë në këto pozicione të legjitimuara përmes Rezolutës së Kuvendit të Kosovës.

Dhe, çështja e fundit apo ripozicionimi i fundit ka të bëjë me vet Kuvendin e Kosovës. Mua më erdhi shumë mirë që shumë deputetë edhe anëtarët e Ekipit të Unitetit sot e hapën temën e marrjes së përgjegjësisë më tepër nga ana e Kuvendit të Kosovës. Edhe unë besoj se Kuvendi i Kosovës duhet të marrë pak më tepër përgjegjësi në procesin e vendosjes për statusin final. Në këtë mënyrë ne do t'ua lehtësojmë barrën anëtarëve të Ekipit të Unitetit dhe në këtë mënyrë ne do të përcaktojmë më drejtë, më saktë dhe më mirë strategjinë e re se si do të ecim deri në bërjen e Kosovës shtet. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Džezair Murat dhe le të përgatitet deputeti Nait Hasani.

DŽEZAIR MURAT – Hvala, gospodine predsjedniče! Dozvolite da pozdravim Ekipu jedinstva u punom sastavu, gospode članove Vlade, zatim kolege goste. Ja bih danas ovde pomenuo da ova rasprava sigurno spada u one prelomne istorijske trenutke kada diplomatija i politička strategija treba da postanu naše glavne oružije u nastavku razgovora. Ja mislim da razum mora da nam nadvlada emocije u trenutku kada su uprte oči, uši ali i želje ne samo naših građana i ne samo naših prijatelja i saveznika. Moramo sve da učinimo da svi ljudi dobre volje, svi odgovorni predstavnici Međunarodne zajednice shvate da jedan dokumenat rađen tako studiozno nepristrasno i objektivno bude temelj privođenja kraju tog rešenja problema, a ne preblem rešenja, kako neki, na sreću malobrojni, žele da urade. Zrelost, mudrost i jedinstvo moraju i više nego do sada da nam budu jedina strategija novog dokazivanja nečeg već dokazanog. I do sada smo u ovoj sali govorili o nekim dosadašnjim propustima, o nedovoljnom uključivanju integrisanih manjinskih zajednica u proces pregovora, već je bilo reči o tome. Nekada, gospodo, o sebi moraju da govore lično i autentično predstanci manje brojnih zajednica. Dakle, lično, sigurno je da smo nebrojeno puta u raznim prilikama i povodima dokazali da sem Kosova nemamo drugu domovinu. Konsultativni savjet nije postigao efekat po nas koji je morao da postigne i tu nešto mora da se menja. U brojnim posetama Kosovu mnogih eminentnih predstavnika Međunarodne zajednice najčešće smo zaobilaženi, o čemu smo i ranije mnogo puta govorili, ali mislim da ni Pregovaračka ekipa, niti ostale institucije Kosova nisu na vrijeme shvatili koji će biti rezultati toga i šta se postiglo time. Samo jedna crno - bjela slika Kosova, čije efekte znamo tek ovih dana. U prestojećem vremenu jednostavno treba prekinuti sa tavlom praksom. Opšti efekat će svakako biti povoljniji. Slika Kosova će time biti u koloru a ne samo crno – bjela, koja šteti Kosovu i koja ne održava pravu realnost.

Gospodo, jedan od kamena spoticanja u procesu pregovora bila je decentralizacija. Mi većina predstavnika Bošnjaka i Turaka, kažem većina, ali ne svih eksplicitno, smo prihvatili da to rješavamo isključivo ovdje, dakle u našim institucijama. Neki su nam zbog toga priljepili neke etikete, ali neću danas o tome. Mi i dalje ostajemo pri takvom stavu, ali sa ovim procesom ne smjemo stati. Zastoj moramo pokrenuti na osnovu našeg zakonodavstva i realnih i opštih potreba, a ne politizacije, kako to neki čine.

Drage kolege,

Kosovo je već dugo, rekao bih predugo, top tema šire političke javnosti koja zakuplja najveću pažnju. Najveća žrtva razvlačenja ovog procesa su naši građani koju saslužuju za strpljenje i pozitivna iščekivanja ogromnu zahvalnost. Mnogi su priželjkivali da ih izda strpljenje, mnogi su ih videli kako ruše, lome, okupljaju se na ulicama, ali su takvi ostali praznih rukava. Dakle, pokazana je puna zrelost u pravom trenutku. Iskreno se nadamo da će u ovom kratkom vremenu koje preostaje, ponašanje naših građana biti, odnosno nastavice se na takav način. Zarad njih, mi moramo da istrajemo. Propuste ne smjemo da ponavljamo, pozitivna mišljenja i konstruktivne predloge moramo da prihvatimo. Na najvećim iskušenjima jesmo, ali ne smemo da dozvolimo da budemo kolateralna šteta u neraščišćenim računima drugih i nikako ne smemo dozvoliti da budemo vaga za poravnanje takvih računa.

Ekipi jedinstva želimo da i dalje ostane homogena i monolitna uz povremene dopune pomoći sugestije koje su uvijek potrebne, ali trebaju na vrijeme da se shvate. Mi smo, takođe, svedoci medijskog bombardovanja i ofanzivne diplomatije našeg sjevernog susjeda. Ja danas mogu da poručim našoj Ekipi jedinstva da su argumenti na našoj strani. Suprotna strana zahteva teritorije, traži, a za uzrat ništa ne nudi. Nikad se niko nije pitao šta će biti sa predstavljanjem u toj njihovoj Skupštini, koliko bi bili i u kom redosledu, recimo, predsednika ili premijera, kada bi i koliko poslanika trebalo biti. Ništa se ne nudi, traži se teritorija, jelda, a za uzvrat se stalno pominju, i vrabci na grani znaju, kad kažu nepromenljivost granica, kršenje međunarodnog prava i tako dalje, ali uvijek samo verbalno, bez argumenata. Mi smo ovih dana svjedoci da je desetina hiljada građana Kosova, među njima i brojni predstavnici moje zajednice, prolazeći jelda kroz teritoriju severnog suseda, naišli su na slike slične onima prije 99-te godine, na razna ubjeđivanja, dokazivanja i tako dalje, i tako dalje. Dakle, to samo potkrepljuje ovu moju tezu da se traže teritorije, a da se za uzrat ne nudi ništa. Šta će onda takva teza koja ne nudi rešenje za stanovništvo koje ovde živi. To pada u vodu, ali da bismo mi to argumentovano iskoristili, trebamo uvijek imati na um, na um, jelda, istinu i argumente koji su na našoj strani.

Ja ću na kraju ponoviti da ostale zajednice, dakle ponoviću još jednom, integrisane u prethodnom periodu, nisu konstruktivno dovoljno bile izkorišćene. Nadam se da će takvi propusti, uz želju da sve ovo privredemo, kako nam već naši prijatelji i saveznici koje ovde pominjemo, moramo razmišljati i o ostalima objektivnima, a ne samo o prijateljima i saveznicima, a i njihovih takođe mnogo ima. Mi u toj našoj diplomatiji moramo da se koristimo iskustvima drugih koji imaju iza sebe jelda poduže vremenske periode. Danas smo ovde imali podosta čak, jelda, ponude novog oružja, novih borbenih redova, novog junačenja, novih kontradiktornosti, te jesmo za samostalnost ili nismo, te biće ili neće biti, i tako dalje. Mislim da takvi ustupci i takve ponude ne koriste nam mnogo. Ja još jednom na kraju želim Ekipi jedinstva da uz sve ono što smo danas naveli i uz konstruktivne prijedloge, nastavi sa poslom i nadamo se će krajem ove godine biti privredni konačni kraj uz želje većine i ogromne većine građana Kosova. Hvala!.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në sallë janë 89 deputetë prezentë. Fjalën e ka deputeti Nait Hasani, le të përgatitet deputeti Xhevat Bislimi.

NAIT HASANI -

Të nderuar deputetë,

I nderuari Kryetar i Parlamentit,

Të gjitha shpresat që u mbollën në Kosovë nga Ekipi i Unitetit, brengat e muajve, të ditëve dhe të orëve u tretën dhe i dogji dielli i qershorit. Këta kanë treguar se nuk kanë unitet në atë “unitet” për Kosovën, këta kanë treguar se nuk e njohin procesin politik të Kosovës, as abc-në politike të ndërtimit të Kosovës shtet. Me deklaratat e tyre të papërgjegjshme këta kanë treguar se nuk janë politikanë, por janë gazetarë të shtypit të verdhë. Këta nuk e kanë kuptuar asnjëherë mesazhin politik nga Bashkësia Ndërkombëtare për çështjen e Kosovës. Këta nuk kanë bërë politikë për Kosovën, por këshilltarët ndërkombëtarë kanë bërë politikën në Kosovë dhe këta politikanë në unitet i kanë transmetuar, në versionin shqip, të këshillave të tyre në parti politike si i kanë bërë

të dëgjueshme me diktaturën e demokracisë fashiste për anëtarët e tyre dhe qytetarët në Kosovë. Këta nuk e kanë kuptuar e as nuk e kuptojnë strategjinë dhe praktikën diplomatike në zhvillimin e çështjeve politike. Këta kanë qenë misionarë në misionin ndërkombëtarë për Kosovën. Politikanët në Kosovë nuk e kuptuan as atëherë mesazhin e Bushit më 1992 për moskalimin e vijës së kuqe nga Serbia në Kosovë. Iu tërhoq vërejtja Milosheviqit për Kosovën, por të gjithë e dimë pastaj çka ndodhi në Kosovë, - vrasje masive, shpërngulje, djegia e Kosovës. Kur luftërat e kishin kapluar të tërë ish Jugosllavinë dhe krijoheshin shtete, por ne pritnim atëherë dhe po presim dhe sot mesazhin e djalit të Bushit të parë, Presidentit Bush, se Kosova do të jetë në fund të procesit shtet. Unë falënderoj zotin President për këtë mesazh xhentëlmen. Edhe një mesazh të tillë e patëm nga babai yt dikur, por politikanët tanë nuk e kuptuan atëherë, nuk e kuptojnë as sot këtë mesazh të dytë. Se shteti bëhet nga qytetarët e Kosovës, e jo nga Amerika, as nga Evropa, por këtë fakt e njohin shtetet e ndryshme. Sipas kësaj logjike të politikanëve tanë dhe të Ekipit të Unitetit, Amerika dhe Evropa duhet të na shpallin shtetin, ndryshe nuk bëhet Kosova shtet. Kjo logjikë është filozofi e mjerimit politik, sepse disa nga ju këtu e dini mirë se atëherë kur ne i kapëm pushkët dhe krijuam Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës e luftuam për Kosovën dhe çlirimin e saj nga Serbia, atëherë të gjithë na njohën dhe thanë vërtet shqiptarët po dashkan çlirimin nga Serbia dhe duhet ndihmuar në çlirimin e Kosovës dhe krijimin e shtetit të saj. Por, ne, si zakonisht, vlojmë shpejt dhe ftohemi shpejtë. Po ashtu harruam shtetin për pushtet më 1999 – 2000. Tani shteti, sipas këtij Ekipi të Unitetit, ndërtohet me fjalë, me pritje, me shkop magjik. Shumë çudi, Kroacia ishte shtet, luftoi për krijimin e shtetit kroat.

Pas gjithë kësaj, ne si Kuvend pranuan lojën që ia diktuam vetes dhe për një vit e gjysmë hymë në paketë të Ahtisarit. Dje paketa ishte kompromis i pikënisjes për qëllimin tonë kombëtar, sot sipas Unitetit është qëllimi ynë jetësor arritja deri te paketa, sepse me këtë politikë dhe kjo është bërë e paarrtshme. Këta politikanë dhe ky ekip dje nënçmonin Rusinë në politikën ndërkombëtare dhe besonin e shpresonin se kjo do të kalohet lehtë në traktativat ndërkombëtare, sepse ishin mendjelehtë në politikë, sepse dëgjonin këshilla politike adoleshente.

Qëndrimi ndërkombëtarë, bisedime shtesë për statusin e Kosovës mes Prishtinës dhe Beogradit. Ekipi i Unitetit në unitet thotë se do të ketë respektim të agjendës ndërkombëtare dhe jo bisedime me Serbinë. Kush i beson këto fjalë? Askush. Këto fjalë nuk i besojnë as vetë këta. Pra, nëse s'ka bisedime me Serbinë, pse këto bisedime shtesë, dhe me kë do të bëhen prapë këto bisedime shtesë. Tjetra, për çka duhet të bisedojmë me Serbinë, në bazë të cilës platformë duhet të bisedojmë me Serbinë tash. Me miratimin e paketës së Ahtisarit ne si Kuvend e ndamë shumë dhimbshëm Kosovën në enklava. Tash çka duhet të ndajmë edhe më shumë në Kosovë. Mitrovicën ta ndajmë, edhe këtë e kemi ndarë. Tash duhet të krijojmë lidhje të dyfishta, të trefishta me Beogradin për serbët që janë 5% në Kosovë. Pra, nëse ndodh edhe kjo, Serbia katërçipërisht është në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

Unë flas në emrin tim, të shokëve të mi dëshmorë. Në emër të Mujë Krasniqit, Zahir Pajazitit, Luan Haradinit, Rexhep Bislimit dhe shumë shokëve dëshmorë, sepse në asnjë

mënyrë nuk do të lejohet ndarja e Kosovës. Ata që mendojnë për ndarje të Kosovës, ka të atillë edhe këtu, por duhet ta dinë se do të mbajmë përgjegjësi para popullit dhe Kosovës të larë me gjakun e dëshmorëve. Ata që marrin vendim për ndarje dhe lëshim Serbisë të territorit të Kosovës, do t'i dënojë historia dhe gjaku i kombit. Por, nga këtu edhe Serbia duhet të dijë se në territorin serb të Serbisë ka qindra mijëra shqiptarë. Atyre duhet t'ju sigurojë atje po ato të drejta kombëtare që i kërkon për serbët këtu në Kosovë. Nëse Serbia do që të ndajë Mitrovicën dhe Veriun e Kosovës, këtë mund ta bëjë vetëm me luftë, por kësaj radhe lufta nuk do të zhvillohet më në territorin e Kosovës, as në Mitrovicë, por në Serbi, në territorin serb në Nish, në Sanxhak dhe në Luginën e Preshevës, në tokët e pushtuara shqiptare nga Serbia. Ndërsa, Bashkësia Ndërkombëtare do të jetë përgjegjëse dhe do të mbajë përgjegjësi për gjendjen e krijuar në Kosovë dhe në rajon.

Por, politikanët tanë duhet ta dinë se kur e kemi nisur luftën në Kosovë për çlirimin e Kosovës nga Serbia, nuk e kemi pyetur as Amerikën, as Moskën, as Evropën e as Serbinë. Ne luftën e kemi nisur vetë atëherë, dhe nëse ka nevojë, do të luftojmë prapë për mbrojtjen e Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Unë mendoj dhe kërkoj që ky Ekip i Unitetit të mos shkojë në bisedime me askënd dhe askund. Ne i kemi kryer bisedimet. Por, ky Kuvend dhe ky Ekip dhe këto institucione duhet të shpallin menjëherë me veprim të vet aktiv politik referendumin për shtetin e pavarur sovran të Kosovës. Në të kundërtën, shtyrja dhe zhgënjimi do të thotë mosdëgjueshmëri qytetare dhe luftë e re në Ballkan. Dhe, nga këtu, nga ky Kuvend, i bëj ftesë Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe asaj të Shqipërisë që ta hartojnë një platformë kombëtare dhe politike për të ardhmen e Kosovës që do të na obligojë të gjithëve si qytetarë të Kosovës që ta respektojmë. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Fjalën e ka deputeti Xhevat Bislimi, le të përgatitet Demir Limaj.

XHEVAT BISLIMI –

Zoti Kryetar,

Zotëri deputetë,

Zotëri të Ekipit Negociator,

Se si u fillua kjo punë e negociatave, si u krijua Grupi Negociator, jemi të gjithë dëshmitarë. Është edhe filmi, me siguri, në arkivat e Kuvendit, por dihet se si është votuar për këtë ekip. Unë personalisht kam qenë kundër angazhimit të Kosovës në bisedime për, disa arsye:

E para, sepse Kosova hynte në bisedime si një Krahinë në një grup përfaqësuesish politik, kurse Serbia hynte në bisedime si shtet.

E dyta, Serbia hynte në bisedime me një dokument të miratuar nga Kuvendi i Serbisë më 29 prill 2004. Kosova hynte pa asnjë platformë për bisedime të miratuar nga ky Kuvend. Dhe, rezultoi që dokumenti i Serbisë, i miratuar në Kuvendin e Serbisë, u bë plani i

Ahtisarit. Në thelb, kush do mund ta krahasojë. Ai dokument i Serbisë është edhe sot edhe në gjuhën shqipe dhe serbishte. U dëshmuar edhe sot këtu se ky grup negociator që ka pëlqyer të vetëquhet i unitetit, faktikisht nuk është grup i unitetit, por i jounitetit. Por, na e kanë ndryshuar, si duket, edhe kuptimin e fjalës unitet, sepse edhe sot këtu dolën 5 fjalime gati pa asnjë ide. Ishin fjalime shterpe, pa ide dhe, nga ana jonë, bunari që shterë, dihet çka bëhet me te. Duhet të mbyllet, sepse mund të mbytet ndokush në te.

Pas Konferencës së Rambujesë, Marrëveshjes së Rambujesë, të cilën e nënshkroi pala shqiptare, por nuk e nënshkroi Beogradi, ne megjithatë edhe pse nuk u nënshkrua ky dokument, vazhduam ta zbatojmë atë dokument, bile më tepër sesa që duhej. U treguam më të zellshëm sesa që duhej, megjithëse ishte një dokument i panënshkruar nga të dy palët. Sot kemi ardhur në një situatë ku plani i Ahtisarit u pranua nga ne, edhe pranimi e miratimi dihet si është bërë këtu në këtë Kuvend, si është manipuluar ky Kuvend, nuk po kalon në Këshillin e Sigurimit, nuk po e pranon Serbia, nuk po e pranon Rusia. Megjithatë, këtu dëgjuam plotë fjalë nga shumë deputetë që ne do ta zbatojmë dokumentin gjithsesi, bile sidomos atë pjesën ku janë bërë koncesionet tragjike për Kosovën.

Grupi Negociator dhe klasa politike kryesisht, po them, institucionale, ata që kishin përgjegjësinë, që morëm besimin e qytetarëve dhe që i kryesojnë, i udhëheqin institucionet e Kosovës, në vend se të angazhoheshin për unifikimin e territorit të Kosovës dhe kontrollimin e plotë të tij që nuk e kishim, u angazhuam për ricopëtimin e mëtejshëm të Kosovës dhe legalizimin e këtij ricopëtimi. Në vend se të angazhoheshin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore shqiptare ilire, të shkatërruar sistematikisht gjatë historisë nga Serbia, jo vetëm këtu brenda, por edhe deri në Nish, këta edhe këtë pak trashëgimi që kishte mbetur në Kosovë, e bënë trashëgimi serbe.

Grupi negociator në vend se të angazhohej për forcimin e unitetit të brendshëm, për rritjen e gatishmërisë së qytetarëve, organizimin, mobilizimin politik, por edhe të formave të tjera që i duhen një vendi, u angazhuan për do simbole, për do paçavure për ta mashtruar edhe kësaj here popullin shqiptar se ne po bëjmë shtet me simbole. Ky grup pati bile guximin ta manipulojë qytetarin e Kosovës gjoja edhe me njëfarë kushtetute. Ku ka në botë që bëhet kushtetutë pa u zgjidhur statusi i një vendi?! Nuk ka kushtetutë që mund të jetë në qoftë nuk është konform statusit të një vendi. Dihet kjo punë, kjo është gjëja më e thjeshtë.

Tash ky plan nuk kaloi, u pa kjo. Ky grup që angazhohej se nuk do të negociojë pavarësinë e Kosovës, pranoi planin e Ahtisarit që nuk është pavarësi e Kosovës, por është një pavarësi e mbikëqyrur, e kontrolluar, e komanduar, thuaj si të duash, s'ka rëndësi. I njëjti grup tash do të hyjë prapë në bisedime me bazë planin e Ahtisarit. A mund të mbahet Kosova për planin e Ahtisarit? Ju e merrni me mend ku do të përfundojë Kosova?! Ky grup, akoma pa kaluar planin e Ahtisarit në Këshillin e Sigurimit, i ka detyruar këta deputetë që t'i duartrokasnin atij planin. Ky grup, akoma pa u miratuar planin e Ahtisarit, kërkon ta zbatojë atë, veçmas atë pjesën që e dimë. Ky grup, akoma pa kaluar planin e Ahtisarit, fton një mision Evropian, nuk e ka pyetur kush, por gjoja po e ftojme një mision evropian! Unë do të isha kundër këtij misioni ose çfarëdo misioni pa u zgjidhur

statusi i Kosovës. Ky grup, në vend se të angazhohej për kthimin e shqiptarëve, një milion shqiptarë që janë shpërngulur vetëm nga 81-shi dhe që jetojnë në gjendje shumë të rëndë si refugjatë nëpër tërë botën, pastaj muhaxhirët që edhe sot pas 130 vjetësh i quajmë muhaxhirë, u angazhua se si të kthehen ata që dihet çfarë i bënë Kosovës çfarë i imponuan Kosovës.

Rusia edhe Serbia kërcënojnë vazhdimisht me luftë Kosovën. E e përsërisin përditë. Koshtunica e ka thënë edhe në Kosovë. Grupi i Unitetit ose Grupi Negociator, në vend se t'i thonë nëse doni fqinjësi të mirë, nëse doni paqe, këtu e keni Kosovën për paqe, nëse doni luftë ju për një vend të huaj, që kur nuk ka qenë i Serbisë, Kosova historikisht ka qenë shqiptare, bile deri në Nish, këta i thonë, shiko, nuk është mirë për të kërcënuar se megjithatë ka demokraci, paqe, bajat, marre, por ata marre s'kanë hiq, nuk pyesin për marre.

Një çështje tjetër që unë këtu dua ta ngris është çështja e Tiranës zyrtare. Unë e ftoj nga kjo foltore Tiranën zyrtare që të marrë përgjegjësitë e saj historike edhe kombëtare, sepse është e vetmja qendër, i vetmi shtet që ka mandat për Kosovën. Nuk mund t'i ikën Tirana zyrtare përgjegjësie që ka për këtë vend. Në qoftë se i del zot Serbia që e kishte pushtuar dhe masakruar përmbi 200, 300 e 500 vjet, si nuk po i dalka zot Tirana vendit të saj?! Kjo ishte porosi edhe e miqve tanë, bile e bëra edhe publike këtë porosi.

Unë mendoj, nuk kam absolutisht asgjë personale kundër këtyre burrave që janë ulur këtu, por unë mendoj që mandati i tyre, ashtu si e kanë pasur, ka përfunduar me planin e Ahtisarit. Por këta, meqë janë të kapur dhe nuk mund të japin dorëheqje, unë propozoj që ky Kuvend e ka minutën e fundit t'i shkarkojë dhe të emërojë një Qeveri të Shpëtimit Kombëtar në qoftë se duam t'i japim mesazhe botës dhe Serbisë se Kosova e ka me gjithë mend të angazhohet për shtetin e saj, për pavarësi të plotë nga Serbia.

Për sot, derisa të bëhen ato punë, në qoftë se i bën ky Kuvend, mendoj se duhet të miratohet edhe një rezolutë që konfirmon vullnetin e paluhatshëm të këtij populli për pavarësi të padiskutueshme, për pavarësi të plotë nga Serbia. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Fjalën e ka deputeti Demir Limaj, le të përgatitet deputeti Sabri Hamiti.

DEMIR LIMAJ –

I nderuari Kryetar i Parlamentit,
Të nderuar kolegë deputetë,

Çështja e mosdefinimit të statusit politik të vendit është bërë brengë dhe shqetësim për të gjithë qytetarët e Kosovës, shtyrja e zgjidhjes dhe vazhdimi prapë i bisedimeve. Në fillim, siç e dimë të gjithë ne dhe qytetarët e Kosovës, bisedimet zgjatën plotë 14 muaj sipas agjendës së faktorëve ndërkombëtarë. Këto bisedime kishin edhe të emëruarin e OKB-së Marti Ahtisarin, për të cilin ishin pajtuar të gjithë anëtarët e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Për të mos u ndalur në detale se si kanë shkuar rrjedhat për arsye se jemi që të gjithë dëshmitarë të këtyre proceseve, në fund doli propozimi për pavarësi të mbikëqyrur.

Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara me propozimin e Rusisë krijoi një ekip fakmbledhës për të shikuar gjendjen në Kosovë. Kjo ishte e pakuptimtë, kur e dimë që të gjitha këto shtete kanë trupat civile, disa edhe ushtarake, me një fjalë, të gjitha kishin informata për gjendjen, përkatësisht për të arriturat që janë bërë në Kosovë. Por, nga këtu filloi presioni apo pakënaqësia ruse për propozimin e zgjidhjes së statusit të Kosovës.

Tash kërkohet të bisedohet prapë. Që për të gjithë, edhe nga diskutimet e mëhershme të kolegëve, por për të gjithë neve këtu që jemi prezentë, edhe për Ekipin e Unitetit, besoj se është e njëjta pyetje: Pse të bisedohet dhe për çka të bisedohet? Unë shpreh bindjen e plotë, edhe pse nuk është kohë zyrtare 120 ditshi që po flitet, unë shpreh bindjen e plotë që ne prapë do të jemi në pozitën e njëjtë ku jemi sot. Bashkësia Ndërkombëtare ka toleruar dhe po toleron Serbinë, në vend që ta dënojë për krimet, për gjenocidin që ka bërë në Kosovë, krime këto që s’kishin ndodhur qysh prej kohës së Luftës së Dytë Botërore.

Një gjë dua t’ju bëj të qartë. Kosova ka fituar të drejtën për shtetin. E drejtë kjo edhe historike, e cila u vërtetua me luftën e fundit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Për formimin e shtetit ranë dëshmorë mbi 2000 ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, mbi 3500 qytetarë që janë të pagjetur, mbi 20 000 qytetarë civilë të vrarë e të masakruar nga forcat serbe, e sa e sa dëme dhe dhimbje të tjera që përjetuan qytetarët e Kosovës. Këto që i ceka janë faktet, apo më mirë të themi themeli i shtetit të Kosovës.

Ekipi Negociator në këtë rast ka përgjegjësi morale dhe politike për ta mbrojtur interesin e vendit, për ta mbrojtur gjakun e gjithë qytetarëve të Kosovës që ranë në luftën e fundit dhe dëshmorët e kombit, sepse bazamentet e shtetit janë ndërtuar në vitin 1999. Mbi këtë bazë është dashur që Ekipi Negociator, por edhe ky Kuvend, ta ndërtojë platformën për shtetin, por edhe për bisedime.

Nga zhvillimet e fundit politike që kemi përcjellë përmes mediave tona, dëgjuam qëndrimet e Ekipit Negociator, përkatësisht të dy anëtarëve të ekipit, të cilët kanë deklaruar që shpallja e pavarësisë të ndodhë, njëri pat deklaruar për Kërshëndella e tjetri për 28 Nëntor. Pyes zotin Çeku dhe zotin Surroi: A e keni ju një platformë të qartë për mënyrën se si do të bëhet shpallja e pavarësisë dhe çka pas shpalljes? Për modalitetet e shpalljes kërkoj që të bëni shpalosjen e kësaj platforme para deputetëve dhe para qytetarëve, apo janë këto vetëm fjalë, lojë nervash për opinion e brendshëm. A do të thotë kjo se Ekipi Negociator është me dy qëndrime? Nga njëri anëtar i grupit të Ekipit Negociator më herët dëgjuam analizat gjeostrategjike për krijimin e blloqeve të reja të Lindjes dhe Perëndimit dhe sipas tij vija ndarëse po duaka të bëhet edhe në Kosovë.

Zotëri, nuk jemi ne këtu që të na jepni analiza të tilla, kursena ne nga këto! Grupi i Unitetit ka mandat për të punuar e për të gjetur rrugë për realizimin e shtetit, e jo për t’u marrë me çështje që as nuk ju takojnë, as që keni kaçik për t’u marrë me to. Për atë ju them, leni çështjet e politikës globale, ua leni ato lojtarëve të mëdhenj që janë për të bërë politikën e kësaj bote, por kthehuni detyrave, kthehuni përgjegjësisë për të cilën ky

Parlament, ky Kuvend ju ka dhënë mandatin dhe asgjë më tepër nga ju s'kisha kërkuar, vetëm të jeni të sinqertë. Ju faleminderit!.

KRYETARI KOLË BERISHA – Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti, le të përgatitet deputeti Behxhet Brajshori.

SABRI HAMITI –

Zoti Kryetar i Kuvendit,
Zoti Kryetar i Kosovës, Fatmir Sejdiu,
Zoti Kryeministër, Agim Çeku,
Zoti Hashim Thaqi,
Zoti Veton Surroi,
Ministra, kolegë të nderuar,

Sot kemi një takim të rëndësishë së veçantë që ndodh në Kuvendin e Kosovës, një takim që, për hir të së vërtetës, nuk është mbledhur aq lehtë. Për çudi, kemi pasur një histori të vogël derisa jemi mbledhur dhe kjo pak a shumë ka ndodhur pikërisht për shkak se nuk ka ekzistuar një komunikim, do të thosha unë, normal ndërmjet Ekipit Negociator dhe Kuvendit. Unë kujtoj që kjo mbledhje e Kuvendit, nëse për asgjë tjetër, atëherë duhet të përfundojë një raport krejt tjetër në mes të një ekipi që do të quhet i unitetit apo negociator, më nuk e di qysh do të quhet, po patjetër një raport substancial në mes këtij Kuvendi dhe këtij grupi, nëse është grup i mandatar nga Kuvendi. Këtu duhet një shpjegim i vogël për shkak se që nga fillimi ka ekzistuar një dualitet i të kuptuarit të funksionit të këtij grupi. Anëtarët e Grupit të Unitetit pak nga pak kanë filluar ta kuptojnë këtë grup si njëfarë super qeverie, e cila ka të drejta dhe merr të drejta që të vendosë edhe për punë përtej punës së negociimit rreth statusit të Kosovës. Në anën tjetër, Kuvendi e ka mbajtur gjithmonë logjikën e vet elementare, nga pak edhe naive e fëmijërore që, meqë ne i kemi mandatar, jemi ata që i kontrollojmë. Në këto më shumë se një vit, gati dy vjet pune, absolutisht duhet ta pranojmë deri në ditën e sotme ka vazhduar kjo kakofoni, ky moskuptim në mes të dy palëve. Unë po them, sot është dita e së vërtetës në këtë Kuvend, e bisedës e cila po më duket që është mjaft e hapur dhe është mirë që është e hapur, që të mendohet që këto dy organizime, po i quaj tash, të merren vesh për punët që do t'i bëjnë bashkë, nëse do t'i bëjnë bashkë. E unë mendoj që punët duhet të bëhen bashkë se shans nuk ka të bëjë punë të madhe dikush vetëm, por duhet të kemi një koncentrim të mendjes dhe të veprimit të të gjithëve, eventualisht të kemi një rezultat. Thashë, kjo dysi e grupit ka prodhuar edhe përgjegjësi dhe do, të thosha, papërgjegjësi për shkak se në te kanë hyrë të gjithë njerëzit që janë dyfishuar, Kryetari i Kosovës është dyfishuar, Kryeministri është dyfishuar, Kryetari i Kuvendit dhe dy shefat e partive më të mëdha opozitare. Kështu që kemi krijuar një alibi ose arsyetim të dyfishtë. Ata që do të duhej të jepnin përgjegjësi për qeverisjen, e kanë marrë alibinë që po punojnë për statusin, një vit kemi punuar për standardet, një vit e gjysmë për statusin. Në anën tjetër, opozitarët e kanë lënë rolin opozitar në një shpresë sepse kanë hyrë në një organ që ka pretenduar të jetë vendimmarrës dhe herë pas here kanë luajtur rolin e opozitarit. Pra, jemi në momentin e së vërtetës dhe unë mendoj që ajo që është esenciale është sot të fillojmë të mendojmë që e kemi të drejtën dhe e kemi detyrimin të kuptojmë që kemi të drejtë të vendosim. Është koha që të merren vendime, që të merren përgjegjësitë, të ushtrohen përgjegjësitë.

Askush askënd nuk e bën të pavarur nëse ai tërë kohën kërkon leje që të bëhet i pavarur. Unë këtu vetëm po parafrazoj fraza që dëgjova edhe nga Ekipi i Unitetit, çka janë duke folur deri më tash. Pra, Kuvendi i Kosovës duhet vet t'i marrë përgjegjësitë. Mos të mshefemi nga retorikat personale, s'na la ne dikush të vendosim diçka. Sekush e ka të drejtën politike t'i marrë përgjegjësitë e veta, sepse është përgjegjësi i zgjedhësve dhe në grup krejt Kuvendi. Pra, Kuvendi i Kosovës, unë mendoj, duhet të shpallë seancë permanente sa i takon statusit të Kosovës në mënyrë që të mos bëhen veprime n'hundë e n'buzë dhe mandej të pendohen njerëzit ose të nguten në marrjen e vendimeve. Ky Kuvend le ta shpallë seancën permanente sa i takon statusit të Kosovës. Kjo i jep mundësi edhe Kuvendit, edhe Ekipit të Unitetit, nëse merremi vesh çka do të bëjmë, që në çdo sekondë, në çdo ditë mund ta marrë çdo vendim dhe nuk ka nevojë që të thirremi e të bindemi me Ekipin e Unitetit kur do ta gjejmë një ditë të përbashkët që të bisedojmë për gjërat kryesore që i përkasin Kosovës.

Nën dy, ky Kuvend duhet rimerret vesh me Grupin e Unitetit në këtë përbërje çfarë është, nuk mendoj që është koha të bëjmë eksperimentime, për çka mund të bisedojë. Mirëpo, nuk mund të marrë vendim asnjëherë për asgjë para se të aprovohet në Kuvend. Ne këtë punë besoj që do ta bëjmë dhe unë mendoj që edhe Grupi i Unitetit e pëlqen këtë mënyrë të veprimt. Në këtë kohë Kuvendi i Kosovës të përgatitet të nxjerrë Kushtetutën, të nxjerrë simbolet dhe të përgatitet juridikisht që në çdo kohë ta bëjë shpalljen e pavarësisë së Kosovës dhe kërkimin e njohjes.

Zonja dhe zotërinj,

Unë e di, këtu po flitet me figura. E gjithë bota e di çka duam e s'duam ne, e gjithë bota i di ëndrrat e çdokujt. Por ne, realisht, institucionalisht kurrë nuk kemi marrë vendim në Kuvend të Kosovës dhe kurrë nuk kemi bërë kërkesë zyrtare që të na njohin. Nëse e kam keq, le të më demantojnë të gjithë deputetët dhe krejt Grupi i Unitetit. Pra, kur të jemi të zotët që ta bëjmë shpalljen, ta marrim vendimin, ta kërkojmë njohjen, atëherë është akt i plotë juridik institucional i Kuvendit të Kosovës. Këtu u përmendën 120 ditë. Unë për vete më së pari nuk e di kur janë bërë institucionale ato 120 ditë. Njëri prej kolegëve tha prej 4 muajve në 6. Unë sa mendoj, 6 muaj bëjnë 180, s'bëjnë 120 hiq. Por, po e zëmë, kur fillojnë ato 120 ditë, askush s'e di. Është një figurë. Pra, mos të caktojmë 120- ditëshat se s'i di kush kur fillojnë e kur mbarojnë, por të jemi në gatishmëri permanente që projektin i cili është vullnet i popullit të Kosovës, me të cilin vullnet ne jemi të gjithë sot këtu, të jemi të zotët ta shpallim, t'i dalim zot. Përndryshe, degazhimi ose lënia porosi tjetres legjislativë është sendi më qesharak se atëherë do të thotë ne s'kemi qenë të zotët të vendosim asgjë dhe ia lëmë kilen dikujt që vjen pas nesh. Kjo është sendi që s'duhet të bëhet hiq, assesi.

Pra, nuk ka nevojë të caktohet as datë, as muaj, sepse është gabim. Por, që të krijohet përgjegjësia permanente dhe puna permanente e organeve përfaqësuese, në rend të parë të Kuvendit, kjo mund të bëhet dhe këtë e kemi obligim. Sa i përket unitetit që është bërë figurë pak qesharake, nuk bëhet uniteti për vullnete individuale. Këtu jemi përfaqësues të gjithë dhe anëtarët e Grupit të Unitetit nuk na japin dhuratë ëmbëlsirë që rrinë bashkë, por janë të detyruar dhe janë të mandatuar nga Kuvendi dhe votuesit e tyre që të jenë bashkë,

kështu që a është, a s'është dhurata, mos të na bëjë gogol dikush se po prishen këta në mes veti, po prishet puna. Jo, jo, janë të detyruar këta, janë të detyruar me mandat të jenë bashkë. A e donë, a s'e simpatizojnë njëri tjetrin, ajo është punë e njerëzve normal që dikë e ka më simpatik se tjetrin, por nuk është kurrfarë dhurate dhe këta që rrinë, këta do të jenë të detyruar të jenë unik, siç do të jetë i detyruar ky Kuvend të jetë unik rreth veprimeve për statusin e Kosovës, se ne sot po bisedojmë zotëri për statusin e Kosovës. që janë pikëpyetje të mëdha, unë nuk dua të bëjë politika të mëdha, por e di sikur ju që e dini, që situata është në gjendje kritike, dramatike. Ka shumë ide, shumë ide të pazgjidhura krijojnë konfuzion. Qysh do të shkojë nesër UNMIK-u, qysh do të vijë nesër ekipi i evropianëve, çka do të kemi ne për bazë në zhvillime të tilla, janë pyetje të mëdha që duhet t'i zgjidhim ne bashkë këtu më së pari, mandej në partneritet me tjerët. Nuk janë punë të vogla, janë punë që donë zhvillim. Të gjitha këto zhvillime ne mund t'i kalojmë nëse marrim përgjegjësitë dhe marrim të drejtën e vendimit që e kemi si përgjegjësi për hapat e ardhshëm.

Unë i dëgjova shtatë pikat që i tha Kryetari i Kosovës, Fatmir Sejdiu, ...(ndërprerje e diskutimit nga ana e teknikës)... funksionojnë vetëm se ato duhet të bëhen vepra. Ato pika nuk bëhen vepra pa e marrë të drejtën e vendimit ne këtu. Faleminderit!.

KRYETARI KOLË BERISHA – Fjalën e ka deputeti Behxhet Brajshori, le të përgatitet deputeti Xhavit Haliti.

BEHXHET BRAJSHORI –

Zotëri President,

I nderuari Kryetar i Kuvendit, Kryeministër, anëtarë të Ekipit Negociator, ministra,

Të nderuar kolegë, deputetë,

Sot po debatojmë për një çështje, do të thoja, e para në interesimin tonë dhe në aktualitetin tonë në përgjithësi, dhe më e rëndësishmja jo vetëm për nga natyra edhe karakteri i saj, po edhe për nga koha në cilën tani gjendemi ne të gjithë. Pa dyshim, dita e sotme nuk është e njëjtë me debatin që kemi zhvilluar në këtë Kuvend para 4 muajsh, sepse kemi zhvillime të reja rreth statusit të Kosovës dhe mund të them se zhvillimet nuk kanë qenë të kënaqshme dhe nuk janë të kënaqshme edhe tani. Prandaj, nevojitet një mobilizim i madh i të gjithë neve për të parë të ardhmen tonë të sigurt dhe për ta ndërtuar atë.

Unë nuk do të ndalem më shumë në çështjet e kaluara dhe në të kaluarën, por do të ndalem në katër observime të miat të cilat do të mundohem që me fjalë të shkurtra t'i them në këtë Kuvend me qëllim që bashkërisht të ndërtojmë një platformë veprimi për këtë periudhë që po na pret.

E para, deshëm apo s'deshëm, është i nevojshëm ndërtimi i unitetit të plotë funksional i të gjitha institucioneve, edhe brenda Ekipit Negociator, edhe të institucioneve që i përfaqësojnë. Nëse kemi qasje të ndryshme, qoftë në media, qoftë edhe në Kuvend, secili prej nesh karshi statusit politik të vendit, sigurisht se forca jonë do të jetë më e vogël karshi atyre që, natyrisht, e kundërshtojnë pavarësinë e Kosovës. Në këtë drejtim mendoj

se ka çka të plotësohemi dhe ka nevojë për një përkujdesje tonë të përbashkët. Nuk është momenti tani për të bërë vrap se kush kujt po ia hedh fajin për një zhvillim jo të kënaqshëm të çështjes që ka të bëjë me statusin e Kosovës kohëve të fundit. Është e vërtetë se kjo çështje ka rënë na Këshilli i Sigurimit në një rang tjetër të cilin ne e çmojmë, por megjithatë kemi dashur që kjo çështje të kryhet përmes Këshillit të Sigurimit dhe kemi besuar se do të kryhet. U tha nga parafolësit, nga kolegët se pakon e Ahtisarit, e mirë ose e keqe, ashtu kemi qenë thjeshtë të detyruar që ta pranojmë, ta shtyjme më tutje për një qëllim të vetëm që Kosova të arrijë pavarësinë e vet, jo për kompromise të tjera, absolutisht, dhe tani ai dokument nuk kalon në Këshillin e Sigurimit.

Prandaj, uniteti veprues i gjithë neve është i domosdoshëm në këtë kohë dhe unë besoj se këtë do ta arrijmë, këtë duhet ta ndërtojmë në ecje e sipër me qëllim të përfundimit final të çështjes sonë.

E dyta, është shumë e vërtetë se na nevojitet partneriteti me faktorin ndërkombëtar. Kemi bërë rrugën e përbashkët, do ta vazhdojmë këtë rrugë, natyrisht, ndoshta me një cilësi tjetër tash, që faktori vendor të prijë në kërkesat tona, të prijë karshi atyre mundësive që i kemi për të dinamizur procesin dhe, natyrisht, për të kërkuar cilësi edhe në veprime. Ky partneritet do të bëjë më të fuqishëm nesër edhe njohjen e pavarësisë së Kosovës.

E treta, jam i bindur thellë se përveç atyre që edhe sot e kundërshtojnë pavarësinë e Kosovës, për të gjithë të tjerët, nuk them për popullin e Kosovës, gjithsesi, por edhe për miqtë tanë pavarësia e Kosovës në tërësinë e vet territoriale është e panegociushme. Kjo u tha edhe në fjalën e Presidentit, është thënë vazhdimisht edhe prej të gjithëve. Absolutisht, nëse dikush mendon se në rrugëtim e sipër në këtë periudhë të ardhshme 120- ditëshe, apo sa do të jetë, do të bëjmë përpjekje për futur kërkesa të tjera, ato janë të papranueshme për popullin e Kosovës dhe sigurisht për Kuvendin e Kosovës edhe më shumë. Prandaj, kjo është minimumi që ne thjeshtë kemi bërë, një pavarësi e cila garanton tërësinë territoriale dhe perspektivë për të gjithë ata që jetojnë në Kosovë.

Dhe, çështja e katërt, çka, të nderuar kolegë deputetë, pas 120 ditësh, ta zëmë se janë 120 ditë, çka do të bëjmë ditën e nesërme? Unë mendoj që Kuvendi i Kosovës që prej sot, përveç që të ndërtojë institucionet e veta në kuptim të legjislacionit dhe të asaj që të përgatisim infrastrukturë për shtet, ne duhet të kemi një qartësim kohor. Nëse nuk mund të themi data, nëse nuk mund të themi tjetër, ne duhet të ndërtojmë një afat i cili këtë popull e bënë më durueshëm në këtë periudhë deri te arritja e qëllimit përfundimtar.

Prandaj, Kuvendi i Kosovës duhet ta luaj rolin e vet. Jam mbështetës i asaj që Kuvendi i Kosovës të jetë kujdestar i kësaj çështje në vazhdimësi në periudhën e ardhshme. Absolutisht për të dhënë kontributin e vet karshi kërkesave të qytetarëve në përgjithësi, pra edhe të ndenjes që e kemi të gjithë bashkërisht që jemi këtu.

Kuvendi i Kosovës duhet të arrijë një mirëkuptim dhe bashkëpunim me faktorin ndërkombëtarë, në rend të parë me miqtë tanë, që në periudhën më të shpejtë të mundshme pas kësaj periudhe, nëse jo edhe më herët, të shpallë pavarësinë e vendit dhe

të kërkojë njohjen ndërkombëtare. Përndryshe, çdo vonesë do të ndikojnë në shumë sfera, si në sferën e zhvillimit ekonomik të vendit. Ne kemi mbetur pengë i këtij procesi, në përgjithësi flas, dhe çdo vonesë në shtyrjen e zgjedhjes së statusit politik të vendit ndikon negativisht edhe në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Ju faleminderit për vëmendje!.

KRYETARI KOLË BERISHA – Fjalën e ka deputeti Xhavit Haliti. Le të përgatitet deputetja Selville Halimi.

XHAVIT HALITI –

Zoti Kryetar,
Të nderuar kolegë,
Të nderuar Ekipi i Unitetit,
Zoti President Sejdiu,
Zoti Kryeministër Çeku,
Zoti kryetar i Partisë Demokratike, Hashim Thaqi,
Të nderuar ministra,

Diskutimi në seancën e sotme është sa i rëndësishëm, aq edhe i vështirë e delikat. Është i rëndësishëm sepse do të vlerësohet puna e veprimtaria e Ekipit të Unitetit në realizim të misionit për të cilin u krijua për të bërë të njohur në gjithë kancelaritë e shteteve anëtare të Këshillit të Sigurimit dhe përgjithësisht të OKB-së, aspiratën, përpjekjet, sakrificat dhe gjakun e derdhur për gati një shekull nga shqiptarët për mbrojtjen dhe pavarësinë e të trullit tonë etnik të Kosovës.

Vënia në dijeni e kancelarive me mundësitë që ofron sot teknologjia e komunikimit, nuk kërkon shumë mund dhe kohë për t'u realizuar. Problemi qëndron në atë se ç'është bërë për të shndërruar problemin Kosovë në një çështje të njohur për opinionin evropian dhe më gjerë, dhe sidomos për të nxitur e organizuar reagimin paqësor, qytetar e masiv të opinionit në Kosovë në mbështetje të mbrojtjes së të drejtës së vetë të njohjes ndërkombëtare të pavarësisë.

Diskutimi i sotëm është aq i vështirë sepse ne sot po gjykojmë vetveten. Do t'i kërkojmë llogari për punën e bërë një institucioni të krijuar, të miratuar dhe të mbështetur prej nesh. Menduam dhe nuk kemi ndryshuar mendimin që e formuam këtë institucion me përfaqësuesit më potentë e më të përkushtuar për finalizimin ndërkombëtar të pavarësisë së Kosovës.

Personalisht i njoh dhe i respektoj të gjithë anëtarët e Grupit të Unitetit për kontributin e dhënë në mënyrat e ndryshme për arritjen e pavarësisë faktike të Kosovës, siç e vlerësoj, për kapacitetet politike dhe intelektuale. Ky diskutim është gjithashtu delikat, sepse raportet bilaterale dhe multilaterale Serbi – Rusi dhe Kosovë – SHBA dhe BE pa folur për flukse dhe refluksë në këto raporte, e bëjnë shumë të vështirë realizimin në kushte normale të misionit të Grupit të Unitetit dhe këtë e kemi parasysh të gjithë. Për të tri këto arsye i mirëkuptoj disa mangësi në veprimtarinë e deritanishme të Ekipit të Unitetit në realizim të misionit të paracaktuar, por ka disa gjëra që nuk arrij t'i kuptoj dhe dua të ndaj me ju shqetësimin tim.

Ajo që nuk kuptoj së pari është, përse ky ekip nuk arriti kurrë, përjashtoj deklarimet personale të anëtarëve të vet, të bënte të prekshme, të besueshme dhe emergjente zgjidhjen sa më parë të aspiratës së shqiptarëve në mbarë Kosovën për njohjen sa më të shpejtë ndërkombëtarisht të pavarësisë së saj. E dimë efektin ndërkombëtar të protestës së organizuar nga Vetëvendosja, por nuk dimë asgjë për ndonjë manifestim mbarë popullor demokratik të nxitur e të organizuar nga Grupi i Unitetit në realizimin e misionit të vet. Nuk e kam fjalën thjeshtë dhe vetëm për organizim protestash masive, qofshin ato edhe festë-protesta në mbështetje të deklaratave të Presidentit të SHBA-së, të ftesave për takimin e Grupit Negociator nga Havijer Solana në Bruksel apo nga sekretarja e Departamentit të Shtetit të SHBA-ve Kondoliza Rajs në Uashington, por edhe me letra, e-maila, telegrame, kërkesa, protesta të dërguara nga individë e grupe e shoqata nga Kosova dhe diaspora e konsiderueshme në Evropë dhe më tej drejtuar organizmave ndërkombëtarë që po diskutojnë dhe pritet të vendosin për statusin e Kosovës.

Kam mendimin se disa nga anëtarët e këtij ekipi, në takimet e ndryshme ndërkombëtare kanë synuar më shumë të evidentojnë veten, sesa të sigurojnë mbështetjen e ndërkombëtarëve për një angazhim këmbëngulës e të argumentuar për ligjërimin sa më të shpejtë ndërkombëtar të pavarësisë së Kosovës.

Së dyti, pyes përse personalitetet eminentë të grupit nuk arrijnë të shfaqen unik në takimet me personalitet apo institucione fatpërcaktuese për zgjidhjen sa më parë të njohjes ndërkombëtare të pavarësisë. Është bërë tashmë e njohur mospërputhja e qëndrimeve të Presidentit dhe të Kryeministrit të Kosovës në konferencën e shtypit me Havijer Solanën, kur ky i fundit u detyrua të kundërshtojë publikisht mendimin e shprehur prej njërit prej tyre.

Grupi i takua edhe me shefin e diplomacisë së SHBA-ve, ku disa ditë më parë nën presionin e egër të Rusisë, Këshilli i Sigurimit ia kaloi çështjen e Kosovës Grupit Ndërkombëtar të Kontaktit. Megjithatë të gjithë anëtarët e Grupit Negociator ishin tërësisht të ndërgjegjshëm për rëndësinë e jashtëzakonshme të këtij takimi, dy anëtarë në zë të këtij ekipi bënë në prag të tij dy deklarata për kohën dhe datën e shpalljes së pavarësisë, që e detyruan Sekretaren Rajs tu thoshte: “Hiqni dorë nga pavarësia e njëanshme, mos shpallni pavarësinë e njëanshme dhe vazhdoni me negociata diplomatike”. Sipas zëvendësit të Departamentit të Shtetit, Rajs theksoi se askush nuk duhet t’i bie shkurt, ndërkohë që procesi diplomatik është në veprim e sipër. Deklarata për shpalljen e pavarësisë më 28 Nëntor, apo për Kërshëndella, shmangu diskutimin në këtë takim të një problemi mjaft të rëndësishëm për Kosovën, zhvillimin e zgjedhjeve lokale parlamentare në vjeshtën e vitit 2007.

As nuk më shkon ndërmend t’i jap ndokujt këshilla por mendoj se duhet kuptuar mirë faktin e të qenit faktor i politikës kosovare në raportet ndërkombëtare. Kurrsesi nuk është dhe nuk mund të jetë në këto zhvillime një faktor determinues. Ne kemi detyrimin dhe të drejtën tonë për të shfaqur botërisht pikëpamjet dhe qëndrimet në interes të realizimit sa më parë dhe sa më drejtësisht të asaj që na takon, pavarësisë. Por të prirur për arritjen e këtij objektivi që absolutisht do të arrihet, duhet të jemi më të matur dhe jo kategorik në

deklarime për mosbisedime të njëanshme me Beogradin, për shpallje të njëanshme të pavarësisë në emër të humbjes së durimit, për të përgëzuar apo mallkuar deklarime apo qëndrime të liderëve të ndryshëm shtetëror që shfaqen pro apo kundër planit të Ahtisarit për statusin e Kosovës etj.

Beogradi, natyrisht, do të përpiqet të përfitojë nga padurimi ynë dhe ka gjasa të përpiqet të na provokojë. Në këto kushte ne duhet të jemi shumë më të matur dhe të kujdesshëm të mos biem në grackat e tyre. Është e natyrshme lodhja që shkaktohet nga pritja për të marrë një gjë që të takon. Edhe durimi lodhet. Përkundër kësaj lodhjeje, do të citoj një thënie që më ka mbetur në mend nga Marti Ahtisari, të cilin Beogradi e akuzoi si të korruptuar nga mafia shqiptare. Ai tha: “duhet të jeni të durueshëm, ashtu siç jam unë”. Në mbyllje të kësaj, dëshiroj të bëj një vërejtje dhe një sugjerim.

Anëtarët e Grupit Negociator që kanë mundësi të takohen e të bisedojnë me përfaqësues të lartë shtetesh të ndryshme, të mos ekzaltohen nga fjalët e mira të tyre, ose në të kundërtën të ndihen pesimistë dhe këto emocione t’ia përcjellin medias dhe opinionit kosovar.

Media kosovare t’i kushtojë më shumë vëmendje punës dhe rezultateve të punës së Grupit të Unitetit. Nuk duhet nënvlerësuar dhe aq më pak të hiqet dorë nga lufta kundër abuzimeve të mundshme, por aktualisht në plan të parë duhet të dalin arritjet dhe dështimet e grupit në realizimin e misionit për të cilin u krijua.

Në të mirë të të gjithëve, në të mirë të fatit të popullit të Kosovës, uroj që misioni i Grupit të përfundojë me sukses. Ndërsa, të gjithë qytetarëve të Kosovës u kujtoj se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dinë të mbajnë fjalët, ashtu siç e mbajtën në vitin 1999. Edhe tani, sot apo nesër premtimi i tyre do të bëhet realitet dhe duke u kujdesur që të mos përmend afate, Kosova do të jetë me siguri e pavarur. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Fjalën e ka deputetja Selviqe Halimi. Le të përgatitet deputetja Saniqe Aliqaj.

SELVIQE HALIMI – Faleminderit zoti Kryetar,

Të nderuar të pranishëm, jemi dëshmitarë të një fakti se procesi për pavarësinë e Kosovës jo vetëm që është ndërlikuar, por madje është duke shkuar kah devalvimi i procesit, si i tillë.

Procesi politik, zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia sociale në Kosovë po edhe në çdo vend tjetër, janë procese që ngushtë varen nga njëra tjetra dhe ne, si duket, të gjithë pas procesit politik, e asgjë për zhvillim ekonomik e mirëqenie sociale. Mirëpo, të gjitha i adresojmë se pengesë është procesi politik. Ky është fakt.

Pse adresimi gjithëherë te procesi politik? Sepse deri më tash shumë pak kemi qenë të sinqertë, shumë pak kemi qenë transparentë, shumë pak të përgjegjshëm dhe, për të mos thënë fare, shumë pak unik. Çdo plan i veprimit kërkon kohë dhe kërkon rishikim gjatë procesit të realizimit të tij. Planet e veprimit për Kosovën jo vetëm që nuk po kanë kohë,

por nuk po kanë as rishikime. Të gjitha këto plane po bëhen së bashku ,komuniteti i Kosovës dhe ai ndërkombëtar. Çdo plan i parashikuar gjatë ekzekutimit shkon drejt dështimit. Kështu, deri më tash dështuam. Çka tash e tutje? Kërkoj nga të gjithë faktorët relevantë kombëtar, do të thotë nga të gjithë njerëzit e Kosovës të cilët flasin për Kosovën brenda dhe jashtë Kosovës, po edhe nga faktori ndërkombëtarë, që çdo plan i veprimit të ketë një afat. Pse të ketë afat? Sepse shkuan tetë vjet nga dita e çlirimit deri më tash. Nuk mund të shfrytëzojmë popullin e Kosovës si sekretari teknike vetëm për fushata zgjedhore, por duhet të punojmë për ta, duhet të punojmë edhe për territorin e Kosovës, sepse nuk është një fushë e shahut për çka edhe po flitet sot në arenën ndërkombëtare, jo gjithëherë në favor të këtij territori.

Përveç kësaj, kisha kërkuar edhe nga faktori ndërkombëtar që interesat e tyre gjeostrategjike të politikave të tyre globale të mos thyhen për Kosovën dhe Kosova të jetë në shërbim të një fuqie më të madhe apo më të vogël, siç na ndodhi gjatë historisë deri më sot. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Fjalën e ka deputetja Sanije Alijaj, le të përgatitet deputeti Ymer Halimi.

SANIJE ALIJAJ – Zoti Kryetar i Kuvendit,

Nga këtu përshëndes Presidentin Sejdiu, Kryeministrin Çeku, zotin Thaqi dhe zotin Surroi, Përshëndetje edhe për ministrat dhe deputetët e respektuar,

Sot është një ditë e veçantë për Kosovës, sepse në institucionin më të lartë të saj debatohet për çështjen e statusit të Kosovës, për të cilin jemi përpjekur mbi një shekull. Mbështes angazhimet dhe fjalën e Presidentit Sejdiu, të Kryeministrit dhe të anëtarëve të Ekipit të Unitetit. Jam e vetëdijshme se krijimi i një shteti ka vështirësi dhe pengesa, por assesi nuk mund ta konceptojë qëndrimin e disa shteteve që për vete preferojnë pavarësinë, lirinë dhe demokracinë, e të tjerëve që përcaktohen me të drejtë për të njëjtat qëllime, i pengojnë me të gjitha forcat, duke bërë skenarë, kalkulime edhe pas tetë vitesh të Kosovës në liri, me arsyetim se Kosova, një territor në qendër të Evropës, me një popullsi etnike ndër më liridashëset, nuk mund të jetë e pavarur se ua prish qetësinë dhe planet të tjerëve.

Kosova me dy milion e gjysmë banorë, në një territor mbi 10 mijë kilometra katrorë, me një popullsi më të re se 50% dhe mbi 60% të papunësuar, duan të jetojnë të dinjitetshëm. Këtu qëndron nervozizmi se njohja e dinjitetit dhe jeta dinjitoze lidhen me zhvillimet ekonomike, e progresi ekonomik me zgjidhjen e statusit të Kosovës.

Edhe përkundër zhvillimeve të fundit, unë besoj në partneritetin e institucioneve vendore dhe të atyre ndërkombëtare për t'i kapërcyer pengesat e fundit, sepse Kosova është një realitet me institucione demokratike e mbështetur nga emigracioni, miqtë tanë dhe misioni ndërkombëtar. Ne kemi dëshmuar partneritet me të gjithë se jemi të gatshëm t'i marrim përgjegjësitë mbi vete. Që Kosova të jetë funksionale edhe përkundër vështirësive të shumta me të cilat ballafaqohet, do të jetë shtet i ri dhe shembull për rajonin.

Angazhimet shtesë prej 120 ditësh nuk arsyetohen me asgjë sepse nuk mund të diskutohet vullneti politik i një populli, ai vetëm mund të njihet. Këto shtyrje, deshëm apo s'deshëm, kanë ngadalësuar procesin politik, e kanë devaluuar besimin në klasën politike, brengosin qytetarët e Kosovës dhe nxisin orekset e Serbisë dhe të Rusisë për ta penguar edhe më tej njohjen e statusit të Kosovës me pretendime për realizimin e synimeve të tyre të errëta. Por, tani jemi në shekullin XXI, shekullin e globalizimit, ku synimet e popujve për të qenë të pavarur e të integruar s'mund të ndalen, sepse ne mbi një shekull kemi punuar dhe jemi sakrifikuar për qenë të barabartë në mesin e të barabartëve.

Kosova edhe para, edhe pas 120 ditësh është detyrë e jona. Nuk duhet të dekurajohemi sepse Kosova, si asnjëherë më parë, është në top agjendën botërore.

Parlamenti i Kosovës, duke u mbështetur në Rezolutën e miratuar për pavarësinë e Kosovës, ka dhënë mbështetjen për pakon e Ahtisarit, të cilin e përkrahën Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe disa shtete të BE-së, prandaj durimin tonë, shpresën dhe synimin tonë ta shndërrojmë duke u përcaktuar në objektivat e përditshme konkrete të mundshme në mënyrë që të shohim sa dhe çka duhet bërë për Kosovën, të bëhemi faktor dhe aktorë të kësaj çështjeje jetike për ne. Qeveria e Parlamenti t'i kryejnë obligimet për ndërtimin e kapaciteteve shtetformuese duke u nisur nga Kushtetuta, ligjet, simbolet dhe duke u angazhuar për ruajtjen e qetësisë dhe të sigurisë në Kosovë.

Tri kërkesat e Grupit të Unitetit me rastin e vizitës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës se vullneti politik i Kosovës për pavarësi, integriteti territorial i Kosovës unike dhe të pandarë dhe pakoja e Ahtisarit nuk negociohen. Rideklarimi i shteteve të bashkuara se garantojnë njohjen e pavarësisë si dhe deklarata e Presidentit Sejdiu më parë dhe sot se në angazhimet shtesë do të punojnë për faktorizimin e Kosovës në qëndrueshmëri dhe stabilitet të përgjithshëm, shton shpresën dhe na obligon në funksionimin e plotë të shtetit të pavarur e sovran të Kosovës, forcon pozitën e përfaqësuesve të institucioneve të Kosovës në fazën e re që ia kanë vënë vetes në dispozicion Bashkësia Ndërkombëtare deri në gatishmërinë për ta njohur ndërkombëtarisht shtetin e Kosovës.

Si deputete e këtij Parlamenti, edhe pse kam besim të plotë në Grupin e Unitetit, ndjej përgjegjësi të kërkoj nga Grupi i Unitetit që në afatin 120 ditësh të deklarojmë vullnetin e popullit për pavarësi në parlament. Të fokusohemi vetëm në funksionimin e raporteve ndërshtetërore me Serbinë në të ardhmen. Në këto angazhime shtesë të jemi palë që i shtron temat për përshpejtimin e njohjes së pavarësisë dhe të sovranitetit të Kosovës edhe de jure, në mënyrë unike, duke përshkruar rrugën në detaje si të arrijmë deri te njohja ndërkombëtare e shtetit të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ymer Halimi, le të përgatitet Bislim Hoti.

YMER HALIMI - Faleminderit Kryetar, Berisha,
I nderuari Kryetar i shtetit, Sejdiu,
I nderuari Kryeminister Çeku,
I nderuari Surroi,
Te nderuar deputetë,

Edhe ne dy seanca te të tjera ne kemi debatuar për çështje të ngjashme dhe atje ka pasur shumë gjëra që janë thënë mjaft mirë dhe do t'u shërbenin edhe sot Ekipit të Unitetit. Por, unë debatin do ta mbështes në mendimin e Shopenhauerit se “syri e sheh botën, por vetën e sheh vetëm kur është para pasqyrës”... Uashington.

E përfunduar luftën për çlirim së bashku me miqtë tanë, të cilët na thanë: “Ju bëni paqen”, e pas një kohe shtuan: “popull i mrekullueshëm, me politikanë të këqij”.

Semantikën e porosive miqësore, me sa duket, nuk i kuptuam.

Ju lutem, një seancë e këtillë do të duhej të mbahej në kohën kur UNMIK-ut i skadonte afati trevjeçar, e të sqaronim: pse UNMIK-u nuk shkon?!

Ku ishim ne atëherë?

Fatkeqësisht, blihej kohë për të na pajtuar mes veti, se kompas i navigacionit politik, politikanëve tanë u kishte rënë nga dora, e skena vendore politike ishte irracionale.

Atëherë duhej të veprohej, por politikanët ishin shkëputur nga trangu i vet e ishin vendosur në hapësira virtuale politike. Të gjithë jetonin në formalizëm për formalizëm.

Po të ishte çështja e Kosovës vetëm thjesht formale, siç thoshin këta politikanët, nuk do të ishin në qiell aeroplanët e NATO-s për bombardime, as vrapi rus për të arritur të parët në Aeroport.

Politikanet nuk e kishin të qartë se një presje në tekst, e veprimet e vonuara për sekonda, si edhe deklaratimet e pamatura e lëkundin procesin. Thjesht, nuk e njohin thellësinë problemit.

Politikisht nga brenda u dekompozuam dhe tash historia na del e pamëshirë. Prandaj, siç thotë Ajnshtajni: “gjërat nuk janë te rastit”, edhe dekompozimi ynë politik nuk është i rastit.

Deputetë të nderuar,

Kuvendi ka për obligim të përcjellë politikat e shtetit dhe Ekipit të Unitetit t'i kërkojë përgjegjësi për çdo veprim, se ky ekip doli kryesori i politikës për shtetin. Mbi institucional. E patë çfarë “ad hoc” diplomacie të mjerë organizoi në Nju Jork, ku reflektuan ngjyra fisnore.

Ekipi i Unitetit me deklaratimet publike i ka kaluar edhe teoritë e Makiavellit. Jotransparent.

Ju lutem, në bisedimet ne Vjenë, Kosovës i është hequr substancë shtetësie, si të ishte në fajësi.

Krijimi i shtetit ka vështirësi dhe kërkon kompromis, por kompromisi ishte i skajshëm. Në diplomaci, fjala e fundit në raundin e parë nuk duhet të ndodhë. Por, kjo ndodhi komfor Ekipit Negociator të Kosovës (!!!)

Atëherë, çka mund te presim nga 120 - ditshi?! Kur kërkohet kompromis i ri. Duhet të themi troç, do të jetë i dhimbshëm.

Ju lutem, pavarësia ka kuptim kur ka përmbajtje, e jo vetëm formë (!)

Ekipi i Unitetit, prej ditës së parë është pa koncept politik. Kjo për ata që e njohin politikën nuk është fshehtësi, por shumë shqetësuese.

Shikoni..., më 1993 serbët e analizojnë idenë e strategjisë së kompromisit, madje vetë Akademia e Shkencave serbe?!

E ne, ku e kemi strategjinë? Ku janë akademikët tanë?

Ndërsa klasa politike i eliminoi ekspertët dhe intelektualët vendorë me përvojë politike.

Atëherë, ku është serioziteti ynë në këtë çast historik?! Faktet janë shqetësuese!

Nga Grupi i Unitetit i patë pesë vetë të flasin me kakofoni mendimesh . Si nuk u gjet të flasë vetëm njëri. Thua se nuk e dinin hierarkinë. Kjo reflekton tepër rënd për ata që e njohin politikën- jounitet.

Ju lutem, koha optimale e pavarësisë ka ikur, por tash është më me rëndësi rezultati i procesit dhe mënyra e realizimit, sesa koha e realizimit.

Kjo më nuk është sekret dhe kjo klasë politike është përgjegjëse për këtë rrëshqitje.

Pavarësia ndërtohet, e nuk ta dhuron askush. Prandaj, duhet te veprohet. Veçmas Kuvendi ka fusha për t'i mbushur me veprime konkrete.

Shtetet nuk janë bërë shtete me vullnetin e të gjitha shteteve, për këtë nuk duhet të kemi edhe aq brengë. Ne i dimë edhe vështirësitë e pranimeve të shteteve, por duhet të mbështetemi te miqtë tanë. Sa duket, edhe këtu kemi vështirësi.

Përgjegjësia për shtetin t'u kthehet institucioneve demokratike të shtetit, e jo individëve të caktuar.

Institucionet demokratike t'i kthehen ligjit. Kjo prek pavarësinë, e jo Grupi i Unitetit me kësi uniteti që pat.

Të kthehemi në pasqyrë. Ia vlen.

Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA - Bislim Hoti, le të përgatitet Hydajet Hyseni. Zoti Hyseni urdhëroni!

HYDAJET HYSENI –

I nderuar zoti Kryetar,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Më lejoni që në fillim të përshëndes posaçërisht anëtarët e Grupit të Unitetit dhe miqtë që na ndjekin, jo veç për hir kurtuazie, por edhe për të dëshmuar që në fillim edhe respektin, por edhe mirënjohjen për atë që është bërë dhe meriton të respektohet. Por, edhe për të dëshmuar diçka tjetër, se gjuha kritike nuk e mohon respektin dhe mirënjohjen për atë që është pozitive dhe që është bërë.

Unë përshëndes veçanërisht debatin e hapur, kështu siç po bëhet sot, e jo si ai tjetri kur u miratua, nëse mund të konsiderohet miratim dokumenti i zotit Ahtisari. Nuk e ka këtu vendin të bëhen vërejtje procedurale dhe unë s'do të mund t'i përmendi ato, por më bëri përshtypje mosrespektimi i rregullës 22.5 a) dhe 25.7 që në rastet si kjo e sotnja

megjithatë Grupi Parlamentar duhet të nisë debatin. S'e them për procedurë, por është fjala te ai raporti kushtetues midis institucioneve. Kur është në pyetje Grupi i Unitetit, ky raport nuk duhet të ndryshohet.

Unë e përshëndes edhe gjuhën pozitive afirmative që e dëgjuam prej anëtarëve të Grupit të Unitetit dhe do të dëshiroja që diskutimi im të ishte në këtë ton, është gjithmonë pozitive. Por, druaj që gjendja në të cilën ndodhemi megjithatë imponon nevojën e një qasjeje pak më kritike dhe, do të thosha, edhe më vetëkritike edhe nga anëtarët e Grupit të Unitetit. Ne kemi dëgjuar këtu të flitet për raunde të fituara të shumta, por tani duhet të themi që nuk e fituam lojën, zotërinj, dhe si ndodh që të fitosh raundet, e të mos e fitosh lojën, a me nokaut, a 8 me 2 etj. etj. A mund të kalojë thjeshtë ashtu, thamë dhe të mos shikojmë çka kemi thënë disa muaj përpara, ndonjë vit përpara, e të tjera. Nuk do t'ia vlente të ktheheshim në të kaluarën, por është çështja te konceptet prej të cilave ende nuk jemi liruar. Ne ende po vazhdojmë t'i trajtojmë lëvdatat në procesin negociues si fitore dhe po harrojmë se nuk kemi shkuar atje për të marrë lëvdata. Çka do të kishte të keqe sikur në atë proces edhe pala tjetër të kishte marrë pak lëvdata, të kishte marrë pak poena dhe gjendja të ishte pak më ndryshe, e jo tani siç u tha këtu, kemi marrë lëvdata, por gesen e kemi bosh, s'kemi çka të qesim në treg dhe të vazhdojmë procesin.

Çuarja në tregti ose është naivitete ose është plëngprishje. Përmendet shpesh një moto në diplomaci, nëse ke një dele dhe duhet të bësh farë negociatash për të, do të ishte punë e mençur të shesësh eventualisht leshin, por jo delen, jo trupin, jo gjymtyrët e saj, se po i shite trupin, gjymtyrët e saj, atëherë ty të mbetet ajo që eventualisht do të mund ta shesësh.

Ne sot jemi në një gjendje që vërtet po ngjall shqetësim me të drejtë ndër qytetarët e Kosovës. Përsëri janë në skenë ata tre faktorët si para 10 vjetësh, si para 50 vjetësh, ndoshta si edhe para një shekulli, e tjera. Nga një anë politikat agresive të Beogradit, nga ana tjetër një tolerim i çuditshëm ndonjëherë edhe inkurajim nga çarqet ndërkombëtare i asaj politike që është jo vetëm e rrezikshme për fqinjët, por është dëshmuar e rrezikshme edhe për vetë Serbinë dhe të ardhmen e saj. Dhe nga ana e tretë, një politikë, thënë më së buti, joadekuate nga ne.

Presidenti Gjon Kenedi porosiste: "të mos frikësohemi të negociojmë, por kurrë të mos negociojmë pa u frikësuar". Kam përshtypjen, zonja dhe zotërinj, se në këtë proces ne i kemi bërë të dy gabimet, edhe kemi ngurrar të hyjmë në proces të negocimit, që s'do të duhej ta bënim, sepse është e drejta jonë, pse të mos negociojmë, por edhe pastaj kemi negociuar në mënyrë noshalante, pa përgjegjësi, prandaj kemi këtë gjendje sot kështu. Për ta dëshmuar këtë, u theksua edhe sa e sa herë. A kishte një program të mirëfilltë negociues, a kishte një platformë, a kishte një strategji të përpunuar mirë, a kishte taktika të përpunuara mirë dhe të zëvendësuara sipas situatave, a kishte pozicion negocius adekuat, çka dëshmoi praktika, a ishte e sqaruar që në fillim për çka bisedohet dhe me kë bisedohet, çka me Bashkësinë Ndërkombëtare, çka me Beogradin dhe çka eventualisht me komunitetet brenda Kosovës? Kush ishte pala në këtë proces? A ishte Bashkësia Ndërkombëtare, siç është thënë shpesh, a ishte Beogradi apo serbët anëllë, siç janë prezantuar shpesh, çfarë cilësie kishin krah përfaqësuesve të Beogradit zyrtar kolegët

tanë, ndonjëherë këtu ministra, deputetë etj., dhe çka do të thotë të pranohet kjo pa kundërpërgjigjen adekuate, pse nuk ishte aty, nëse duhej të ishte Beogradi për çështje të brendshme të Kosovës, pse nuk ishte Tirana.

Nëse duhet të kishte një komunikim serbo – shqiptar, pse të mos ishin shqiptarët e Preshevës, është shtruar kjo pyetje dhe kurrë nuk është marrë përgjigje siç duhet. Hapat e parë e determinojnë pastaj edhe rezultatin në fund. Pse u lejua që me Beogradin të bisedohet për çështje që në çdo variant, me çdo kriter janë çështje të brendshme të Kosovës, janë trajtuar si çështje të brendshme të Kosovë edhe në kohën e represionit më të egër.

A u nënçmua Beogradi në këtë proces dhe pse? A po vazhdon edhe tutje, a po shkojmë prej një skaji në skajin tjetër dhe në të njëjtën kohë a u tejçmua kapaciteti i Grupit Negociues dhe për pasojë edhe për çështje që janë thjesht profesionale, siç janë kultura, siç janë monumentet, siç është organizimi i pushtetit lokal, nuk u ftuan ekspertët, ata që i njihnin dhe, për pasojë, u bënë gabime trashanike, kështjellat të shpallen monumente religjioze, kështjellat që janë të antikës shekuj të tërë para se të jetë ai religjion në këto pjesë, etj.

A bëhet pavarësia me vartësi ekstreme që po na shoqëron në vazhdimësi? A ishte opsioni i pavarësisë fjala e vetme e jona si opsion maksimalist e licitues, siç u prezantua, dhe a mos po i paguajmë tagrin kësaj pikërisht, atij ngurrimi për të thënë edhe ne tonën. Nëse dikush thotë se për këtë arsye Kosova duhet të jetë Serbi, pse të mos jetë një përgjigje e ngjashme - Kosova për 99 arsye më tepër ka të drejtë të jetë Shqipëri, nëse flasim me këta parametra, dhe të vlerësohet pavarësia e Kosovës ashtu siç është vërtet si zgjidhje kompromisi nën të cilën s'ka zgjidhje.

Po identifikimi me Grupin Negociues, me UNOSK-un, tani edhe me dokumentin e Ahtisarit, a është hap i arsyetueshëm negociues, a mund të pritet që arbitri të shënojë gol ose kosh. Ai ta jep topin, por golin duhet ta shënosh ti. Pse ky identifikim yni jo i sigurtë me dokumentin e Ahtisarit. Në bisedat tona gjithë i kemi 100 vërejtje në atë dokument, pse nuk i themi. Në Web sajtin e Qeverisë Serbe kemi të publikuara vërejtjet e Qeverisë Serbe në dokumentin e Ahtisarit. Çka ka të keqe, pse mos t'i themi edhe ne tonat dhe pastaj, duke qenë të sigurtë, të dëshmojmë pjekurinë, konstruktivitetin etj. Nuk i mohan askush te ne seriozisht, as grupet, forcat më radikale, më nacionaliste nuk i mohojnë të drejtat dhe liritë e komuniteteve të tjera, as të drejtat dhe liritë e serbëve. Dhe, mund të jenë ato edhe më shumë, por ama të gjithë pajtohen se nuk është liri e drejtë e qytetarit serb në Kosovë loja me toka, me territore, politizimi i tyre dhe shfrytëzimi i tyre si casus belli për konflikte të reja. Nuk i ndihmohet në atë mënyrë komunitetit serb në Kosovë, as pajtimit, as integritet, as perspektivës së ardhshme. Pse nuk e themi këtë më shkoqur dhe t'ia themi këtë "po", kësaj "jo", nuk pajtohemi, e konsiderojmë të gabuar.

Tani për pasojë po imponohet me tamtame tamam çështja e ndarjes së Kosovës, e copëzimit të saj, dhe ka nisur njëfarë mënyre edhe të dëgjohen tone në favor të një farë pajtimi edhe me gjëra të tilla. Megjithatë, ndarja sjell ndarje dhe për mendimin tim ekuivalencën Preshevë /Veri do të duhej marrë parasysh seriozisht, jo pse e duam ne, po sepse ajo do të funksionojë si e tillë.

Për të përfunduar, zoti Kryetar dhe zonja e zotërinj deputetë, unë dëgjova dhe tone e propozime të cilat i mbështes. Do të ishte mirë që parimet të na ishin sjellë me shkrim dhe mendoj se Grupi i Unitetit do të duhej ose të merrte përgjegjësinë dhe të bëjë propozimet dhe hapat e duhur edhe afatet, sepse zoti të jep shenja tjera se kur është koha e korrijeve, por nuk dërgon lajm ose mesazh: "tash dil në ara dhe korre grurin". Prandaj, edhe ne i mbështesim këto, por kërkojmë nga Grupi i Unitetit, nga Qeveria që e bënë në vende të tjera, që të marrë nismën t'i sjellë propozimet Kuvendit dhe Kuvendi pastaj edhe t'i miratojë e t'i legjitimojë ato.

KRYETARI KOLË BERISHA – Fetah Berisha, le të përgatitet Nimon Alimusaj.

FETAH BERISHA – I nderuari zoti Kryetar,
I nderuari President i Kosovës, Kryeministër, dhe ai ministri që është atje është i nderuar,
Të nderuar kolegë deputetë,

Sot në këtë seancë po debatojmë për temën: "Shtyrja e statusit final të Kosovës". Po debatojmë për një temë jetike për ne shqiptarët e shumëvujtur dhe po debatojmë për Kosovën, pavarësinë e saj gjatë të robëruar. Lëvizja jonë për liri e pavarësi ka filluar pikërisht atëherë kur të huajt i robëruan dhe i copëtuat trojet tona. Lëvizja jonë është e ngjashme historikisht me lëvizjet përparimtare të popujve të shtypur, ndërsa përpjekjet e shqiptarëve të Kosovës për ta flakur sundimin serbë kanë jetë njëshekullore. Të gjitha përpjekjet tona për liri e pavarësi brenda një shekulli u sakatosën nga regjimi serb me represalie, gjenocid e pastrim etnik. Mirëpo, lëvizja politike e shqiptarëve të Kosovës e viteve të 90-ta për liri e pavarësi bënë unitetin e shqiptarëve më shumë se në të gjitha kohërat pas asaj skenderbegiane. Në lëvizjen tonë u fut filozofi e re e veprimit, u proklamua pavarësia legalisht dhe në midis të Prishtinës. Kjo formë e re veprimi kishte efekt drejt lirisë dhe pavarësisë së Kosovës dhe kështu bëhej ndërkombëtarizimi i çështjes sonë kombëtare më shumë se kurrë më parë. Prandaj, edhe i nderuari dr. Rugova vazhdimisht e përsëriste, vazhdimisht thoshte se Kosova do të jetë në miqësi të përhershme me SHBA-të dhe kurrë Kosova nuk ka qenë më afër për t'i realizuar aspiratat e veta për pavarësi. Ndërsa, shtyrja e përkohshme për definimin e statusit të Kosovës, me arsye ka sjellë shqetësim në Kosovë, sepse edhe faktori vendor e ndërkombëtar pat proklamuar se viti 2005 është vit i pavarësisë, pastaj u proklamua se viti 2006 është viti i pavarësisë. Ja tani që edhe në vitin 2007 pengohet pavarësia nga ata që s'na deshën kurrë të mirën. Mirëpo, procesi drejt pavarësisë nuk mund të zgjatë në pamundësi dhe nuk mund të ndalet dhe një ditë ky proces do të realizohet. Ndërsa, faktorizimi me çdo kusht i Rusisë si qendër, apo si qendër dirigjuese e politikës botërore, i ngjan anekdotës së Nastradinit kur thoshte se aty ku e lidh unë gomarin, aty është qendra e botës, por kjo nuk u vërtetua kurrë. Sidoqoftë, në procesin e pavarësisë duhet të dakordohet edhe Rusia dhe të tjerët, të cilët janë kundër pavarësisë sonë sepse, siç shprehet një diplomat ndërkombëtarë, pavarësia do të arrihet, por mbijetesa e saj duhet të jetë e qëndrueshme. Natyrisht, sa më afër që do të definohet pavarësia e Kosovës, regjimi i Beligradit aq më shumë do të pjellë sfida e provokime, vetëm e vetëm për ta dëmtuar procesin e pavarësisë së Kosovës. Por, ne duhet t'i përgjigjemi me një politikë dhe diplomaci konstruktive. Ja një provokim shovinist që ndodhi këto ditë në komunën e Rahovecit, në fshatin Zoqishtë të Rahovecit, aty ku është një kishë e vockël serbe, aty rrinë dy – tre murgj serbë dhe aty,

me sugjerimin e zotit Artemije, u vendos flamuri serb në kulmin e asaj kishe. U provokua popullata e kësaj ane, u hidhërua ajo dhe i thanë, t'i zoti Artemije je njeri i fesë apo i paqes, t'i je njeri i paqes apo i zotit, apo je timonieri i provokimeve, apo je timonieri i shovinizmit dhe hegjemonizmit serb? Në këtë kishë serbe në Zoqishtë të Rahovecit gjatë luftës kanë qenë të vendosur paramilitarët serbë të cilët masakruan shqiptarët e pafajshëm në masë, u masakruan në masë 106 shqiptarë të fshatit Pastasel, mbi 70 të Celinës, me qindra të tjerë u masakruan në Rahovec, Krushë të Madhe, Krushë të Vogël, në Zatriq, Drenas etj. Edhe ky eksces po e dëmton edhe procesin e kthimit në Zoqishtë ku minoritetit serb i janë ndërtuar dhe i presin shtëpitë e ndërtuara. Dhe, banorët e kësaj treve i thonë zotit Artemije: ” Ja, këta janë shqiptarët të cilëve ju ua keni grabitur tokën, ju ua keni marrë pasuritë dhe ata kanë ndërtuar shtëpitë për ardhacakët e juaj”. Këto provokimet tjera sikur kanë mbështetjen edhe tek Rusia, e cila po zgjohet nga gjumi, sikur po përfiton në kohë dhe po synon të rikthehet në Ballkan. Po tenton ta mbajë peng edhe diplomacinë botërore, edhe Ekipin e Unitetit tonë, edhe proceset e pavarësisë së Kosovës, po ashtu edhe Ballkanin. Apo, ndoshta vlen të thuhet thënia këtu për Kosovën se “Vetë bukuria jote, oj Kosovë, qenka një kob për fatin tonë tragjik dhe po e mban peng pavarësinë e Kosovës”.

Është fakt se kundërshtarët e pavarësisë i kanë shfrytëzuar edhe ngjarjet e marsit 2004 dhe vdekjen e Presidentit Rugova për t'i stagnuar proceset. Prandaj, është mirë që Ekipi i Unitetit të ringjall shembullin e Presidentit Rugova për komunikimin e brendshëm dhe diplomatik ndërkombëtar. Ne kemi argumente të shumta. Qeveria serbe institucionalisht ka bërë gjenocid shekullor mbi shqiptarët. Ata vazhdimisht kanë tentuar ta bëjnë pastrimin etnik të Kosovës, kanë bërë disa herë kolonizimin e Kosovës. E drejta jonë historike, autoktonia jonë, rezistenca jonë paqësore, rezistenca jonë e armatosur etj., nuk duhet vënë në dilemë pavarësinë sepse Kosova e meriton denjësisht pavarësinë. Ndërsa, kalimi i çështjes së Kosovës nga Këshilli i Sigurimit në Grupin e Kontaktit, aty ku është edhe Rusia, por s'ka të drejtë vetoje, le të bashkëpunohet thukhtë e le t'i thuhet edhe le të sqarohen gjërat rreth Kosovës, bile edhe le të përsëriten disa herë.

Grupi i Unitetit ka bërë dhe po bën punën e vet, nuk ka vend për dyshime, po le të sugjerohet të përdorë dhe të sqarojë edhe të drejtën historike të Kosovës, e cila nuk ngjanë me asnjë territor në Evropë që të jetë i sakatosur dhe i copëtuar kaq shumë sa trojet shqiptare, e të cilët kanë një kompaktësi etnike. Pastaj, dihen edhe vitet, datat, konferencat kur është copëtuar, kështu që nga 120 mijë kilometra katrorë të trojeve shqiptare, sot është tkurrur në 10 mijë e 800 kilometra. Serbia po thirret në të drejtën ndërkombëtare përmes përpjekjes gjoja se cenohet sovraniteti i shtetit, se gjoja Kosova po bëka 15% të territorit të Serbisë. Po Serbia, me çfarë të drejte ndërkombëtare e pushtoi Kosovën më 1912? Kësaj pyetjeje duhet t'i jepet përgjigje atje ku duhet. Pra, Kosova, thjesht, kurrë s'ka qenë territor i Serbisë, por është tokë e pushtuar nga Serbia. Të sqarohen pastaj mitet që i krijoi regjimi serb dhe Kisha Ortodokse Serbe për Kosovën dhe rreth Kosovës. Nëse sllavoserbët erdhën në Ballkan në shekullin VII pas Krishtit, nga kush ishin të banuara këto troje para se të vinin ata? Pra, kush ishte autokton këtu, ardhacakët në Kosovë, apo shqiptarët të cilët janë autokton në trojet e veta.

Pas shtyrjes 120 - ditëshe, zgjidhjen e statusit të Kosovës për t'i vazhduar bisedimet me palët ndër vete, ata veprim i njëanshëm, thuhet vazhdimisht veprim i njëanshëm, për të cilin sugjerohet që të mos veprohet. Dakord, ne nuk do t'i kundërshtojmë sugjerimet e aleatëve tanë evropian, e në asnjë mënyrë as Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por Grupi Negociator duhet të jetë më këmbëngulës në shpjegimet dhe qëndrimet e veta për çështjen tonë jetike. Zaptuesit dhe kolonizatorët rrallë ndodh që kolonitë e veta t'i lirojnë me dëshirë. Të gjitha shpalljet, pra, sikur janë të njëanshme. Pas 120 ditëve të shihet e të bëhet, ky Kuvend mos ta hedh as opsionin dhe shpalljen e pavarësisë së Kosovës dhe vazhdimisht në këshillim me aleatët tonë. edhe Ismail Qemajli e pat shpallur thuaja njëanshëm pavarësinë e Shqipërisë më 28 Nëntor 1912. Edhe atëherë Serbia e Greqia kanë qenë kundër pavarësisë së Shqipërisë e pse, pra, dihet. Bile ndërkombëtarisht ndoshta nuk kanë qenë shumë çështje të sqaruara apo të ndërkombëtarizuara sa janë sot të sqaruara rreth Kosovës dhe për Kosovën.

Pra, kemi të drejtën historike, kombëtare të jemi të lirë e të pavarur, sepse ne jemi për stabilitet e për paqe në Ballkan e në Evropë. Këtë e kemi dëshmuar gjatë gjithë historisë, e po e dëshmojmë edhe sot. Është koha të na shpërblehet munda dhe sakrificat jonë dhe pas këtij afati 120 ditësh të zbatohet me këmbëngulje pakoja e Ahtisarit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Nimon Alimusaj, le të përgatitet Melihate Tërmkolli.

NIMON ALIMUSAJ – Faleminderit zoti Kryetar,
I nderuari zoti President,
Zoti Kryeministër,
I nderuari Surroi,
Të nderuar ministra dhe kolegë deputetë,

Nëse e përcjellim rrugën e procesit për caktimin e statusit të Kosovës, mund të nxjerrim dy konstatime. Deri në qershor të këtij viti, ky proces qonte vazhdimisht e gjithnjë më afër përcaktimin e statusit të Kosovës. Kjo fazë kulmoi me vendosjen e planit të Ahtisarit në tavolinën e Këshillit të Sigurimit, të ku gjithë dëshirojmë të qëndrojmë edhe sot dhe besojmë se do të qëndrojmë. Këtë plan e kanë përkrahur më të thirrurit, përfaqësuesit kryesor të OKB-së, të UNMIK-ut, të KFOR-it, të NATO-s dhe shumica e shteteve me peshë në botë. Kësaj përkrahjeje i kontribuan institucionet e Kosovës, Grupi i Unitetit dhe populli i Kosovës në përgjithësi.

Dy, që nga qershori procesi ka stagnuar. Tash është caktuar një 120 ditësh i cili nuk e ka të caktuar fillimin dhe nuk duket fort i qartë se kjo kohë do të shërbejë për të bindur Rusinë dhe Serbinë se nuk ka zgjidhje tjetër përveç pakos së Ahtisarit, apo për të korrigjuar sado lehtë këtë pako. Kjo e dyta nuk do të guxonte të ndodhte. As ky stagnim i kësaj faze të dytë nuk është rezultat i paaftësisë së palës shqiptare, as të institucioneve të Kosovës, as të Grupit të Unitetit. Mendimet që dolën këtu se statusi i Kosovës qenka shtyrë si rezultat i 4-5 burrave, siç u tha nga një diskutues, më shtynë të konstatoj se tek të tillët çështja kaq madhore është kapur prej degësh e jo prej trungut. Problemi nuk është aq i lehtë. Është i pamohueshëm konstatimi se rezultat i këtij stagnimi është kokëfortësia ruse mbase edhe e fuqisë së saj ta stagnojë procesin. Nëse ka pasur ndonjë gabim, ka

pasur gabim se nuk është çmuar shumë kjo, jo vetëm nga faktori shqiptar, por as nga disa shtete të Bashkësisë Evropiane. Rusia, si duket, do të jetë kokëfortë edhe më tej në mbrojtjen e interesave të Serbisë në Kosovë dhe ka për ta stagnuar këtë proces. Ajo duket se ka një gamë të tërë opsionesh që do t'i paraqesë në vazhdimësi si gardh për të penguar statusin e Kosovës.

Presioni ndërkombëtar ndaj kësaj kokëfortësie të Rusisë dhe të Serbisë nuk më duket se ka qenë përputhje me kokëfortësinë e tyre. Rusia dhe Serbia mohimin e përcaktimit të statusit të Kosovës po e realizojnë, do të thosha, me një platformë që do ta quaja platforma ose teoria e pritjes së pafund. Teorinë e pritjes së pafund ajo realizon me qëndrimin: “nuk pranoj asgjë që nuk është rezultat i marrëveshjes së Prishtinës dhe Beogradit”, e dihet se të presësh derisa Beogradi të bindet për pavarësinë e Kosovës, me këtë presion kaq të vogël të faktorit ndërkombëtar ndaj saj, unë mendoj se është njësoj sikur të presësh deri në pafundësi.

Beogradi dhe Moska kanë vërtetuar shumë herë se nuk do të pranojnë asgjë për statusin e Kosovës, përveç opsionit të tyre. Ata nuk kanë pranuar pakon e Ahtisarit, të cilën e kanë përkrahur të gjithë, si e thashë më lart, më të thirrurit dhe e cila mbi 90% ka elemente të asaj që quhet diskriminim pozitiv për serbët, e diskriminime të tilla pozitive unë nuk kam parë në ndonjë shtet, sado demokratik të jetë, të botës. Ata i kanë refuzuar të gjitha, rezolutat ende pa u publikuar mirë. Shkurt, Moska dhe Beogradi synojnë vetëm pritjen e pafund.

Së këndejmi, një konstatim i parë. Institucionet e Kosovës, Grupi i Unitetit, në bashkëpunim me Bashkësinë Ndërkombëtare, angazhimin primar duhet ta kenë në përpjekje për t'i dhënë fund kësaj që unë po e quaj pritje të pafund.

Së dyti, Ekipi i Unitetit dhe institucionet e Kosovës duhet të jenë të kujdesshme që me asnjë element të mos i kontribuojnë asaj pritjeje të pafund. Kështu, për shembull, duhet të jenë të matur në vendime për disa çështje, të cilat unë i kuptoj të zorshme, siç është: të mbajmë apo të mos mbajmë zgjedhje, sidomos të përgjithshme, paralel me statusin, ose të caktojmë apo të mos caktojmë një datë të shpalljes së pavarësisë nëse nuk ecën procesi. Dihet se veprimet e mëdha e kanë orën e vetë dhe institucionet e Kosovës dhe grupi i ynë duhet ta gjejnë orën më të mirë për vendimet e tilla të zorshme. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Melihate Tërmkolli, le të përgatite profesor Muhaxheri.

MINISTREJA MELIHATE TËRMKOLLI – Faleminderit zotëri kryetar,
I nderuari Kryetar i Kosovës,
I nderuari Kryeministër,
Zoti Thaqi, zoti Surroi,
Të nderuar deputetë,

Do të përpiqem që të mos i përsëris çështjet që disa nga deputetët i kanë thënë më herët, ndonëse do të jetë pak e vështirë. Kujtoj se po na përsëritet vazhdimisht kjo rreth funksionimit të grupit, që po e quajmë të unitetit, dhe vërtet do të kërkoja dhe konsideroj

se është koha e fundit që të jetë një rikonceptim i mënyrës së funksionimit të këtij grupi, sepse 5 zëra nuk shprehin unitetin as në esencë, as në formë dhe Kosovës i duhet një unitet edhe në esencë, por edhe në formë. Është kryetari i Kosovës ai që duhet të shprehte formë atë që esencialisht do të ndodhte në Grupin e Unitetit.

Kujtoj se të gjithë anëtarët, në fakt, potencuan edhe një herë se kemi një përkrahje të plotë të pavarësisë së Kosovës nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga Bashkimi Evropian dhe kjo është e qartë, kujtoj, edhe për institucionet, edhe për të gjithë qytetarët e Kosovës, njësoj siç është shumë e qartë që edhe në vitin e kaluar, pra edhe në vitin 2006 ne kemi pasur një përkrahje shumë të fuqishme, deklarata shumë të fuqishme të të gjitha këtyre segmenteve edhe institucioneve ndërkombëtare për njohje të pavarësisë së Kosovës. Dhe, natyrisht, kjo nuk le hapësirë për të dyshuar në seriozitetin dhe sinqeritetin, në radhë të parë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por edhe të Bashkimit Evropian për atë që thonë. Megjithatë, ka një problem. Problemi është se ende nuk kemi njohjen e pavarësisë së Kosovës. Dhe kujtoj më shumë se gjithçka tjetër kjo na jep të kuptojmë dhe shenjë e mjaftueshme për një punë shumë më të madhe të institucioneve të Kosovës. Është një shenjë e mjaftueshme se definitivisht institucionet e Kosovës dhe lidhshipi i saj duhet të marrin qëndrime edhe vendime dhe, natyrisht, t'i bindim edhe miqtë tanë, ta bindim edhe Bashkësinë Ndërkombëtare se këto qëndrime dhe vendime duhet të realizohen. Kujtoj që kjo është ajo pika shumë esenciale e funksionimit tonë, sepse me këtë tregojmë partneritetin tonë që fatkeqësisht nuk e kemi treguar ndoshta në masën sa duhet dhe sa vërtet janë kapacitetet e Kosovës për ta shprehur atë dhe për ta treguar atë.

Sjellja si partner në asnjë mënyrë nuk nënkupton përjashtimin apo abstrahimin e Bashkësisë Ndërkombëtare. Përkundrazi, është një bashkëpunim i fuqishëm me miqtë tanë ndërkombëtarë në drejtim të realizimit të njohjes së pavarësisë së Kosovës, sepse në esencën e vet partneriteti është një fuqi vepruese e institucioneve, një fuqi bindëse për të realizuar synimet dhe qëllimet tona.

Unë kujtoj që grupi dhe kam menduar që, në fakt, grupi sot do të duhej që para Kuvendit të Kosovës, nëse jo sot, gjithsesi në një kohë shumë të afërt, duhet të qartësojë disa çështje për të cilat duhet të merren vendime në Kuvendin e Kosovës. Duhet të qartësohen qëndrimet e institucioneve të Kosovës për situatën e re. Ne mund të themi çfarë të duam, por është shumë e qartë, ne kemi një situatë të re në Kosovë dhe duhet të ndërtojmë një politikë dhe një strategji krahas kësaj situatë e cila është krijuar. Do të kemi një qëndrim shumë të qartë rreth planit të Presidentit Ahtisari. Deklarativisht ne kemi një qëndrim, por realisht kjo nuk ndodh. Ne kemi veprime të ndryshme për situata dhe çështje të caktuara në atë që thotë plani i Ahtisarit dhe të ndryshme për çështje të tjera.

Unë kujtoj që institucionet e Kosovës me seriozitetin e plotë duhet ta kenë qëndrimin shumë të qartë dhe të sillen, thjesht, jo në mënyrë të dyfishtë dhe të kemi kritere të shumta rreth zbatimit të këtij plani, por të kemi një kriter unik dhe një veprim unik rreth tij. E kemi potencuar vazhdimisht se pavarësia e Kosovës është e panegociueshme, është e pashmangshme dhe është i vetmi opsion, njësoj siç e kemi potencuar se tërësia territoriale e Kosovës është e paprekshme. Por asnjëherë deri më sot nuk kemi asnjë fjalë

të vetme se cilat janë veprimet tona që e garantojnë këtë, cilat janë veprimet tona dhe jo deklaratat, sepse absolutisht jemi vetëm në nivelin e deklaratave, edhe rreth opsioneve tjera të cilat janë në horizont. Fatkeqësisht janë në horizont dhe janë rrezik real. Tashmë po shfaqet një rrezik real. Ne mund t'i abstrahojmë këto, mund të mos i themi asnjëherë, por realisht këto janë opsione të cilat po shfaqen edhe ndaj të cilave ne do të kemi jo veç deklaratat, por edhe të kemi qëndrime të fuqishme.

Është Kuvendi i Kosovës, kujtoj, ai që duhet të miratojë një dokument rreth hapave të mëtejshëm në formë të planit, apo çfarëdo emri që t'i japim, është vetëm Kuvendi i Kosovës dhe kurrfarë surrogati tjetër, siç përpiqet ndonjë deputet këtu ta propozoj ndonjë farë asambleje parlamentare, apo çka tha dikush për shpëtimin kombëtar, e nuk di çfarë emra tjerë pa lidhje që i thonë deputetët aksidentalisht. Më falni, kam përshtypje që ata deputetë janë aksidentalisht deputetë të Parlamentit të Kosovës dhe sigurisht nuk e kanë vendin këtu.

Dhe, është shumë e qartë për institucionet dhe për qytetarët e Kosovës se me të gjitha përpjekjet që janë bërë edhe deri tani për bisedime e të tjera, nuk ka pasur një marrëveshje. Nuk ka pasur marrëveshje dhe e kemi shumë të qartë që edhe në këto bisedime që po thuhet se do të bëhen, këtë duhet ta themi shumë hapur, nuk ka marrëveshje me Beligradin, absolutisht s'ka dhe bota duhet ta ketë të qartë. Ne krejt atë çka po bëjmë mund të themi se sikur po bëjmë diçka, në fakt sikur po e pranojmë një lojë, sikur po bëjmë bisedime për të mos bërë asgjë. Thjesht, nuk ka marrëveshje. Ka një qëndrim shumë të fuqishëm për njohjen e pavarësisë së Kosovës dhe, thjesht, kjo është e vetmja zgjidhje. Mund të jetë kjo vetëm një arsyetim, ndoshta për shtyrje etj., por zgjidhje jo.

Dhe, një çështje, plani i Ahtisarit, në fakt ne e kemi shumë të qartë që të gjithë, që është jo vetëm kompromisi më i madh, por i ka tejkaluar që të gjitha kompromiset e Kosovës. Nëse na kujtohet, Presidenti Rugova vazhdimisht e ka potencuar se pavarësia e Kosovës është kompromisi i shqiptarëve dhe kujtoj që është pavarësia e Kosovës kompromisi dhe jo këto dokumente tjera. Fatkeqësisht, çështjet sikur kanë filluar të bisedohen, madje edhe nën këtë dokument dhe në këtë rast, logjika e vetme që do të duhej vepruar, është rritja e kërkesave dhe unë kujtoj që këtë ne do ta kemi që të gjithë parasysht, madje detyrimisht Parlamenti i Kosovës. Nuk po dua të merrem me ditë e data, sepse është shumë e qartë, janë procese që në asnjë mënyrë nuk mund të vësh, madje po të jetë edhe krejt në dorën tonë, të institucioneve tona, nuk mund ta vësh thjesht një datë, apo një ditë, por gjithsesi një vizion dhe një qëndrim shumë të qartë rreth asaj se cilat janë veprimet tona dhe cilin veprim do ta marrë Parlamenti i Kosovës.

Dhe krejt në fund, unë kujtoj që, natyrisht, e kemi të qartë të gjithë, situata nuk është krejt e lehtë, nuk është kjo për t'u dekurajuar, ani pse është shumë delikate, por unë kujtoj që, thjesht, vazhdimi i bisedimeve apo i bisedave, debateve në parlament vetëm sa për debatuar, duhet të ndërpritet. Është tepër e padobishme dhe e papranueshme që Kuvendi të debatojë vetëm për sa për debatuar. Kuvendi është institucioni vendimmarrës, kjo është përpjekja e shqiptarëve të Kosovës e qytetarëve të Kosovës për institucione, për fuqizimin e tyre, për marrjen e vendimeve nga këto institucione sepse jemi zgjedhur me

votën e qytetarëve dhe atë votë ne duhet ta arsyetojmë, thjesht, jo veç sa për ta arsyetuar, por për të realizuar interesat e qytetarëve të Kosovës. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI KOLË BERISHA – Profesor Muhaxheri, le të përgatitet Mazllom Kumnova. Urdhëroni profesor Muhaxheri!

YMER MUHAXHERI – Kuvend i nderuar, zotëri kryetar,

U theksua rëndësia e pakos së Ahtisarit, e cila është aprovuar në Kuvend, që shërben si platformë dhe program i punës së Kuvendit. Kjo pako ka marrë përkrahjen dhe mbështetjen e faktorit ndërkombëtar. Kjo mbështetje është argument i fuqishëm dhe në këto biseda, negociata shtesë që me konsekuencë duhet t’iu përmbahemi. Motivi i paraqitjes për bisedë është sikleti që më është paraqitur në atë rast kur prej një anëtari Grupit të Unitetit u theksua, po e citoj: “jemi zotuar që plani i Ahtisarit ka për t’u zbatuar në plotësi”. Me këtë rast, mjerisht, përmendi një shembull i cili me të dy këmbët e shkel pakon e Ahtisarit. Qysh në fillim në të thuhet se zgjedhjet organizohen pas shpalljes së pavarësisë. Në këtë rast, autoriteti Ryker është i obliguar me Rezolutën 1244. por krahas kësaj ai ka edhe obligim institucional ndaj Këshillit të Sigurimit dhe Kryetarit të tij Ban Ki Mun se kjo paketë e Ahtisarit është aprovuar dhe e ka mbështetjen e saj dhe se ajo duhet të jetë bazë për të gjitha bisedat e mëvonshme. Paraqitet pyetja, ku është kjo përgjegjësi e fjalës së thënë publike, a ka një diskrepancë të hatashme mes fjalës së thënë publikisht dhe sjelljes e veprimit praktik kur nxirret vendimi për organizimin e zgjedhjeve. Çfarë jehone, si ka për të influencuar në opinionin e jashtëm dhe në atë brendshëm një vendim i tillë, vendim, i cili mbështet në një konstatim të çuditshëm se procesi zgjedhor nuk e pengon paralelisht procesin e statusit. Faktikisht, ky proces i ka dy anë. Procesi i votimit, zgjedhjet kanë të bëjnë me ato raporte që caktohen lidhur me ndërtimin e institucioneve të shtetit. Është një konstatim fukara për sa i përket vlefhtës njohëse, për sa i përket të vërtetës, pasqyrimin të realitetit. Një institucion i tillë të dalë me një konstatim të tillë nuk i shërben prestigjit, imazhit të cilin duhet ta ketë ai ekip. Përkundrazi, e ka emanacionin, e ka ndikimin e dëmshëm, ridyshimin edhe jashtë, edhe brenda se ky ekip ka për të qenë konsekuent në zbatimin e planit të Ahtisarit, ka për të vepruar sipas nevojës, sipas tekes dhe kjo sjellje, ky veprim kësaj është i dëmshëm për këtë institucion.

Paraqitja e idesë së zgjedhjeve dyshoj se është nevojë e jona, e realitetit të krijuar, të asaj tradite demokratike kinse është thelluar te ne dhe se Qeverisë i ka skaduar legjitimiteti. Pa kurrfarë arsye i kemi shtyrë zgjedhjet lokale, e tash nuk duam ta shtyjme për një javë, një muaj, dy muaj çështjen e zgjedhjeve. Qëndrojnë shumë arsye pse ishte dashur të shtyhet çështja e zgjedhjeve. Po i përmendi disa:

Një, Koha kur për ata dy muaj rasformohet Kuvendi, nuk është në funksion Kuvendi, ka koincidence, përputhet me kohën kur mbaron procesi negociues, e ai është momenti më kritik i kësaj faze.

Shkaku se, edhe aleatët, edhe kundërshtarët tanë, apelojnë që ne të mos bëjmë një shpallje, që kishte për të qenë fatale. Në një fjalim presidenti Tadiq lutë diplomacinë e

Evropës që të kenë kujdes e ta frenojnë faktorin kosovar që eventualisht të mos bëjnë shpalljen. Kjo flet shumë edhe të shtyn të dyshosh se iniciativa e OSBE-së nën patronatin e zotëri Rykerit, i cili është autoritar, i gjithëpushtetshëm, i gjithë fuqishëm te ne. Të shtyn të dyshosh në këtë sinqeritet, këtë korrektësi të kësaj ideje. Fakti se ky proces koincidon, është një arsye e fortë për të shtyrë procesin e zgjedhjeve.

Dy, publikisht e kemi shpallë se ky Kuvend ka për të shpallë pavarësinë e Kosovës. Mandatin e tij, këtë premtim e shkeli. Një arsye tjetër është se zgjedhjet organizohen, por nuk mendohet se këto zgjedhje a kanë për të pasur sukses. Kjo pakënaqësi e akumuluar në popull, në gjendjen ekonomike në perspektivë, në mospërbushjen e atyre fjalëve pompoze që janë paraqitur në raste të ndryshme prej niveleve të ndryshme të elitës politike kosovare. Është zhgënjim i madh edhe është një faktor rreziku që ato nuk kanë për të pasur sukses.

Edhe një arsye po e përmendi, e cila nuk është ndjellamirë. Me të madhe flitet në qarqet intelektuale dhe të elitës politike të Beogradi se procesi i filluar ka për të mbaruar me një hepiend, se Këshilli i Evropës ka për të ndërmjetësuar në atë përplasje të madhe që ka për t'u krijuar prej faktorit Rus dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe se ideja shpëtimtare ka për të qenë në një kompromis në dëm të shqiptarëve. Një lidhje që duhet të ekzistojë në mes të Kosovës edhe Serbisë, a quhet konfederatë a federatë, apo diçka tjetër, ajo lidhje shkon kah ajo që shqiptarët me pakon e Ahtisarit t'i kenë e t'i gëzojnë të gjitha ato të drejta edhe atë karrigen në Kombet e Bashkuara etj., por të mbetet integriteti i kufijve të Serbisë. Kjo është mundësi, ndoshta formale, në mesin e atyre mundësive që janë më afër probabilitetit, më të afërta. Vërtet duhet pasur kujdes, është një arsye e fortë për t'i shtyrë zgjedhjet.

Grupi i Unitetit duhet të mendojë edhe njëherë në këtë drejtim. Kishte për të qenë fatale diçka e ngjashme të na ndodhë e të mos jemi në funksion, të mos jetë mobil Kuvendi. Kuvendi i ka frikësuar edhe aleatët, edhe kundërshtarët tanë në këtë proces. Me këtë po e theksoj se gjithsesi ai akt i shpalljes duhet të jetë plotësisht në pajtim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ne me përpikëri e zbatojmë, aty është fuqia e faktorit kosovar. Por mund të paraqiten aso situatash, ku Kuvendi kishte për të ndërprerë një kompromis të tillë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Një pauzë për kafe, 10 minuta!

Vazhdimi i punës së seancës pas pauzës

KRYETARI KOLË BERISHA – Fjalën e ka deputeti Mazllom Kumnova, le përgatitet deputetja Myrvete Dreshaj.

MAZLLOM KUMNOVA –Zoti Kryetar, zoti President, zoti Kryeministër, zoti Thaçi,

Në këtë çast historik në të cilin jetojmë, veprimi ynë, për të cilin jemi përgjegjës ndaj popullit tonë, duhet të çojë drejt atij qëllimi historik, a do ta bëjmë Kosovën të

pavarur dhe sovrane? Për këtë duhet të kemi guxim politik, moral, mendor dhe, mbi të gjitha, kombëtar. Unë nuk kam dilema dhe mendoj se të gjithë e kemi një përgjegje të sigurtë për këtë, por shpesh po i ngatërrojmë prioritetet. Shpesh po ligemi, si thotë populli, dhe po tërhiqemi nga e drejta jonë elementare- vetëvendosja. Kur mbi 90% e popullatës së Kosovës është e vendosur për pavarësi, për ne këtu qoftë si politikbërës apo që kemi marrë përsipër realizimin e aspiratës historike të këtij populli dhe për të cilin publikisht jemi zotuar në të gjitha fushatat zgjedhore dhe deklarimet, kërkohet një veprim më konkret, më i fuqishëm në bashkëveprim me miqtë tanë. Unë nuk shoh mbështetje më të fuqishme, më morale, më politike që e kanë pasur politikanët tonë për veprimin politik, siç është aktualisht në Kosovë. Janë të arsyeshme shqetësimet që mos po gabojmë, mos po i krijojmë vetës pengesa në këtë periudhë historike për Kosovën, se dimë ta bëjmë këtë ndonjëherë dhe na ka kushtuar shumë shtrenjtë. Ktheni kokën nga largësia historike deri në ditët e vona, të cilën nuk është momenti këtu ta zbërthejmë, por është e domosdoshme të vlerësojmë çastin historik në të cilin ndodhet Kosova.

Unë mendoj, se sot duhet të bëjmë disa veprime, kuptohet me një konsensus, sepse fuqia e situatës politike në të cilin ndodhemi e bën këtë të domosdoshme. Me këtë debat, varësisht më se me çfarë vendimesh do të dalim nga ky, së paku do t'ia kthejmë dinjitetin këtij Parlamenti. Kështu mendoj se duhet filluar. E para, duhet pranuar publikisht nga ky Kuvend, por me propozim të Grupit të Unitetit se procesi politik për Kosovën ka dështuar, se jemi kthyer nga jemi nisur. Ky veprim i yni do të ishte akt moral i përgjegjësisë që kemi ndaj qytetarëve të Kosovës. Pra, debati të orientohet se çfarë duhet bërë dhe jo të bëjmë hetime sa euforik, e sa të papërgjegjshëm kanë qenë në deklarata Grupi i Unitetit dhe çështjet e tjera të këtij konteksti. Nuk është thirrur Grupi i Unitetit në këtë debat as për të rrëfyer se sa janë përgjegjës për atë pse procesi po shkon drejt përkeqësimit, por është edhe fakt., Grupi i Unitetit nuk e ka faktorizuar as Serbinë as nuk e ka zgjuar Rusinë e vjetër. Të gjithë jemi të vetëdijshtë se këtë ia ka bërë pavendosmëria e Bashkësisë Evropiane jo vetëm tani, por gjithnjë kur është çështja shqiptare. Kjo është çështje e njohur që nuk më befason dhe për momentin përgjegjësia e Grupit të Unitetit për mua në këtë fazë të zhvillimit është dytësore. Fatura e mospjekjes së procesit politik të Kosovës duhet adresuar te Bashkësia Evropiane e jo te Grupi i Unitetit.

Për Evropën që sa kohë është një thënie: “Evropa ka gjithnjë e më shumë organizma e gjithnjë e më pak shpirt. Sot nuk ka as shpirt, as mendim, as ide, as veprim”- kështu thuhet në një libër –nuk e them unë.

E dyta, unë mendoj se çështjet duhet shtruar pak më ndryshe edhe pse një analizë e procesit politik të Kosovës deri ku kemi arritur e bërë nga Grupi i Unitetit, duke mos llogaritur paraqitjet e anëtarëve të Grupit të Unitetit, do të ishte një kontribut i mirë për sot, por këtë nuk e kemi. Përkundër kësaj edhe pa një analizë të tillë si institucion i përgjegjshëm për situatën tilla, si përfaqësues të popullit, secili prej nesh veç e veç, qoftë edhe si grupe parlamentare, kemi qenë të përfshirë me njëfarë mënyre në rrjedhat e këtij procesi, dikush shumë, dikush më pak. Prandaj sot mund të debatojmë me një kompetencë që duhet përfillur.

E treta, kjo seancë duhet të ketë një rëndësi të veçantë edhe për mua objektivi i saj duhet të jetë një veprim historik bërës sot për sot. Këtë nuk mund ta bëjmë për momentin derisa kemi kërkuar që nga fillimi partneritet me miqtë tanë dhe nuk mund ta përmbysim atë që është arritur deri tani, por ne duhet bërë detyrën tonë. Duhet të bëjmë një plan konkret, duke iu propozuar partnerëve tanë, qoftë edhe me alternativa kohore të përafërta, sidomos pas 120 dite, Përtej këtij afati nuk mund të jemi koopërues me një proces që po na çon drejtë përmbysjes së vullnetit të popullit tonë. Kështu është momenti për të bërë një veprim të denjë për fatin tonë, për të ardhmen tonë, sepse për këtë jemi përgjegjës ndaj popullit. Kështu mund t'i shmangemi një politike kapitulluese me pasoja shumë të rënda për fatin e popullit tonë, e cila politikë sa jemi të vetëdijshëm dhe aktualisht duhet pranuar se jemi me të dyja këmbët në shtegun e saj. Në këtë kontest edhe nga kjo seancë edhe një herë nuk mund të dalim pa një plan të veprimit për një periudhë kohore e cila mund të pranohet dhe t'iu afrohet partnerëve tanë, nëpërmjet të cilit do të përcaktohen detyrat konkrete të Kuvendit të Kosovës, të Grupit të Unitetit, të Qeverisë dhe institucioneve të tjera. Ky plan i veprimit duhet nisur se territori i Kosovës është i paprekshëm dhe se çdo përpjekje në këtë drejtim, nga cilado anë do të çojë drejt një konflikti me përmasa rajonale. Ndarja e Kosovës, për mua është shqetësimi kryesor dhe fatkeqësisht është shqetësim i përgjithshëm që ka përfshirë të gjitha shtresat e popullit tonë dhe duhet qartësuar kjo. Si çështje e katërt që po e ngreh, është se ky Kuvend, gjatë këtij debati vlerëson se ndarja e Kosovës është opsion që po qarkullon nëpër disa kancelari të Evropës, atëherë çfarë na mbetet? Është e pafalshme për këtë Kuvend të veprojë sipas përrallës “Bëje Zot ëndërr”. Pra, duhet të përgatitemi për më të keqen - luftën.

Shumë më e arsyeshme është dhe i përgjigjet realitetit që ky Kuvend si institucion më i lartë, Qeveria dhe institucionet e tjera, të bëjnë mobilimin e nevojshëm karshi këtij rreziku që mund të ndodhemi. Nëse situata shkon drejtë një lufte dhe përgatitja jonë duhet të çojë drejtë asaj. Këtë më së paku e dëshirojmë ne shqiptarët, por a mund të pranohet një kapitullim? Kurrsesi, shpesh e vërteta mund të jetë e hidhur, mirëpo sjellja e strurit do të ishte fatale. Unë mendoj se sot duhet dalë me një plan të veprimit si Kuvend, si Grup i Unitetit, si Qeveri dhe institucione. Duhet të nisemi nga ajo që është thënë se pavarësia është e pa negociueshme se çdo përpjekje e kujtdo qoftë për realizimin e ndarjes së Kosovës çon drejtë luftës për të cilën si institucione të popullit mbi këtë përgjegjësi, duhet t'i bëjmë të gjitha përgatitjet e duhura, duke filluar që nga dita e sotme, përcaktimi i afateve për partnerët tanë për njohjen e pavarësisë. Gjatë kësaj kohe të miratohen Kushtetuta, simbolet, pakoja e ligjeve, që janë të domosdoshme për një shtet të pavarur dhe sovran. Të dinamizohet procesi politik me partnerët për misionet të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë, funksionin e tyre vëzhgues, duke konsideruar se vetëm prania ushtarake e NATO-së dhe ndihmesa administrative nga Bashkësia Evropiane është e pranueshme. Çdo prani tjetër të jetë objekt i marrëveshjes me institucionet e Kosovës.

Administrata e UNMIK-ut tani në ikje, të shpërbëhet brenda këtij afati dhe të gjitha kompetencat të kalojnë te institucionet vendore. Të kërkohet ndihmë dhe asistencë nga bashkësia ndërkombëtare për disa çështje në relacionin me minoritetin serb. Pakoja e Ahtisarit është maja e kompromisit që kanë bërë shqiptarët në Kosovë dhe nuk

pranohet asnjë ndryshim dhe nëse jemi të detyruar të ulemi karshi delegacionit të Beogradit për 120 ditë, nuk ka negociata për pavarësi dhe nuk ka shtyrje të afatit.

Grupi i Unitetit, partitë politike dhe shoqatat e ndryshme në këtë afat duhet të veprojnë për interesin e shtetit të Kosovës dhe realizimin e pavarësisë që do të ndërtohet brendapërbrenda, të jetë prioritet mbipartiak dhe mbi interesat e grupeve të ndryshme, do me thënë t'i marrim përgjegjësitë e një shteti sovran. Vullneti i popullit duhet të jetë bazë e autoritetit të Kuvendit, i Qeverisë, i partive politike, i Grupit të Unitetit, i organizmave dhe institucioneve të tjera në Kosovë. Ky vullnet duhet të shprehet me unitet. Unë jam optimist se në fund të këtij debati do ta çmontojmë këtë paralizë të vullnetit dhe të mos lejojmë një dorëzim pasiv në këtë stinë të keqe të verës që na ka mbërthyer dhe jo për fajin tonë. Në fund për disa teprime të kompetencave që kohë pas kohe po merr Grupi i Unitetit deri te shpallja e zgjedhjeve të ardhshme që po dëgjohet këto ditë, pa mandat që as nuk e ka e as nuk do ta ketë. Janë çështje që duhet zënë vend në përfundimin e këtij debati. Është ky Kuvend që vendos edhe për zgjedhje edhe për çështje të tjera. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Myrvete Dreshaj, pastaj Fadil Geci

MYRVETE DRESHAJ - Zoti Kryetar, Grup i Unitetit, ministra, kolegë deputetë,

Gjendja në të cilën gjendemi nuk nënkupton as të jemi pesimistë të papërmirësueshëm deri në fund, as të jemi optimistë, as t'i harrojmë detyrat me të cilat jemi ngarkuar. Nuk mund ta kalojmë me një fjalë faktin se ne e kemi përkrahjen e miqve tanë historik, por as të bëhem sikur nuk po e shohim se kundërshtarët tanë politikë vazhdojnë të flasin me diskursin politik të shekullit XIX dhe të sillen madje sikur disa vjet më parë të mos kishte ndodhur asgjë. Kjo do të thotë se ky Kuvend, Qeveria e Grupi i Unitetit duhet t'i qartësojnë edhe më tej qëndrimet e tyre veç e veç dhe së bashku të jenë unik e të qartë në domosdoshmërinë e marrjes sa më të shpejt të vendimeve dhe pa humbur kohë bashkë me faktorin ndërkombëtar ta gjejnë rrugën për bërjen e shtetit sovran e të pavarur të Kosovës. Nuk është në interesin tonë të vazhdojmë kështu.

Pas dështimit të procesit në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, ne jemi kthyer edhe një herë nga fillimi, por fatmirësisht prapë me pavarësinë e Kosovës si zgjidhje e vetme dhe pa alternativë e statusit të Kosovës, e cila kësaj radhe duhet të na obligoj ne dhe bashkësinë ndërkombëtare më fuqishëm dhe më me vendosmëri për përgjegjësitë serioze që kemi së bashku në respektimin e të drejtës së popullit të Kosovës për bërjen e shtetit.

Grupi i Unitetit ka pasur një mandat, i cili është dhënë nga ky Kuvend dhe ne sot kemi pritur që do të dalë me një analizë të procesit të derikëtushëm, duke përfshirë këtu edhe mangësitë që kam përshkruar. Gjithashtu, ne kemi pritur që ky Grup do të dalë edhe me një strategji a plan të detajuar të veprimit të mëtutjeshëm. Para këtij Kuvendi, Qeverisë dhe Grupit të Unitetit shtrohet kërkesa urgjente e planifikimit të çdo dite pune brenda 120 ditëve për përfundimin e zgjidhjes së statusit, duke pritur të tjerët ta realizojnë obligimin e tyre, njëkohësisht ne jemi të obliguar t'i kryejmë detyrat tona.

Ka disa muaj që me plogështi merremi me simbolet dhe Kushtetutën, një prej aspekteve të shtet bërjes së Kosovës dhe së fundi edhe me zgjedhjet. Kanë mbetur edhe shumë ligje, shumë vendime, shumë punë pa u nisur dhe pak dhe po kaq të tjera në proces për të cilat përgjegjësinë e kanë jo vetëm institucionet vendore, por edhe ato ndërkombëtare. Çka mund të bëhet për 120 ditë? A mund t'i kryejmë obligimet e saj Qeveria dhe Parlamenti në përfundim të mandatit të tyre? A kemi nevojë për ligje të tjera, vendime të tjera, presione shtesë në qendrat e vendosjes etj? Të gjitha këto kërkojnë angazhime të përditshme, investime të shumta dhe sidomos profesionalizëm, pa përzierje kompetencash. Gjithashtu nuk e shoh se kemi vlerësuar këtë periudhë në kontekst të asaj shtresës sociale të qytetarëve të Kosovës, të cilët pengun e statusin të Kosovës po e provojnë përditë edhe me varfërinë e tyre. A është bërë ndonjë analizë nga institucionet shtetërore, ndërkombëtare dhe shoqëria civile për këtë periudhë? A është përcjellë kjo në bisedimet me ndërkombëtarët dhe a e dimë se si do të rrjedhë situata e sigurisë në Kosovë pas një muaji. Kush mund të premtojë se në vjeshtë nuk do të kemi shpërthime sociale të qytetarëve të dëshpëruar me këtë gjendje. Për të gjitha këto dhe të tjerat do të duhej të shtronin pyetje sot dhe të merrnin përgjigje. Këto janë çështje të përditshmërisë sonë. Këto janë pragu të cilin jemi të obliguar ta kalojmë. Në këtë proces siguria është një nga segmentet bazë, e megjithatë sigurinë në Kosovë nuk e rrezikojnë shpërthimet sociale, ato do ta rrezikojnë eventualisht hierarkinë qeveritare dhe politike, por jo edhe paqen në Kosovë. Paqen në Kosovë e rrezikojnë ndërhyrjet e strukturave kriminele serbe, si ajo vendosjes së granatës para autobusit me udhëtarë shqiptarë. Paqen në Kosovë e rrezikon vendosja provokuese e flamurit në kishat serbe, si ajo e Prizrenit. Tubimet e qeveritarëve serb në Kosovë dhe diskursi politik tipik millosheviqian, manifestimi si ai i përkujtimit së luftës së Kosovës, në të cilën veç tjerash u promovua edhe hyrja publike e organizatës kriminale me emrin “Car Llazar” në Kosovë etj.

Sikur mund të shihet ditëve të fundit flamurin e prishjes së sigurisë e ka marrë përsëri kisha ortodokse serbe, po ai institucion i cili një dekadë më parë e mbante flamurin e urrejtjes dhe të krimit në ish Jugosllavi. Në vend se liderët e saj të shkonin të parët në Tribunalin e Hagës për nxitjen e gjenocidit në ish- Jugosllavi, muret e kishave dhe të manastireve të tyre për vite me radhë kanë vazhduar të mbulohen me fotografitë e kriminelëve të luftës, ndërsa drejtuesit e saj të marrin pjesë në tubimet, në bisedimet për Kosovën. Sot ata edhe një herë dalin në rend të parë, prishës të sigurisë me të cilët do të pësonin të gjithë. Nëse ata vazhdojnë me këtë sjellje ndaj qytetarëve në mesin e të cilëve jetojnë, askush nuk mund t'ua premtojë sigurinë as atyre as institucioneve në të cilat, si duket më parë se sa për paqen, lutën për urrejtje.

Në këtë kontekst edhe kjo seancë mendoj se nuk mund të dalim pa një plan të veprimit për një periudhë kohore, e cila mund të pranohet dhe t'iu ofrohet partnerëve tanë nëpërmjet të cilit plan do të përcaktoheshin detyrat konkrete të Kuvendit të Kosovës, Grupit të Unitetit, Qeverisë dhe institucioneve tjera me prioritet se Kosova është unik, vend unik dhe i pandarë. Çdo hapje të diskutimit të kufijve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës e hap mundësinë e lëvizjes së kufijve në Ballkan. Kosova do të jetë shtet unik dhe funksional për gjithë qytetarët e saj, i paanshëm mes etniteteve dhe i pacenueshëm

prej të ashtuquajturave objekte fetare dhe historike. Përcaktimi i afateve të nënkuptohet si kohë për t'i kryer të gjitha obligimet që na presin si bashkësinë ndërkombëtare ashtu edhe ne, nën moton- Të gjithë për pavarësinë sot- të bashkohen institucionet qeveritare dhe jo qeveritare si dhe institucionet arsimore, shkencore për t'i përmbushur të gjitha obligimet që kanë të bëjnë me përmbylljen e pakos ligjore, ekonomike pse jo edhe morale për Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Të caktohen dhe të fillojnë punën zyrtar përfaqësuese, pavarësisht si do të quhen në të gjitha qendrat më të rëndësishme politike, ekonomike, ndërsa në këtë linjë të bëhet organizimi i mërgatës sonë, kuptohet jashtë strukturave partiake dhe klanore.

Të nderuar kolegë deputetë. Unë kam shpresë se në debatin e sotëm sado pak do të caktojme limitet e punës sonë të mëtutjeshme. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Fadil Geci, pastaj Ramadan Musliu.

FADIL GECI – Ju faleminderit! Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Të gjithë ne sot këtu do të ishim të nderuar të deklaronim se Kosova është shtet sovran dhe i pavarur, në miqësi të përjetshme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në rrugë të mbarë për t'u bërë anëtare e Bashkimit Evropian, vend me standarde të larta demokratike, në marrëdhënie të mira fqinjësore me shtetet e tjera, anëtare e rregullt e organizatave ndërkombëtare, një vend që duke iu falënderuar popullit, të rinjve dhe të rejave, kuadrove të shkolluara, duke iu falënderuar resurseve natyrore, është bërë joshës për investitorët e huaj dhe për ndërtimin e kapaciteteve e të veprave kapitale me koncesion dhe në kooperim e bashkëfinancim. Në Kosovë po zbatohet projekti i ndërtimit të autostradës moderne që na lidh me korridoret kryesore evropiane, por gjithashtu edhe i lidh ndërmjet veti të gjitha qytetet e Kosovës. Po ndërtohet e dhënë me koncesion edhe hekurudha moderne që Kosovën e lidh me hekurudhat evropiane me portin detar të Durrësit. Gjithashtu, me projekt të bashkëfinancimit të përbashkët vendor e ndërkombëtar është në përfundim rrjeti hekurudhor që i lidh të gjitha qytetet e Kosovës. Është ndërtuar tashmë hidrosistemi “Ibër Lepenc” dhe Kosova nuk e ndien mungesën e ujit. Gjithashtu, janë ndërtuar shumë kapacitete ekonomike të vogla dhe të mesme, që i shfrytëzojnë resurset e mira natyrore, kushtet klimatike dhe të tokës, gjë që ka bërë që prodhuesit bujqësorë të Kosovës të kenë plasman dhe të jenë të kërkuar në tregun ndërkombëtar. Duke marrë politikën e mirë ekonomike nuk ka papunësi dhe bashkëkombësit tanë jashtë shtetit po kthehen për të jetuar e investuar këtu. Çmimet po shënojnë rënie të vazhdueshme, falë edhe ligjeve të mira në qarkullim që shkurtuan distancat si dhe falë ndërlidhjes organike të hapësirës gjeografike shqiptare dhe të komunikimit intensiv që ka krijuar një treg të fuqishëm dhe të qëndrueshëm kombëtar.

Në lëmin e arsimit, të shkencës dhe të kulturës ka kohë që po bëhen përpjekje gjithëkombëtare që po japin rezultatet e lakmueshme e të pranuar, duke i dhënë një ndihmesë konkrete planit zhvillimor të vendit.

Të nderuar deputetë,

A thua pse nuk është realitet kjo që unë thashë këtu në vetëm 20 rreshta, apo në vetëm tre minuta kohë. Pse nuk po realizohen idealet tona që sot në shekullin XXI të jetojmë të lirë e të pavarur, të denjë ashtu si kombet e tjera të Evropës. A thua çka ka ndodhur që sot Kosova jeton më keq se Serbia, që sot Kosova ka përkrahje më të vogël se Serbia, që sot projektet dhe argumentet e Kosovës po humbin para atyre të Serbisë. E gjithë kjo që po ndodh tregon fakti se Serbia këtu bëri luftë dhe gjenocid, se bëri vrasje, dhunime, djegie, plaçkitje, se përzuri një popull nga trojet tona. Më krejt këto gjëra në qafë Serbia po mundet ta pengojë vullnetin e popullit të Kosovës, po mundet tash e tetë vjet pas luftës ta pengojë pavarësinë e Kosovës. Veç ndaluni pak e të mendojmë, po të ishim ne në vendin e Serbisë, po të ishim ne agresorë e jo Serbia, atëherë çka do të kishte ndodhë me ne. Populli thotë: “Qeni i keq ta bien ujkun në torishtë”. Duke dashur ta shpëtojë veten dhe në vend se të qëndrojë aty ku duhet, vjen e fshihet te delet. Kështu, edhe Ekipi ynë, pasi e ka bërë skllotë në të gjitha anët, po vjen e po fshihet prapa popullit.

Të nderuar deputetë,

Ekipi i Serbisë nuk ka marrë para shtese edhe pse, si në futboll, ka fituar, si po merr Ekipi ynë i bisedimeve. Nuk e di pse ky delegacion i ynë t’i marrë parat prej buxhetit të Kosovës, kur ne kurrfarë dobie, tashmë po shihet, nuk kemi parë. Më mirë do të ishte që parat t’ia jepte Serbia se asaj i ka ndihmuar me decentralizim me 11 komuna serbe, me 14 projekte të mbrojtura, me të drejta të veçanta në vendimmarrje dhe në vazhdimin e bisedimeve për 120 ditë të tjera, por tash me tjetër ndërmjetësues dhe sipas Rezolutës 1244.

Të nderuar deputetë,

Ekipi i Unitetit po thotë se është me Amerikën, se po punojmë në bazë të udhëzimeve të SHBA-ve dhe të Bashkimit Evropian, duke thënë se pavarësinë e Kosovës do ta shpallin kur t’u thonë miqtë ndërkombëtarë. Këtë po e bëjnë lojën e keqe, sepse e dinë se askush që i respekton rregullat e lojës dhe aktet ndërkombëtare publikisht nuk ju thotë se kur duhet ta shpallin dhe ta bëjnë pavarësinë. Në rast së shprehjes së pakënaqësisë së popullit, këta do të thonë se atëherë këto protesta dhe akte të tjera do të ishin antiamerikane. Mirëpo, edhe këta edhe të gjithë të tjerët duhet ta dinë se populli i Kosovës është populli më pro amerikan në botë, populli që më së shumti i do dhe ka respekt për Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Presidenti Ibrahim Rugova gjithmonë thoshte: “Se mundi, Zoti, SHBA-të dhe NATO-ja e shpëtuan popullin e Kosovës nga asgjësimi”. Ky Ekip i Unitetit me asgjë nuk iu përmbajt parimeve të Presidentit Rugova, nuk iu përmbajt bisedimeve të para në Vjenë kur ishin Presidenti i Kosovës dhe ish-kryetari i Kuvendit, Nexhat Daci. Nuk mund të thonë se asnjë dokument që e quan në Vjenë, nuk është miratuar për të gjallë të Presidentit. Të gjithë e dinë se Presidenti përpara çdo diplomati dhe përpara kryetarëve

të shteteve thoshte se duhet të bëhet njohja formale e pavarësisë së Kosovës nga vendet individuale, se nuk ka bisedime me Serbinë për statusin e Kosovës, se nuk ka decentralizim pa regjistrimin e popullsisë, se serbët e Kosovës në bisedime janë të përfaqësuar në kuadër të institucioneve të Kosovës e jo të Serbisë. Gjithashtu, për politikën e kthimit, Presidenti Rugova përpara përfaqësuesve të Grupit të Kontaktit thoshte se në Kosovë nga lufta të gjithë kemi dal më pak, duke theksuar viktimat shqiptare dhe përgjegjësinë serbe për luftë.

Të nderuar deputetë,

Edhe pse zgjedhjet parlamentare në Kosovë nuk i organizuam një vit e gjysmë pas lufte, duke dashur ta mënjanojnë liderin Ibrahim Rugova, populli gjithherë atij ia dha votën, duke ia dhënë besimin dhe duke e legjitimuar si fitues dhe prijës në të gjitha zgjedhjet lokale dhe qendrore. Ekipi i Unitetit, jam i sigurt se do ta marrë dënimin e popullit dhe më vonë në zgjedhjet e lira do të shkojë në pjesën e turpshme të historisë kombëtare. Për mua ky ekip nuk e përfaqëson vullnetin e popullit dhe për mua asgjë deri tash nuk mund ta dëshmojë se ka punuar në të mirë. Gjendja në Kosovë është shumë më e keqe se para bisedimeve në Vjenë. Pasojat janë shumë më të rënda dhe më të rrezikshme për Kosovën. Ky Ekip i Unitetit i hapi edhe mundësi Serbisë që tash prej Ranillugut, Novo Bërdës, Graçanicës e deri në Lypjan Serbia të hyjë nëpër territore që ia ka dhënë me decentralizim. Këta njerëz nuk e kanë përkrahjen as votën time më tutje. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA- Ramadan Musliu, pastaj Nazim Jashari.

RAMADAN MUSLIU – Të nderuar anëtarë të Ekipit të Unitetit me në krye Presidentin Sejdiu,

Të nderuar ministra dhe kolegë deputetë,

Kosova tashmë ka hyrë në një proces diplomatik që shpie në zgjidhjen e statusit final dhe të gjitha gjasat janë të përmbillet me pavarësinë e Kosovës. Procesi diplomatik dhe procesi politik në përgjithësi nuk janë procese kimike-fizike që do të limitohen me kohë, që mund të caktohet se ky proces do të zgjasë kaq dhe përfundon, për shkak se derisa të përfundojë, u pa edhe deri tashti, mund të dalin shumë probleme. Është fat historik që Kosova në këtë proces ka hyrë e përcaktuar edhe si vizon politik, por edhe si aspirata për vlerat e demokracisë perëndimore. Kjo ka bërë që të jemi aleat me SHBA-të dhe Bashkimin Evropian si garantues, sepse fundi i këtij procesi të negociatave dhe diplomatik do të jetë shteti i pavarur.

Sot në botë me shumicë ekzistojnë shtetet totalitare të majta dhe të djathta, ekzistojnë edhe shtete teokratike me të cilat Kosova nuk ka të bëjë fare. Kjo është një garanci e madh për përkrahje të pa rezervë që e kemi nga shtetet e BE-së dhe nga SHBA-të. Po kështu në këtë proces diplomatik ka ndodhur që zgjidhja e statusit të shtyhet, por jo në pakufi. Të gjithë e dimë se për shtyrjen e statusit të Kosovës nuk është fajtor Ekipi i Unitetit, por është fajtor vetoja dhe kërcënimi, përkatësisht kërcënimi me veto i Rusisë. Për të mos ndodhur zbatimi i vetos në Këshillin e Sigurimit, dihet se procesi për

zgjidhjen e statusit final të Kosovës zbritet në nivel të Grupit të Kontaktit, ku e drejta e vetos nuk ekziston e asnjë shteti. Prandaj, të gjithë shpresat janë se pikërisht në këto negociata të cilat janë paraparë që të zgjasin 120 ditë, do të bëhet edhe zgjidhja me një përfundim, ashtu siç e kanë pritur edhe çfarë aspiratat dhe kanë qenë përherë të popullatës së Kosovës.

Shumë kush thotë dhe mendon se Ekipit të Unitetit i mungon një strategji. Nëse mendojmë se Ekipi i Unitetit nuk ka pasur strategji, atëherë si mund të vijë, fjala vjen që Kosova të hyjë në agjendat e institucioneve më të larta ndërkombëtare. Secili që i ka minimumin e dijeve për konfliktet që sot ndodhin në botë e di se çka do të thotë të kesh aleatë strategjikë, siç i ka Kosova. Në anën tjetër, po ashtu, duhet ta dimë se Kosova as nuk ka potenciale as njerëzore as një hapësirë, as një pasuri ekonomike, as kurrfare që të imponohet si një partner serioz në superfuqitë botërore.

Po kështu, realiteti politik kosovar është zhvilluar edhe nën kontrollin, por edhe nën presionin e fuqive ndërkombëtare, përkatësisht të Këshillit të Sigurimit, të cilët na kanë imponuar standardet e njohura nga të cilat kanë derivuar edhe 12 standarde të tjera, po ashtu edhe problemi i decentralizimit për t'u përmbyllë pastaj me pakon e Ahtisarit si rezultat i negociatave të zhvilluara midis dy palëve e nën mbikëqyrjen e faktorit ndërkombëtar. Unë mendoj se detyrë e Ekipit të Unitetit është të insistojë në ruajtjen e partneritetit ndërkombëtar, në ruajtjen e raporteve shumë pozitive që sot Kosova i ka me aleatët strategjikë, përkatësisht me SHBA-të dhe me Bashkimin Evropian. Po kështu, jo vetëm Ekipi i Unitetit, por të gjithë jetojmë midis dy realiteteve, një realiteti konkret që zhvillohet dhe një realiteti virtual, i cili zhvillohet përmes gazetave dhe përmes ideologjive që shfaqen herë përmes grupacioneve të caktuara politike e herë përmes individëve, të cilët perceptimin e tyre personal edhe të gjitha ato grackat ideologjike na i imponojnë si realitet, duke i kërkuar që të ikim nga ato skema të njohura të ndërtimit të shtetit nga institucionet legale të sistemit, të krijohen dhe të shumëzohen institucionet të cilat nuk e di se çfarë funksioni mund të kenë. Dihet se cilat janë kompetencat e Qeverisë, cilat janë kompetencat e Presidencës, cilat janë kompetencat e Kuvendit dhe brenda atyre kompetencave duhet të veprohet.

Është e vërtetë, po ashtu, se këtu u bënë vërejtje e ndoshta një vërejtje e tillë mund t'i bëhet se Ekipi i Unitetit ka marrë herë pas here edhe disa kompetenca që ndoshta në rrethana të caktuara nuk duhet t'i kishte. U përmenden këtu se është problemi i zgjedhjes, i konkursit për flamur dhe për simbole, po ashtu edhe problemi i zgjedhjeve. U përmenden edhe probleme të tjera, sidomos problemi i zgjedhjeve është problem i tryezës politike, të partive politike ku përfaqësohet në nivel të kryetarëve të partive. Por, me qenë se ekzistojmë dhe funksionojmë në një sistem ku institucionet legale të shtetit janë të brishta, ku uniteti duhet të krijohet nganjëherë përmes një pritjeje shumë të gjatë, në këtë rast të mos harrojmë ta përsërisim unitetin që është arritur pikërisht në Grupin e Unitetit, i cili përbëhet nga personalitete dhe individë me pikëpamje të ndryshme nga përfaqësuesit e partive të ndryshme, herë-herë edhe polarizuese. Mirëpo, kur është fjala e një përgjegjësie konkrete, kur është fjala e fatit të Kosovës, ai që është pjesë i atij ekipi, ai e di se çfarë përgjegjësie. Deri tash Ekipi i Unitetit, mendoj se e ka pasur nivelin e unitetit të cilin duhet patjetër ta ruajë. Nëse kërkohet që brenda një

platforme të veprimit të Grupit të Unitetit, unë mendoj që duhet të merret parasysh edhe problemi që duhet të ndikohet dhe të frenohen tendencat e kërkesave të tilla çfarë ishte ajo e shpalljes së njëanshme të pavarësisë. Unë mendoj se asnjë pavarësi, asnjë deklaratë e pavarësisë që mund të shpallet në mënyrë të njëanshme, pa pëlqimin e aleatëve tanë strategjikë do ta ketë fatin e gjithë deklaratave të mundshme që mund t'i shpallim para buke e pas buke. Prandaj detyrë e këtij ekipi është ta ruajë raportin e shëndosh dhe kooperimin që e kemi me aleatët strategjikë. Po kështu kohëve të fundit kemi dëgjuar shpesh disa deklarata të pamatura, ndoshta edhe prej anëtarëve të Grupit të Unitetit që mendojnë se janë viktima të një folklori politik dhe të kërkesave të elektoratit, ndoshta edhe periudhës paraelektorale, po them para paraelektorale se ende nuk kanë filluar, nuk janë shpallur zgjedhjet. Unë mendoj se Kosova nuk guxon ta humbë, siç thashë aleancën me Perëndimin ku është e ardhmja e saj. Po ashtu kërkohet nga Grupi i Unitetit një veprim dhe qëndrim më i fuqishëm karshi problemeve të brendshme. Mund të them lirisht se ky qëndrim i fuqishëm në raport me problemet e brendshme duhet të merret parasysh se Kosova gjithçka ka investuar në plotësimin e standardeve, duke harruar rimëkëmbjen ekonomike, duke harruar telashet e jetës së përditshme, mirëpo me qenë se situata është e tillë dhe gjendemi në një tranzicion të tillë kur duhet shumë çka të flijohet për pavarësinë, konsideroj se është momenti që të kthehemi kah problemet reale dhe të zgjidhen ato. Ju faleminderit për vëmendje

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Nazim Jashari, Bajrush Xhemajli.

NAZIM JASHARI – I nderuari kryetar i Kuvendit,
Të nderuar anëtarë të Grupit Negociator,
Kolegë deputetë, ministra,

Sot po debatojmë për temën më të rëndësishme jo vetëm të momentit, por edhe kundruar në aspektin historik të Kosovës. Jemi në një institucion të rëndësishëm, institucionin më të rëndësishëm që e prodhon vullneti demokratik i këtij i këtij populli, pra jemi në Kuvendin e Kosovës.

Përmendorja e qëndresës shqiptare në Kosovë, Adem Demaçi, shpesh i thoshte “Parlament saksii”. Ai e ka përsëritur vazhdimisht që nga viti 2001 kur është themeluar ky Parlament, por nuk e di se a i shkon a nuk i shkon kjo metaforë, por sjellja edhe mënyra se si po i trajtojmë problemet kaq të rëndësishme për të ardhmen tonë, për të ardhmen e fëmijëve tanë, po më krijon përshtypjen që zoti Demaçi na paska pas njohur më mirë se sa kemi menduar edhe ne vetë.

Unë e kam një Rezolutë përpara, të nxjerrë më 17 nëntor të vitit 2005 nga ky Kuvend. Edhe institucionet komunikojnë me rezoluta, me akte, me dokumente. Zoti Haliti e shpalli Grupin e Unitetit sot këtu institucion, ose unë nuk kam lidhje me atë se çka paraqet institucion në një shoqëri, ose zoti Haliti e ka humbur busullën. Institucionet, pra, komunikojnë me akte edhe janë institucione të cilat parashihen në një akt themelues të një shoqërie. Pra, mos t'i themi shtet Kosovës, se Kosova shtet nuk është, por e ka njëfarë Kornize kushtetuese, në bazë të cilës i rregullon veprimet e veta dhe aty parashihen disa institucione ndër të cilat Grupi Negociator i Kosovës nuk është i

paraparë. Në pikën 10 të kësaj Rezolute thuhet kështu: “Kuvendi i Kosovës, duke e mbështetur delegacionin e Kosovës do të përcjellë gjithë procesin e punës së tij dhe çdo vendim për të ardhmen e Kosovës do të ratifikohet në Kuvend apo nëpërmjet referendumit”. Në fjalinë e fundit thuhet: “Kjo Rezolutë paraqet bazën juridike dhe politike për platformën e delegacionit të Kosovës për pavarësinë e Kosovës”. Me këtë Rezolutë është filluar procesi negociator i Vjenës, është udhëhequr dhe është përmbyllur. Pse po them është përmbyllur. Është përmbyllur, sepse ne të gjithë këtu bashkërisht, vetëm me një votë kundër, e kemi votuar pakon e Ahtisarit si pako e cila ka qenë produkt i këtij procesi negociator dhe si e tillë, mendoj se vetvetiu tregon që procesi është përmbyllur. Çka po ndodhë tash? Pse kërkesa për bisedime shtesë? Madje - madje me cinizëm dëgjojmë interpretime, bisedime të vërteta thuaja se abë e teze kanë luajtur në Vjenë këta që kanë shkuar për 15 muaj me radhë. Nuk kanë biseduar bisedime të vërteta, por symbyllas apo nuk di çfarë lojërash kanë bërë. Çështja është se ne, këtu u përmend shumë fjala partneritet, por nuk e kemi merituar partneritetin me bashkësinë ndërkombëtare se partneriteti nuk falet, ai meritohet dhe meritohet duke marrë qëndrime. Politika komunikon me qëndrime, me rezoluta, me akte të shkruara dhe jo me marrëveshje vesh në vesh. Marrëveshjet vesh në vesh janë marrëveshje për të tjera fahe të veprimit institucional, e jo për politikën. Politika komunikon përmes akteve të shkruara. Neve pak më parë na e solli një akt të shkruar shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së. E përshëndesim për atë nismë që ne bashkërisht t’i harmonizojmë qëndrimet me të cilat duhet të dalim si Kuvend sot nga kjo seancë. Pra, sigurisht se jemi të hapur që të bisedojmë, jemi të hapur t’i rishikojmë ato pozicione, t’i sqarojmë më tutje, por gjithsesi të dalim me një dokument të shkruar, sepse institucionet komunikojnë përmes dokumentesh dhe fryma e debatit këtu sot, mënyra se si shumica e deputetëve diskutuan sot e lë përshtypjen e një çoroditjeje në orientim, një çorientimi. E përshëndes zotin Hasani, i cili me shumë guxim edhe me shumë elokuencë u paraqit këtu me një historik dialektik të rrjedhës së procesit politik të Kosovës që nga viti ’90 e këndeje. U mundua ta japë një vizion më ndryshe edhe nga shefi i tij i partisë. Nuk është i vetmi, pati edhe të tjerë, është edhe zoti Hamiti, i cili kërkoi shumë qartë që ky Kuvend të jetë në seancë të përhershme për statusin e Kosovës dhe që vazhdimisht ta luajë rolin e vet, të jetë i angazhuar vazhdimisht lidhur me këtë proces deri në përmbylljen e tij. Kishte propozime edhe nga anëtarët e Grupit Negociator, që po ashtu kërkonin fuqizimin edhe rritjen e rëndësisë të këtij Kuvendi në këtë proces, sepse ky Kuvend e ka humbur krejtësisht rëndësinë e vet. Dhe në qoftë se ky Kuvend e humb rëndësinë e vet, atëherë të jeni të sigurt, kolegë të nderuar deputetë, që qytetarët që i kanë sytë tek ne dhe i kanë sytë tek ne, unë po takohem me ta përditë, ata po thonë se ne ua kemi deleguar juve përgjegjësinë. Ata e kanë deleguar ç’është e vërteta përgjegjësinë, por përgjegjësinë të cilën ne e kemi marrë nga ata dhe kemi kërkuar nga ata, ne duhet ta ushtrojmë. Po nuk e ushtroam atë përgjegjësi, atëherë krijojmë rrethana të cilat nuk janë në favor të Kosovës, krijojmë rrethana kur thjeshtë në Kosovë nuk do të dihet ku ndodhet përgjegjësia dhe kur të mos dihet ku është përgjegjësia në Kosovë, atëherë krijohen rrethana të tilla ku përgjegjësia të kalojë në rrugë dhe rruga nuk është kurrë aleati më i mirë i nacionalitetit në politikë. Prandaj, ju kisha apeluar të gjithëve, që duke pasur parasysh të gjitha këto propozime konstruktive që erdhën nga kolegët tanë, duke pasur parasysh po ashtu që na dolën përfaqësuesit tonë që i kemi në Grupin Negociator, të përpiqemi ta ndërtojmë një platformë të re për negociatat që priten të ndodhin. Nuk mund të hyhet në bisedime të

reja, këto janë bisedime të reja, ne edhe ashtu po themi se pakoja e Ahtisarit është e pa negociueshme, Një pyetje fundamentale shtrohet këtu para jush, çka nëse pakoja e Ahtisarit çilet, çka nëse një çështje e cila e ka rregulluar pakoja e Ahtisarit, na parashtrohet si kusht që ta diskutojmë ose ta diskutojmë sërish në negociata. Cili do të jetë qëndrimi i Grupit tonë përfaqësues? Cili do të jetë qëndrimi i Kuvendit të Kosovës në qoftë se ndodhë që , po e zëmë se decentralizimi ku jam shumë i sigurt që ka për të qenë sulmi i parë, sepse jetoj në Anamoravë dhe kam fatin t'i përcjellë nja 7 -8 programe televizive të Serbisë. Aty ka për të qenë sulmi i parë për ta rishikuar pakon e Ahtisarit, A kemi ne përgjigje lidhur me atë rast? Në rast se ndodhë, pra, hapja e pakos së Ahtisarit, çka do të ndodhë? A do të vazhdojmë të rrimë dhe rinegociojmë për atë pako, për pikat e veçanta të asaj pakoje, apo do të dalim edhe ta përplasim derën, sepse jemi njerëz edhe na dhe themi që në këtë proces 15- mujor ne nuk kemi luajtur abë e teze në Vjenë, por kemi negociuar. E kemi dhënë një pajtueshmëri, një kompromis dhe përtej tij nuk kemi ku të shkojmë . Nuk mund të thuhet nuk kemi ku të shkojmë përtej tij me fjalë, por duhet të thuhet me akte, me shkresat të cilat janë obliguese për Grupin tonë përfaqësues.

Po qe se dalim sot nga ky debat pa një shkresë, pa një platformë, unë ju tërheq vërejtjen, të nderuar kolegë deputetë, që niveli i këtij Kuvendi bie nën nivelin e Kuvendit të Rrahman Morinës, sepse sot jemi të zgjedhur në mënyrë demokratike, nuk kemi tanke jashtë Parlamentit, kemi vetëm ndërgjegjen tonë dhe zotimet që i kemi marrë para qytetarëve të Kosovës, që këtë proces ta çojmë aty ku ata presin - në pavarësinë e Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë , duhet ta dini që të gjithë dhe duhet ta dinë qytetarët e Kosovës që pavarësia e Kosovës nuk është monopol i pesë vetave as monopol i 120 vetave, por është kërkesë edhe synim i dy milion qytetarëve të Kosovës. Prandaj, duhet ta keni edhe këtë element parasysh që mos ta detyrojmë dymilionëshin që ta detyrojë 120-shin e ta detyrojë 5-shin, por përkundrazi të përpiqemi që bashkërisht t'i prijë atij vullneti që ky 5-shi të udhëhiqet nga ky 120-shi dhe ky 120-shi t'i prijë atij dymilionëshi. Të mos ndodhë e kundërta, se po ndodhi e kundërta, atëherë mund të ketë pasoja të cilat realisht nuk i dëshirojmë asnjë nga ne se jemi të përgjegjshëm. Prandaj, përderisa jemi të përgjegjshëm, unë po insistoј që të ngritmi në përgjegjësi. Shpallja e pavarësisë është akt i përgjegjësisë edhe kërkesa për të qenë i mëvetësishëm është akt i përgjegjësisë. Unë po frikësohem që ata që po frikësohen ta caktojnë datën për ta shpallur pavarësinë, po frikësohen nga përgjegjësia. Po qe se frikësohemi nga përgjegjësia, kurrë nuk do ta fitojmë të drejtën ta shpallim pavarësinë, sepse tek e fundit, Kosova do të duhet të bëhet shtet që udhëhiqet nga politikanë të përgjegjshëm dhe për të qenë të përgjegjshëm ne duhet ta bëjmë hapin tonë të marrjes së përgjegjësisë dhe ai hap është shpallja e pavarësisë së Kosovës, për të gjithë qytetarët e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Xhavit Haliti e ka fjalën – replikë, Ju ka përmendur emri.

XHAVIT HALITI – Pa dashur ta kontestoj mendimin e kolegut, besoj që një organ për të cilin voton Parlamenti është institucion dhe nuk mund ta mohojmë këtë, kur ne po themi se jemi përfaqësues të popullit se na ka përfaqësuar populli, po me ato vota të deleguara e kemi zgjedhur këtë organ që për mua është institucion . Më vjen keq që nuk është edhe anëtar i pestë këtu, të cilin po me vota të Parlamentit e kemi zgjedhur. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Bajrush Xhemajli e ka fjalën, le përgatitet Besa Gaxherri

BAJRUSH XHEMAJLI – Ju faleminderit zoti Kryetar, përshëndetje për ju, për Grupin Negociator, për ministrat, kolegët deputetë dhe të gjithë të pranishmit në sallë,

Unë do të jem shumë i shkurtër në diskutim pasi u tha shumë çka dhe në veçanti për faktin se e mbështes në mënyrë integrale krejt atë që e tha zoti Jakup Krasniqi në emër të Grupit Parlamentar. I dëgjova me vëmendje fjalët e anëtarëve të Grupit Negociator, prandaj e shoh të arsyeshme që t'i them pak fjalë në lidhje me procesin e statusit të Kosovës. Se si erdhi te pakoja e zotit Ahtisarit e pamë të gjithë. Në këtë proces Grupi Negociator padyshim ka qenë tërësisht i përgatitur jo vetëm në mungesë strategjie, por edhe emocionalisht, gjë që u reflektua në tërë procesin. Ky Grup Negociator u tregua naiv, madje shfaqti një naivitet fëmijëror , duke vrapuar se cili nga anëtarët po flet fjalë më të mëdha, se cili po e di muajin, javën, ditën madje edhe orën se kur do të ndodhë pavarësia. Na kujtohet se si nga Vjena rezultatet e para na interpretoheshin ashtu si rezultate sportive -një me zero, dy me zero, pastaj në stilin tetë me dy etj. Realisht rezultati përfundoi shumë keq , pra jo tetë me dy në favorin tonë, po nëse flasim me këtë zhanër , në këtë formë ishte tetë zero për Serbinë. Unë nuk do të ndalesha në këtë naivitet të Grupit Negociator sikur të mos shihja edhe sot këtë naivitet me tërë pasojat që do të ketë. Vetë kryetari i Kosovës sot, z. Sejdiu tha se pakoja e z. Ahtisari është e panegociuar. Këtë e tha edhe z. Surroi, por negociohet apo negociatat paskan për t'u bërë për të pagjeturit, për Fndin e Pensionistëve e kështu ngjashëm diçka.

Zoti Kryetar i Kosovës, për mua kjo qasje është shumë shqetësuese për faktin se do të bisedohet pikërisht për pakon e zotit Ahtisarit, e jo për diçka tjetër. Mund edhe për diçka tjetër, por ma së shumti për pakon e Ahtisarit dhe do të ketë presione prej më të ndryshmëve për këtë pako. Jo ë dobi tonën që të rregullohet më mirë kjo pako, por pikërisht në dëm të Kosovës e në dobi të Serbisë, sepse ne u pajtuam me këtë pako, ndërsa Serbia nuk u kënaq, madje nuk u kënaq as me decentralizimin, i cili u bë, sipas nesh në kompensim për të fituar pavarësinë e Kosovës. Pastaj, siç duket ju anëtarë të nderuar të Grupit Negociator, nuk e keni pasur parasysh edhe sot nuk dëgjova se e keni parasysh ende se Serbisë nuk i intereson fort ajo pako e Ahtisarit, por i intereson vetëm ndarja e Kosovës, pasi qëllimi i vetëm sipas meje dhe i fundit i Serbisë është lufta për territore, pra ndarjen sa më të madhe të Kosovës dhe këtë bukur mirë ia ka arritur qëllimit për faktin se ne vet e kemi aprovuar një decentralizim që e favorizon një ndarje sa më të madhe të Kosovës. Dhe për më shumë, edhe opsioni i ndarjes së Kosovës është në horizont. Prandaj, nuk duhet futur kokën në zall si struci, por duhet shikuar realitetin në sy dhe duhet pasur përgjigje për të gjitha çështjet e mëdha dhe atë duhet dhënë

përgjigje me zë të lartë dhe jo të mekur se, nëse hapet pakoja e Ahtisarit, gjendja e bisedimeve kthehet në pikën zero. Ne s'kemi kah të shkojmë më shumë se sa kemi lëshuar pe në pakon e Ahtisarit, ndërsa sa i përket ndarjes nëse hapet çështja e kufijve me marrëveshje ne nuk kemi arsye t'i ikim, sepse kemi se çka të ndajmë ne shqiptarët edhe me Serbinë, edhe me Maqedoninë dhe ju konvenon shqiptarëve formimi i një shteti me kufi natyral, por nëse dikush tenton ta copëtojë me forcë ndarjen e Kosovës, pjesët e saj që po flitet dhe besoj që edhe do të tentohet, atëherë duhet bërë qartë se po hapet Kutia e Pandorës me krejt pasojat që ka për paqen dhe sigurinë në rajon dhe më gjerë, prandaj krejt në fund dua të them se populli i Kosovës nuk është mirë të fle dathë, siç është porositur që tetë vjet , por duhet vërtet të jetë shumë i kujdesshëm. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Besa Gaxherri, le të përgatitet Nekibe Kelmendi

BESA GAXHERRI – Ju faleminderit , të nderuar kolegë deputetë dhe ju të pranishëm në sallë,

Unë do të mundohem që vërtet të mos i përsëris kolegët e mi, por është e vërtetë që në këtë moment në të cilin gjendet Kosova, në veçanti Kuvendi i Kosovës, organi më i lartë i këtij vendi, është tejet i komplikuar dhe shumë i vështirë. Edhe unë mendoj, po mendoj për vetën time, nuk di nga t'ia filloj. Një gjë që në fillim dua të them se të gjithë kundërshtarët e pavarësisë të Kosovës le të mendojnë, sot e nesër që zgjidhje tjetër nuk ka për Kosovën, përveç pavarësisë së Kosovës. Pa marrë parasysh a jemi ne sot në nivel të detyrës apo nuk jemi, unë mendoj se për Kosovën nuk ka zgjidhje tjetër, përveç pavarësisë dhe është dashur deri më tash të jetësohet kjo pavarësi. Atëherë shtrohet tjetër pyetje. Është ndoshta lehtë të flasim pse ka ngecur, do me thënë, megjithatë unë dua t'ia filloj kështu: A thua vallë, Kuvendi i Kosovës gjithmonë duhet të merret me pasojat, realisht kësaj radhe me Grupin e Unitetit? Është shumë e vërtetë që ky Kuvend i ka dhënë besimin një grupi jo çfarë është ky, por megjithatë e ka përkrahur Grupin e Unitetit dhe Grupi i Unitetit vjen në Kuvend vetëm atëherë kur bllokohet procesi, kur nuk ka zgjidhje. Vjen për të kërkuar edhe pak mandat, ose vjen për ta hequr përgjegjësinë të cilin nuk ka mundur ta çojë në vend.

Ky Grup i Unitetit më shumë se një vit në këtë proces, deputetëve të Kuvendit të Kosovës, nuk iu ka ofruar qoftë një letër më të thjeshtë, e të mos flas për dokumente sepse vërtet çdo proces, në veçanti procesi i Kosovës, duhet të shkojë apo të zhvillohet me dokumente, me vendime, të arkivuara të gjitha, të cilat unë nuk i di dhe jam e bindur që asnjë deputet nuk e di, sepse deputetëve të Kuvendit të Kosovës, qoftë një faqe material nuk iu ka ofruar për këtë proces. Unë për vetën time nuk jam e kënaqur dhe nuk kërkoj nga deputetët dhe nuk duhet të tolerohet një gjë e tillë. Grupi i Unitetit është dashur të merret shumë më seriozisht dhe duhet të merret shumë më seriozisht , në radhë të parë me Kuvendin e Kosovës, sepse vetëm në këtë formë mund të japë shembull që vërtet Kosova është partner që u theksua disa herë, është partner, por legjitimitetin e ka Kuvendi dhe për të qenë partner , çdo bisedë, çdo lëvizje duhet, është dashur të diskutohet dhe duhet të diskutohet në Kuvendin e Kosovës.

Fatkeqësisht, Grupi i Unitetit e ka tejkaluar ndoshta në një formë atë kompetencën të cilën ia kemi dhënë ne. Grupi i Unitetit ka humbur kohë duke u marrë me simbolet e Kosovës, por nuk ia ka dhënë Kuvendi i Kosovës këtë besim, Vetëm Kuvendi i Kosovës mund të merret me simbolet, vetëm Kuvendi i Kosovës mund të merret me Kushtetutën e Kosovës, vetëm Kuvendi i Kosovës duhet dhe mund të merret me shpalljen e zgjedhjeve. Sikur Grupi i Unitetit të mos ishte marrë me këto gjërash, ndoshta do të ishte më i suksesshëm në nivel të bisedimeve për statusin e Kosovës.

Pavarësinë e Kosovës nuk e kemi filluar, apo procesin e pavarësisë së Kosovës nuk e kemi filluar ne, Procesi i pavarësisë së Kosovës ka filluar para shekujve, por rrumbullakimi i pavarësisë së Kosovës ka ardhur në këtë shekull, duke iu falënderuar aleatëve të cilët i kemi përfituar me një edukatë, me një shembull që kemi dhënë se vërtet jemi të përgatitur për pavarësinë e Kosovës. Këtij procesi i kemi hyrë së bashku me aleatët: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkësinë Evropiane dhe me NATO-n dhe unë mendoj se duhet të dalim së bashku. Duhet të dalim gjithsesi së bashku nga ky proces, por sa kemi dhënë kontribut ne? Çfarë pavarësie kemi përgatitur ne për qytetarët e Kosovës, kjo është pyetje tjetër dhe ky është realitet të cilin e dimë të gjithë ne që vërtet nuk është i kënaqshëm.

Jemi këtu ku jemi. Nuk mendoj se duhet të merremi tash me numërimin e të gjitha të metave, të defekteve apo të problemeve për të cilat nuk është pa përgjegjësi as Kuvendi i Kosovës, sepse tek fundi i fundit, ne kemi obligim dhe përgjegjësi, në qoftë se Grupi i Unitetit nuk ka qenë i ndërgjegjshëm, nuk ka qenë në nivel, ta ftojme ndoshta çdo javë nga një seancë të tillë. Megjithatë, në momentin në të cilin gjendemi, mendoj dhe duhet t'i shpallë Kuvendi zgjedhjet dhe të mbahen zgjedhjet. Populli duhet t'i japë legjitimitetin këtij Grupi të Unitetit, ose duhet t'ia marrë legjitimitetin këtij Grupi të Unitetit. Procesi nuk është e thënë që do të ndërpritet me rastin e mbajtjes së zgjedhjeve. Absolutisht, procesi duhet të vazhdojë dhe unë jam e prirur të mendoj se pavarësia do të ndodhë nesër. Nuk ka rëndësi, zgjedhjet duhet shpallur. Nuk ka rëndësi, Kuvendi duhet t'i kryejë punët e veta. Duhet t'i miratojë ligjet të cilat na mungojnë: Ligjin për zgjedhjet, po them disa prej tyre, Ligjin për prona që e kemi filluar, kemi privatizuar më shumë se gjysmën e pronës së Kosovës pa Ligj mbi prona e shumë ligje të tjera të rëndësishme, në të cilat duhet të punojmë, të vazhdojë në kontinuitet çdo institucion ta kryej punën e vet. Është shumë e vërtetë që ky Grup i Unitetit ka filluar ta humbë besimin te qytetarët e Kosovës, andaj duhet të provohemi tek vota e qytetarëve të Kosovës. Zgjedhjet duhet t'i shpallë ky Kuvend dhe unë mendoj se duhet të mendojmë edhe ne, edhe Grupi i Unitetit t'i marrë përgjegjësitë e veta, t'i shpallim zgjedhjet dhe të vazhdojmë më tutje. Nuk është e thënë që do të mbetet Kosova në vakum institucional, absolutisht. Ne jemi ata të cilët do të bëjmë edhe Ligjin për zgjedhjet, por edhe rregulloret edhe sa kohë do t'u japim këtyre institucioneve që janë, kështu që të mos ketë vakum institucional, por duhet të marrin legjitimitetin institucionet e Kosovës, gjithsesi.

Në fund, kisha ftuar edhe njëherë, në radhë të parë deputetët e Kuvendit të Kosovës, në qoftë se dikush mendon se me Kuvend mund të manipulohet, ne duhet të mendojmë

për veten tonë se jemi ne ata, tek e fundit që kemi përgjegjësinë edhe për statusin e Kosovës dhe për çdo problem në Kosovë. Prandaj, ftoj kolegët e mi deputetë që të jemi vërtet këto ditë në nivel të detyrës dhe, natyrisht, të japin atë çka pritet prej nesh, të cilën e kemi marrë me votën e qytetarëve të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Fjalën e ka zonja Nekibe Kelmendi, le të përgatitet deputeti Bujar Dugolli.

NEKIBE KELMENDI - I nderuari zoti kryetar, kryeministër, kryetar i Parlamentit, ministra, deputetë dhe ju mysafirë që e përcillni këtë seancë plenare,

Unë së pari duhet të them se do t'i përmbahem pikës së rendit të ditës, që është: Debat për procesin politik lidhur me vazhdimin e zgjidhjes së statusit të Kosovës. Kjo nënkupton se një proces është filluar, një fazë ka përfunduar, por faza tjetër akoma nuk ka përfunduar. Cila është ajo fazë e procesit për zgjidhjen e statusit politik që ka përfunduar? Modestia ime politike më thotë se faza e parë e procesit të zgjidhjes së statusit politik të Kosovës është përfundimi i negociatave me palën serbe dhe hartimi me ndërmjetësimin e komunitetit ndërkombëtar të pakos së Ahtisarit. Nuk e pranoj diskutimin e disa kolegëve deputetë këtu se Grupi i Unitetit këtij Parlamenti nuk i ka ofruar asnjë letër. Të gjithë jemi dëshmitarë se na është ofruar letra e ajo është dokumenti i Ahtisarit. E kemi pasur të gjithë në dorë dhe kemi nxjerrë Rezolutë me të cilën e kemi miratuar pikërisht në pakon e Ahtisarit. Mendoj se tani, meqë çështja e statusit të Kosovës nuk është zgjidhur ashtu si ishte koncipuar nga aleati ynë i përbetuar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Grupi i Kontakti, për bllokadën që e vendosi, për interesat e ku të di kujt, Rusia së bashku me Serbinë, atëherë procesi vazhdon vetëm përkitazi me zgjidhjen e statusit, kurse për pikat e tjera, të cilat patëm rastin t'i dëgjojmë nga shefi i Grupit të Unitetit, përkatësisht kryetari i Kosovës, ato janë të panegociushme dhe ato ne të gjitha i mbështesim, sikur që e mbështesim Grupin e Unitetit. Pse e mbështesim Grupin e Unitetit? Sepse vetë ia kemi dhënë votën këtij Grupi të Unitetit t'i udhëheqë negociatat. A mos mori vallë ndonjë vendim vetë krye në veti ky Grup i Unitetit pa dalë në Parlament? Asnjë vendim nuk e ka marrë as për zgjedhjet, sepse nuk ka vendim akoma për zgjedhjet dhe vendimi për zgjedhjet me siguri se do të merret nga ky Kuvend.

Për vazhdimin e procesit për zgjidhjen e statusit të Kosovës, unë mendoj se nuk do të ketë bisedime vetëm Grupi i Unitetit me palën serbe, ndoshta do të jetë një takim, apo jo. Mos harroni se angazhimin më të madh do ta ketë diplomacia e shteteve të cilat e mbështesin të drejtën tonë për pavarësi, siç janë : Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Grupi i Kontaktit dhe, me përjashtim të dy- tri shteteve, e gjithë Bashkësia Evropiane. Grupi i Unitetit mendoj se duhet të punojë në mënyrën siç ka punuar dhe duhet t'i realizojë, t'u përmbahet pikave të cilat sot na i prezantoi këtu para Kuvendit të Kosovës, por deri në zgjidhjen e statusit politik të Kosovës a duhet ne të rrimë e të bëjmë sehir mendoj se jo, duhet të punojmë edhe si Parlament edhe si Qeveri, kemi me çka të merrmi, kemi një mori ligjesh që dalin nga pakoja e Ahtisarit të cilin veç kemi filluar ta implementojmë në pjesë të caktuara. Kur të vij momenti do të implementohet edhe ajo më e rëndësishmja. Ky Kuvend do të jetë ai i cili do ta marrë vendimin për pavarësinë e

Kosovës dhe pastaj do ta bëjë kërkesën për njohjen e asaj pavarësie nëse nuk ndodhë që vetëdijësohet Rusia se është më shumë në favorin e saj që pavarësia e Kosovës të zgjidhet me një Rezolutë të Këshillit të Sigurimit, sepse tek atëherë nuk do të shërbente si shembull dhe do të konsiderohej si rast unik Kosova. Në të kundërtën, atëherë do të ndodhë ndryshe dhe do t'u hapen apetitet edhe vendeve të tjera, por ajo është çështje e Rusisë. Në një gjë e kemi të garantuar. E kemi të garantuar se Grupi i Unitetit do t'i përmbahet këtij afati dhe nuk do të lejojë që të zgjatet ky afat. Kjo është nën një. Nën dy Shtetet e Bashkuara të Amerikës na premtojnë dhe e mbajnë fjalën që ta njohin pavarësinë e Kosovës, qoftë nëpërmjet të shpalljes në variantin në Kuvendin e Kosovës, qoftë nëpërmjet të Këshillit të Sigurimit që s'do mend se do ta miratojnë edhe shtetet e tjera.

Unë gjatë kësaj kohe thashë se ne nuk duhet të qëndrojmë, duhet të punojmë, përveç ligjeve të cilat i bëj apel përfaqësuesit ndërkombëtar z. Ryker që mos ta bllokojë procesin e nxjerrjes së ligjeve, qofshin edhe ato që dalin nga pakoja e Ahtisarit, në mënyrë që procesi sa i përket legjislacionit të avancojë, të shkojë përpara dhe t'i përmbushim ne, të mos lë vakum juridik në Kosovë sa i përket legjislacionit.

Pika e dytë është t'i luftojmë dukuritë e këqija që gjenden në shoqërinë tonë, ta luftojmë korrupsionin, t'i luftojmë nepotizmat. Ta luftojmë trafikimin e ku ta di çfarë dukurish tjera. Kemi çka të punojmë për këto 120 ditë, derisa të vendoset për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Konsideroj se sa i përket të drejtave të komuniteteve, u dëgjuan disa ankesa këtu. Unë mendoj se komunitetet pakicë që jetojnë në Kosovë e kanë fatin më të mirë në botë që për popull shumicë kanë atë popull i cili vullnetarisht i mbron dhe u ofron edhe më shumë të drejta se që u garantojnë konventat ndërkombëtare. Shtrohet pyetja, u tha këtu se çka bëri Grupi i Unitetit që nuk u miratua në Këshillin e Sigurimit Rezoluta për pavarësinë e Kosovës, kurse unë pyes - Çka do të ndodhte nëse nuk do t'i kishim Amerikën, Grupin e Kontaktit dhe shtetet e BE-së që kanë kërkuar të vazhdoen bisedimet jo thjesht negociatat, por bisedimet për zgjidhjen e formulës për bërjen e Kosovës shtet të pavarur. Me siguri se do të ndodhte një konflikt i ngrirë në këtë pjesë të Ballkanit dhe ku ta di unë se kur do të vendosej për atë konflikt të ngrirë. Prandaj, nga zemra të gjithë ne duhet t'i falënderojmë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Grupin e Kontaktit, zotin Ahtisari, Banki Munin, i cili duarhapur e pranoi dokumentin e Ahtisarit dhe këtë Parlament, i cili me Rezolutën e vet e pranoi, gjithashtu, pakon e Ahtisarit. Gjithsesi sa i përket statusit të Kosovës asnjë nga ne nuk duhet të shqetësohemi. Fjalën e fundit do ta ketë ky Parlament edhe nëse duhet të shtyhet edhe më tutje përtej 120 ditëve, përsëri fjalën duhet ta ketë ky Parlament, sepse vërtet e kemi një garanci dhe një premtim të fortë se pas 120 ditëve, po hajde lere edhe 180 ditëve, do të zgjidhet statusi i Kosovës.

Mos harroni se këtu u tha se ky Parlament nuk e ka nxjerrë, e keni harruar se pikërisht ky Parlament e ka nxjerrë Rezolutën për rikonfirmimin e vullnetit të popullit të Kosovës dhe askush mos të mendojë se do të dilet jashtë kornizave të kësaj Rezolute. Kaq do të kisha, kam edhe diçka, por nuk kam kohë të bisedoj më tutje. Ju falënderoj për durimin.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bujar Dugolli le të përgatitet deputeti Ferid Agani.

BUJAR DUGOLLI - Ju faleminderit z. kryetar, i nderuar zoti president, kryeministër, të nderuar deputetë,

Faktikisht është një veprim i mirë që në Kuvendin e Kosovës në këto zhvillime politike të hapet një debat, i cili ka për qëllim ndihmesën që mund të jepet nga ana e deputetëve të Kuvendit edhe për Ekipin e Unitetit, por në një farë mënyre edhe për qartësimin edhe më të madh të gjendjes së Kosovës karshi zhvillimeve ndërkombëtare.

Është mirë që të kihet veprime kontinuele edhe të mos harrohen veprimet që janë bërë në të kaluarën për të ardhur deri te kjo ditë. Në legjislaturën e kaluar ishte një grup deputetësh që inicioi një rezolutë për shpalljen e shtetit të Kosovës në kufijtë e Kushtetutës '74, rezolutë e cila është nxjerrë në kohën kur bëheshin projekte të ndryshme për vazhdimin e krisesë artificiale Jugosllavi në një model të ri Serbi e Mali i Zi që është dashur të ishte reagim i Kosovës dhe i institucioneve të saja për të mos ndodhë ajo që ndodhi më vonë, që pas reagimit tonë jo efikas u bë që përgjegjëse për Rezolutën 1244, përgjegjësia të bie drejtpërdrejtë mbi Serbinë edhe pse Rezoluta 1244 nuk e ka autorizuar eksplicitë Serbinë që të jetë përgjegjëse e Rezolutës 1244. Megjithatë, Kuvendi i kaluar me miratimin e grupeve parlamentare të tri forcave kryesore politike e mirëpriti idenë, e përkrahu në parim, por nuk caktoj një datë të shpalljes të pavarësisë së Kosovës. Ajo gjendje po vazhdon edhe sot, por megjithatë, duhet të jemi respektues të zhvillimeve politike gjatë kësaj kohe dhe e dimë se Kuvendi aktual ka filluar një proces, të cilin e ka filluar në partneritet me bashkësinë ndërkombëtare dhe tash në këtë proces duhet ta përfundojnë këtë partneritet. Pra, i mbetet zhvillimeve të kohës ta vlerësojë se a ishte veprim i mirë në 2003 që nuk u bë apo nuk ishte.

Tani ne jemi në një situatë ndryshe. Nuk do të pajtohemi me disa vlerësime që u thanë para katër muajve kur kemi diskutuar prapë është gjendje e njëjtë. Unë nuk pajtohemi se është gjendje e njëjtë. Para katër muajsh ne nuk patëm mbështetjen e qartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës sa i përket pavarësisë së Kosovës, tani e kemi. E kemi fjalën e presidentit Bush e cila është fjalë shumë domethënëse dhe shumë e rëndësishme, të cilën fjalë asnjëherë nuk e pat populli i Kosovës nga asnjë president, do me thënë është një fjalë shumë e fortë. E kemi fjalën e presidentit Sarkozy, e kemi fjalën e kryeministrit Braun, i kemi fjalët e Këshillit të NATO-së, e kemi fjalën e shumicës së vendeve të Bashkimit Evropian që e mbështetin pavarësinë e Kosovës konform platformës së negociuar nga z. Ahtisari.

Ne jemi tash në disa rrethana që nuk duhet t'i shtrojmë luks vetes, por të mendojmë se si të jemi funksional në zhvillimet që na presin. Këtu u diskutuan shumë fajësime. Unë nuk besoj që Ekipi i Unitetit është fajtor për këtë gjendje të krijuar, se po të ishte ky fajtor do të ishte shumë lehtë t'ju themi se ju jeni fajtor dhe largohuni se do t'i zgjedhim disa të tjerë, por nuk është fajtor. Unë mendoj që fajtori kryesor tash ka emër atë e din çdo kush, e di bota, e dinë edhe qytetarët e Kosovës se fajtor është bllokada e Rusisë këtij procesi, procesit të definimit të statusit politik të Kosovës. Për veten time

asnjëherë nuk kam pasur iluzione se zgjidhja e statusit politik të Kosovës konform vullnetit të popullit të Kosovës do të kalojë përmes Këshillit të Sigurimit, pse as intervenimi i NATO-së nuk ka kaluar përmes Këshillit të Sigurimit, as zgjedhja e konflikteve tjera në ish-Jugosllavi, zgjedhjen e çështjes së Bosnjës apo intervenimet në vatra tjera të krizave nuk ka ndodhur ashtu. Ne në këtë proces duhet të shkojmë konform kërkesave edhe të miqve, posaçërisht Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat në mënyrë strikte janë përcaktuar për të ardhmen e Kosovës. Tash çka na duhet neve? Ne na duhet që të presim kalimin fazës 120-të të procesit shtesë ashtu siç është bërë, siç është kërkuar dhe pas kalimit të kësaj faze prapë Kuvendi i Kosovës të mbledhet dhe të shikojë se çfarë veprimi duhet të ndërmerret. Ka obligime të tjera që e presin Kuvendin e Kosovës. Unë mendoj që nga ky debat duhet të dilet edhe me qëndrime ose rekomandime në rast se nuk janë bërë, nuk janë evidencuar nga shefat e grupeve apo anëtarët e Kryesisë mendoj duhet të rezymohen të gjitha dhe t'u dërgohet Grupit të Unitetit dhe Grupi i Unitetit, Presidenti dhe Kryeministri t'i bartin ato tek qendrat e vendosjes se ne nuk mundemi të negociojmë apo rinegociojmë çështjet që janë negociuar një herë dhe që është gjetur një solucion zgjidhjesh sipas pakos së Ahtisarit, pra, duhet të jetë qëndrim i yni i prerë. Ajo diplomacia fluturuese mund të ndodhë përmes treshes së përcaktuar dhe t'i marrin prapë mendimet, por ato mendime duhet t'u jepen atyre përfaqësuesve të Grupit të Kontaktit se ne nuk kemi çka të negociojmë për çështje që janë përfunduar. Dikush thotë për çështje teknike. Ju e dini se edhe para se të filloj ky proces është bërë kërkesë përmes çështjes plotësimi i standardeve që të vazhdoen bisedat teknike. Rezultati i tyre ka qenë çdo here zero, për shkak se nuk mund të zgjidhet asnjë çështje teknike me Serbinë pa u bërë Kosova shtet dhe vetëm në këto parime ne mund t'i zgjedhim, d.m.th. në çdo aspekt duke i mbështetur parimet e reciprocitetit.

Kuvendi i Kosovës, Qeveria dhe Grupi i Unitetit duhet të përgatiten gjatë kësaj faze që ta përgatisin Kosovën që të funksionoj si shtet. Edhe me pakon e Ahtisarit edhe me veprimet tjera i lejohet Kosovës që të formojë Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe t'i hapë zyrat diplomatike. I lejohet Kosovës që të ketë edhe Ministri të Mbrojtjes, të ketë Ushtri të Kosovës, të krijojë Shërbimin e Inteligjencës, të përgatitë ligjet, që janë determinuese si ligjet zgjedhore apo edhe ligjet tjera që janë të rëndësishme dhe normalisht pas vendimit politik për statusin e Kosovës pas skadimit të kësaj periudhe të përkohshme të marrë vendimin që ta mbajë nivelin e zgjedhjeve ashtu siç e parasheh ligji. Pra, nga ky Kuvend duhet të dalë një mbështetje e qartë, d.m.th. duhet t'i dërgohet popullit një mesazh që institucionet e Kosovës, Kosova qytetarët e saj, por edhe Parlamenti nga ky debat nuk e ka humbur besimin në aleatin kryesor - Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe aleatët e saj në këtë proces dhe kjo është e vërtetë se asnjëri nga ne, nga diskutimet që u tha askush nuk e ka humbur këtë besim. Prandaj popullit duhet t'i thuhet nuk është humbur besimi. Zgjidhja që po kërkohet është zgjidhje që të jetë sa më gjithëpërfshirëse dhe Kosova të mos lëngojë në proceset e para definimit të statusit dhe të mos ketë probleme të vazhdueshme me njohjen e saj. Por sido që të jetë, ne pas skadimit të kësaj periudhe tranzitore duhet veprojmë, por veprimi duhet të jetë i koordinuar ashtu siç është premtuar edhe nga Grupi i Unitetit. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Deputeti Agani, le të përgatitet profesor Krasniqi.

FERID AGANI - I nderuari zoti Kryetar, i nderuar zoti Kryeministër, i nderuar kryetar i Parlamentit, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë dhe mysafirë që patët durim që deri më tash ta përcillni këtë debat,

Të gjithë pajtohemi se jemi në një moment specifik me përmasa historike. Grupi Parlamentar për Integrim dhe unë, si përfaqësues i Partisë së Drejtësisë, kemi qenë të vetëdijshëm për një gjë të tillë qysh para një muaji, kur në këtë Kuvend kërkuam që në një mënyrë të falënderojmë për punën e tij Ekipin e Unitetit dhe të rishikojmë mandatin të cilin Kuvendi ia ka dhënë me qëllim të mirë që ky rishikim të rezultojë me një strategji të re të veprimit në rrethanat e reja të cilat po krijoheshin.

Ne jemi në një situatë kur duhet të ballafaqohemi edhe me një periudhë të negociatave të udhëhequra nga bashkësia ndërkombëtare, konkretisht nga treshja e Bashkësisë Evropiane, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Federatës Ruse. Megjithatë, pas kësaj periudhe e cila nuk mund të jetë e pafundme dhe e cila në disa dokumente është përmendur se mund të jetë diku rreth 120 ditë ose pak më shumë, megjithatë na presin vendime historike. Mendoj se ky Kuvend në njërin prej konkluzioneve të tij nga ky debat duhet të potencojë këtë se kjo do të jetë shtyrja e fundit para deklarimit përfundimtar të qëndrimit të Kuvendit të Kosovës, lidhur me të ardhmen e vendit sa i përket pavarësisë dhe sovranitetit për të cilin në mënyrë të padyshimtë është përcaktuar në çdo akt të tij që nga themelimi. Është fakt se jemi në fazën përfundimtare të një procesi shumëvjeçar. Është fakt se ndërkombëtarizimi i çështjes së Kosovës është maksimal, asnjëherë nuk ka qenë më i madh se që është tani.

Përkrahja historike e Shteteve të bashkuara të Amerikës, të Britanisë së Madhe, shumicës së madhe të shteteve të Bashkësisë Evropiane për pavarësinë e Kosovës, është fakt i pamohueshëm. Të gjitha janë këto të arritura, të cilat duhet pasur parasysh dhe duhet vlerësuar. Është e qartë se ka vështirësi evidente për sigurimin e përkrahjes së Federatës Ruse për statusin e pavarur politik të Kosovës. Është fakt edhe realiteti i molisjes psike- sociale dhe ekonomike të qytetarëve të Kosovës. Mendoj se edhe miqtë tanë ndërkombëtarë janë të vetëdijshëm për këtë. Unë mendoj se ne në këto qaste nuk guxojmë të zhgënjehemi pa marrë parasysh se dëshpërimi është kërcënues. Duhet të jemi të bashkuar. Duhet të jemi edhe më transparent dhe më të vendosur. Ekziston një domosdoshmëri për realizimin e plotë të kompetencave kushtetuese të Kuvendit dhe të Qeverisë së Kosovës. Kjo u përmend edhe nga shumë diskutues deri më tani. Ritheksimi i rolit të Kuvendit të Kosovës, mendoj se është me rëndësi esenciale në fazën e ardhshme dhe në këtë fazë përfundimtare të përcaktimit të statusit politik të Kosovës. Po ashtu është e domosdoshme bashkërenditja e plotë e aktiviteteve politike të Kuvendit të Kosovës dhe të Qeverisë së Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shtetet përkrahëse në Bashkësinë Evropiane. Mendoj se edhe rreth kësaj nuk kemi asnjë dilemë apo mospajtim.

Duhet të jemi të gjithë të vetëdijshëm dhe shpresoj se jemi, se shtyrja e vendimit për statusin politik të Kosovës si shtet sovran dhe të pavarur për kundërshtarët e kësaj pavarësie paraqet një tendencë dhe një sukses që të zvarritet procesi deri në pafundësi,

ndërsa për miqtë tanë ndërkombëtar një rast për të ndërtuar konsensusin edhe më të gjerë për këtë pavarësi të Kosovës. Mendoj kjo është arsyeja themelore pse Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe miqtë në Bashkësinë Evropiane e kanë pranuar këtë shtyrje. Ajo që është e domosdoshme në këtë moment, është që Ekipi i Unitetit ta ketë një strategji më të qartë, më të profilizuar për veprimet në periudhën e ardhshme. Me veprimet tona, ne nuk guxojmë që partnerëve tanë ndërkombëtarë, partnerëve strategjik ndërkombëtarë si po i quajmë, t'ua vështirësojmë këtë proces, por përkundrazi duhet ta lehtësojmë në maksimum.

Mbështetur në këto qëndrime, Kuvendi i Kosovës duhet t'i intensifikoj veprimet legislative për përpilimin e Kushtetutës së Kosovës në radhë të parë.

Strategjia në periudhën e ardhshme duhet të mbështetet në procese shtet formuese edhe në këtë vazhdë, si hap të parë dhe të domosdoshëm e shoh miratimin e Kushtetutës së Kosovës, të mbështetur në dokumentin e presidentit Ahtisari dhe atë në referendum gjithë popullor, ashtu siç është paraparë edhe me Rezolutën e këtij Kuvendit të nëntorit të vitit 2005, ku thuhet se të gjitha vendimet me rëndësi mund të merren në këtë Kuvend ose me referendum. Jam i bindur se miratimi i kësaj Kushtetute në referendum gjithë popullorë do të paraqesë mbështetje të fuqishme për procesin ndërkombëtar për caktimin e statusit politik të Kosovës. Nuk mund të deklarohet si veprim unilateral dhe do të paraqiste një hap konkret drejt ndërtimit të shtetit sovran dhe të pavarur për të cilin menjëherë mund të kërkojmë edhe njohjen ndërkombëtare.

Unë nuk shoh alternativë tjetër më konstruktive në periudhën e ardhshme kohore, në qoftë se Kuvendi i Kosovës dëshiron të realizojë autonominë e tij vepruese, në qoftë se nuk dëshiron të shndërrohet në vrojtues pasiv të zhvillimeve. Mendoj se ky është një akt i cili është në kompetencën e tij legislative që është në vazhden e përpjekjeve ndërkombëtare për realizimin e vullnetit politik të popullit të Kosovës.

Në përfundim, unë apeloj që kjo ide, ky mendim, ky sugjerim për referendum në cilin do të miratohet Kushtetuta e Kosovës deri në fund të këtij viti, të shqyrtohet në mënyrën ma serioze nga anëtarët e Ekipit të Unitetit dhe nga ju të nderuar kolegë deputetë. Është shumë e qartë se nuk mund të kemi shtet pa kushtetutë, prandaj është me rëndësi që ta ndërtojmë bazën legislative të shtetit të ardhshëm të Kosovës, fillimisht dhe më pastaj njohjen ndërkombëtare ta kërkojmë mbi këtë bazë. Me këtë do ta dëshmojmë pjekurinë tonë demokratike dhe përkushtimin për rezultat konkret në procesin e përcaktimit të statusit politik gjatë këtij viti. Me këtë do të eliminohen edhe rreziqet për të cilat foli z. Surroi në fjalën e tij, do të eliminohej mundësia e rrezikimit të funksionalitetit të shtetit të ardhshëm të Kosovës, do të eliminohej mundësia e thellimit të vijave ndarëse në veriun e Kosovës në veçanti që mund të jetë një prej pasojave më konkrete negociatave të ardhshme, në drejtim të krijimit të një etniteti të ri politiko-territorial të entitetit serb dhe njëkohësisht do të lehtësojmë procesin e njohjes ndërkombëtare të Kosovës. Ju faleminderit!

KOLË BERISHA – Profesor Mark Krasniqi e ka fjalën, le të përgatitet Gjergj Dedaj.

MARK KRASNIQI – I nderuari President i Kosovës, i nderuari Kryetar i Kuvendit, i nderuari Kryeministër, ministra, anëtarë të Ekipit Negociator dhe deputetë, të gjithëve ju përshëndes për zemërsisht. Kur bisedohet për një problem të përbashkët edhe marrin pjesë më se 30 deputetë në këtë rast konkret, atëherë sigurisht se imponohet përsëritja e disa gjërave. Do të përpiqem që të largohem sa të mundem, por është e pamundur që mos të përsëriten disa gjëra. E para, shtyrja e vendimit për pavarësinë e Kosovës dhe bisedat me Serbinë. Kjo është një humbje kohe. Këtë e kemi provuar na sa e sa here, këtë e di edhe faktori ndërkombëtar. Nuk di pse na imponohet kjo punë e papunë, kjo punë që nuk jep kurrfarë rezultati në fund, vetëm humbim kohë. Kjo do të thotë për ne njëkohësisht humbje e kohës së pavarësisë, por edhe zgjatje e varfërisë në Kosovë, zgjatje e pasigurisë në Kosovë, zgjatje e papunësisë në Kosovë, por edhe shkurtim i durimit të popullsisë. Këto janë gjëra të paevitueshme në qoftë se zvarritet ky problem i Kosovës. Thuhet se për 120 ditë do të kryhet puna, por kur janë ato 120 ditë, çdo vjet janë 120 ditë. Duhet të caktohet data, prej kësaj date të caktohet 1 gushti, për shembull. Atëherë, në qoftë se caktohet 1 gushti, ne po presim edhe 150 ditë, do me thënë deri në fund të këtij viti. Më në fund, ne do të jemi të detyruar nga situata në Kosovë që nuk do të jetë e sigurt, as e qetë, në qoftë se kjo zvarritet më se 120 ditë, apo 150 ditë që do t'i caktojmë ne këtu. Do të na dalin prej dore populli, do të na dalin strukturat e ndryshme prej dore dhe ne nuk do të mund të bëjmë asgjë, por do të jemi përgjegjës. Prandaj, neve, faktori ndërkombëtar na i ka lidhur duart me këtë Rezolutën 1244, është si ajo shpata e Demokleut mbi kokën e njeriut.

Zgjedhjet pas pavarësisë janë caktuar me këtë pakon e Ahtisarit. Më falni ndoshta gabova, pavarësia, pastaj pas gjashtë muajve zgjedhjet nacionale. Mund të bëhen zgjedhjet komunale brenda këtij viti, por zgjedhjet parlamentare janë të përcaktuara se si bëhen atje, prandaj kot na flasim ndryshe. Unë mendoj se data të cilin ne duhet, ne nuk mund t'i imponohemi faktorit ndërkombëtar me data, sepse nuk vendosim ne asgjë as ne këtu në Parlament nuk jemi ata që vendosim për asnjë ligj. Ne propozojmë atje dhe ai a e jep si thonë “imzanë” a po jo, ajo është punë e tij. Prandaj, as Grupi Negociator nuk ka kurrfarë fajë për shumë gjëra për të cilat po i akuzojmë ne këtu, se nuk varet prej tyre zgjidhja e problemit për të cilin diskutohet.

Negociatat me kompromis. Çka do të thotë kjo me kompromis? Do të thotë kompromisi është të lëshojë pe njëra ose tjetra palë. Nuk do të lëshojë tjetra palë as për një, jo as për një centimetër, se tjetra palë është Serbia e cila do të na mbajë neve në robëri si na ka mbajtur një kohë, në shekullin XII. Prandaj, këto negociata do të përfundojnë në dëmin e Kosovës, mos asgjë tjetër me sakrifikimin e Mitrovicës, por siç na kanë thënë, dhe po na thonë gjithmonë edhe ndërkombëtarët, se nuk ka çenim të kufijve të Kosovës, atëherë ne do të ngulim këmbë që në asnjë mënyrë të mos pajtohemi me copëtimin e territorit të Kosovës.

Uniteti duhet të jetë problemi i Kosovës që na lidhë. Duhet ta konsiderojmë veten në këtë situatë të gjithë si kosovarë, si shqiptarët, si serbët, si turqit, si boshnjakët e të gjithë të tjerët që të punojmë për të mirën e Kosovës, në qoftë se punojmë për të mirën e Kosovës, punojmë për shtëpinë tonë.

Më duhet se faktori ndërkombëtar është i bindur se ne shqiptarët kërkojmë që ta shpatallojmë Serbinë dhe t'ia marrim 15% të territorit të Serbisë. Nuk kam dëgjuar asnjëherë prej shokëve edhe të nderuarve tanë që janë në Grupin Negociator që ta kenë kundërshtuar këtë anën e Serbisë që nuk është e vërtetë që ne po duam 15% të territorit të Serbisë ne ta marrim, po duam ta marrim tokën tonë, të cilën Serbia e ka okupuar më 1918, siç kanë dashur ta marrin dhe e kanë marrë të gjithë të tjerët, duke filluar prej Sllovenisë, Kroacisë, Bosnjës e Hercegovinës dhe Maqedonisë. Prandaj, këto 15% të territorit të Serbisë janë të tokës shqiptare, gjithmonë kanë qenë dhe duhet të mbesin patjetër. Shkojmë në këto të drejta historike për t'i zgjidhur problemet tash aktuale, atëherë unë prapë po e përsërisë këtë që e kam thënë disa here ndoshta, po harrohet kjo, atëherë duhet ta dijë Serbia se 500 vjet nuk e ka sunduar Kosovën, e tash edhe kur e ka sunduar është bërë një padrejtësi ndaj popullit shqiptar e kjo ka qenë me 1180 kur është bërë një luftë këtu. Është histori e gjatë kjo, megjithëse edhe kjo duhet përmendur, sepse është bërë para sa e sa shekujve një padrejtësi 500 vjet pastaj nuk është bërë se edhe Serbia ka qenë e okupuar nga Perandoria Osmane, e tash Serbia përsëri insiston se kjo tokë është serbe, se kishat serbe janë aty. Kishat, çka është kryesore, nuk janë serbe, janë bizantine, përveç Deçanit. Këto kisha janë ndërtuar në kohën kur asnjë serbë nuk ka qenë në Kosovë. Edhe në qoftë se ne shkojmë nga ajo që të drejtat historike të përrallave mesjetare të realizohen tash dhe Kosovën ta sundojë Serbia, atëherë Turqia ka plotë të drejtë në bazë të fakteve historike që ta sundojë Serbinë, sepse e ka sunduar 500 vjet edhe ja, po qesh ai shoku im dhe mirë e ka se do ta bëjmë ambasador të Turqisë këtu. Mirë, ju lutem ne duhet të jemi gjithmonë mirënjohës ndaj faktorit ndërkombëtar. Ai na ka shpëtuar prej shfarosjes. Ka qenë ora e fundit -ju ka thënë Millosheviqi bandave të veta - Kosovën ta spastrojmë njëherë e përgjithmonë, e pastrimi i Kosovës kanë thënë edhe përpara shumë shkencëtarëve se gjoja Kosova nuk mund të pastrohet ndryshe përveç shfarosjes së shqiptarëve fizikisht. Këtë e ka bërë Millosheviqi me bandat e veta, por megjithatë Gjyqi i Hagës nuk do ta dënojë atë si gjenocid, si krijues të gjenocidit, por është bërë një luftë edhe asgjë askujt, ne jse. Ne prej kësaj mbledhje nuk mund të dalim pa një konkluzion meritore, me një rezolutë, me një çka s' di, juristët do ta emërojnë diçka, edhe në atë rezolutë ose çka do të jetë ajo të hyjnë këto shtatë pika që na i lexoj z. Presidenti edhe këto edhe nga diskutimet të merren ajo që mungon në ato shtatë pika. Ju faleminderit për durim.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit profesor! Gjergj Dedaj e ka fjalën, le të përgatitet Hatixhe Hoxha.

GJERGJ DEDAJ – Ju faleminderit shumë zoti Kryetar, I nderuari zoti President, zoti Kryeministër, z. Thaçi, deputetë të Kuvendit të Kosovës, mysafirë e të gjithë ata që na përcjellin,

Nuk di a e kam pasur fatin e mirë a të keq, por kam qenë një argat që në vitet '90-ta sikur shumë prej jush në skenën politike të Kosovës ku nëse asgjë tjetër nuk kam mësuar prej saj, kam mësuar se miku i mirë gjendet në ditën e vështirë. Duke u nisur nga ky proverb popullor, mendoj se partneriteti ynë me miqtë tanë ndërkombëtarë nuk daton që nga viti '98 – '99, por fillimisht ka filluar të forcohet që me shfaqjen e subjekteve politike në krye me liderin historik dr. Rugova, sepse që nga ajo kohë shumë

burrështetas nga Uashingtoni, Brukseli, Londra, Boni, Parisi e kanë vizituar Kosovën, na kanë sugjeruar edhe ne gjithashtu kemi vizituar të gjitha qendrat ndërkombëtare të vendosjes, me të cilët kemi bashkëpunuar ngushtë edhe para lufte, duke ua bërë të ditur se çka do Kosova, çka po ndodhë në Kosovë dhe çfarë duhet bërë me Kosovën. Shfaqja në skenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e dinamizoi këtë bashkëpunim dhe erdhi deri te intervenimi historik i NATO-së në krye me liderin e paqes, të lirisë dhe të demokracisë botërore Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të gjitha vendeve anëtare të NATO-së, të cilat e stopuan gjenocidin serb në Kosovë dhe i shporrën forcat serbe paramilitare një herë e për gjithmonë nga Kosova, Çka duhet tjetër të bëjnë miqtë tanë që të na dëshmojnë se e kanë me seriozitet përkrahjen për ne, përkrahjen për Kosovën dhe kjo është parë në momentet më të vështira dhe mu për këtë e thashë se edhe tash e tutje Ekipi Negociator, përkundër vërejtjeve që i kemi për çështje të ndryshme në vija të trasha dhe në planin e përgjithshëm duhet ta marrë mbështetjen e Kuvendit të Kosovës, duhet ta marrë mbështetjen e grupeve parlamentare dhe të deputetëve, por edhe qytetarëve të Kosovës për të vazhduar këtë proces të nisur deri në përfundimin e tij, sepse duhet të kemi besim të plotë në miqtë tanë, se presidenti Bush, u përmend disa here këtu e tha në Tiranë, e tha në Romë e tha në Sofje, zonja e nderuar Rajs ua tha delegacionit tonë në Uashington .Anëtarët e Grupit të Kontaktit, kryeministra e ministra thanë dhe po thonë që do ta mbështesim pavarësinë e Kosovës dhe nëse e shikojmë në garat maratonike shpeshherë ata të cilët garojnë ndoshta pak pa arritur te caku mbushën frymë dhe fillojnë t'i lëshojnë gjunjët e kjo nuk guxon t'i ndodhë as Ekipit Negociator, as Kuvendit të Kosovës as qytetarëve të Kosovës.

E thashë edhe një herë, se ndoshta, nuk ka qenë dashur që Ekipi Negociator të vihet mbi Kuvendin e Kosovës, sikur që ka ndodhur disa here, Nuk ka qenë dashur që ta luaj rolin e një super qeverie sikur që ka ndodhur disa herë pa u konsultuar fare Kuvendi i Kosovës as grupet parlamentare të shpall Komisionin për Kushtetutën për simbolet, të flitet për zgjedhjet për pragun zgjedhor. Ne si deputetë, si Grup parlamentar kemi dëgjuar nga mediat ,kurrë nuk është biseduar këtu. Nuk ka qenë dashur Kuvendi i Kosovës, do me thënë Grupi Negociator t'i marrë ato kompetenca të cilat më parë nuk janë bërë çështje e debatit në Kuvendin e Kosovës, sepse Kuvendi i Kosovës është ai mekanizëm, është ai trup dhe është ai forum ku duhet të merren të gjitha çështjet e rëndësishme, sepse ky Kuvend ia ka dhanë besimin edhe mandatin edhe Ekipit Negociator për të negociuar për statusin dhe jo për Kushtetutën, jo për pragun zgjedhor, jo për zgjedhjet, jo për simbolet dhe jo për çështjet të cilat shpeshherë ne deputetët i dëgjojmë edhe nga gazetat dhe nga mediat. Kjo është non sens , kjo është e pafalshme dhe e papranueshme.

Në emër të liberalëve ,të Ekipit Negociator jap mbështetje, që ndoshta nuk di sa është e nevojshme, por megjithatë i jap mbështetje publike që të vazhdojë edhe për këto 120 ditë nëse është e nevojshme edhe 150 ditë , sepse jemi kah durojmë dhe sakrifikojmë me shekuj dhe do të presim dhe do të durojmë, do të sakrifikojmë edhe pak, sepse të mos harrojmë se i kemi partnerët e besueshëm, i kemi miqtë që i kemi bërë me gjakun tonë të besueshëm, i kemi autoritetet dhe Administratën Amerikane, NATO-në dhe Bashkimin Evropian , me të cilët duhet jo vetëm që ta bëjmë realitet pavarësinë e Kosovës, por të mendojmë edhe për statusin e Kosovës pas statusit se edhe atëherë do të

na duhen edhe ma shumë miqtë tanë për ta integruar Kosovën në Bashkimin Evropian, në NATO dhe në të gjitha strukturat veri-atlantike.

Nga kjo foltore ju dëshiroj sukses anëtarëve të Ekipit Negociator për punën e ardhshme shumë delikate, shumë të rëndësishme. Do të qëndrojmë pas jush, do t'ju përkrahim dhe shpresojmë që do ta çoni në vend amanetin tonë, amanetin e dëshmorëve, të martirëve dhe do ta bëni realitet pavarësinë e Kosovës. Po ashtu nuk dua me e lëshua rastin, sepse kjo RTK-ja shumë rrallë po na përcjell neve partive të vogla. Do me thënë nuk dua me lëshuar rastin që edhe një herë ta falënderoj Administratën Amerikane, NATO-në, dhe Bashkimin Evropian për gjithë kontributin e çmueshëm dhe jetik që po e bëjnë për fatin dhe të ardhmen e Kosovës. Zoti e bekoftë Amerikën, Zoti e bekoftë Bashkimin Evropian, Zoti e bekoftë NATO-në dhe Zoti e bekoftë NATO-në dhe Zoti e bekoftë Kosovën. Ju faleminderit shumë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Falën e ka deputetja Hatixhe Hoxha, lë përgatitet deputeti Zef Morina.

HATIXHE HOXHA - Zoti Kryetar, kolegë deputetë,

Me gjithë rezervat tona të shprehura në lidhje me pakon, siç ishin ato që kanë të bëjnë me decentralizimin, kompetencat shtesë të komunave të reja serbe, te metat në sferën e trashëgimisë kulturore e fetare dhe zonave mbrojtëse, pastaj votimin e dyfishtë në Kuvendin e Kosovës e të tjera, na u tha atëherë se këto ishin kompromise, siç u quajtën të dhimbshme e të cilat u bënë në interes të pavarësisë së Kosovës. Mirëpo edhe pas gjithë kësaj sërish kërkohet nga ne bisedime dhe kohë shtesë. Natyrisht, kuptohet se me bisedime të reja insistohet në prolongimin e afateve dhe vazhdimin e bisedimeve me qëllim të nxjerrjes së kompromiseve të reja.

Kolegë deputetë,

Edhe pas tetë vjetëve të Administratës së Kombeve të Bashkuara statusi i Kosovës ende mbetet çështje e hapur, çështje e ndjeshme, çështje e pa definuar. Paqartësia mbi statusin e saj të ardhshëm është bërë padyshim pengesë kryesore për zhvillimin demokratik të Kosovës, llogaridhënien dhe rimëkëmbjen ekonomike.

Statusi i pasigurt politik i Kosovës, i ka pamundësuar asaj qasje në institucionet financiare ndërkombëtare, integrimin e plotë në ekonominë rajonale apo tërheqjen e kapitalit të jashtëm, i cili nevojitet për të investuar në infrastrukturën themelore si dhe për ta ulur varfrin dhe papunësinë e madhe.

Është thënë tashmë se Kosova është rast unik që kërkon zgjedhje unike. Ajo nuk krijon precedencë për konfliktet e reja të pazgjedhura, prandaj, detyra jonë është të kërkohet dhe të punohet që ma shpejt të definohet statusi i saj dhe opsioni i vetëm është Kosova e pavarur, sepse e ardhmja e Kosovës dhe e qytetarëve të saj nuk mund të mbeten peng i tekeve dhe të dëshirave të atyre që në vazhdimësi aq shumë të këqija bënë mbi ne, mbi

popullin tonë. Të gjithëve duhet t'u bëhet me dije se pavarësia është mundësia e vetme për një Kosovë politikisht stabile dhe ekonomikisht të qëndrueshme. Vetëm me një Kosovë të pavarur institucionet e saja demokratike do të jenë plotësisht përgjegjëse dhe të përgjegjshme për veprimet e tyre. Ky do të ishte thelbi i ndërtimit dhe respektimit të sundimit të ligjit dhe mbrojtjes së pakicave. Prandaj duhet të kihet parasysh fakti se çfarëdo vonimi i zgjidhjes së statusit të Kosovës sfidon jo vetëm stabilitetin e saj, por paqen dhe stabilitetin e rajonit në tërësi, ndërsa pavarësia e Kosovës do t'i mundësonte rajonit që të ketë paqe, stabilitet dhe prosperitet për të gjithë. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Fjalën e ka deputeti Zef Morina, le të përgatitet deputeti Hajredin Kuçi.

ZEF MORINA – Ju faleminderit, zoti Kryetar, i nderuari zoti President, zoti Kryeministër, i nderuari zoti Thaqi, zoti Surroi, të nderuar kolegë deputetë,

Debati që po zhvillohet sot në këtë Kuvend është i një rëndësie të veçantë, sepse paraqet qëndrimin e popullit për statusin politik që do të ketë Kosova. Gjithashtu, nga Grupi i Unitetit u njoftuam saktësisht për punën që është bërë gjer më tani.

Nga presidenti i Kosovës z. Fatmir Sejdiu dhe anëtarët e tjerë të Grupit të Unitetit u njoftuam për ecurinë e bisedimeve rreth 18 muajve dhe qëndrimin e faktorit ndërkombëtar për zgjedhjen e statusit të Kosovës.

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Mendoj se Grupi i Unitetit bazuar në mandatin që ia ka dhënë Kuvendi i Kosovës, ka vepruar konform kërkesës së popullit të Kosovës, duke dhënë të gjitha argumentet për Kosovën shtet sovran dhe të pavarur. Gjithashtu duke qenë në kohezion të plotë me faktorin ndërkombëtar që është faktori kryesor për njohjen e pavarësisë së Kosovës. Ky Kuvend, muaj parë e ka mbështetur propozimin e kryenegociatorit Marti Ahtisari, i cili propozoi që Kosova të jetë shtet i pavarur në mbikëqyrjen ndërkombëtare për një afat të caktuar, propozim i cili është mbështetur edhe nga faktori ndërkombëtar, duke filluar nga SHBA-të, BE dhe shumë vendeve anëtare të Këshillit të Sigurimit, por kundërshtarë ishin Serbia dhe Rusia. Rusia e cila është anëtare e përhershme e Këshillit të Sigurimit me të drejtë veto, për shkak të lidhjeve tradicionale që ka me Serbinë po mundohet të pengojë të drejtën e popullit të Kosovës për të jetuar në shtetin e tyre të pavarur si çdo popull tjetër. Ne jemi të sigurt se Rusia në ditë do të pajtohet dhe do ta pranojë shtetin e Kosovës, sepse, mendoj se Kosova është i vetmi vend në botë që mbi 95% të popullit e mbështesin pavarësinë.

Nuk ka më shumë se një vit e disa muaj kur Rusia ishte kundër prishjes së unionit Serbi – Mali i Zi, por ndër të parat e njohu pavarësinë e Malit të Zi për të cilën votuan rreth 55.5% , pra pak më shumë se gjysma e popullit. Rolin kryesor këtu e ka luajtur Bashkimi Evropian, i cili nuk kërkoi rezolutë nga Këshilli i Sigurimit, por lejoi që populli të vendos se si dëshiron të jetojë

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Mendoj se pas këtyre 120 ditëve duhet që SHBA-të dhe Bashkimi Evropian të njohin pavarësinë e Kosovës, sepse Kuvendi i Kosovës unanimisht ka mbështetur pavarësinë, gjithashtu mbi 95% të popullit janë deklaruar për pavarësi,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Edhe ne nuk jemi pa gabime, sepse ka raste kur institucionet tona vendore nuk kanë qenë të kujdesshme në punën e tyre. Pavarësia dhe zhvillimi ekonomik janë ngusht të lidhura. Nuk mund të jetë një shtet stabil po që se ekonomikisht është i dobët. Zhvillimi ekonomik varet nga qeverisja që i bëhet atij vendi. Në kohën kur Serbia për interesa politike për ta penguar pavarësinë e Kosovës, i ofron Rusisë resurset më të mëdha ekonomike të vendit në shfrytëzim, institucionet tona mjerisht qoftë nga paaftësia apo nga interesat e ngushta personale dhe klanore, jo vetëm që nuk i ofruan miqve tanë, SHBA-ve dhe shteteve të Bashkimit Evropian mundësi direkte për të hyrë në Kosovë, por i eliminuan nga gara, duke i konsideruar si të pasuksesshëm. Rast konkret është rasti i telefonisë mobile, për të cilin u deshtë të kalojnë tri vjet për t'u bindur se ka në mesin tonë të atillë që nuk dinë apo nuk dëshirojnë të veprojnë për të mirën e zhvillimit ekonomik të vendit. Fatkeqësisht, kemi edhe deputetë këtu në mesin tonë, të cilët nuk qanin kokën pse kompanitë e shteteve që e çliruan Kosovën nuk e fituan të drejtën për të vepruar në Kosovë, por insistonin me çdo kusht të fitonte kompania, e cila jo vetëm që nuk i plotësonte kriteret, por ishte një konzorcium, gjegjësisht në lidhje me kompanitë nga Serbia. Një veprim i tillë i ka kushtuar dhe po i kushton shumë Kosovës si në aspektin ekonomik, ashtu edhe politik.

Zonja dhe Zotërinj deputetë, ka ardhur koha që të jemi më të sqartë, më të përgjegjshëm dhe ta lëmë anash retorikën boshe, por të veprojmë për interesat e Kosovës, e jo për interesa personale e klanore. Dëgjuam edhe kritika nga parafolësit për të cilët kam respekt, por mendoj se nuk është koha për të bërë fushatë, sepse asnjëri nga ne nuk do të kishte mundur të bënte më shumë se ka arritur Grupi i Unitetit dhe grupet e tjera, të cilat kanë qenë direkt të angazhuara në këto bisedime. Mendoj se është dashur të bisedohet më shpesh në këtë Kuvend për vështirësitë dhe pengesat që ka mundur t'i ketë Grupi i Unitetit gjatë bisedimeve.

Partia Demokristiane e Kosovës e mbështet fuqishëm angazhimin e Grupit të Unitetit dhe kërkon që të jetë unik në qëndrimet dhe kërkesat për të ardhmen e Kosovës, gjithnjë duke ruajtur bashkëpunimin me miqtë tanë ndërkombëtar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të arrijmë deri te pavarësia. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Hajredin Kuçi, le të përgatitet deputeti Genc Gorani.

HAJREDIN KUÇI – Ju faleminderit zoti Kryetar i Kuvendit, zoti President, Kryetar Thaqi, Kryeministër, Kryetar i ORA-s zoti Surroi,

Të nderuar deputetë, debati që po e bëjmë sot, me siguri e pat edhe ju, është përshkuar me emocione të ndryshme, natyrisht edhe me vlerësime diku me vend e diku pa vend, me siguri edhe me hidhërime, por edhe tendenca për ta gjetur fajin dhe fajtorët. Por, ajo që ka munguar dhe jo në të gjitha rastet, mendoj se është ajo që të gjejmë atë se çka duhet bërë tash e tuje, gjë që ka qenë edhe qëllimi ftesës së Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës për këtë debat.

Kur kemi diskutuar para katër muajsh, ka qenë pak ma lehtë dhe kemi qenë të koncentruar paksa në përmbajtjen e procesit dhe më pak në dinamikën e procesit. Kësaj radhe duket se jemi të interesuar për të dyja. Ajo çka është në këtë rast bartja e çështjes së Kosovës nga Këshilli i Sigurimit në Grupin e Kontaktit, është diçka që në një ose në mënyrë tjetër na ka dëshpëruar neve, por duhet të pranojmë që se ka humbur besimin te qytetarët e Kosovës dhe në veçanti nuk e ka humbur besimin në kohën kur kemi fituar përkrahjen nga bota liberal-demokratike apo nga SHBA-të, në veçanti, dhe Unioni Evropian. Çka do të thotë kjo? Shpresat për një përkrahje të tillë që nuk kanë qenë para katër muajsh, sot janë të thëna publikisht dhe kemi arsye që t'i besojmë më shumë. Në anën tjetër, kemi arsye t'i besojmë nëse e marrim edhe para tetë vitesh, të njëjtit njerëz apo të njëjtat shtete, të njëjtat qeveri kanë dhënë fjalët e veta, përkrahjet e veta dhe e kanë ndryshuar realitetin në Kosovë.

E di se të gjithë neve na brengos ajo që nuk është çështja në duart tona, dhe kjo është çështja ndoshta më negative që neve shpeshherë na bënë të dyshojmë në vetveten apo në njëri-tjetrin. U hap këtu me shumë dilema çështja e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Unë nuk dyshoj në asnjë deputet të Kuvendit të Kosovës, qoftë shqiptar apo edhe ata të komuniteteve të tjera që marrin pjesë, që dëshirojnë apo nuk dëshirojnë ta shpallin. Çështja apo dilema kryesore është a duhet ta shpallim në bashkërendim me dikë tjetër dhe a është çështja e kohës së vetëdijesimit nacional apo është çështja e kohës së vetëdijesimit ndërkombëtar. Unë mendoj se çështjen e vetëdijesimit nacional e kemi tejkaluar vite me parë dhe tani kemi nevojë për një bashkërendim të aktiviteteve, në radhë të parë me SHBA-të dhe me Unionin Evropian, që shpallja e pavarësisë së Kosovës me aktet shtesë duhet të jetë diçka jo vetëm e dëshirueshme nga ne, por njëkohësisht e pranueshme edhe nga faktori ndërkombëtar.

Unë do t'i fokusoj mendimet e mia në atë çka duhet të bëjmë brenda këtyre 120 ditëve, edhe pse për mua 120 ditë janë relative. Ajo çka duhet të them është - duhet të orientohejmë në dinamikën e procesit dhe në përmbajtjen e tij. Dinamika e procesit kërkon një bashkërendim të aktiviteteve dhe një përshpejtim, do të thosha, të këtij bashkërendimi me faktorët ndërkombëtar. U përmend shpeshherë afatizimi. Është vërtetë që ne kemi dëshirë që sa më shpejtë që është e mundur ta bëjmë një gjë të tillë, por njëkohësisht është e vërtetë që afatizimi dhe këto ditë duhet të kuptohen si harxhim i argumenteve të atyre që janë kundër pavarësisë dhe si fuqizim i mbështetjes së atyre që janë pro. Në një ose në mënyrë tjetër ky është qëllimi ynë dhe mu për këtë qëllim ne edhe po hyjmë brenda kësaj dinamike. Natyrisht, ne duhet të themi, në përmbajtjen e statusit tonë u përmend, dhe unë do t'i them këto tri gjëra. E para, përmbajtja nuk duhet preket sa i përket asaj që ka të bëjë me shtetin sovran dhe të pavarur. Përmbajtja nuk duhet të preket sa i përket tërësisë territoriale të Kosovës dhe sa i përket funksionalitetit

të institucioneve të Kosovës në tërë territorin e saj. Brenda kësaj qasja në negociatat e reja që duhet ta pranojmë është kërkesë e bashkësisë ndërkombëtare që kërkohet nga ne t'i bëjmë në ditët në vijim, pragu i bisedimeve tona fillestare është pakoja e Ahtisarit, U përmend me të drejtë këtu, do të thotë ne kemi thënë dhe mendoj se është edhe qëndrim i këtij Kuvendi, por në rastet e tjera mendoj që Grupi i Unitetit dhe të tjerët do të kenë alternativa të tjera dhe shpeshherë dikujt do t'i duket, do të jemi edhe në ofensivë.

Unë mendoj se kemi nevojë ta bëjë Grupi i Unitetit agjendën e vet vendore dhe ndërkombëtare. Grupi i Unitetit në agjendën vendore në radhë të parë duhet ta ketë unitetin politik sa i përket statusit final të Kosovës. I duket dikujt pak interesant ta thotë dikush nga opozita. Unë e di se të qenët e opozitës në Grupin e Unitetit është topitje e reagimeve opozitare, por mendoj se në këtë proces të gjithë duhet ta japin kontributin e vet dhe uniteti politik, pa marrë parasysh proceset që mund të ndodhin, në veçanti proceset demokratike sa u përket zgjedhjeve nuk duhet ta prishin këtë unitet. E dyta, është menaxhimi i situatave. Kosova nuk është në gjendje krize, por Grupi i Unitetit duhet të jetë i gatshëm të menaxhojë çdo situatë eventuale që paraqitet në ditët në vijim. Pastaj, mendoj se duhet të bëhet më shumë në mirëqenien ekonomike dhe në këtë drejtim duhet të kërkojmë ndihmën edhe nga faktorët ndërkombëtarë. Pra, çështja e mirëqenies ekonomike nuk duhet të jetë një ndër faktorët që bën pengesë për reagime apo çështjet e reagimeve sociale. Dhe, u përmend, diku me të drejtë e diku pa të drejtë, çështja e Kushtetutës, e kështu me radhë. Ata që e kanë lexuar dokumentin e Ahtisarit dhe e kanë miratuar në këtë Kuvend, e kanë parë që në pikën 1.7 thuhet se si themelohet Komisioni Kushtetues. Unë, atë çka dua ta them nën një, kam qenë i nderuar që jam emëruar në atë pozicion, po e them edhe një - vendimet politike që merren nga institucionet e Kosovës dhe afatet kohore, ne do t'i respektojmë Nëse kërkon vendime politike, cilën bazë juridike ta krijoni ju, cilin afat kohor ta bëni ju, unë jam i bindur me gjithë anëtarët e Komisionit në afatin e duhur që thoni ju, do ta plotësojmë.

Një çështje tjetër që u përmend janë zgjedhjet. Është qëndrim i të gjithëve që proceset demokratike dhe statusi i Kosovës duhet të shkojnë ndaras. Nuk ka qëllim opozita që ta dëmtojë statusin e Kosovës përmes zgjedhjeve, por njëkohësisht nuk duhet të kemi edhe mohim të proceseve demokratike nën petkun se po zhvillohen çështjet për status. Ne jemi këtu, do t'i përcjellim çështjet dhe mendoj ky Kuvend dhe Grupi i Unitetit do ta thonë fjalën e vet meritore.

Unë mendoj se duhet ta kemi një agjendë edhe me ndërkombëtarët, në radhë të parë lotimin, ndoshta që duhet të rritet më shumë, çfarë kemi parë në ditët e fundit. E dyta, ofrimi i projekteve konkrete çfarë duhet të ketë Grupi i Unitetit dhe çështje e partneritetit që unë do të ndalem me dy- tri fjali. E para, unë mendoj se duhet të kemi bashkëpunim, partneritet. Është vështirë që ne t'i vejmë kushte dikujt për të cilët kemi nevojë. Ne duhet të jemi korrekt, ne duhet që t'i ofrojmë ndihmën tonë, përkushtimin tonë, mirënjohjen tonë për kushte atyre për të cilët kemi nevojë, jo vetëm sot por edhe pasi të bëhemi shtet nuk mund t'i vejmë. Dhe ky bashkëpunim çfarë do të jetë? Duhet të jetë serioz, duhet të jetë i përgjegjshëm dhe duhet të jetë në momentet e caktuara ndoshta balancë në mes të vullnetit të vendorëve dhe ndërkombëtarëve. Unë do ta parafrazoj pak presidentin e ndjerë Kenedi, i cili në një rast, për rastin që e ka bërë marrëveshjen

e krizës së Kubës, kur është kthyer, nga Kongresi ka marrë kritika dhe ai ka thënë: “Gabimi në politikën e jashtme e humb shtetin, gabimi në politikën e brendshme e humb pushtetin. Unë kam vendosur ta humb pushtetin e jo shtetin”. Në këtë drejtim mendoj që, ajo çka duhet ta gëzojë Ekipin e Unitetit, është se e ka ruajtur procesin brenda dhe jashtë Kosovës. Unë mendoj se fillimi ka qenë i mirë, edhe dalja, dhe mendoj edhe në të ardhmen. Pse? Ne kemi hyrë në proces me miqtë tanë ndërkombëtar dhe nëse kemi arritur pas 18 muajsh negociatash që bashkësia ndërkombëtare, presidenti Bush, Unioni Evropian ta mbështesin qëndrimin dhe vullnetin tonë, unë mendoj që ky është sukses dhe këtij sukcesi ne duhet t’i gëzohemi. Është ana tjetër, edhe në Grup të Unitetit, si në çdo shoqëri tjetër, ka edhe lëshime, ta zëmë. Për mua Grupi i Unitetit është vend ku harmonizohen qëndrimet, për mua nuk është Grupi i Unitetit ku vërehen dallimet. Unë mendoj se Grupi i Unitetit ka begrande të ndryshme aty, ka përgatitje të ndryshme. Kanë të drejtë që të japin propozime, por në opinionin publik të dalin me një qëndrim. Mendoj se këtë propozim duhet ta harmonizojmë. Në këtë drejtim do ta ftoja Presidentin të jetë më i kujdesshëm, të kërkojë më shumë përgjegjësi edhe nga vetja, edhe nga të tjerët, dhe brendapërbrenda kur dalin, të dalin me një përgjegjësi ose me një qëndrim. Ajo çka duhet të them, nuk është mirë të na hutojnë neve me begrande politike ose edhe me begrande të tjera që mund të jemi si qytetarë të Kosovës.

Një veprim tjetër që duhet ta them është çështja e perceptimit për institucionet e Kosovës dhe për këtë Kuvend. Unë nuk dua ta kualifikoj asnjë institucion të Kosovës me ndonjë krahasim paraprak. Ky institucion i Kosovës, ky Kuvend i Kosovës mendoj që ka edhe guximin edhe përgjegjësinë edhe vullnetin edhe dëshirën t’i kryejë obligimet e veta njerëzore, morale dhe kombëtare, dhe besoj që këtë do ta bëjë, por perceptimi me institucionet paraprake mendoj se nuk është adekuat. E dyta, edhe ky institucion nuk mund të jetë imun ndaj zhvillimeve që do të bëhen, dhe nëse ne nuk e kryejmë punën tonë, do t’i lëmë hapësirë dikujt ta kryej punën në rrugë. Unë për hir të fëmijëve të mi kisha dashur që politikën e Kosovës ta udhëheqin institucionet e Kosovës dhe jo rrugët e Kosovës. Këtë e them me sinqeritetin më të madh, me bindjen e plotë dhe unë dua të besoj që këta njerëz dhe unë, po e them personalisht, duhet t’i japim mbështetje Ekipit të Unitetit dhe ta them një fjalë ku thuhet: “ajo çka është bërë, duhet të bëhet, dhe ajo çka ndodh, duhet të ndodhë”. Këta me siguri do ta përcjellin punën, do ta kenë mbështetjen tonë. Unë do ta përfundoj me një fjalë – Nëse i kemi vënë në ekip si lojtarët, atëherë nuk është mirë që ne si trajner t’u themi në çdo minutë, na pyetni neve a të jepni gol, apo jo. Le ta luajnë lojën 120 minuta dhe ne pas 120 minutash do ta shohim se si e kanë luajtur lojën. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERSHA – Desha të ta vazhdoj prapë fjalën. Fjalën e ka deputeti Genc Gorani, le të përgatitet deputetja Teuta Hadri.

GENC GORANI – Ju faleminderit zoti Kryetar, i nderuari zoti president, zoti Kryeministër, zoti Thaçi, zoti Surroi, ministra të nderuar, zonja dhe zotërinj deputetë,

Më lejoni me gjithë modestinë t’i ndajë një apo dy mendime me ju në këto orë mjaft të vonshme. Për mua personalisht ky debat vërteton se është dashur të mbahet para shkuarjes të Grupit të Unitetit në Uashington. Grupi i Unitetit sot shprehu dallime në

strategji, posaçërisht nga aspekti i afatit të shpalljes së pavarësisë nga Kuvendi i Kosovës. As ky Kuvend nuk është duke e vënë veten në pozitë të marrjes së vendimeve përgjatë këtij procesi për çështjet esenciale.

Mendoj se platforma e mëtejme e Grupit të Unitetit duhet të ndërtohet dhe miratohet në Kuvend. Në këtë kontest e përshëndes idenë për seancën permanente kushtuar statusit. Sa u përket zgjedhjeve të paralajmëruara parlamentare po thuhet se ato do të prodhojnë një Kuvend dhe Qeveri me legjitimitet të ri, të domosdoshëm madje edhe për vazhdimin e mbarë të procesit. Kisha dashur si çështje të fundit ta shtroj këtë si çështje fundamentale: A duhet të shpallet pavarësia nga Kuvendi në legjislacionin aktual? A është kjo një punë që i takon këtij legjislacioni dhe që nuk guxon, nuk ka të drejtë t'ia përcjellë legjislacionit tjetër, apo duhet që shpallja e pavarësisë, puna kryesore të kryhet në legjislacionin pas zgjedhjeve? Unë nuk mendoj se kjo është çështje e një grupi cilido dhe pa marrë parasysh se a është grup në cilin janë deleguar prerogativat tona të sovranit, por duhet të debatohet dhe të vendoset në nivelin themelor në Kuvend të Kosovës. Përgjigja në këtë pyetje nuk është unike nga Grupi i Unitetit, andaj mendoj se përgjigjen në këtë duhet marrë në nivel më të lartë sovran. A do ta quajmë prapë, po e përsëritëm, këtë çështje të Kuvendit, apo çështje të ndonjë këshilli kombëtar, kjo është çështje e cila duhet të debatohet në një rast tjetër, ndoshta në atë seancë permanente kushtuar statusit. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Teuta Hadri, le të përgatitet deputeti Ragip Zekolli

TEUTA HADRI – Të nderuar deputetë, i nderuari zoti Kryetar,

Çështja e pavarësisë së Kosovës dhe statusi i Kosovës janë çështje e të gjithë popullit të Kosovës. Për këtë ka dëshmuar edhe vetë populli i Kosovës me sakrificën dhe gjakun e derdhur për liri, pavarësi dhe shtet të Kosovës. Kjo nuk është çështje individi dhe nuk ka të drejtë askush të vendos pa dëshirën e popullit të saj. Po të ishte e drejtë demokratike dhe po të respektohej demokracia dhe e drejta e popujve për vetëvendosje, populli i Kosovës këtë do ta bënte moti me referendum. Këtë të drejtë demokratike e pamë, historia po na përsëritet dhe po kam frikë se mos po na ndodhë si në mbledhjen e Bujanit. Të mos lejojmë të vendosin individët, por ky Parlament,

Të nderuar deputetë,

Luftën nuk ka popull në botë që e do, nuk e deshëm as ne. E tha dikush këtu, na u imponua, jo vetëm që na u ka imponuar, por që 100 vjet ajo u planifikua, u organizua nga plan-programet e Serbisë për të bërë kundër popullit të Kosovës, dhe u bë. Kujtojeni kohën e para luftës së UÇK-së, vuajtjen e popullit të Kosovës, vrasjen e bijve tanë në armatën jugosllave, burgosjet e qindra bijve dhe bijave vetëm pse kërkonin liri, helmimet e fëmijëve shkollorë dhe parashkollorë, vrasjen e intelektualëve, të patriotëve, të njerëzve të ndershëm vetëm pse donin të luftonin për aspiratën e shtetit të Kosovës. Të gjitha këto vrasje u bënë nga një dorë kriminele e shtetit serb, për një gjenocid, për një shkatërrim, për një dëbim nga trojet e veta, çka Serbia arriti ta bëjë mu në qendër të

Evropës demokratike. Sa e sa rezoluta Këshilli për Mbrojtjen dhe të Drejtat dhe Liritë e Njeriut në Kosovë ka bërë për Kosovën dhe ka kërkuar nga ndërkombëtarët që të dalë nga ajo gjendje që ishte dhe ndërkombëtarët na premtë se do të na mbronin nga lufta dhe luftë nuk do të ketë në Kosovë, por vetëm negociata, por jo luftë në zemër të Evropës, se populli i Kosovës po të hynte në luftë do të jetë jo i barabartë në armatim. U treguam ndërkombëtarëve se kjo do të jetë luftë jo e drejtë, prandaj i lusim si anëtar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut të shteteve të Bashkësisë Evropiane ta ngritin zërin të mos ndodhte luftë në Kosovë. Për krimet e papara që bëri Serbia me agjiturën e vet e ngriti urrejtjen popullore dhe populli i Kosovës u detyrua ta ngritë armën për ta mbrojtur nderin dhe pragun e shtëpisë. Ne nuk shkuam për ta sulmuar Serbinë në Beograd, por mbrojtëm shtëpinë dhe nderin e popullit. Populli i Kosovës luftës së UÇK-së ia fali bijtë dhe bijat më të mira që luftuan dhe penguan shuarjen e këtij populli si konfiguracion dhe si i tërë në hartën e Evropës. Prandaj, falë sakrificës dhe gjakut të këtyre bijve, arritëm t'i bindim edhe ndërkombëtarët për të na ndihmuar në luftën për mbrojtjen tonë, çka edhe u bë. Me ndihmën e tyre arritëm fitore dhe lirinë tonë nga një gjenocid prej një shteti fqinj. De fakto, pavarësia e Kosovës u arrit në luftën e UÇK-së më 1999, por pas tetë vjetësh ende de-jure ajo nuk u arrit. Populli i Kosovës ende nuk u ka bërë asnjë kundërshtim deri me tani politikave dhe programeve të ndërkombëtarëve, nuk i ka kundërshtuar asnjëherë. Atëherë pse po zgjatë pavarësia dhe shteti i Kosovës de-jure. Njohja dhe ndihma e ndërkombëtarëve u bë jo pse Kosova ishte simpatike dhe e donin, por se Kosova ishte i vetmi shtet në botë që i mbronte demokracinë dhe frytet e demokracisë me luftën e saj. Prandaj SHBA-ja dhe BE-ja mbrojtjen Kosovën se ata i mbrojtjen të drejtat elementare të demokracisë, se të drejtat elementare të demokracisë duhen të mbroheshin ngas shtet më të fuqishme demokratike siç ishte SHBA-ja dhe BE-ja. Por të mbrohej kjo luftë demokratike në botë, demokracia në botë do të përmbysë.

Nuk më çuditë Rusia dhe vota e saj, se Rusia mban peng pavarësinë e Kosovës se përmes pavarësisë së saj ajo do t'i zgjerojë pozicionet e saj dhe ta rikthejë simpatinë e ish- shteteve prezentë të bllokut socialist. Nuk mendon fare për Serbinë dhe për Kosovën Rusia, po për vete dhe fuqizimin e saj. Prandaj, deputetë jemi në ky Parlament që edhe de-jure do ta bëjmë ta njohin statusin tonë, po të jemi unik dhe të bashkëveprojmë sinqerisht me ndërkombëtarët se me njohjen tonë, ata do t'i njohin edhe ligjet e veta demokratike që ne po i mësojmë nga ata. Prandaj, po ta njohin shtetin e Kosovës ata do ta mbrojnë demokracinë në Evropë. Pa njohjen e shtetit të Kosovës Evropa nuk do ta jetë demokratike. Edhe këto 120 ditë do të jetë teste për ndërkombëtarët e jo për kosovarët. Prandaj, e mbështes edhe propozimin e zotit Hamiti kur tha të dihet fillimi i 120- ditëshit, se fundi dihet. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Fjalën e ka deputeti Ragip Zekolli, le të përgatitet Gjylnaze Sylja, një sqarim e ka.

RAGIP ZEKOLLI – Ju faleminderit zoti Kryetar, i nderur Grup i Unitetit, të nderuar kolegë,

Edhe pse vërtet jemi mjaft gjatë, unë nuk dua ta zgjas shumë. Nën një dua ta paraqes një çështje që vërtetë është mjaft e ndjeshme kohëve të fundit e pak u përmend këtu. Gjithmonë po thirrmi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mirëpo është rreziku i bartjes së këtyre kompetencave nga amerikanët te evropianët dhe do të ishte mirë që vërtet në këtë drejtim të punohet sa më shumë.

Çështja e dytë, që mendoj se e zuri në gojë presidenti i Kosovës edhe e falënderoj, e që nuk u përmend shumë pak është çështja e të pagjeturve që gjithmonë po mbetet peng. Nuk do të ishte mirë që kjo çështje të mbetet çështje e dialogut teknik po vërtetë të bisedohet se është pjesa më e dhimbshme që vërtet nëse nuk zgjidhet në Kosovë, familjarët do të kenë një pozicion tejte të rëndë.

Nën tre, po i referohem deklaratave të fundit të Human Rights Watch - organizatës më të njohur amerikane ku flet për këtë çështje dhe emërimi i Këshillit për krimet e luftës. A llogaritni që ende atë këshill e udhëheqin njerëzit të cilët kanë qenë të implikuar në konflikte. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Urdhëroni Gjylnaze, një sqarim.

GJYLNAZE SYLA – Ju faleminderit zoti Kryetar,

Dëshiroj të sqaroj propozimin tim lidhur me Asamblenë Parlamentare se më duket se ministrja nuk e pat të qartë. Ideja e propozimit tim ishte që të formohet një trup, natyrisht nga Kuvendi i Kosovës dhe nga deputetët e Kuvendit të Kosovës, të cilët kanë vullnet të mirë për t’iu bashkëngjitur këtij trupi. Ideja pse ia kam dhënë asamblenë është se me qenë më e madhe se një komision ose më i madh se një grup punues dhe me pas sa më shumë përfaqësues nga secili grupacion. Natyrisht një ndër rolet e këtij trupi do të ishte monitorimi i procesit ose i rrjedhës së statusit. Unë desha vetëm me e dhënë një sqarim të shkurtër lidhur me këtë. Ky trup do të punonte në vetë përgatitjen e deklaratës së pavarësisë jo me vendos ndonjë afat kohor, po ka të bëjë më tepër me cilësinë e shpalljes, natyrisht në kuadër të Kuvendit gjithnjë. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ramadan Kelmendi, le të përgatitet deputeti Fehmi Mujota

RAMADAN KELMENDI - Ju faleminderit! I nderuari President, i nderuari Kryetar i Kuvendit të Kosovës, të nderuar anëtarë të Grupit Negociator, të nderuar deputetë dhe të pranishëm të tjerë,

Vlerësimi im lidhur me shtyrjen e statusit për Kosovën shtet i pavarur fillon me mendimin e patriotit Hasan Prishtina thënë në rrethana politike shumë të rënda për popullin shqiptar, pikërisht në prag të ndarjeve territoriale dhe gllabëruese të hapësirës gjeografike dhe etnike të shqiptarëve. Në vitin 1911, citoj: “Shteti nuk bëhet lehtë. Për ta bërë shtetin nuk ka përlujt as lëshime. Shteti bëhet me popull, natyrisht i ndihmuar edhe nga miqtë e vërtetë siç i kemi ne sot, por shteti nuk bëhet duke marrë nga shteti, por duke shkrirë krejt dijen, pasurinë dhe guximin për shtetin. Shteti nuk mbahet me

familje, me të njohshëm me të pashkolluar. Shtetin e mbajnë të diturit, të guximshmit, sakrifikuesit dhe atdhetarët”, mbaron citati. Sikur këto vlerësime gjeniale janë shumë aktuale edhe sot për shqiptarët, e kjo do të thotë se ne pasi t’i kryejmë punët, shikojmë se a i kemi kryer punët mirë për shkak se nuk planifikojmë punën që duhet kryer, sikur që nuk planifikuam pavarësinë në këto rrethana politike, sepse planifikimi që duhet kryer mungoi gjatë rrugëtimit tonë, duke harruar qëllimin kryesor, duke mos menaxhuar situatën politike në raport me qëllimin madhor dhe duke nënçmuar palën biseduese apo kundërshtare.

Grupi i Unitetit sikur harroi kërkesën e 96% të popullit të Kosovës për pavarësi, mosndarjen e saj, Rezolutën dhe vendimet e këtij Kuvendi, Rezolutën dhe vendimet e Kuvendit të mëparshëm të Republikës së Kosovës. Dhe, në fund, duke mos mundur ta mbrojmë as dokumentin e Ahtisarit, i cili më së paku ofroi një pavarësi të mbikëqyrur. Të gjithë duhet ta kemi të qartë se situata e tanishme që mbretëron në Kosovë, me humbjen e besimit të qytetarit në institucionet vendore dhe qendrore, situata nuk mund të mbetet gjatë e kontrolluar. Nga bisedimet e mëtutjeshme me Serbinë kemi humbur çdo arsyetim sikur edhe faktin se shqiptarët po ta kishin forcën, drejtësinë do ta gëzonin dhe do ta realizonin para 100 vjetësh dhe në këtë mënyrë edhe tani pikërisht e drejta jonë përsëri mposhtet nga forcat e padrejta.

Në opsionin politik po luhet loja e rrezikshme dhe Grupi i Unitetit në shumicën e rasteve vëzhgon këtë lojë dhe nuk po ecën me hapat e lojës diplomatike- politike me projektet e veta konkrete të padiskutuara për pavarësinë. Në popull është krijuar opinionin se kjo klasë politike që nga niveli lokal e deri te ai qendror sikur nuk e shohin nevojën për shtetin e pavarur, por vetëm angazhohen për pushtetin inekzistent sikur që pushteti nuk mund të ushtrohet mbi tërë Kosovën dhe në veçanti mbi pjesën veriore. Ekipi i Unitetit e ka adutin më të fortë për mbrojtjen e pavarësisë së Kosovës dhe popullin e saj, i cili është këmbëngulës në të drejtën legjitime të bazuar në të drejtën ndërkombëtare dhe atë natyrore për pavarësi, të drejtë të cilën fuqishëm e përkrahin edhe boshnjakët, turqit, ashkalinjtë, romët, egjiptasit e të tjerët. Mbetja peng e pavarësisë së Kosovës nga ana e Rusisë do të krijojë kushte reale që procesi politik mund të dalë jashtë institucioneve të Kosovës, ngase është humbur besimi në to e kjo mbjell krizë politike, ekonomike, sociale, qeveritare dhe kuvendare. Grupi i Unitetit patjetër duhet të rikonfirmojë me gojën e Kuvendit shtetësinë e Kosovës, miratimin e Kushtetutës së shtetit të Kosovës, aprovimin e simboleve të shtetit të Kosovës, nxjerrjen e Ligjit zgjedhor, miratimin e masave urgjente për ruajtjen stabilitetit ekonomik, politik dhe social si dhe ofrimin e të dhënave konkrete mbi situatën e Veriut të Kosovës dhe në veçanti për statusin juridik dhe politik të Mitrovicës. E pohoj këtë sepse në Kosovë e kaluara ka dëshmuar se 8 deri 10 vjet mbretëron heshtje e thellë dhe pas kësaj periode heshtjeje shpërthejnë vullshëm si vullkan pasojat që shkaktojnë trauma të mëdha dhe kërkojnë sanime afatgjate.

Shtyrja e pavarësisë së Kosovës është peng dhe cungim i ideve shekullore, i të drejtave legjitime dhe i mohimit të të drejtave universale shqiptare në Kosovë, është mohim i demokracisë së arritur, është mohim i kontributit të Grupit Negociator dhe të institucioneve të Kosovës dhe të Bashkësisë Ndërkombëtare. Shtyrja e pavarësisë së Kosovës, po vërehet për të satën herë, se të tjerët nuk e duan stabilitetin në rajon, andaj

duhet thënë publikisht se shqiptarët dëshmuar gatishmërinë për stabilitet rajonal, i cili po shihet se nuk varet nga shqiptarët, por nga politika hegjemoniste serbe. Të themi të vërtetën se në procesin e pavarësisë ka fajtor, e ai në një pjesë është vetëm Grupi Negociator për faktin se deri dje paska mbjellë optimizëm pa mbulesë, ndërsa tani deklaroi pamundësi.

Opsioni politik na thotë se qenka plani B, i cili nënkupton shpalljen e njëanshme të pavarësisë së Kosovës. Dua ta them me modestin më të madhe, por një të vërtetë të padiskutuar, se edhe unë jam një ndër ata 11 deputetë që në vitin 1990 bëmë aktin e shpalljes së pavarësisë para të gjitha ish republikave të Jugosllavisë. Aktin e bëmë pa flamur, pa himn, pa stemë, pa kushtetutë, por para tankeve dhe policisë pushtuese serbe dhe, fatkeqësisht, askush nuk na njohu, nuk na pranoi si shtet, ndonëse akti shënoi një datë të rëndësishme historike të shtetbërjes së Kosovës. Unë mendoj se nuk duhet të na përsëritet situata përdërisa nuk kemi përkrahjen nga miqtë tanë, në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe nuk i kemi simbolet e shtetit të Kosovës dhe atributet e lartcekura.

Tani çështja e Kosovës ka kaluar në vendosjen e institucioneve ndërkombëtare dhe evropiane në mes të Amerikës dhe Evropës. Në këtë lojë të madhe, e cila mund të vazhdojë, natyrisht ne kemi besim, shpresë tek miqtë tanë se nuk do të na lënë në këtë situatë të padëshiruar dhe nuk do të na ricopëtojnë trojet tona. Në këtë situatë patjetër duhet dëgjuar zëri i popullit shumicë, i artikuluar përmes institucioneve të Kosovës, Kuvendit të Kosovës, duke i sjellë vendimet tona, sepse ato nuk do të na sjellë askush tjetër përveç miqve tanë duke i përkrahur dëshirat tona të cilat duhet t'i themi haptas. Unë nuk kam qëllim të akuzoj Grupin e Unitetit, por ekzistimi dhe funksionimi i tij i mëtutjeshëm përballë institucioneve të dala nga vota e lirë dhe demokratike të popullit është i paarsyetuar tani e tutje në aspektin juridik, politik dhe financiar. Është koha që brenda 120 ditësh i tërë mekanizmi institucional, akademik, politik, profesional të kenë veprimtari të qartë konkrete, jo për të vajtuar të shkuarën e kritikuar njëri tjetrin, por për të prezantuar zgjedhje konkrete në mbrojtjen e pavarësisë së Kosovës.

Po përfundoj se ne e kemi të qartë se kush e pengon procesin e pavarësisë së Kosovës, kush është fajtor sikurse që me të drejtë pohojmë se aspirata jonë nuk mund të shtyhet në pakufi, sepse formula e shtyrjes është gabim, është dështim, është në kundërshtim me ardhmërinë politike, juridike dhe atë ndërkombëtare të Kosovës dhe të rajonit ngase shteti nuk është krijesë magjike, krijesë shoqërore dhe ne si shoqëri, shqiptarët duhet të jemi të organizuar në truallin tonë historik me kufijtë e njohur, duke e bërë shtetin për nevojat tona dhe jo të atyre të dëshirojnë të na bëjnë të robëruar nën ombrellën e një shteti që bëri gjenocid mbi një shekull. Duke përfunduar këtë, më lejoni të konstatoj se asamblatë parlamentare dhe Grupi i Unitetit tani e tutje kanë humbur arsyen. Fuqizimin duhet ta marr Kuvendi, Kryeministri dhe institucionet që janë nën ombrellën e tij dhe Presidenti i Kosovës. Vetëm në këtë mënyrë me një platformë të cekur më lartë ne mund të hyjmë në fazën e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Fehmi Mujota, le të përgatitet deputeti Xhelal Canziba.

FEHMI MUJOTA – Zoti kryetar,
Zoti Kryetar i Kosovës Sejdiu,
Zoti Kryeministër Çeku,
Zoti Surroi,
Zoti Thaqi dhe ju ministra prezentë, kolegë deputetë dhe deputete,

Kemi dëgjuar mendime racionale e irracionale politike, do të thoja, në këtë moment kaq të ndjeshëm politik për Kosovën, kemi dëgjuar edhe mendime shumë pozitive edhe prej atyre që japin kurajë për të ecur më tutje, kemi dëgjuar edhe mendime të cilat ndonjëherë kanë pasur edhe ngjyra të frustrimit politik, por gjithsesi është e mirë që kemi një debat të hapur në Parlamentin e Kosovës për një çështje kaq jetike dhe një moment në të cilin të gjithë po e vlerësojmë si mjaft delikat dhe jo vetëm ne, por edhe Bashkësia Ndërkombëtare dhe bota demokratike.

Më lejoni që në fjalën time të përqendrohem në disa nga çështjet të cilat meritojnë vëmendje.

E para, duhet të ndalemi tek përkrahja e propozimit të Ahtisarit nga Kuvendi i Kosovës dhe arsyet pse kemi përkrahur një propozim të tillë si Kuvend i Kosovës. Duhet të ndalem tek dokumenti që është cilësuar si balancuar dhe pse është cilësuar si i balancuar. Duhet të ndalem tek parimet e Grupit të Kontaktit dhe pse këto kanë një peshë të rëndësishme në këtë moment në të cilën po diskutojmë. Duhet të ndalemi mandej te ekuilibri dhe qëndrueshmëria e kufijve në Ballkan dhe reciprociteti për të drejtat etnike në rajon. Duhet të kemi një obligim tjetër shtesë për zbatimin e atyre obligimeve që u takojnë institucioneve të Kosovës dhe për të cilat jemi zotuar dhe duhet të zotohemi në vazhdimësi, jo vetëm në kuptimin teorik, por edhe në veprimin praktik, pastaj duhet të ndalemi paksa në ato 120 ditët e përmendura për negociata shtesë apo dëshmi shtesë për pavarësinë e Kosovës.

Sikur që duhet të kemi edhe një vëmendje tjetër se çka në këtë rast nuk duhet të negociohet dhe çka mund të kemi për materie diskutimi dhe negocimi në ditët në vijim.

Një tjetër çështje që është mirë të përmendet është ajo se zgjidhjet në parimin etnik nuk janë zgjidhje të cilën e ka ofruar Kosova dhe pse jo të kemi parasysh edhe vet faktorët tjerë relevantë brenda Kosovës për funksionimin më tutjeshëm të institucioneve tona, të respektojmë natyrisht kohezionin e punës së Grupit të Unitetit dhe, pse jo, edhe të vlerësojmë këtë angazhim me gjithë diversitetin dhe kundërthëniet e mundshme të natyrave politike, por edhe natyrave funksionuese në këtë periudhë kohore të rëndësishme.

Të ndalem shkurtimisht në secilën prej tyre. Të nderuar kolegë, plani i Ahtisarit dhe propozimi i këtij plani para Këshillit të Sigurimit nuk ka ardhur si një vendim ad-hoc. Ka ndodhur pas një periudhe të gjatë kohore negocimi, dëshmimi në kuptim të brendshëm dhe në kuptim ndërkombëtar. Natyrisht që, të vetëdijshëm për të gjitha ato lëshime në kuptim kompromisi brenda pakos së Ahtisarit, që nuk kanë bazë ose nuk kanë parime universale ndërkombëtare, që nuk janë bazuar në kriteret dhe, natyrisht, edhe në të gjitha

standardet e tjera ndërkombëtare të pranuara, ashtu siç veprohet me shtetet tjera, na ka bindur të gjithë neve se Kosova po bën një rrugë të vet të veçantë drejt njohjes ndërkombëtare. Pra, trajtimi i çështjes si sui-generis për trajtimin e mëtutjeshëm të mekanizmave ndërkombëtarë të statusit të Kosovës. Me këtë ka pasur edhe një trajtim sui-generis për të drejtat e pakicës serbe në Kosovë dhe këto të drejta dhe këto rrugë të cilat ne i kemi proklamuar, i kemi dëshmuar dhe në një mënyrë apo tjetër i kemi negociuar në tryezën e negocimit, del që alternativë nuk ka përveç pavarësisë si zgjidhja e vetme në Kosovë. Pse, do të thoja se nuk ka alternativë tjetër pos pavarësisë në Kosovë?

Meqë në kuadër të parimeve të Grupit të Kontaktit kanë ekzistuar si parime të vendosura, jo ndarje, jo bashkim me një vend tjetër, jo kthim në vitin 1999, kjo nënkupton që pakoja e Ahtisarit ka pasur për rrjedhojë pavarësinë e mbikëqyrur për një periudhë kohore për të ofruar stabilitet dhe për të ofruar respektim të të drejtave të pakicave në Kosovë. Mbi bazën e këtyre tri parimeve të Grupit të Kontaktit del që pavarësia e Kosovës nuk ka alternativë dhe projektet e tjera që mund të hapen dhe Ekipit të Negocimit i duhen shumë në periudhën e ardhshme kohore, duhet të respektojnë këtë fakt. Meqë Kosova nuk ka ofruar zgjidhje në parimin etnik, atëherë kushdo që hap këtë çështje duhet të bëjë me dije se Kosova nuk është ajo që do bartë me çdo kusht në kurrrizin e vet edhe këtë lëshim.

Duhet të manifestojmë fuqishëm dhe me një agresivitet dëshmimi para Bashkësisë Ndërkombëtare, në këtë rast në një format tjetër të negocimit, se Kosova është e orientuar dhe është e përqendruar dhe është e angazhuar që saktësisht të realizojë pavarësinë e Kosovës duke njohur të drejtat e pakicës në kuptimin civilizues. Nuk guxojmë të jemi normativistë dhe të dalim e të mendojmë dhe të flasim për gjërat të cilat në një mënyrë apo një tjetër nuk funksionojnë në Bashkësinë Ndërkombëtare dhe në kuadër të drejtës ndërkombëtare.

Të lidhemi shumë për parimin tonë të drejtë që kemi të drejtë për të qenë shtet, të kemi parimin përkatësisht faktin historik para vete, të kemi faktin e realitetit të krijuar dhe pse jo edhe faktet juridike. Mbi bazën e këtyre tri fakteve ne mund të dalim si dëshmues të fuqishëm se pavarësia e Kosovës nuk ka alternativë. Në të kundërtën, Grupi i Kontaktit do të hiqte dorë nga parimet e veta dhe heqja dorë nga parimet e veta, Grupi i Kontaktit do të hapte opsione të tjera për të cilat Kosova duhet të jetë e përgatitur. Ne nuk dëshirojmë që të kemi një trajtim tjetër për pakicën etnike serbe në Kosovë dhe për pakicën shqiptare nëse jeton në Serbi apo diku tjetër. Realisht, këtu duhet të kenë vëmendje të gjithë aktorët, por edhe të gjithë faktorët relevantë ndërkombëtarë që vendosin për këtë çështje bashkë me popullin e Kosovës dhe institucionet e Kosovës, që vendet e rajonit duhet të kenë një kujdes të veçantë që të mos futen në një drejtim të cilin me siguri nuk e dëshirojnë as vetë ato, por në të kundërtën do të futeshin në një përkrahje të një opsioni të cilin më së paku kanë arsye shqiptarët e Kosovës dhe qytetarët e Kosovës të mos e përkrahin. Pra, nuk është Kosova ajo që frikohet nga shtrirja gjeografike dhe etnike, por ne duhet të përqendrohemi në parimet e vendosura në Grupin e Kontaktit dhe bashkërisht me këtë duhet ta përmbylim këtë proces.

Të nderuar kolegë,

Grupi i Unitetit ka një vlerësim jashtëzakonisht pozitiv si në arenën ndërkombëtare, si në arenën e brendshme, me gjithë kundërshtitë dhe mendimet ndryshe që i kemi dëgjuar këtu. Cila do të jetë arsyeja që unë do të nxjerrë në këtë rast? Po të mos kishim një grup të tillë funksionues dhe në këtë rast do të veçoja rolin jashtëzakonisht konstruktiv të opozitës, dikush do të thoshte me që ju jeni nga opozita tani po e bëni këtë, jo. Parimisht po them. Në pozitën që është ndodhur Kosova pa një rol konstruktiv të opozitës nuk do të kishim funksionim të mirëfilltë drejt rrugës që po na ndjek në përcaktimin e statusit për Kosovën. Natyrisht, edhe pa një pranim të mirë të pozitës në raport me opozitën për këtë çështje ne do të kishim dëmtuar kapacitetet tona negociuese dhe kapacitetet e tjera të nevojshme në këtë fazë. Por, momentet e ardhshme do të përcaktojnë diçka tjetër dhe ne do të bindemi se asnjëherë në Kuvendin tonë opozitë më konstruktive s'kemi për të pasur. Dëshiroj të kemi, por megjithatë për hir të statusit, opozita ka qenë jashtëzakonisht konstruktive dhe ka luajtur rolin e vet pozitiv. Unë besoj në këtë, prandaj edhe do ta dëshmojë vlerësimi i mëvonshëm.

Një çështje tjetër që dua të ngris në këtë moment është kjo: Në planin e Ahtisarit duhet të presim një sulm agresiv të palës serbe, në planin e Ahtisarit do të presim një sul agresiv, ndërsa politika e Kosovës në raport me Bashkësinë Ndërkombëtare do të ketë një agresivitet dëshmues në të kundërtën e saj. Pika kritike në të cilën jemi vendosur ne është pikërisht pranimi i planit të Ahtisarit. Ndërsa pika maksimaliste për të gjithë ne dihet se është kompromisi për pavarësinë e Kosovës dhe rrugët që qojnë më tej. Prandaj, në raport me Bashkësinë Ndërkombëtare duhet të kemi jashtëzakonisht kujdes që pikën kritike të një vlerësimi real të gjendjes në Kosovë e kemi bërë, ndërsa të gjitha çështjet e tjera mund ta defunksionalizojnë e të mos e bëjnë të realizueshëm një plan të tillë. Për të gjitha pikat e tjera të cilat mund t'i hapë dikush tjetër në tavolinën e negociimit kemi faktet tona argumentuese, si në parimin etnik, si dhe në parimet të tjera për të cilat besoj se gjithë ne jemi koshientë.

Të nderuar kolegë,

Është koha me siguri që të kemi një racionalitet politik me veprim praktik. Pa veprim praktik do të humbet edhe vlera edhe forca e racionalitetit politik. Unë besoj shumë, sikur që besoni edhe të gjithë ju, se kemi një obligim që të jemi përfaqësues të denjë të qytetarëve të Kosovës për të realizuar të gjitha qëllimet tona politike dhe para së gjithash të drejtën tonë politike. Nuk do të dëshiroja të lëshojmë nivelin tonë për të thënë që ne po realizojmë një ëndërr tonën. Ne nuk kemi parë asnjëherë ëndërr për një diçka që nuk është e jona, ne kemi të drejtë, kolegë të nderuar, kemi të drejtën tonë historike, juridike dhe faktike për të qenë shtet i pavarur dhe sovran dhe mbi bazën e saj jemi të gatshëm dhe duhet të jemi të gatshëm në çdo kohë të ballafaqohemi me çdo aleatë tonë bashkëpunues.

Dhe, krejt në fund, për të mos ndodhur diçka që nuk kisha dëshiruar... do ta bëj me këtë rast në formë ofendimi duke lavdëruar së tepërmi Bashkësinë Ndërkombëtare, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian në veçanti, do të thoja se Kosova me institucionet e veta do të jetë partner i vazhdueshëm konstant dhe i

qëndrueshëm deri në realizimin e pavarësisë së Kosovës dhe marrjes së obligimeve pas pavarësisë së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputet Xhelal Canziba.

XHELAL CANZIBA – Faleminderit Kryetar,
Të nderuar anëtarët të Grupit të Unitetit,
Të nderuar kolegë deputetë,

Procesi politik për statusin e Kosovës nuk ka lëvizur nga vendi dhe as që shihet që do të lëvizë edhe disa javë, jo pa e qartësuar pozitën që do ta ketë Rusia brenda Grupit të Kontaktit. Derisa nuk qartësohet roli i Rusisë, procesi asnjëherë nuk do të mund të ecën përpara ose do të lëviz me shumë vështirësi duke u shantazhuar dhe rrezikuar zgjidhja dhe përsëri do të kërkohet të fillojë çdo gjë nga e para. Çfarë duhet bërë. Do të provojmë të jemi hartues të politikave dhe jo vetëm konsumues apo zbatues të tyre.

Liderët politikë të Kosovës duhet ta kenë agjendë të qartë. Kosova duhet të paraqesë një plan për të ardhmen e saj. Nuk duhet pritur gjithnjë që të tjerët të na tregojnë rrugën. Edhe ne mund t'u tregojmë atyre se nga duhet të vinë në fund të procesit. Nuk duhet të na prijë procesi politik dhe të na shndërrojë në ekzekutues të tij. Duhet t'i paraprijmë këtij procesi. Me këto sjellje prej të dëgjueshmëve të urtë çfarë mund t'i ofrohet si perspektivë procesit politik në Kosovë dhe qytetarëve të saj. Nëse nuk kemi një agjendë, atëherë shumë e qartë se duhet nënshtruar asaj ndërkombëtare. Për dy dekada ne iu nënshtruam kësaj agjende. Asnjëherë nuk u bënë llogaritë se ku ishte gabimi që nuk u realizua kjo agjendë e Bashkësisë Ndërkombëtare, as kjo e fundit e Presidentit Ahtisari. Liderët politikë të Kosovës kurrë nuk kanë qenë hartues dhe bartës të proceseve politike të dala prej tyre, por vetëm ekzekutues të politikave ndërkombëtare.

Është çështja tjetër se a pajtohen apo jo ndërkombëtarët, por është e sigurt se edhe ata kur e shohin vendosmërinë tonë sigurisht se do të na mbështesin në agjendën tonë. Deri tani nuk kemi parë një plan konkret nga Grupi i Unitetit se si ata e kanë menduar realizimin dhe funksionimin e kësaj pavarësie. Nuk mund ta bindësh Bashkësinë Ndërkombëtare me fjalë, nuk bindet ajo vetëm me dëshirën tonë se duam pavarësi. Disa herë ditëve të fundit kemi dëgjuar se si deklarohet nga këto adresa se plani i Ahtisarit do të jetë bazë për bisedime. Kjo është kuptuar sikur Kosova e paska garantuar pavarësinë, siç po thuhet, aspak bindëse sepse pakoja e Ahtisarit nëse është bazë e qartë, shumë janë bërë lëshime në të, do të thotë se fundi i ardhshëm i negociatave apo ai far kompromisi që po kërkohet, do të jetë edhe më i keq dhe edhe më shumë në disfavorin tonë. Do të thotë se duhet rënë edhe më poshtë se kjo pako. Ata tani e kanë të qartë se pala shqiptare mbron pakon e Ahtisarit që ofron pavarësi të mbikëqyrur. Përmendet pakoja e Ahtisarit si bazë për negociatë të reja dhe si pikë ku mund të gjendet kompromisi në bisedimet e ardhshme. Duhet pasur parasysh se asgjë nuk do të hiqet nga ajo që është dhënë serbëve. Përkundrazi, ata do të fitojnë ende më shumë. Në anën tjetër, do të kërkohet që pala shqiptare të heq dorë edhe më tutje nga disa parime apo qëndrime që ka mbajtur deri më tani. Prandaj, Kuvendi i Kosovës duhet të jetë i përgatitur për shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Faleminderit!

Diskutim i bashkangjitur
QIBRIJE HOXHA-

I nderuari Kryetar

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju të pranishëm të tjerë,

Nuk po them asgjë të re kur them se shtyrja e këtij ankthi të mundimshëm të statusit të Kosovës, është pik së pari në dëm të qytetareve të Kosovës, pastaj në dëm të stabilitetit të gjithë regjionit dhe doemos ky status quo dëmton edhe vendet mike demokratike, të cilat investuan dhe vazhdojnë të investojnë për ndërtimin e shtetit demokratik në Kosovë.

Është shumë i qëndrueshëm vlerësimi se Kosova është sui generis në disa aspekte, si në aspektin historik të së kaluarës, si vend dhe popull i okupuar nga Serbia, që janë një popull tjetër, me kulturë, histori gjuhë dhe mentalitet krejt tjetër nga shqiptarët të cilët jemi autokton dhe me prejardhje të njohur ilire.

Aspekti tjetër për veçantinë e Kosovës është edhe organizimi i shqiptarëve që u bë së bashku me minoritete tjera, për organizim të veçantë shtetëror e institucional, nga ai i regjimit okupues serb. Ky organizim u bë me shumë sakrifica, por me realizim demokratik të zgjedhjeve, zgjedhjes së Presidentit, krijimit të institucioneve, shpalljes së Deklaratës Kushtetuese dhe shpalljes së pavarësisë me referendum, të gjitha këto në kushte okupimi. Këtij organizimi institucional dhe demokratik të qytetarëve të Kosovës, regjimi okupues serb iu përgjigj me masakra dhe gjenocid, gjë që rezultoi me dhjetëra mija viktima. Kurse populli u organizua me vetëmbrojtje të organizuar ushtarake.

Kosova është sui generis edhe në rastin e intervenimit të forcave të NATO-s mbi caqet e makinerisë vrastare të forcave okupuese serbe me kërkesën dhe lutjen për ndihmë të qytetareve të Kosovës drejtuar NATO-s, SHBA-ve dhe miqve në Evropë.

Kosova është sui generis edhe sa i përket kthimit të gati 1 milion kosovarëve në shtëpitë e tyre mbas hyrjes së forcave të NATO-s në Kosovë.

Kosova është sui generis edhe për shkak se sot de fakto po funksionon e pavarur nga judikatura dhe sistemi shtetëror serb dhe po formësohet si shtet me ndihmën e demokracive botërore që janë prezentë edhe fizikisht në Kosovë në krye me SHBA-të. por megjithatë de jure, çuditërisht po mbahet peng nga Rusia dhe Serbia në aspektin e së drejtës për të jetuar në Liri, edhe de jure.

Me fjalë të tjera, Serbia dhe Rusia po e pengojnë njohjen formale të pavarësisë së Kosovës. Është paradoksale se këto dy shtete po përkrahen edhe nga disa vende, të cilat në fakt së bashku me vendet e tjera që gjenden në Kosovë, po e ndihmojnë Kosovën në ndërtimin e sistemit shtetëror demokratik.

Kjo zhagitje e njohjes formale të pavarësisë së Kosovës po i pengon qytetarët e Kosovës të punësohen, të sigurojnë ekzistence për familjet e veta. Ky frenim i njohjes së

pavarësisë së Kosovës pengon funksionimin normal të arsimit dhe të shëndetësisë. Mosnjohja e pavarësisë së Kosovës, nuk lejon investime të institucioneve monetare ndërkombëtare si dhe të atyre që janë të interesuar për të investuar këtu.

Derisa në njërin anë Kosova me ndihmën e vendeve demokratike po ecën me hapa të sigurt drejt funksionimit demokratik si të administratës, të institucioneve, po ashtu edhe të shoqërisë civile, në anën tjetër mosnjohja e pavarësisë së Kosovës po e mban peng zhvillimin ekonomik dhe po krijon ditë për ditë gjendje më të vështirë sociale.

Kjo nuk mund të shpjegohet ndryshe por vetëm si përpjekje të destabilizimit të Kosovës dhe të rajonit si dhe instalim të vlerave antidemokratike nga ana të atyre që janë kundërshtarë të pavarësisë së Kosovës.

Për fund, desha të them se, Kosova ende mund të trajtohet si sui generis në arenën politike-diplomatike ndërkombëtare, por e drejta për të vendosur për fatin e vet, që konsiston në të drejtën elementare të njeriut, është e padrejtë të trajtohet si sui generis, për shqiptarët shumicë dhe për të gjithë ata që e duan Kosovën si shtet të vetin dhe që dëshirojnë të jetojnë në Kosovë.

Status quo-ja e gjatë , tri gjëra nuk i ndryshoi në mendjen dhe shpirtin e qytetarëve të Kosovës, e këto janë:

1. Besimi në Zot,
2. Besimi në SHBA, dhe
3. Vendosmëria për shtetin e pavarur dhe demokratik të Kosovës.

Këto ishin vizioni dhe angazhimi i Presidentit Ibrahim Rugova dhe mbeten përcaktim dhe synim i institucioneve dhe të përfaqësuesve të popullit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Para se ta marrin fjalën përfundimtare anëtarët e Ekipit, ka kërkuar fjalën Jakup Krasniqi.

JAKUP KRASNIQI – Zoti Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Se është dashur të jetë një debat, mendoj që ky debat që u zhvillua sot vërtetoi se është dashur. Ne kërkesën e kemi pas bërë që ky debat të zhvillohej më herët, por pasi ekziston një fjalë e jona popullore, më mirë vonë se kurrë, mendoj se ishte i nevojshëm që ky debat të zhvillohej edhe sot.

E përshëndes gatishmërinë e Grupit Negociator, edhe pse nuk kemi pas kërkuar në kërkesën tonë për të ardhur në këtë seancë të debatit. Ne do të kërkonim dhe do të dëshironim njëkohësisht që Grupi Negociator të vinte më shpesh në Parlament, por me qëndrime të harmonizuara dhe veprime e vendime të përbashkëta.

I përshëndes të gjithë ata që morën pjesë në debat dhe mendoj që i dhanë kuptim këtij debati, por kisha kërkuar që askush nga ne mos ta kuptojë debatin si uniformë të mendimit, qoftë edhe të veprimit, por ta kuptojë debatin edhe atëherë kur është i kundërt, edhe atëherë kur është mbështetës, edhe atëherë kur mund të mos pajtohem me debatin apo diskutimin e ndonjë parlamenti. Në fund të fundit, Parlamenti ka kuptim debatin.

Unë nuk dua të zgjatem shumë, por duke u konsultuar me shumicën e shefave të grupeve parlamentare në Parlament, kemi ardhur në disa përfundime që ndoshta nuk e përmbushin tërë vullnetin tonë ose vullnetin e gjithsecilit, por jemi përpjekur që të vijmë në disa përfundime që mendoj se janë të rëndësishëm për procesin që është në vazhdim. Kemi ardhur në tri përfundime që mund t'i jenë edhe si rekomandime, por edhe si qëndrime të Kuvendit të Kosovës.

1. Kuvendi i Kosovës, sot në këtë debat, konfirmoi fuqishëm Rezolutën e 17 Nëntorit 2005, kurse nga Grupi Negociator kërkojmë që t'i përmbush obligimet që dalin nga kjo Rezolutë.
2. Kuvendi i Kosovës do të jetë në seancë të përhershme për t'i përmbushur obligimet e veta për procesin politik në çdo kohë e pa procedura administrative, sepse nganjëherë këto procedura administrative vërtet po bëhen pengesë e punës sonë.
3. Kuvendi i Kosovës autorizon Grupin Negociator që të hartojë një platformë politike unike për përfundimin e procesit politik për shtet të pavarur dhe sovran, duke respektuar edhe kërkesat e këtij debati të frytshëm që ndodhi sot në Kuvendin e Kosovës.

Edhe njëherë, me vullnetin tim por edhe të deputetëve të Partisë Demokratike, kishim kërkuar dhe kishim dëshiruar që kjo platformë politike të jetë e miratuar në Kuvendin e Kosovës, kjo platformë politike të jetë unike dhe e obligueshme për të gjithë anëtarët e Grupit Negociator dhe që Grupi Negociator vërtet të përfaqësojë Kosovën institucionalisht, sepse mendoj që përfaqësimi që iu bë në takimin e fundit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishte më tepër një përfaqësim fisnor sesa institucional. Mendoj që duhet në këtë drejtim përfaqësimi i Kosovës në të ardhmen të jetë vërtet institucional. Ju faleminderit!.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Alush Gashi e ka fjalën.

ALUSH GASHI – Faleminderit, zoti Kryetar,

Mendoj se ka qenë një debat i dobishëm sot dhe fjala e Presidentit Sejdiu ka hasur në mbështetje të plotë për vazhdimin e këtij procesi në bashkëpunim të plotë me Bashkësinë Ndërkombëtare. Niveli i ndjenjës së përgjegjësisë në këto rrethana është i tillë që kërkon që ne të punojmë intensivisht së bashku aq sa të jetë mundur që procesi të ecën përpara.

Ne e mbështesim frymën e mbështetjes për Ekipin e Unitetit në këtë proces të rëndësishëm dhe përkushtimin e të gjithëve që të jetë një bashkëpunim i plotë dhe intensiv me Bashkësinë Ndërkombëtare në përmbyllje të këtij procesi.

Ne si Grup Parlamentar, duke i dhënë mbështetje fjalës së Presidentit dhe duke e rikonfirmuar gatishmërinë tonë për vazhdim të punës intensive në të gjitha nivelet, jemi të bindur se sa herë që të ketë nevojë të bashkëbisedohet në seancë plenare me Ekipin e

Unitetit, Ekipi i Unitetit do t'i përgjigjet kërkesës sonë dhe e mendojmë si mënyrë të mirë dhe efektive për fuqizim të punës së Ekipit të Unitetit si dhe të ecjes së procesit përpara. Ne jemi të bindur se me punën e përbashkët të të gjithëve në Kosovë, Kosova ka arritur që ta fitojë mbështetjen e Bashkësisë Ndërkombëtare për realizimin e vullnetit politik të qytetarëve të Kosovës. Paqja dhe pavarësia për të cilën ne angazhohemi është për të mirën e gjithë qytetarëve të Kosovës, për paqen në rajon. Ne kemi fituar të gjithë së bashku mbështetjen e gati të gjithë fqinjëve tanë dhe jemi shumë të interesuar që ta kemi mbështetjen edhe të atyre që ende nuk janë të gatshëm ta pranojnë realitetin e ri.

Gjatë këtyre viteve ne kemi mësuar dhe në bazë të asaj i japim mbështetje Presidentit dhe Ekipit të Unitetit që ta fuqizojë dëshirën tonë, e cila është dëshirë për një jetë të barabartë për të gjithë qytetarët e Kosovës. Insistimi që ne e kemi të gjithë së bashku për qartësim, respektivisht për pavarësi të Kosovës, është kontributi më i sigurtë për paqe në vend në një mirëqenie me fqinjët dhe mënyra më e mirë e falënderimit për Bashkësinë Ndërkombëtare për ndalje të gjenocidit në Kosovë dhe hapje të perspektivës zhvillimore për të gjithë të tjerët. Falënderimi më i mirë që ne mund t'i bëjmë botës së lirë që e ka shpëtuar Kosovën, është që ta ndërtojmë një demokraci të qëndrueshme në vendin tonë.

Andaj, zoti President, Grupi ynë Parlamentar e vazhdon mbështetjen e plotë për Delegacionin e Unitetit dhe për bashkëpunim me Bashkësinë Ndërkombëtare. Ju faleminderit!.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e kanë anëtarët e Grupit të Unitetit. Ftoj zotin Surroi ta marrë fjalën.

VETON SURROI – Faleminderit, zoti Kryetar,

Pesë pika me të cilat shpresoj të rikonstatoj çka kam dëgjuar këtu:

Pika e parë është se kemi hyrë në një fazë tjetër dhe këtë fazë tjetër e ka autorizuar Kuvendi i Kosovës me seancën e vet të përhershme dhe me mënyrën se si do të trajtojnë atë seancë të përhershme. Kjo nuk ka ndodhur me një dokument me shkrim. Me sa di unë, ka qenë një iniciativë, së paku e konsultimeve për një dokument me shkrim mes grupeve parlamentare, por sipas të gjitha gjasave është ndërprerë hartimi i një dokumenti të përbashkët me shkrim për ndonjë arsye për të cilat nuk jemi të informuar.

Përmbledhja e kësaj pike është se kemi hyrë prej një faze në fazën tjetër negociatore pa një qartësi në Kuvendin e Kosovës. Nuk mund të kërkohet qartësi më e madhe nga Ekipi Negociator seqë ekziston në Kuvendin e Kosovës. Bile unë mendoj se mënyra se si është paraqitur Ekipi i Unitetit ka qenë shumë më e qartë, shumë më unisone seç kemi dëgjuar këtu në debatet e Kuvendit të Kosovës, bile edhe në debatet nga e njëjta parti.

Çështja e dytë, është kontesti kohor. Çdo ditë që do të kalojë, po e përsërisë, do të jetë më e vështirë se dita e kaluar në përcaktimin e statusit. Me qenë se kemi hyrë në një fazë e cila nuk ka një rrjedhë logjike të veten, me përfundim të legalitetit çfarë e ka pasur rruga e kaluar me presidentin Ahtisari, atëherë çdo pikë tjetër që na pret, çdo ditë tjetër që na

pret, do të kërkojë më shumë konsultim, do të kërkojë më shumë unitet, do të kërkojë një veprim shumë më aktiv.

Çështja e tretë, është se Kuvendi i Kosovës, dhe ky më duket se do të duhej të kishte qenë debati kryesor të cilin duhet ta zhvillojmë në të ardhshmen, duhet të përcaktojë agjendën e vet legislative. Kuvendi i Kosovës me qenë se po hynë në një seancë të përhershme, me qenë se po e njeh gjendjen si gjendje e cila kërkon përkujdesje të veçantë, duhet po ashtu të përcaktojë edhe një agjendë legislative të vet edhe aty debati fundamental i këtij Kuvendi është të përkthehet në ligj e kushtetutë paketa e Ahtisarit, apo jo, dhe këtu ishin mendimet të ndryshme. Kuvendi i Kosovës duhet ta ketë një përcaktim të përbashkët rreth kësaj. Unë besoj që Presidenti Sejdiu në fjalën e vet dhe të gjithë ne paraqitëm argumentet tona pse duhet të vihet në agjendën legislative, por ky është në fund vendimi i Kuvendit, jo i Ekipit të Unitetit.

Konteksti kohor, u fol disa herë dhe dua të sqaroj edhe njëherë. Këtu u fol për 120 ditë, mund të jenë 180, mund të jenë 190. Atë proces nuk e menaxhojmë ne. Atë që mund ta menaxhojmë, është agjenda jonë dhe përcaktimi i agjendës sonë kohore. Dhe këtë jemi përpjekur ta bëjmë në përgatitje të rrugës për Uashington edhe në vetë Uashingtonin. Sa për sqarim, se duhet të sqarohemi para anëtarëve të Kuvendit të Kosovës, angazhimi që Kosova të përmbushë ose Kuvendi t'i përmbushë obligimet ndaj qytetarëve të vet në fund të vitit, nuk ka hasur në reagim negativ. Ajo çka ka hasur është kërkesë që të mos ndërmerren hapat të cilat nuk bëhen në konsultim me Bashkësinë Ndërkombëtare, e këtu ekziston një dallim esencial. Kosova ka kërkuar të jetë partnere në Uashington dhe Kosova ka marrë premtim të partneritetit. Nuk e ka bërë njëri, e ka bërë Ekipi i Unitetit si tërësi. Ekipi i Unitetit është kthyer me dorën e partneritetit, e jo njëri apo tjetri anëtar i këtij Grupi.

Dhe, çështja e tretë që lidhet me takimin me zonjë Rajs ka qenë çështja e zgjedhjeve. Ajo çështje as që ka mund të vihet në debat, sepse ajo tashmë është konsumuar nga vetë Grupi i Unitetit. Ne kemi dalë me propozimin konkret për zgjedhje, natyrisht, për çështje e cilat duhet të vendoset edhe në nivelin e Kryeadministratorit. Krejt në fund, Ekipi i Unitetit ka qenë më i bashkuar në Uashington dhe këtu në Prishtinë, në Kuvendin e Kosovës, seç ka mundur të përjetohet nga vet Kuvendi i Kosovës.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, zotëri Surroi! Zoti Thaqi urdhëroni!

HASHIM THAQI – Faleminderit, zoti Kryetar Berisha,

Të nderuar deputetë,

Fillimisht dëshiroj që t'ju falënderoj për të gjitha diskutimet që kanë qenë në shërbim të përsheptimit të angazhimeve tona dhe të ruajtjes së unitetit për arritjen deri në momentin e zyrtarizmit të pavarësisë së Kosovës, të gjithë diskutantët e gjitha partive politike.

Me rëndësi është që kemi diskutuar, kemi debatuar, jeni informuar, ka qenë një proces shumë transparent i opinioneve të ndryshme, por dua të besoj, me qëllimin më të mirë që ky proces historik të përmbyllet sa më shpejtë, sa më suksesshëm dhe plotësisht në përputhshmëri me vullnetin e qytetarëve të Kosovës për shtetin e pavarur dhe sovran.

Dua të potencoj se të gjithë ne pajtohemi dhe kemi punuar dhe e meritojmë, dhe jemi shumë të vendosur që Kosova të pavarësohet dhe se pavarësia e Kosovës është e panegociueshme, gjithashtu, të gjithë ne pajtohemi se Kosova është unike dhe e pandarë dhe ky është qëndrim edhe ndërkombëtar. Gjithashtu, të gjithë ne pa dallime e kemi mirëpritur, e kemi përshëndetur dhe kemi marrë zotime për propozimin e Presidentit Ahtisari, propozimin ndërkombëtar për Kosovën e pavarur dhe sovranë. Mendoj se ky proces i angazhimeve të përbashkëta, i përgjegjësive të përbashkëta, i përgjegjësive të ndara, por edhe shumë unifikuese, ka qenë shembull i mirë i dërgimit të mesazheve për mbështetje të fuqishme të botës demokratike për Kosovën e pavarur dhe sovranë. Sot, kjo përgjegjësi ka bërë që ne të kemi përkrahjen e plotë për pavarësinë e Kosovës nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian e vende të tjera.

Prandaj, strategji Kosova ka pasur, platformë Kosova ka pasur, plan Kosova ka prezantuar dhe kjo strategji, kjo platformë, ky plan është mirëpritur prej komunitetit ndërkombëtar dhe është i kyçur, është i inkorporuar në propozimin e Presidentit Ahtisari për rregullimin shtetëror të Kosovës.

Kosova në këtë proces ka hyrë shumë e vetëdjishme se rruga nuk ka qenë e lehtë, procesi nuk do të jetë edhe pa vështirësi dhe pengesa, por edhe ka hyrë shumë e vendosur se e drejta e saj do të respektohet dhe sot po respektohet. Ne kemi ditur se Beogradi nuk do të pajtohet me pavarësinë e Kosovës, e kemi ditur se edhe Beogradi i ka miqtë e vet që janë kundërshtarë të pavarësisë së Kosovës, por edhe kemi qenë edhe ne të vendosur dhe kemi qenë ata që kemi punuar vazhdimisht që partnerët tanë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian të na përkrahin dhe kjo po ndodhë. Unë mendoj se nuk duhet të ketë hezitime, nuk duhet të ketë dilema për pavarësi. Kemi përkrahjen e fuqishme dhe shumë të qartë e të vendosur edhe të deklaramit të Presidentit Bush, edhe të Bashkimit Evropian. Dhe tash çështja shtrohet se kur do të ndodhë ky vendim, kur do të ndodhë kjo njohje. Prandaj, të jemi të sigurt se ky veprim i përbashkët i politikës kosovare do të jetë veprim dhe mesazh që Komuniteti Ndërkombëtar të shpejtojë nxjerrjen e vendimit dhe njohjen ndërkombëtare për Kosovën e pavarur dhe sovranë.

Tash është më se e vërtetë se ballafaqohemi me realitete të ndryshme, ballafaqohemi me procese të ndryshme që kërkojnë edhe përgjegjësi nga ne, por kur është formuar Ekipi i Unitetit, kur e kemi ndërtuar këtë unitet shtet formues, secili nga ne si parti paksa ka humbur nga vetvetja në shërbim dhe vetëm në shërbim të ndërtimit dhe të zyrtarizmit të shtetit të Kosovës. Prandaj, jemi në momentet e kthesës, të kthesës mund të them vendimtare dhe pozitive, dhe unë besoj se sa më tepër që po afrohet koha e vendimit, ditët do të jenë më të lehta sepse përgjegjësitë tona kanë qenë plotësisht në përputhshmëri me vullnetin e qytetarëve të Kosovës dhe në përputhshmëri me ruajtjen dhe kultivimin e partneritetit tonë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian. Tash, Kosova e ka në fuqi Rezolutën që u përmend këtu edhe të nëntorit të vitit të kaluar të Kuvendit të Kosovës që rikonfirmon vullnetin e qytetarëve të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran. Ajo Rezolutë është në fuqi, do të respektohet dhe Ekipi i Unitetit ka punuar plotësisht në përputhshmëri me këtë rezolutë. Prandaj, Kosova e ka fuqinë e vet vendimmarrëse, Kosova ka mandatarin në kuptimin e plotë të fjalës, e ka Prishtinën dhe nuk ka nevojë për mandat të askujt. Tash u përmend edhe Serbia. Unë sinqerisht nuk

dëshiroj që të humbim shumë kohë me reagimet e Serbisë për Kosovën. Ne kemi hyrë në proces si fitues, sepse kemi fituar luftën, kemi hyrë në proces si të përgjegjshëm dhe po dalim të përgjegjshëm dhe besoj fuqishëm dhe jemi shumë të vendosur në këtë drejtim se do të dalim përsëri fitues në kuptimin e plotë të fjalës, që Kosova do të zyrtarizohet definitivisht si shtet. U potencuan edhe angazhimet paralele që mund të jenë. Ne të gjithë jemi zotuar se pavarësisht prej procesit të statusit apo të zgjedhjeve të rregullta, Parlamenti i Kosovës, duke qenë të gjitha partitë e fokusuar për ndërtimin e shtetit të Kosovës, para së gjithash do të jetë funksional deri në momentin e duhur dy, tri ditë para ditës së zgjedhjeve, por edhe ekipi i Unitetit do ta ruaj kontinuitetin veprues, unifikues në mënyrë që të jetë i përgatitur, të jetë unik, i përgjegjshëm për çdo rrethanë dhe realitet të ri që mund të krijohet, por edhe rrethanat e tjera që mund të jenë. Natyrisht, zhvillimi i demokracisë e ndihmon përshtetimin e vendimit. Vakumi institucional që mund të krijohet, pastaj edhe deficitin demokratik, e dëmtojnë ndërtimin e shtetit.

U diskutua këtu edhe për çështje të tjera që sigurojnë dhe garantojnë stabilitet e zgjedhje të lira. Kushtetuta e shtetit të Kosovës, simbolet shtetërore të Kosovës sjellin stabilitet, sjellin unitet, sjellin perspektivë dhe përgjegjësi të re nga ana jonë. Dua të potencoj se Kosova ka përfaqësuesit legjitim të zgjedhur dhe të mandatuar dhe assesit nuk duhet lejuar që të kërkohet suprimimi i institucioneve të zgjedhura nga vota e qytetarëve. Kjo është e rrezikshme, nuk dua të ndodh e nuk do të lejojmë që të ndodh. U përmend se duhet që Kosova të jetë një realitet i prekshëm. Unë dua të ritheksoj se realitet më i prekshëm sesa realiteti funksional i Kosovës si shtet nuk ka, por edhe përkrahja e fuqishme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës e të Bashkimit Evropian dhe të vendeve të tjera dhe në këtë proces nuk do të kthejmë prapa, por ecje përpara.

Prandaj, dua të potencoj se ky është një angazhim i përbashkët, është një përgjegjësi e përbashkët dhe jam shumë optimist se ne do t'ia dalim, por duhet të ruhet ky unifikim i qëndrimeve tona, i qëndrimeve që janë në përputhshmëri të plotë me vullnetin dhe sakrificën e qytetarit të Kosovës dhe vizionin tonë perëndimor dhe çështja se kur do të ndodhë pavarësia do të vendoset shpejtë. Ne do të jemi të përgatitur, do të jemi unik. Faleminderit për gjitha diskutimet, kuptimin e mirëkuptimin dhe mbështetjen e procesit për të ardhmen e Kosovës shtet të pavarur dhe sovran. Faleminderit!.

KRYETARI KOLË BERISHA – Faleminderit, zoti Thaqi! Ftoj Kryeministrin Çeku ta marrë fjalën.

AGIM ÇEKU – Faleminderit, zoti Kryetar. Të gjithë po thonë që do të përpiqen të jenë të shkurtër dhe nuk po janë. Unë vërtet do të përpiqem që të jem i shkurtër.

Faleminderit për debat, debati ishte shumë konstruktiv. Faleminderit për mbështetje dhe shumica nga ju e mbështetën Grupin e Unitetit, mbështetje e qartë që për ne është shumë e rëndësishme apo esenciale. Dua të jap vetëm disa sqarime. Disa deputetë në diskutimet e tyre ju referuan një qasjeje ndryshe që mund ta kem unë si anëtar i Grupit të Unitetit. Aq më tepër, deputeti Limaj kërkoi edhe sqarim të platformës, siç tha, të kryeministrit nëse e ka.

Në këtë debat jemi ftuar si Grup i Unitetit dhe nuk jam i ftuar si Kryeministër, kështu që në këtë debat edhe unë jam me kapacitet anëtar i Grupit të Unitetit. Si Grup i Unitetit

kemi ardhur me qëndrim unik dhe Presidenti fjalën e nisi me fjalinë në emër të Grupit të Unitetit, do me thënë qëndrimet që i ka paraqitur Presidenti janë qëndrime të Grupit të Unitetit. U tha edhe më përpara se të gjithë ne, pa marrë parasysh se çfarë detyre kryejmë, të drejtën e vendimmarrjes e kemi deleguar sa i përket çështjes së statusit, të gjithë e kemi deleguar në Grupin e Unitetit edhe në këtë debat, por deri në marrjen e vendimeve të gjithë kemi të drejtë të japim propozime, të shpalojmë platforma dhe të vijmë krejt me qëllim që me ardhur te një vendim, te një qëndrim i përbashkët dhe më i fuqishëm. Po, e përmenda në fjalën time, por desha t'i shmangem sa më shumë gjatë debatit se kam pasur një qëndrim të tillë, është bërë edhe publik ky qëndrim. Ka pasur dhe krejt kjo me qëllim që të gjetjes së një platforme të përbashkët për të pasur një qasje të re, një qasje ndryshe sepse ka ndryshuar procesi. Procesi i definimit të statusit në Këshillin e Sigurimit dështoi dhe e pamë më herët se do të dështojë.

Bashkësia Ndërkombëtare për një moment u gjend para dilemave se si të procedojë më tutje, çfarë të bëjë, sa do të zgjasë, çfarë hapash, çfarë modalitetesh në definimin e statusit dhe në këtë kërkim të përgjigjeve ne deshëm që ta kemi zgjidhjen tonë, deshëm që të jemi, bëhet fjalë për ne, për të ardhmen tonë, për vendin tonë, për popullin tonë, të jemi përfaqësues legjitim të këtij populli dhe duhet ta ndihmojmë. Krejt kjo me qëllim që ta ndihmojmë Bashkësinë Ndërkombëtare. Treguam gatishmëri, treguam se kemi ide, vizion, gatishmëri të marrim përgjegjësi dhe ta ndajmë përgjegjësinë, ta ndajmë barrën me Bashkësinë Ndërkombëtare e të hapim rrugë. Kjo rrugë e ka një emërues të përbashkët që po kontestohet nga shumë kush dhe u kontestua kështu sot caktimi i datës. Esenca e kësaj qasjeje është caktimi i datës, jo caktimi i datës si ultimatium ndaj Bashkësisë Ndërkombëtare, por si kërkesë e vazhdueshme për qartësi, për afatizim.

Dhe, vërtet unë mendoj dhe ky debat, më vjen keq, por nuk më ka bindur që e kam gabim për një kërkesë të tillë. Data është e nevojshme, sjell qartësi, sjell afatizim të procesit. Tjetër, na lehtëson punën në bisedime, e dimë, e kemi një vendim të Parlamentit, në qoftë se Parlamenti e ka caktuar një datë. Ne e dimë ku po shkojmë dhe dimë deri ku do të shkojmë dhe kemi një pozicion shumë komod në bisedime. Na mundëson që ta kemi një planifikim shumë detaj, kishim mund ta bëjmë planin ditor, çdo ditë çka do të bëjmë, cilin ligj do ta miratojmë, cilin takim do ta kemi, kur do të takohemi me NATO-n, kur me SHPK-në, kur me doganat, kur ta përgatisim Kosovën për atë datë. Dhe ajo çka është më e rëndësishmja që më ka shty të mendoj për datë, është që e bëmë vetë, është propozim i yni, është vendim i yni, i Parlamentit dhe kjo është me rëndësi. Gradualisht ne po na inponohet një fakt që ndoshta do të mbetet në histori që Bashkësia Ndërkombëtare ne na solli këtë, na solli atë, na solli lirinë, na solli pavarësinë. Fakt historik është që Bashkësia Ndërkombëtare na ndihmoi, na ndihmoi. Është kah na ndihmon ta na vijë pavarësia, por edhe jemi me fat që i kemi këta miq, në radhë të parë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por jemi edhe meritore vetë që i kemi këta miq, sepse kemi sakrifikuar, kemi punuar, u kemi prirë proceseve dhe ideja e caktimit të datës është prirje e proceseve, se na e bëmë, Bashkësia Ndërkombëtare na mbështeti, na njohu. Nuk mjafton, mendoj, që në këtë periudhë të gjetjeve të modalitete të ecjes përpara në këtë pjesë të procesit ne themi se kemi besim në ju dhe ne kemi ende durim. Dhe nuk ka dilema, as nuk kam dilema, asnjëri prej nesh nuk ka dilema, por Kosova do të jetë e pavarur. Por një qasje e tillë është një vendim i vështirë, vendimet e vështira nuk bëhen

më të lehta duke i shtyrë, duke i prolonguar dhe çdo ditë që ne po tregojmë gatishmëri për të pritur, atëherë Bashkësisë Ndërkombëtare nuk po i ngutet fort, nuk po i ngutet fort.

Kështu që, është e vërtetë, unë dua ta sqaroj pak një plan që e kam të shkruar këtu, çka thotë ky plan, po edhe një koment. U tha këtu më herët që është një agjendë personale dhe është një politikë koti. Agjendë personale nuk është, politikë koti ndoshta është, derisa nuk ka mbështetje, atëherë është kot. Agjendë personale nuk është se unë këtë e kam propozuar me qëllim që të vishet ky plan me identitetin e Grupit të Unitetit dhe Grupi i Unitetit ta sjell këtu në këtë Parlament dhe rubrika e parë shkruan: “Menjëherë pas kthimit nga Uashingtoni...”, çka do të thotë se përpjekja ka qenë që ky plan të harmonizohet me Uashingtonin, do të thotë në seancën plenare Ekipi i Unitetit, jo Kryeministri, t’i drejtohet Kuvendit dhe të propozojë planin dhe Kuvendi i Kosovës e nxjerr një deklaratë të propozuar nga Ekipi i Unitetit në aneks të këtij planit me të cilin caktohet data deri kur Kosova mund të pret për shpalljen e pavarësisë. Në qoftë se Bashkësia Ndërkombëtare edhe më herët vjen deri te një zgjidhje, është më se e mirëseardhur, por ne po i japim hapësirë së paku 120 ditë Bashkësisë Ndërkombëtare të punojmë bashkë me ta në gjetjen e zgjidhjes dhe në qoftë se e gjejmë më herët, aq më mirë, d.m.th. deri kur Kosova mund të pret dhe atëherë do ta shpallë pavarësinë dhe do ftojë Bashkësinë Ndërkombëtare ta njohë pavarësinë. Dhe atëherë e kemi një periudhë të angazhimit të përbashkët me Bashkësinë Ndërkombëtare, periudhën që të gjithë u pajtuam. Shumë kush nga ju tha, çka do të bëjmë ne 120 ditë? Jemi të gatshëm të bisedojmë me Bashkësinë Ndërkombëtare, të takohemi edhe me Serbinë, me këdo dhe t’ia shpjegojmë procesin, të japim garanci të nevojshme, t’i japim mesazhe pozitive se kjo është një zgjidhje e mirë e pranueshme për të gjithë. Ta miratojmë Kushtetutën, simbolet, ligjet, planin e tranzicionit, të takohemi me UE, por me rëndësi është edhe plani që të takohemi me KFOR-in, me SHPK-në dhe t’i definojmë mënyrat e menaxhimit të kufijve në këtë periudhë dhe të situatës së sigurisë, sidomos në veriun e Kosovës etj. etj.

Dhe, në qoftë se deri në datën e caktuar, datë të cilën e cakton ky Kuvend, nuk ka zgjidhje të statusit, atëherë Kuvendi në një seancë të veçantë, seancë solemne të Kuvendit të Kosovës bëhet shpallja e pavarësisë, miratimi i Kushtetutës atë ditë, miratim formal, deri atëherë kemi përfunduar punën, miratimi i simboleve, miratimi i të gjitha ligjeve të pakos të Ahtisarit dhe manifestimi qendror për pavarësi. Ky është shkurtimisht plani.

Unë nuk kam dyshim, kam besim faktikisht, se ky plan do të ishte mbështetur. Pse do të ishte mbështetur? Sepse Kosova do të ishte njohur pas shpalljes së pavarësisë, sepse nuk ka asnjë arsye pse të mos njihej, sepse kjo shpallje do të bëhej mbi bazat e propozimit të Ahtisarit. Propozimet e Ahtisarit vetëm dy vende në botë nuk e kanë përkrah: Rusia dhe Serbia. Ka munguar një akt legal legjitim për ta njohur pavarësinë dhe ne jemi Parlament legjitim dhe Rezoluta e Parlamentit mund të shërbej edhe si akt legal.

E dyta, jemi pajtuar që të jetë pavarësi e mbikëqyrur. E ftojmë, e mirëpresim Bashkësinë Ndërkombëtare në Kosovë, NATO-n edhe Unionin Evropian,

E treta, po i vendosim të gjithë mekanizmat për mbrojtjen dhe akomodimin e komuniteteve në Kosovë etj. etj. Të gjitha kërkesat e Bashkësisë Ndërkombëtare ne po i implementojmë dhe situata nuk është sikur në të 90-në, si e tha Ramadani. Atë ditë Kosova do ta ketë Kushtetutën e vetë bazuar në dokumentet ndërkombëtare, simbolet e veta, ligjet e veta, Kosova i ka institucionet e veta legjitime, Parlamentin, Qeverinë etj. Etj., të gjitha ministritë, Kosova i ka institucionet e sigurisë, i ka 8.000 policë, i ka doganat, shërbimin korrektues, e ka TMK-në, shërbimin emergjent. Është shumë me rëndësi që Kosova e ka buxhetin e vet, buxhetin i cili mbushet tërësisht nga të hyrat vetanake d.m.th që mund të mbijetojë një kohë deri te njohja ...

KRYETARI KOLË BERISHA – Faleminderit, anëtar i Grupit të Unitetit. Ftoj Presidentin e Kosovës ta marrë fjalën.

PRESIDENTI FATMIR SEJDIU – Faleminderit, zoti Kryetar. Ju faleminderit për debatin e thellë, e them, mjaft të sinqertë, të nderuar deputetë. Një debat që është i nevojshëm që Parlamenti i Kosovës ta ketë në vazhdimësi dhe që është, po ashtu, në një temë edhe në një proces tepër të rëndësishëm.

Ajo që dua të them ishte se nga kjo seancë mund të konkludojmë emëruesin e përbashkët se Kuvendi i Kosovës, si institucioni më i lartë i vendit, ka përkushtimin e tij të thellë që procesin e filluar të pavarësisë së Kosovës dhe që është edhe i brezave të mëhershëm, do ta përfundojë duke kontribuar maksimalisht me gjithë mekanizmat e tij, pra bashkë edhe me Ekipin e Unitetit, dhe në veçanti në një partneritet të sinqertë dhe të suksesshëm me të gjithë miqtë e Kosovës, them për vendet veç e veç, dhe të gjithë mekanizmat ndërkombëtarë që e kanë kuptuar shumë thellë që çështja e Kosovës paraqet një nga sfidat më të drejtpërdrejta dhe më me peshë në Evropën Juglindore që duhet të mbyllet si duhet dhe që duhet të mbyllet konform vullnetit politik të popullit të saj.

Është shumë e rëndësishme që debatet të bëhen në Kuvend dhe që Kuvendi të ndërtojë politikat themelore që do të jenë busull orientimi në këtë rast për Ekipin e Unitetit, që do të jenë busull orientimi edhe për mekanizmat qeveritarë në pjesën e përmbushjes së obligimeve që jemi zotuar se do të ecim përpara dhe me një qëllim themelor për të shkurtuar rrugën tonë edhe për procesin e statusit, por edhe për procesin e sfidave të reja që do t'i kemi para vetes, integriteteve Euroatlantike. Prandaj, Kosova e ka këtë shans në këtë kohë të vështirësive objektive që të bëjë edhe këtë hap paralel dhe që me seriozitetin e saj, sikur që e ka dëshmuar në procesin e gjertanishëm, ta dëshmojë edhe në këtë pjesë të ecjes së saj që do të cilësohet po kështu si pjesë e ecjes dhe e ndërtimit dhe e zhvillimit shtetformues të Kosovës.

Shikohemi, flas nga analizat që i marrin dhe i bëjnë dashamirët e Kosovës dhe që janë kritik të thellë të proceseve, jo në kuptimin për të bërë qefin, apo për të qitë zënkën. Po shikohemi krahas krejt pengesave që i kemi me një admirim të veçantë, për rrugën, për mënyrën, për qasjen që kemi pasur për unitetin e rëndësishëm që kemi mbajtur dhe do ta mbajmë në përmbyllje të këtij procesi të rëndësishëm, për të krijuar, po kështu, paralelisht shansin e konkurrencës së projekteve politike në ecje të mëtejshme në

demokracinë që do ta ndërtojë Kosova dhe që do të ecë në thellësi të saj, sepse s'gjej sot asnjë vend që ka përfunduar me këtë proces të rëndësishëm.

Është e natyrshme që në Kuvend krahas këtyre politikave, të vijmë sikur edhe sot, dhe do të vijmë edhe nesër dhe herëve të tjera, për të prezantuar pozicionet se deri ku i kemi mbërri në kuadër të asaj politike gjenerale që udhëheqet këtu. Por kini, sikur që edhe shprehët besimin, po kështu besim në Ekipin e Unitetit se ka edhe momente të cilat duhet t'i operojmë në cilësinë e një ekipi, në cilësinë e një formacioni që ka marrë barrë dhe është përgjegjësi e jona që pikërisht buron edhe nga Rezoluta e nëntorit 2005 dhe nga politika jonë e përgjithshme që t'i referohem dhe që ta kem busullën qendrore të orientimeve tona nga e cila nuk ka shmangie. Këtë e themi edhe këtu në Prishtinë, këtë e kemi thanë edhe në Vjenë, këtë e themi edhe në Uashington, e themi edhe në Bruksel edhe në Berlin dhe gjithkund tjetër. Prandaj, është pjesë e borxhit tonë aktiv që të ecim në realizimin e këtij projekti të rëndësishëm që do ta bëjmë, ripërsëris, me miqtë tanë.

Është e drejtë e anëtarëve të Ekipit të Unitetit brenda formacionit që e kemi që të japin ide, por është edhe obligim paralel që vendimet që i marrim, vendimet që i përmbledhim, t'i respektojmë. Nuk kemi agjenda personale. Kemi një agjendë të formacionit të përbashkët për të prezantuar këtu para vetvetes dhe në agjendën tonë është po kështu e rëndësishme, që në këto momente të nxitjes së veprimeve tona që sa më me urgjencë të kryhet ky proces, në festën e pavarësisë së Kosovës t'i kemi edhe miqtë tanë. Këtë e them me një kuptim plus, t'i kemi ata që kanë ndihmuar Kosovën në vitet më të vështira, në orët më të liga të saj, t'i kemi ata që i quajmë partnerë, t'i kemi ata që e mbrojnë Kosovën nga oguret e vazhdueshme që i sillen përreth, t'i kemi ata që e duan dhe e kanë shtrirë dorën për Kosovën që të ecim në integritet euroatlantike dhe nuk janë të paktë. Prandaj, për ne është me rëndësi që kjo pjesë e qasjes sonë të kuptohet në dinjitetin e vetë, jo në kërkimin e lëmshës, jo në përuljen, por në ecje normale, në bashkëpunim të sigurt dhe të thellë dhe në besim reciprok. Prandaj, kemi bërë këto veprime, do t'i bëjmë edhe në periudhën që e kemi para vetes, po kështu, po them dhe po ripërsërisë, me një nevojë të bashkëveprimit dhe të bashkërenditjes në momentet kyçe që do t'i kemi para vetes. Ne e kemi kornizuar një platformë gjenerale, apo të përgjithshme, që e prezantuar edhe këtu sot. Ka qenë, t'ju them realisht, edhe bisedë e prezantuar edhe në takimet që i kemi pasur në këtë periudhë të fundit dhe askush dhe asnjë qendër e rëndësishme nuk ka mohuar të drejtën tonë t'i qasemi kësaj problematike. Është po kështu me rëndësi, që në këtë pjesë të strategjisë së mëtejshme të ecjes, të bëjmë hapa të kujdesshëm, hapa serioz që mund dhe dimë t'i bëjmë.

Një çështje që u shtrua në kuadër të proceseve që i lëvizim bashkë, çështja e zgjedhjeve ishte një nga pyetjet apo pjesë e debatit që u lëshua me të drejtë, them, nga deputetët. Ekipi i Unitetit ka vlerësuar, keni parasysh këtë cilësi, se në Kosovë ka nevojë dhe duhet të respektohen proceset demokratike në ecjen e tyre normale. Kjo është formula e parë që i dedikohet edhe procesit të zgjedhjeve. Ekipi i Unitetit, po kështu paralelisht vlerëson, se procesi i statusit është procesi kryesor të cilit i subordinohen të gjitha proceset e tjera. Prandaj, këtu jemi të punojmë, të bashkërendojmë dhe të bashkëveprojmë për të mirën e Kosovës edhe në momentet delikate, posaçërisht kur ka edhe këso temash, sepse vërtet do t'i kthehem ndoshta një qasjeje të hershme që e ka pasur Presidenti Ahtisari edhe që e ka

zënë esencën e përcaktimit të Kosovës si fenomen sui-generis. Kosova është me historinë e saj sui-generis, është me gjenezën e saj sui-generis, është me rrugëtimin e saj sui-generis, është me ndërtimin e saj sui-generis, është me intervenimin ndërkombëtar sui-generis, është me përjetimet e saja sui-generis, është me këtë kualitet të jetës që kemi ecë dhe kemi lëvizur fuqishëm në këtë periudhë krahas krejt problemeve që kemi është sui-generis, prandaj e ka edhe vlerësimin se e meriton plus krahas të drejtës apo parimit të drejtës vetëvendosjes që të jetë shtet i pavarur dhe sovran. Prandaj, do ta bëjmë Kosovën shtet të pavarur dhe sovran, do ta bëjmë me miqtë tanë, do ta bëjmë me punën tonë. Ju faleminderit shumë!

(Duartrokitje)

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, zoti President. Falënderoj të gjithë deputetët, kolegët që me diskutimet e tyre kontribuan dhe rekomandimet, vërejtjet dhe sugjerimet që u dhanë do të jenë pjesë e punës së Ekipit të Unitetit. Falënderoj të gjithë ata që përcollën punimet e këtij Kuvendi. Mirupafshim!

(Mbyllja e seancës)

